66	3310	Buxheti Gjyqesor	3	Costot locale		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
66	3320	Veprimtaria Gjyqesore	1	Çelje nga buxheti	72300	68223.05	12200	9623.55	16300	12161.38	0	0	0	0	1700	1673.61	753.6	753.6	0	0	4000	3922.05	107253.6	0
66	3320	Veprimtaria Gjyqesore	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	8759.2	0	227.56	0	0
66	3320	Veprimtaria Gjyqesore	3	Costot locale		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
67	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti	32820	32753.54	5210	5183.79	13747	11018.22	0	0	0	0	113	112.7	301.35	301.35	0	0	4000	3956	56191.35	0
70	4940	Kontigjence per rualtjen e deficitit	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
70	4980	Shpenzime te tjera	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1700000	1450000	0	0	0	0	1700000	0
73	1610	Veprimtaria administrative e institucionit	1	Çelje nga buxheti	73000	64701.22	11300	10308.42	31460	28784.01	0	0	0	0	300	243	240	240	0	0	33000	32941.16	149300	0
73	1620	Administrimi i zgjedhjeve te Pergjithshme dhe Vendore	1	Çelje nga buxheti	269000.01	263931.79	8000	7946.97	398290	393171.84	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	675290.01	0
73	1620	Administrimi i zgjedhjeve te Pergjithshme dhe Vendore	5	Nga te ardhurat e veta		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
75	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
76	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti	101820	97043.67	15880	12925.33	20260	16414.44	0	0	0	0	0	0	240	240	0	0	3000	2972.39	141200	0
76	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
77	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
77	4110	Çështje të përgjithshme ekonomike dhe tregtare	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
77	4120	Mbikqyrja e Tregut dhe Garantimi i Konkurrences	1	Çelje nga buxheti	45641	45383.79	7000	6894.74	12060	11318.84	0	0	0	0	0	0	1051.1	1031.1	0	0	1000	988.2	66752.1	0
77	4120	Mbikqyrja e Tregut dhe Garantimi i Konkurrences	3	Costot locale		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
78	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti	35053.41	35053.41	4299.12	4299.12	22315.1	22315.1	0	0	0	0	0	0	270	270	0	0	0	0	61937.63	0
78	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	43597	0	0
78	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	5	Nga te ardhurat e veta		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
78	1140	Sherbime te Pergjithshme Publike IV	1	Çelje nga buxheti	14957.1	14957.1	2538.12	2538.12	1139.67	1139.67	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	18634.88	0
78	1150	Sherbime te Pergjithshme Publike III	1	Çelje nga buxheti	38397.36	38397.36	6468.81	6468.81	3525.04	3525.04	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	48391.21	0
78	1150	Sherbime te Pergjithshme Publike III	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2384.54	0	0
78	1150	Sherbime te Pergjithshme Publike III	3	Costot locale		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3532.14	3532.14	3532.14	0
78	1150	Sherbime te Pergjithshme Publike III	4	TVSH, Detyrim Doganor		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	359.56	359.56	359.56	0
79	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
80	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
80	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	5	Nga te ardhurat e veta		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
82	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti	6000	4150.34	1200	665.19	3600	1855.4	0	0	0	0	400	318.2	0	0	0	0	1000	335.88	12200	0
82	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	5	Nga te ardhurat e veta		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
83	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
85	3520	Veprimtaria Informative Shteterore	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
86	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
87	1130	Shërbime të përgjithshme publike	1	Çelje nga buxheti	48700	47999.69	9000	7627.98	13200	7217.71	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	146627.35	133222.57	217527.35	0
87	1130	Shërbime të përgjithshme publike	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
87	1140	Sherbime te Pergjithshme Publike IV	1	Çelje nga buxheti	51388.69	5713.19	10302.09	1822.15	268312.94	236377.66	0	0	0	0	4927.48	0	0	0	7600	192	238090.47	175341.56	580621.67	0
87	1140	Sherbime te Pergjithshme Publike IV	3	Costot locale		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
87	1140	Sherbime te Pergjithshme Publike IV	4	TVSH, Detyrim Doganor		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
87	1150	Sherbime te Pergjithshme Publike III	1	Çelje nga buxheti	241746.4	191269.28	45027.96	30263.29	148325.91	84319.12	0	0	0	0	0	0	282.3	268.58	30057.78	27220.8	153158.19	142330.81	618598.53	0
87	1150	Sherbime te Pergjithshme Publike III	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	20000	0	20000	0
87	1160	Sherbime te Pergj. Publike II	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
87	1160	Sherbime te Pergj. Publike II	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
87	1320	Sherbime te tjera te pergjithshme	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	113978.76	110545.25	0	0	0	0	0	0	0	0	34000	15697.65	147978.76	0
87	1330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike	1	Çelje nga buxheti	39220.3	13113.66	11471.96	2150	30903.6	11161.24	0	0	0	0	1230	0	0	0	2200	192	28518.72	19500.87	113544.58	0
87	1330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
87	1330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike	5	Nga te ardhurat e veta		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
87	1510	Sherbime per Kerkim-Zhvillimin, Teknologjine dhe Inovacionin	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
88	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti	13743	13686.25	2600	2268.81	6300	6255.21	0	0	99700	98500	0	0	30	30	0	0	1000	656.4	123373	0
88	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
89	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti	36700	35916.94	6400	5741.83	19660	19206.2	0	0	0	0	100	83.04	290	290	0	0	2500	2379.6	65650	0
89	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
89	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	4	TVSH, Detyrim Doganor		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
91	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti	22700	19130.88	5100	3168.27	9760	5141.9	0	0	0	0	0	0	370	320	0	0	6000	3999.6	43930	0
92	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti	17500	14916.56	2803	2241.84	13000	8922.07	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1000	0	34303	0

92	1520	Veprimtaria Akademike	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
93	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti	109524.47	109524.47	17413.07	17413.07	103780.91	103489.89	0	0	0	0	211.58	211.58	582.6	582.6	0	0	2073.2	2073.2	233585.83	0
93	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4119111.3	0	1275714.8	0	0
93	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	3	Costot locale		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
93	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	4	TVSH, Detyrim Doganor		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
93	4320	Mbeshtetje per Energjine	1	Çelje nga buxheti	6066.09	6066.09	1168.93	1168.93	84518.49	84518.49	0	0	1000000	1000000	0	0	0	0	22500	22500	1351200	1351200	2465453.51	0
93	4320	Mbeshtetje per Energjine	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	232394.83	595000	144182.98	595000	0
93	4320	Mbeshtetje per Energjine	3	Costot locale		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2134.28	2134.28	0	0	2134.28	0
93	4320	Mbeshtetje per Energjine	4	TVSH, Detyrim Doganor		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	20124.75	20124.75	7654.01	7654.01	27778.76	0
93	4430	Mbeshtetje per Burimet Natyrore	1	Çelje nga buxheti	95990.45	95990.45	15989	15989	17118.77	17118.77	0	0	0	0	0	0	547.5	547.5	45533.85	45533.85	55283.33	55283.33	230462.89	0
93	4430	Mbeshtetje per Burimet Natyrore	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	25000	0	0	0	25000	0
93	4430	Mbeshtetje per Burimet Natyrore	5	Nga te ardhurat e veta	3896.65	3896.65	800	800	1802.48	1802.48	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6499.13	0
93	4440	Mbeshtetje per industrine	1	Çelje nga buxheti	125487.06	125487.06	21454.94	21454.94	50766.27	50766.27	0	0	0	0	0	0	110.05	110.05	0	0	72647.01	72647.01	270465.33	0
94	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti	90844.13	90844.13	14046.06	14046.06	197506.34	197506.34	0	0	0	0	0	0	728.82	728.82	0	0	29986.17	29986.17	333111.52	0
94	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	4	TVSH, Detyrim Doganor		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
94	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	5	Nga te ardhurat e veta		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
94	4760	Turizmi	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
94	4760	Turizmi	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
94	4760	Turizmi	5	Nga te ardhurat e veta		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
94	6180	Planifikimi Urban	1	Çelje nga buxheti	467065.8	467065.8	77043.45	77043.45	100332.42	100198.01	0	0	0	0	0	0	266504.89	266462.8	40847.83	39365.94	126913.99	126913.99	1078708.38	0
94	6180	Planifikimi Urban	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	316914	136544.37	908.9	947.39	317822.9	0
94	6180	Planifikimi Urban	3	Costot locale		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
94	6180	Planifikimi Urban	4	TVSH, Detyrim Doganor		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	18712.87	18712.87	18712.87	0
94	6180	Planifikimi Urban	5	Nga te ardhurat e veta		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
94	6210	Programe Zhvillimi	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5952461.4	5952461.39	5952461.4	0
94	6220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
94	6220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	4	TVSH, Detyrim Doganor		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
95	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti	21850	21492.35	3150	3103.38	10000	6963.15	0	0	0	0	0	0	50	50	4274.5	4274.5	5725.5	1604.55	45050	0
99	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
99	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	5	Nga te ardhurat e veta		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
99	4240	Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	1197329.9	797329.9	0	0	0	0	0	0	0	0	1197329.9	0
99	4260	Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	170455.51	170455.51	0	0	0	0	0	0	0	0	170455.51	0
99	4520	Rrjeti rrugor	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	547726.91	547726.91	0	0	0	0	0	0	0	0	547726.91	0
99	4530	Studimet rrugore	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
99	4960	Ndermjet llogarive ne gender	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	14546913.09	14541913.09	0	0	0	0	0	0	0	0	14546913.09	0
99	4960	Ndermjet llogarive ne gender	2	Financim i huaj		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
99	6260	Sherbimet Publike Vendore	5	Nga te ardhurat e veta		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
99	6370	Furnizimi me Uje dhe Kanalizime	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
99	7220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
99	8140	Zhvillimi i Sportit	5	Nga te ardhurat e veta		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
99	9120	Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollorollorin)	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	4404867.03	4404867.02	0	0	0	0	0	0	0	0	4404867.03	0
99	9120	Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollorollorin)	5	Nga te ardhurat e veta		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
99	9230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	918886.53	918886.53	0	0	0	0	0	0	0	0	918886.53	0
99	1043 0	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	66984.54	66984.54	0	0	0	0	0	0	0	0	66984.54	0
99	1091 0	Emergjencat Civile	1	Çelje nga buxheti		0	0	0	0	0	0	0	939514.75	919514.75	0	0	0	0	0	0	0	0	939514.75	0
4	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	8	Granti i Universitarit, Spi		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4	4130	Mbështetje për zhvillimin ekonomik	8	Granti i Universitarit, Spi	39041.61	39041.61	6384.87	6384.86	840	840	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	46266.48	0
4	4160	Shërbimi i tregtieve, akreditimi dhe inspektimi	8	Granti i Universitarit, Spi		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	4540	Transporti Detar	8	Granti i Universitarit, Spi		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
10	4130	Mbështetje për zhvillimin ekonomik	8	Granti i Universitarit, Spi	5601.62	4107.03	1082.93	671.58	970.07	322.37	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7654.62	0
11	9450	Arsimi Universitar	8	Granti i Universitarit, Spi	4944783.78	4882443.4	759042.88	741338.13	171944.59	159644.39	0	0	0	0	1016	488.09	7759.03	7566.6	0	0	0	0	5884546.28	0
11	9770	Fonde per Shkencen	8	Granti i Universitarit, Spi		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12	8230	Arti dhe Kultura	8	Granti i Universitarit, Spi		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
13	7330	Sherbimet e Kujdesit Dytesor	8	Granti i Universitarit, Spi	7552543.7	7519366.77	1246352	1229888.47	7777195	7663261.05	0	0	0	0	0	0	12496.3	11269.55	0	0	0	0	16588587	0
13	7450	Sherbimet e Shendetit Publik	8	Granti i Universitarit, Spi		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
16	1160	Sherbime te Pergj. Publike II	8	Granti i Universitarit, Spi		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
18	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	8	Granti i Universitarit, Spi		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
26	4260	Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	8	Granti i Universitarit, Spi		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
28	1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	8	Granti i Universitarit, Spi		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
50	1310	Planfikimi i përgjithshëm dhe shërbimet statistikore	8	Granti i Universitarit, Spi		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
					74,950,031.95	**73,435,011.06**	**12,423,197.74**	**11,897,351.03**	**36,775,031.26**	**34,898,734.98**	**2,353,978.76**	**2,310,459.65**	**88,580,197.20**	**85,185,570.50**	**1,507,352.12**	**1,379,483.01**	**32,119,057.59**	**27,571,392.79**	**2,778,617.82**	**11,889,842.06**	**71,479,355.15**	**63,359,676.98**	**322,966,819.37**	**51,732,956.62**	

Tabela-6-shoqëruese- Shpenzime buxhetore faktike sipas funksioneve të Qeverisë 2017

Te dhena progresive (Progresive Data) *ne milion leke(in million leks)*

Funksionet	Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht Aug	Shta Sep	Tet Oct	Nent Nov	Dhjetor Dec	Functions
TOTAL	**25,634**	**55,791**	**95,189**	**129,825**	**170,448**	**209,595**	**247,392**	**284,982**	**322,603**	**359,883**	**400,978**	**461,410**	**TOTAL**
Sherbimet e Pergjithshme Publike *	5,858	12,311	19,815	25,541	32,503	38,663	46,209	52,661	58,627	65,631	74,718	85,237	General Public Services
Mbrojtja	443	1,016	1,655	2,312	3,206	4,198	5,169	5,994	6,779	7,644	8,505	10,949	Defense
Rendi dhe Siguria Publike	1,644	3,542	5,463	7,439	9,558	11,624	13,855	15,942	18,171	20,443	22,792	26,730	Public Order and Safety
Ceshtjet Ekonomike	883	2,499	8,445	11,731	18,546	23,215	27,223	30,907	35,590	39,644	45,682	53,616	Economic affairs
Mbrojtja e Mjedisit	158	444	739	1,129	1,455	1,757	1,963	2,166	2,444	2,480	2,559	2,857	Environmental protection
Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit	576	2,446	5,799	9,149	12,420	16,182	18,812	21,744	25,345	28,019	30,731	38,250	Housing and community amenities
Shendetesia	2,893	6,082	9,558	12,978	16,472	21,162	24,805	28,872	32,566	36,344	40,151	45,352	Health
Argetimi, Kultura dhe Ceshtjet Fetare	293	667	1,148	1,741	2,425	2,773	3,221	3,711	4,254	4,890	5,386	6,440	Recreation, culture and religion
Arsimi	3,013	6,371	10,182	14,112	18,264	22,324	26,439	30,416	34,339	38,316	42,785	47,914	Education
Mbrojtja Sociale	9,874	20,412	32,384	43,692	55,599	67,697	79,696	92,571	104,488	116,474	127,669	144,066	Social protection

RAPORT
MBI ZBATIMIN E BUXHETIT VJETOR, SITUATËN MAKROEKONOMIKE DHE FISKALE GJATË VITIT 2017

Tiranë, maj 2018

I. ZHVILLIMET NË EKONOMINË SHQIPTARE

I.1 Zhvillimet e fundit ekonomike

Sektori real

Viti 2017 tregoi ritme pozitive dhe përshpejtuese të rritjes ekonomike. PBB-ja reale u rrit me 3.4% në tremujorin e katërt të vitit 2017 krahasuar me 3.6% në tremujorin e tretë. Rritja vjetore e PBB-së arriti në 3.8% në vitin 2017, nga 3.4% që ishte një vit më parë (rritja më e lartë vjetore që nga viti 2008). Kontributin kryesor në këtë rritje e kanë dhënë degët: *Ndërtimi* me +1.04 pikë përqindje; *Administrata publike dhe mbrojtja, arsimi, shëndetësia etj.* me +0.64 pikë përqindje, *Tregtia me shumicë dhe pakicë etj.* me +0.89 pikë përqindje; *Industria dhe Taksat mbi Produktet* me +0.45 pikë përqindje, *Aktivitetet financiare dhe të sigurimit* me +0.32 pikë përqindje.

Nga pikëpamja e shpenzimeve, rritja ekonomike u gjenerua nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet. Konsumi total u rrit me rreth 2.8% në terma real me një kontribut prej rreth 2.5 pikë përqindje në rritjen ekonomike, ndërsa konsumi privat u rrit me rreth 2.9% në terma real. Gjithashtu, *formimi i kapitalit fiks bruto (investimet totale)* gjatë vitit 2017 u rrit me rreth 7.7% duke dhënë një kontribut prej rreth 2 pikë përqindje në rritjen ekonomike të PBB për vitin 2017. Ndërkohë kërkesa e huaj kishte një kontribut negativ në rrittjen totale të vitit 2017 prej rreth 1.1 pikë përqindje në reflektim të peshës së lartë të importeve, megjithëse eksportet e mallrave dhe shërbimeve u rritën më tepër se sa importet.

Tregu i punës reflektoi zgjerimin e vazhdueshëm ekonomik. Në fund të vitit 2017, shkalla e papunësisë ra në 13.6% për popullsinë 15 vjeç e lart, dhe tani është më e ulëta që nga tremujori i parë i vitit 2012. Ritmi vjetor i rritjes së punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart, nga tremujori i katërt i vitit 2016 në tremujorin e katërt të vitit 2017 ishte 3.4% ose me rreth 38 mijë të punësuar. Forca e punës u rrit me 2.4% në terma vjetorë dhe shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore vazhdoi të rritet, duke arritur në 67.4% krahasuar me 65.7% që ishte në tremujorin e katërt të vitit 2016. Në terma vjetor, gjatë vitit 2017 numri i të punësuarve në Shqipëri ishte 1,167,785 persona.

Sektori monetar

Gjatë vitit 2017, *inflacioni mesatar* rezultoi 2.0%, ndërkohë inflacioni i fund-vitit rezultoi 1.8%. Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

(i) "Ushqime dhe pije jo alkoolike" me një rritje vjetore të çmimit prej +2.8%
(ii) "Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji" me një rritje vjetore të çmimit prej +2.2%
(iii) "Transport" me një rritje vjetore të çmimit prej +2.0%

Treguesi i parasë së gjerë, agregati M3, shënoi një normë mesatare rritje vjetore prej 2.5% përgjatë vitit 2017, krahasuar me normën mesatare vjetore të vitit 2016 prej 1.8%. Gjatë muajit dhjetor të vitit 2017, stoku total i kredive bankare pati një rritje me 0.4% krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2016. Stoku i kredive në lekë shënoi rritje prej 5.2%, ndërsa ai në valutë shënoi

rënie prej 3.8%, krahasuar me muajin dhjetor të vitit të kaluar. Pjesa më e madhe e kontributit në rritjen e stokut total të kredisë gjatë kësaj periudhe ka ardhur prej kredive akorduar individëve. *Stoku i kredive* akorduar individëve deri fund te vitit 2017 shënoi rritje prej 5.5% krahasuar me dhjetorin e vitit 2016, duke kontribuar pozitivisht me 1.7 pikë përqindje në ndryshimin e stokut total të kredisë. Përgjatë vitit 2017 rezulton se *monedha shqiptare* ka vazhduar trendin mbiçmues ndaj dollarit amerikan dhe ndaj monedhës evropiane. Përgjatë vitit 2017, kursi i këmbimit Lek/Euro arriti mesatarisht në nivelin e 134.13 për 2017, ndërsa kursi ndaj dollarit Lek/Dollar arriti në 119.05.

Sektori i jashtëm

Eksportet e mallrave për periudhën janar – dhjetor 2017 shënuan një rritje prej 12.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kontributi pozitiv në rritjen e eksporteve totale ka ardhur kryesisht nga kategoritë "Materiale ndërtimi dhe metale" dhe "Tekstile dhe këpucë" me respektivisht 4.9 dhe 4.4 pikë përqindje, si dhe kategoria "Ushqime, pije e duhan" e cila pati një rritje prej 18.7% me një kontribut prej 1.9 pikë përqindje në rritjen totale të eksporteve. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me -1.4 pikë përqindje.

Importet e mallrave për vitin 2017 u rritën me 8.1% krahasuar me vitin 2016. Të gjitha grupet kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, ku grupet që kanë ndikuar më tepër në rritjen vjetore të importeve, janë: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me +2.8 pikë përqindje, "Tekstile dhe këpucë" me +1.2 pikë përqindje, "Produkte kimike dhe plastike" me +1.2 pikë përqindje. Rrjedhimisht, gjatë periudhës janar – dhjetor 2017, deficiti i bilancit tregtar u zgjerua me 5.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 66.3% të gjithë tregtisë. Në fund të vitit 2017, eskportet drejt vendeve të BE-së zenë 78.3% të eksporteve gjithsej ndërsa importet zënë 62.0% të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë Italia, Kina, Greqia dhe Gjermania.

Për vitin 2017, *Bilanci i Pagesave* shënoi rritje duke arritur vlerën +185.4 milionë euro, nga +48 milionë euro që ishte në të njëjtën periudhë të vitit 2016. Ndërsa vetëm për tremujorin e katërt 2017, BP arriti vlerën +215.4 milionë euro, krahasuar me tremujorin e katërt të 2016 që shënoi vlerën +153.4 milionë euro. Për periudhën janar-dhjetor 2017, defiçiti i llogarisë korente u rrit në -814.4 milionë euro krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë që ishte -811.6 milionë euro, ndërsa Llogaria financiare dhe kapitale për vitin 2017 u zgjerua në vlerën +1,185.8 milionë euro krahasuar me +730.6 milionë euro që ishte në vitin 2016.

I.2 Krahasimi me vendet e rajonit

Rimëkëmbja ekonomike në Ballkanin Perëndimor vazhdoi në vitin 2017, por rritja reale u ngadalësua nga 3.1% në vitin 2016 në 2.1% në vitin 2017. *Konsumi dhe investimet private* vazhduan të mbështesin rritjen ekonomike, ndërkohë që eksportet duket se kanë fituar dinamizëm.

Deficitet e llogarisë korrente janë ngushtuar në disa vende, por pozicionet e jashtme në shumë ekonomi mbeten vulnerabël. Expansioni ekonomik çoi në krijimin e mëtejshëm të vendeve të reja të punës dhe në rënie të papunësisë, megjithatë *norma e papunësisë* mbetet në nivele të konsiderueshme në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, nivelet e larta të borxhit publik dhe/ose mungesa e mbikëqyrësve fiskalë mbeten burim risku në shumicën e vendeve të rajonit.

Tabela 1 Produkti i Brendshëm Bruto

Produkti i Brendshëm Bruto *(rritja vjetore ne %, ne terma real)*	**2016**	**2017**
Maqedonia	2.9	0.0
Mali i ZI	2.9	4.4
Serbia	2.8	1.9
Turqia	3.2	7.4
Shqipëria	3.4	3.8
Bosnja dhe Hercegovina	3.3	1.6
Kosova	4.1	3.7

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Situata e tregut të punës në Ballkanin Perëndimor mbetet sfiduese. Pavarësisht rimëkëmbjes ekonomike, ritmi i krijimit të vendeve të reja të punës u ngadalësua në shumicën e vendeve të rajonit gjatë vitit 2017 krahasuar me vitin e kaluar. Rritja e niveleve të punësimit kontribuan në një rënie të normave të papunësisë në shumicën e vendeve të rajonit gjatë vitit 2017.

Tabela 2 Norma e papunësisë

Norma e Papunësisë *(mesatare vjetore, në %)*	**2016**	**2017**
Maqedonia	24.0	22.4
Mali i ZI	18.0	16.4
Serbia	13.5	15.3
Turqia	11.1	11.1
Shqipëria	15.6	14.1
Bosnja dhe Hercegovina	25.4	20.5
Kosova	27.5	:

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Si rezultat i bazave të kufizuara të prodhimit dhe sfidave të konkurrencës, deficitet e tregtisë së mallrave mbeten shumë të larta në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Deficitet tregtare janë kompensuar pjesërisht nga tepricat në llogarinë e shërbimeve dhe në transfertat korrente, duke rezultuar në nevoja të mëdha të financimit të huaj. Zhvillimet e llogarive të jashtme në rajon gjatë vitit 2017 tregojnë një pamje mjaft të ndryshme.

Tabela 3 Bilanci Tregtar

Bilanci tregtar (i mallrave) (ne % te PBB)	**2016**	**2017**
Maqedonia	-19.1	-17.9
Mali i ZI	-41.9	-43.9
Serbia	-10.5	-12.3
Turqia	-4.8	-6.9
Shqipëria	-22.8	-22.1
Bosnja dhe Hercegovina	-22.7	-23.5
Kosova	-40.9	-41.8

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Në vitin 2017, inflacioni i çmimeve të konsumit në vendet e Ballkanit Perëndimor u përshpejtua, megjithëse marxhinalisht. Rritja e kërkesës së brendshme dhe çmimet më të larta të energjisë dhe çmimeve të ushqimit krijuan presione rritëse.

Tabela 4 Norma e Inflacionit

Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit (Inflacioni) *(ndryshimi vjetor në %)*	**2016**	**2017**
Maqedonia	-0.3	1.4
Mali i ZI	0.1	2.8
Serbia	1.1	3.1
Turqia	7.8	11.1
Shqipëria	1.3	2.0
Bosnja dhe Hercegovina	-1.1	1.2
Kosova*	0.3	1.5

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Në vitin 2017, balancat fiskale në pjesën më të madhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor mbetën brenda ose tejkaluan në kahun pozitiv objektivat e buxhetit.

Tabela 5 Bilanci Fiskal

Balanca e pergjithshme e qeverise (Deficiti fiskal) *(ne % te PBB)*	**2016**	**2017**
Maqedonia	-2.7	-2.7
Mali i ZI	-3.6	-5.4
Serbia	-1.3	1.2
Turqia	-0.9	-2.4
Shqipëria	-1.8	-2.0
Bosnja dhe Hercegovina	1.2	:
Kosova	-1.2	:

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Tabela 6 Borxhi Publik

Borxhi publik total *(ne % te PBB)*	**2016**	**2017**
Maqedonia	39.5	39.3
Mali i ZI	63.4	65.1
Serbia	71.9	61.5
Turqia	26.4	28.2
Shqipëria	72.4	70.0
Bosnja dhe Hercegovina	39.1	:
Kosova	14.6	16.6

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

II. POLITIKAT FISKALE DHE EFEKTET NË EKONOMI

II.1 Ndryshimet fiskale në vitin 2017 dhe efektet në buxhet dhe në ekonomi

Paketa Fiskale 2017, në tërësinë e saj ka synuar përgjithësisht korrektime në elemente të vecantë tatimesh dhe taksash si akcizat, taksat kombëtare, apo tarifat doganore. Qëllimi i paketës fiskale lidhet me thjeshtimin e procedurave dhe mbështetjen e biznesit dhe sektorëve të ndryshëm prioritare të ekonomisë, duke synuar nxitjen e rritjes ekonomike. Ndryshimet kryesore paraqiten si më poshtë:

Taksat Kombëtare

- *Renta Minerare*

Mbështetja e industrisë minerare dhe aplikimi i lehtësirave fiskale nga qeveria është një stimul i rëndësishëm për zhvillimin e industrisë përpunuese në vend. Reduktim i rentës minerare për mineralet metalore e destinuar për përpunim brenda vendit ulet nga 4% në 3% me efekt të parashikuar –10 milionë lekë në të ardhurat nga renta, por me faktorë pozitivë në rritjen e vlerës se produkteve të prodhimit vendas.

- *Taksa për ambalazhet*

Taksa për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend nga 50 lekë/kg ulet në 1 lekë/kg. Efekti i parashikuar në të ardhurat e buxhetit të shtetit -60 milionë lekë.

- *Taksa e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin*

U hoq aplikimi i taksës së qarkullimit për benzinën dhe gazoilin të prodhuar në vend me qëllim eksporti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nisur nga parimi i përgjithshëm i lehtësimit nga taksat të eksporteve, me qëllim stimulimin e tyre.

- *Taksa e automjeteve luksose*

Hiqet aplikimi i taksës së qarkullimit për benzinën dhe gazoilin të prodhuar në vend me qëllim eksporti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nisur nga parimi i përgjithshëm i lehtësimit nga taksat të eksporteve, me qëllim stimulimin e tyre.

Akciza

- *Ndryshime në nivelin e Akcizës së duhanit dhe nënprodukteve të tij.*
  - Shfuqizohet rritja e akcizës për vitin 2017. Akciza mbetet 5500 lekë/1000 copë dhe riskedulohet rritja në vitet 2018-2021, duke u rritur me 250 lekë/1000 copë në vit.
  - Shfuqizohet rritja e akcizës sipas kalendarit për vitin 2017 për importimin e duhanit të grirë (mbetet 4400 lekë/kg) duke arritur përafrimin me direktivën 2011/64/EU, ku raporti midis akcizës së cigareve dhe duhanit është në nivelin 2/3. Për shkak të diferencës së ulët të nivelit të taksimit ndërmjet duhanit të grirë dhe cigareve, u propozua të ruhet niveli ekzistues i taksimit të duhanit duke mos aplikuar rritje për vitet 2018-2021, me qëllim përafrimin me diferencimin që ka duhani i grirë me cigaret.

- Me qëllim mbështetjen e prodhimit vendas dhe luftën kundër informalitetit, u parashikua nivel i reduktuar i akcizës në 2500 lekë/kg për duhanin e prodhuar brenda vendit me gjethe të duhanit nga bimë të kultivuara në Shqipëri. Kjo masë është praktikë e parashikuar edhe në Direktivën e BE 2011/64/EU, ku parashikohet taksim më i ulët për të njëjtin produkt në zona specifike. Efekti i parashikuar i kësaj politike, me synimin rritje progresive të deklarimit të prodhimit vendas, është +0.075 miliard lekë, ndërkohë aktualisht vlerësohet që ky efekt është +0.026 miliard lekë në buxhetin e shtetit.
- Rritet akciza për purot dhe cigarillos nga 2500 lekë/kg në 4400 lekë/kg. Krahasuar me vitin 2016, sasia e importuar për purot dhe cigarillos është rritur me 43%, ndërkohë që të ardhurat e siguruara nga akciza për këtë produkt, janë rritur me 1.47 herë.

- *Gazi i Lëngët*
  - Vendoset Akciza për Gazin e Lëngët (GLN) në masën 8 lekë/litër, në rastet kur përdoret si lëndë djegëse për motorr automjetesh, me qëllim iniicimin e procesit të përafrimit me direktivën e BE-së. Importi i gazit të lëngët për përdorim nga automjetet, vlerësohet rreth 95 mijë ton për vitin 2017, me efekt në të ardhurat buxhetore 1 miliard lekë, nga të cilat 0.7 miliard lekë nga akciza dhe 0.3 miliard lekë nga TVSH-ja.

Tarifat Doganore

- *Tarifa për Fasonët*
  - Reduktimi i Tarifës për Fasonët nga 2%, 6%, 10% dhe 15% në masën 0%, me qëllimin për të krijuar një klimë më të favorshme për këtë industri, duke rritur eksportin dhe konkurrueshmërinë në tregjet ndërkombëtare.

- *Koks dhe gjysmë koks nga qymyrguri*
  - Heqja e tarifës nga 2% në 0% të produktit koks dhe gjysëm koks nga qymyrguri, e cila përdoret për procese teknologjike në furra pasurimi mineralesh etj., favorizon industrinë prodhuese e përpunuese në vend, duke ulur ndjeshëm kostot dhe duke nxitur prodhimin në vend dhe eksportit në tregun ndërkombëtar.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Me qëllim zhvillimin dhe nxitjen e mëtejshme të sektorit të turizmit, për akomodimin në strukturat akomoduese, aplikohet shkallë e reduktuar e TVSH-së, në masën 6%. Kjo politikë fiskale u ndermorr për të nxitur zhvillimin e sektorit të turizmit si dhe rritjen e konkurrencës me vendet fqinje.Në këtë mënyrë, synohet që të stimulohet rritja ekonomike nga sektori i turizmit.

III. BUXHETI I VITIT 2017

III.1 Arritjet Kryesore

- Konsolidimi i stabilitetit makroekonomik e fiskal, nëpërmjet reduktimit të deficitit e borxhit publik, dhe arrtjes së një balance primare pozitive, në zbatim të plotë edhe të rregullave fiskalë.
- Politikë fiskale optimale me efekt të rëndësishëm në përshpejtimin e rritjes ekonomike dhe rritjes së punësimit.
- Mbështetje vazhdueshme buxhetore ndaj sektorëve prioritarë, të tillë si: arsimi, shëndetësia, bujqësia dhe infrastruktura.
- Përmbyllja me sukses e Marrëveshjes Dy-Palëshe të bashkëpunimit me FMN, duke mundësuar uljen graduale të borxhit publik dhe reformat në sektorët kyç të ekonomisë.
- Konsolidimi i një sistemi të shëndetshëm të menaxhimit financiar, i cili shmang krijimin dhe mbartjen e detyrimeve të reja të prapambetura financiare;
- Miratimi i ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore dhe fillimi i zbatimit të tij, një hap cilësor përpara në drejtim të përmirësimit të ndjeshëm të menaxhimit të financave publike në nivel vendor.

III.2 Karakteristikat kryesore

- Çdo politikë e re buxhetore/financiare reflektoi opinionin e publikut, biznesit apo shoqërisë civile;
- Shtresat në nevojë u kompensuan nëpërmjet skemave sociale më transparente dhe ekonomike, si edhe paketave të solidaritetit të Qeverisë;
- Arsimi ishte prioritet dhe u fokusua drejt atij profesional, me qëllim sigurimin e një lidhjeje më të mirë mes tregut të punës dhe arsimimit të brezit të ri;
- Shëndetësia ofroi shërbime publike më cilësore, nëpërmjet sigurimit të një mbështetjeje të veçantë ndaj shërbimit spitalor, atij të urgjencës dhe kryerjes së diagnostifikimit falas;
- Fermerët përfituan subvencione, në përputhje me nivelin e prodhimit bujqësor të realizuar;
- Efektet fillestare të reformës administrativo-territoriale dhe të ligjit të ri për financat e vetëqeverisjes vendore, u dëshmuan gjatë vitit 2017 në rritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore si edhe rritjen e investimeve në nivel vendor.

III.3 Arritje dhe investime konkrete, realizuar përmes buxhetit 2017

Arsimi

- U miratua korniza kurrikulare e Arsimit Parashkollor dhe standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç dhe janë në proces pilotimi programet me kurrikulën e re për grupmoshën 3-4 vjeç. U zbatua kurrikula e re në të gjitha klasat e dyta dhe të shtata dhe u pilotua kjo kurrikul në 26 klasa të treta dhe të teta në 13 DAR-e.

- Janë përzgjedhur shkollat, janë përshtatur pyetësorët, përkthyer testet dhe manualet dhe ka filluar përgatitja për pjesëmarrjen e Shqipërisë në PISA 2018, dhe në prill 2017 në 32 shkolla të 17 DAR/ZA-ve u zhvillua pilotimi i PISA 2018, me pjesëmarrjen e 2147 nxënësve 15-vjeçarë.
- U realizua financimi i shërbimit të transportit falas për nxënësit e arsimit bazë dhe mësuesit e arsimit parauniversitar, nga ku përfitojnë shërbim transporti falas rreth 30,000 nxënës që mësojnë në një distancë prej më shumë se 2 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre si dhe i rreth 10,000 mësuesve që punojnë më shumë se rreth 5 km nga vendbanimi i tyre me një fond prej 600 milion lekë.
- U realizua rimbursimi i teksteve shkollore falas, për rreth 100 mijë nxënës të arsimit parauniversitar me një fond prej 349.8 milion lekë nga të cilët; 82 815 nxënës të arsimit bazë në vlerën 268.9 milion lekë dhe 16 400 nxënës të arsimit të mesëm të përgjithshëm në vlerën 80.9 milion lekë.
- Gjatë vitit 2017 u realizua financimi për rikonstruksionin, rindërtimin e 64 objekteve arsimore/kontratave të miratuara me Vendimin e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, nga të cilat:
  - ✓ *Në arsimin bazë u financuan 44 objekte arsimore/kontrata me vlerë të plotë në shumën 2,917,626,274 lekë dhe me vlerë financimi në shumën prej 1,220,812,476 lekë për vitin 2017.*
  - ✓ *Në arsimin e mesëm të përgjithshëm u financuan 18 objekte arsimore/kontrata me vlerë të plotë në shumën 1,444,812,892 lekë dhe me vlerë financimi në shumën prej 723,092,524 lekë për vitin 2017.*
- U zbatua programi "Edukimi, ndërgjegjësimi dhe reduktimi i kërkesës për drogë dhe substanca të tjera të rrezikshme" në 365 shkolla 9-vjeçare publike dhe private të vendit, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që synon ndërgjegjësimin e fëmijëve të klasave të 6-ta, të moshave 12-13-vjeçare, mbi fenomenet negative të duhanit, alkoolit, marijuanës etj.
- U hartua dhe zbatua plani kombëtar i veprimit për nismën "Stop dhunës në shkollë", ku u përfshinë 3235 shkolla dhe kopshte publike me 515,981 nxënës në të gjithë vendin. Në këtë kuadër DAR/ZA-të kanë raportuar për 2 824 raste te evidentuara dhe të trajtuara, të dhunës në institucionet shkollore.
- U zhvillua nisma "Shkolla si qendër komunitare, synon ta kthejë shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet", pilotimi në vitin 2015 në 66 shkolla, në vitin 2016 u përfshinë 184 shkolla, në vitin 2017 u përfshinë 270 shkolla të shtrira në 38 DAR/ZA, ku përfitues janë 96,398 nxënës dhe 2,820 mësues.
- Viti 2017 shënoi implementimin e reformës në arsimin e lartë, ku u realizua për herë të parë procesi i akreditimit institucional i 35 institucioneve të arsimit të lartë publike dhe private.
- Janë mbështetur financiarisht me bursë të plotë 37 studentë të shkëlqyer nga të cilët 23 studentë janë mbështetur për herë të parë në vitin 2017, si dhe 14 studentë të ndërmjetëm me një fond prej 150 milion lekë.
- U financua pjesëmarrja në programin Horizon 2020, me një fond prej 140 milion lekë për

Kërkimin dhe Inovacionin (2014 - 2020), i cili do të bashkojë kërkimin me inovacionin dhe do të ketë një akses më të thjeshtë se programet paraardhëse për kompanitë dhe universitetet, në tri shtylla kryesore: i) Shkencë -Ekselence, ii) Lidership industrial, iii) Sfidat shoqërore.

- U mbështetën financiarisht 25 federata sportive dhe sportistët me rezultatet e larta;

Arsimi Profesional dhe Punësimi

- Arriti në 36% niveli i nxënësve të cilët vazhdojnë arsimin e mesëm në drejtimin e arsimit professional, me një rritje me 25% në krahasim me 2016 të numrit të nxënësve të regjistruar;
- 19 000 nxenes studiojne ne shkollat e AP; 15 711 persona u certifikuan ne qendrat e formimit profesional nga te cilet 8 040 femra; 13 000 nxenes moren kompesim per tekste; 8 shkolla dhe reparte te bazave prodhuese u rikostruktuan/ndertuan te reja; 20 reparte te praktikave profesjonale jane pajisur me makineri e pajisje.
- U krijua Këshilli kombëtar i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe komiteteve sektoriale me përfaqësim të partnerëve sociale dhe me një minimum përfaqësimi të femrave në masën 30%
- Shndërrimi i ofruesve në nivel rajonal (21) në qendra polifunksionale, në funksion të optimizimit të rrjetit të ofruesve, promovimi i një sistemi modern dhe gjithpërfshirës;
- Fondet e nxitjes së punësimit janë pesëfishuar në krahasim me 5 vite më parë, duke arritur vlerën e 490 milionë lekë në vitin 2017. Me këtë financim është arritur që:
  - ✓ *Numri i punëkërkuesve të papunë që trajtohen nga skemat e nxitjes së punësimit ka një rritje të konsiderueshme në mbi 7000 në vitin 2017.*
  - ✓ *Janë zgjeruar fushat e zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit deri në vitin 2017 në fusha të tilla si: industria prodhuese, industria e turizmit, teknologjia e informacionit, aktivitete të lidhura me bujqësinë dhe blektorinë, dhe industritë të tjera prioritare.*
- Janë mbyllur disa projekte në fushën e arsimit profesional:
  - ✓ *Rikonstruksioni i ndërtesës dhe bazës prodhuese të shkollës "Ali Myftiu", Elbasan,*
  - ✓ *Rikonstruksion dhe përshtatje e Bazës Prodhuese të shkollës së Mesme "Kristo Isak ",*
  - ✓ *Ndërtim i ndërtesës së Shkollës Kombëtare të Agrobiznesit "Charles" telefort*
  - ✓ *Rikonstruksioni i ndërtesës së shkollës teknologjike "Hamdi Bushati", Shkodër*

Shëndetësia

- Gjatë 2017 përfunduan disa projekte të rëndësishme si:
  - ✓ *Rikonstruksioni i urgjencës së spitalit rajonal Berat*
  - ✓ *Rikonstruksion i godinës së reanimacionit në Spitalin e Pediatrisë Vlorë.*
  - ✓ *Rikonstruksioni i ambienteve të reanimacionit të Spitalit Shkodër*
  - ✓ *Rikonstruksioni dhe pajisja e Qendrës Shëndetësore në Bashkinë Kamëz*
  - ✓ *Furnizimi me pajisje mjekësore dhe hotelerie për godinen e maternitetit të Spitalit Sarandë*
- U hoq tatimi mbi vlerën e shtuar për barnat dhe materialet mjekësore.
- U zgjerua programi i kontrollit bazë për grupmoshat 35 – 70 vjeç duke i dhënë këtë mundësi

1,260 mijë vetëve rezidentë në Shqipëri.

- Tarifat e vizitave dhe ekzaminimeve për personat e pasiguruar që ndjekin sistemin e referimit janë ulur në jo më shumë se 300 lekë (nga deri 500 lekë që ishte deri në dhjetor 2015).
- 600 mijë vetë të pasiguruar përfitojnë nga rimbursimi i barnave.
- Shpenzimet publike të shëndetësisë për çdo banor u rritën nga 12,295 lekë në 2013 në 16,260 lekë në 2017.
- Çmimet e barnave janë ulur me rreth 30% dhe lista e barnave të rimbursueshme është zgjeruar me 81 principe të reja aktive dhe 141 alternativa të reja.
- Mjeku i familjes është falas për këdo, përfshirë edhe 600 mijë vetë të pasiguruar
- Rradha e pritjes për ekzaminime të rëndësishme është ulur në:
    - *2 javë për angiografi koronare*
    - *2 javë për provën e ngarkesës së zemrës*
    - *1 muaj për rezonancë magnetike*
    - *2 javë për skaner*
- Shërbimi i Urgjencës Mjekësore u rithemelua duke përqëndruar komandën dhe dekoncentruar vendndodhjen e flotës së autoambulancave në territor. Në 2017:
    - U shtuan 20 autoambulanca dhe 1 helikopter mjekësor.
    - U hapën 25 qendra shëndetësore 24/7 në mbështetje në sezonit turisitik veror.
    - Funksionoi urgjenca kardiake dhe ajo vaskulare-cerebrale për 24/7.
- Po zbatohet dosja elektronike e shëndetit, receta elektronike, referimi elektronik i pacientëve dhe nënshkrimi elektronik i profesionistëve të shëndetësisë
- Janë vendosur dy njësi moderne të radioterapisë për të përmirësuar kujdesin për të sëmurët me kancer, janë hapur 14 kabinete kardiologjie, 6 kabinete diabeti, dhe disa qendra të reja të shërbimit të dializës duke shmangur udhëtimet e përjavshme të pacientëve dhe marrjen e shërbimit në orët e vona të mbrëmjes
- Mundësohet furnizimi falas i protezave ortopedike në spitalet universitare dhe rajonale.

Zhvillimi Ekonomik

- Finalizimi i procesit të miratimit të Protokollit Shtesë 5 për lehtësimin e tregtisë në kuadër të marrëveshjes CEFTA. Protokolli është dërguar në KM për të vijuar me procesin e ratifikimit
- Finalizimi i negociatave teknike për Protokollin Shtesë 6, liberalizmi i tregtisë së shërbimeve në kuadër të CEFTA. Në proces për gatitja për firmosje
- Finalizimi i planit shumëvjeçar për krijimin e Zonës Ekonomike Rajonale, pjesa e tregtisë dhe investimeve.

Infrastruktura dhe Energjia

- Reduktimi në rreth 25%, i humbjeve të energjisë elektrike (teknike dhe joteknike), krahasuar me 31.34% që ishte në 2016;
- Norma e arkëtimit (mesatarisht) u rrit në masën 89.51%
- Hartimi i Paketës së Projekteve Prioritare për sektorin e transportit, (Single Sector Project Pipeline-SSPP), me 29 projekte të identifikuara, nga të cilat 16 janë projekte të infrastrukturës

së rrugëve primare, (në vazhdim të reja), si dhe projekte për rrugët sekondare.

- Startoi projekti i Bankës Boterore për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore 2015-2020, (afërsisht 130 milion USD, bashkëfinancimi Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore), koncepti i së cilit ishte ai me bazë-performance (output and performance based).
- Përdorimi i energjisë së rinovuar u rrit me 22% më shumë, krahasuar me vitin 2009;
- Përfundoi instalimi i sistemit ËEB-GIS në Autoritetin Rrugor Shqiptar.
- Janë mbyllur disa kontrata të rëndësishme investimesh në infrastrukturë:
  - ✓ *Ndërtim rruga e Porto Romanos, Durrës Loti 1,*
  - ✓ *Ndërtim rruga Unaza e re Tiranës, Komuna e Parisit - Shkolla Teknologjike,*
  - ✓ *Ndërtim i rrugës së Arbërit (Dalja e urës së Vashës Bulqizë) Loti 2 (shtesë punimesh)*
  - ✓ *Ndërtim rruga Lushnje - Berat Loti 2*
  - ✓ *Ndërtim rruga Lushnje - Berat Loti 3 (shtesë punimesh Nr.2)*
  - ✓ *Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit - rruga e Kavajës)*
  - ✓ *Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit - rruga e Kavajës)*
  - ✓ *Ndërtim rruga by Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë, Loti 7*
  - ✓ *Ndërtim rruga Unaza e re Tiranës (segmenti Komuna e Parisit - rruga e re Tiranë - Elbasan)*

Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Ujitja dhe Kullimi

- Rehabilitimi i kanaleve të kullimit me qëllim kullimin dhe mirëmbajtjen e 3000 ha tokë
- Sipërfaqja e ujitshme nga 155,000 ha, është rritur në 160,354 ha, duke futur në ujitje për herë të parë 5,000 ha;
- Janë realizuar punimet e mirëmbajtjes në infrastrukturën e ujitjes me tregues kryesorë pastrimin e rreth 158 km kanale kryesore, me impakt përmirësimin e ujitjes në rreth 30 000 ha.
- Janë realizuar punimet e mirëmbajtjes në infrastrukturën e kullimit, me tregues kryesorë pastrimin e rreth 220 km kanale kryesore kullues dhe kanalet të ujërave të larta, duke ndikuar në përmirësimin e kullimit në një sipërfaqe prej rreth 50 000 ha.
- Janë realizuar mbi 10 projekte investimesh për argjinaturat e lumenjve dhe mbrojtjen prej tyre, ku përmendim:
  - ✓ *Kanali Peqin - Kavajë (Lumi Shkumbin)*
  - ✓ *Argjinatura e lumit Drin i Zi, fshati Potgorcë*
  - ✓ *Mbrotja nga Lumi i Vjosës në krahun e djathtë, zona Pishporo*
  - ✓ *Argjinatura mbrojtëse nga lumi Shkumbin, Muriqan*
  - ✓ *Lumi Devoll, 100 meter poshte urës së Trenit,*
  - ✓ *Dunavec, grykederdhja e përroit, Voskop*
  - ✓ *Skema Ujitëse e fushës së Milotit, Mamurrasit dhe Drojës*
  - ✓ *Argjinatura e lumit Mat, krahu i djathtë i rrjedhës, Tale dhe krahu i majtë, zona Alk Kurbin*
  - ✓ *Mbrojtja nga lumi Kir, Bleran*
  - ✓ *Sistemi i përrenjeve malor mbi KUL Kurbin*
  - ✓ *Riparim porta mbi KUL Gjorm (shërben edhe si kanal ujitës), mbi KUL-portat Kashnjet,*

mbi Kulluesin K-3 Mamurras-hidrovori Drojë
- ✓ *Argjinatura Darragjat, lumi Buna, Shkoder*

- Janë mbyllur projektet e mëposhtme me financim të huaj
  - ✓ *Granti Francez "Projekti per biodiversitetin"*
  - ✓ *Mbeshtetje per Bujqesine dhe Zhvillimin Rural, IPARD Like 1*

Siguria Ushqimore

- Përfundoi fushata e vaksinimit të brucelozës të të gjitha kafshëve të imta mbështetur në strategjinë kombëtare si dhe në bashkëpunim me projektin PAZA "Përmirësimi i mbrojtjes së konsumatorit, për luftimin e sëmundjeve zoonotike", në masën 2.308.533 krerë të imta.
- Filloi programi i monitorimit të mbetjeve në kafshë dhe produkteve me origjinë shtazore si dhe programi i monitorimit të molusqeve dhe ujërave të brendshëm.
- Në zbatim të strategjive në lidhje me masat që duhet të merren për sëmundjen e Dermatozës Nodulare të gjedhit (LSD), u sigurua vaksina kundër LSD me një fond prej 148 milion lekë dhe u krye vaksinimi i 312.607 kafshëve të llojit gjedhë.
- Janë dëmshpërblyer një numër prej 127 krerë gjedh dhe 8 krerë të imta kundër sëmundjes së plasjes dhe brucelozës.

Zhvillimi Rural

- Skemat mbështetëse të fermerëve lëvruan një fond prej 946.4 milionë lekë. Nga të cilat:
  - *202.3 milionë lekë për luftimin e mizës së ullirit në 6 Qarqe (Elbasan, Fier, Vlorë, Tiranë, Lezhë dhe Berat, në një sipërfaqe prej 5599.57 ha.*
  - *335.8 milionë lekë për dëmshpërblimin e fermerëve me lopë të dëmtuara nga dermatoza nodulare, si edhe për blerjen e 1912 krerë lopëve për fermerët e dëmtuar.*

Mbrojtja Sociale dhe Strehimi

Ndihma Ekonomike

- Ndihmë ekonomike tashmë e plotë dhe jo më e pjesshme, sipas numrit të individëve të çdo familje, ku 32.441 familje paguhen dyfish/trefish më shumë krahasuar me skemën e vjetër.
- Janë trajtuar me ndihmë ekonomike 52,443 familje përfituese të ndihmës ekonomike;
- Pagesë shtesë për fëmijët që ndjekin shkollën dhe vaksinohen;
- Rritje e fondit nga 3% në 6% për pushtetin vendor për të trajtuar rastet që nuk mund të përfitojnë nga sistemi elektronik;
- Shpërblime për 80 mijë familje në nevojë për festat e fundvitit;
- Program ri-integrimi social që lidh skemën e Ndihmës Ekonomike me skemat aktive të Punësimit/Riintegrimit Social.
- Regjistër Elektronik Kombëtar me infrastrukturë elektronike të zhvilluar në të gjithë vendin që siguron menaxhim dhe kontroll më të mirë mbi përdorimin e fondeve të ndihmës ekonomike dhe shmang abuzivitetin.

- Shmangia e abuzivitetit në skemën e ndihmës ekonomike në masën 23% të skemës krahasuar me 2013;

Aftësia e Kufizuar

- Janë trajtuar me pagesën e aftësisë së kufizuar 159,621 persona nga disa kategori, "Individë të verbër përfitues nga programi i Aftësisë së Kufizuar", "Individë paraplegjikë e tetraplegjikë përfitues nga programi i Aftësisë së Kufizuar", "Personat me aftësi të kufizuara mendore, fizike përfitues nga programi i Aftësisë së Kufizuar";
- Indeksimi i përfitimeve me nivelin e inflacionit;
- Skemë e re vlerësimi për aftësinë e kufizuar bazuar në modelin bio-psiko-social sipas standardeve ndërkombëtare të OBSH-së;
- Regjistër Elektronik Kombëtar dhe Arkivë Elektronike e ngritur për të shmangur vonesat e shkaktuara proceduariale të individëve përgjatë procedurës së komisionimit;
- Përfituan pagesa të plota dhe në kohë 66.557 persona me aftësi të kufizuar, 18.311 kujdestarë të tyre si dhe, 71.528 invalid pune, ndryshe nga praktika e qeverisjes së kaluar.
- Praktikë e re në katër vite qeverisje, personat me aftësi të kufizuara kanë përfituar edhe pagesë shtesë në fund të çdo viti.
- Për herë të parë që nga viti 2014, skema e aftësisë së kufizuar tërësisht e audituar dhe ulur abuzivizmi me 8,7% (8,079 PAK).
- 900 paraplegjikë dhe tetraplegjikë kanë përfituar pajisje asistive falas në sajë të partneritetit me shoqërinë civile.

Përkujdesi Social

- Paketë ligjore e plotë për Shërbimet e kujdesit Shoqëror, hap konkret drejt decentralizimit të shërbimeve shoqërore, krijimit të fondit social dhe zgjerimit të hartës së shërbimeve;
- Ligj "Për ndërmarrjet Sociale në RSH" me qëllim integrim dhe riintegrim i personave të përjashtuar nga tregu i punës;
- Janë trajtuar me shërbime në institucionet e përkujdesit social 257 fëmijë, 460 të moshuar, 405 persona me Aftësi të Kufizuar që përfitojnë shërbime rezidenciale publike, 14 vajza të trafikuara dhe 28 vajza të dhunuara;
- Ngritur Regjistër Elektronik Kombëtar për Shërbimet Sociale i Integruar për të menaxhuar në kohë reale dhe efektive rastet e individëve në nevojë;
- Rritur me 300% numri i fëmijëve në familje kujdestare duke garantuar rritjen e fëmijeve në familje në vend të institucioneve.

Strehimi

- Në programin e strehimit janë realizuar 3 projekte të rëndësishme:
  - ✓ *Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin Rom/Egjiptian në bashki të ndryshme të vendit, Shijak, Elbasan, Fier, Rrogozhinë, Krujë, Librazhd, Lushnje, Rrëshen dhe Pogradec.*

- ✓ *Rikonstruksion i godinave në pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore për strehim social për Bashkitë Patos dhe Koplik*
- ✓ *Për projektin "Banesa me Qëllim Social", për fazën e II-të, me 126 apartamente, u lidhen kontratat me të gjithë përfituesit.*

Drejtësia

- Ndërtimi dhe rritja e kapaciteteve të disa burgjeve në vend, si Burgu 313 me standardet e BE.
- Është realizuar kompensimi financiar për 220 vendime pronësie dhe janë trajtuar rreth 5 000 kërkesa për njohje pronësie.
- Jane përthithur në Arkiven Shtetetore të Sistemit Gjyqësor 75 644 dosje të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe apeleve.
- Janë miratuar procedurat e birësimit të 43 fëmijëve, në familje shqiptare dhe të huaja.
- Janë realizuar rreth 7 425 akte ekspertimi mjeko-ligjor.
- Është rritur numri i rasteve të asistencës juridike për institucionet shtetërore nëpërmjet këshillit dhe përfaqësimit në Gjykatat Kombëtare dhe Ndërkombëtare me 13 496 raste;
- Është realizuar informatizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, sistem informatizimi i kartave të të dënuarve;

Turizmi dhe Mjedisi

- TVSH per turizmin u ul ne 6% per vitin 2017;
- Është rehabilituar plotësisht vend-depozitimi ekzistues i mbetjeve në Elbasan, si dhe është ndërtuar një landfill i ri modern bashkë me impiantin e parë për prodhim energjie elektrike dhe termike. Krahas sa më sipër, menaxhimi i mbetjeve përmes landfilleve është shtrirë dhe në qarqe të tjera:
- Vazhdon puna për ndërtimin e impiantit të dytë në vend për prodhim energjie nga mbetjet në Qarkun e Fierit;
- Ka filluar ndërtimi i landfillit në Maliq, për qarkun e Korçës dhe në Vlorë, fal mbështetjes së donatorëve;
- Ka përfunduar ndërtimi i Landfillit të Bajkajt kryesisht për zonën e Himarës dhe Sarandës;
- Është ndërtuar impianti i parë modern për grumbullimin e mbetjeve në grykëderdhjen e Shkumbinit dhe pritet të realizohet një projekt i tillë dhe në grykderdhjen e Ishmit.
- Ka përfunduar projekti i rëndësishëm i "Ruajtjes dhe Përdorimit të Qëndrueshëm të Biodiversitetit në Liqenet e Ohrit, Prespës dhe Shkodrës".
- U ngrit Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. që ka për qëllim menaxhimin, mbrojtjen, zhvillimin, zgjerimin dhe funksionimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura në vendin tonë, që përbëjnë sot rreth 16.61% të territorit të Shqipërisë. Kjo agjenci krahas rritjes së shkallës së ruajtjes së zonave të mbrojtura, është në proces për të zgjeruar shtrirjen e tyre dhe në dy zona: (i) zona e mbrojtur detare e Porto Palermos dhe (ii) Parku Kombëtar i Alpeve (i cili përfshin zonën e Vermoshit, PK Theth, PK Lugina e Valbonës).
- Krijimi i Inspektoriati Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, ka mundësuar pajisjen me leje mjedisore të 95% të subjekteve. Për të siguruar mbrojtjen kundër zjarreve në pyje dhe

kullota, Inspektoriati ka investuar duke vendosur mbi 240 kamera monitoruese (24 orë) dhe 24 kamera termike në mbarë vendin, duke kontrolluar situatën në terren në kohë reale.

- Është ulur niveli i zhurmave nga 3 herë mbi mestaren urbane, në 2 herë me mesataren e ndotjes së zhurmave në nivel evropian.

Rendi dhe Siguria Publike

- Viti 2017 shënoi numrin më të ulët të vrasjeve në 3 dekada. Gjithashtu, vjedhjet me pasojë vdekjen apo krimi ndaj pronës ka pësuar një rënie në minimume historike
- Numri më i ulët i aksidenteve rrugore me pasojë vdekjen në 10 vitet e fundit.
- Dalja e Shqipërisë nga harta e vendeve kultivuese të bimëve narkotike. U rrit forca goditëse ndaj kultivimit e trafikut të kanabisit dhe lëndëve të tjera narkotike, u rishikua Plani Kombëtar Antikanabis dhe masat që duhen marrë për ta luftuar këtë fenomen.
- Miratim i Planit të Veprimit, Operacioni "Forca e Ligjit" dhe zbatim i tij: Skedimi i 41 grupeve kriminale në shkallë vendi dhe hetimi, operacionet e para në Fier, Lezhë, Sarandë dhe në Shkodër.
- Rreth 40 milion euro pasuri e paligjshme e sekuestruar në vitin 2017.
- 1,103 vepra korrupsioni të evidentuara nga organet e rendit, numri më i lartë në 10 vitet e fundit.
- 24% më pak azilkërkues në 2017, krahasuar në 2016.
- Deregulimi, heqja certifikatave familjare dhe personale dhe marrja e tyre tashmë online. U morën masa më të thella për shërbimet që ofrohen në MB dhe Policinë e Shtetit, ku lehtësimi i kërkesave do ta afrojë më pranë qytetarin me Policinë.
- Nisja e punës për reformimin e Akademisë së Sigurisë.
- Nisja e zbatimit konkret të strategjisë së re të "Policimit në komunitet", një qasje e re e bashkëpunimit me qytetarët, me fokus parandalimin e krimit në territor.

Mbrojtja

- Lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura.
- Nënshkrimi i 19 marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të partneritetit mes vendeve, rritjes së sigurisë në rajon e më gjerë, duke implementuar në mënurë cileor detyrimet që rrjedhin nga pjesmarrja dhe anëtarësia në organizma të niveleve të larta ndërkombëtare si: NATO, EAPC, RACVIAC, Karta e Atlantikut, etj;
- Modernizimi me armatim të lehtë dhe municioni per FA-së, sistemet e mbështetjes për zjarr;
- Vendosja e kamerave Infra të Kuqe stacionare te integruara me sistemin SIVHD

Kultura

- Është realizuar promovimi, ruajtja, konservimi, restaurimi i objekteve dhe fondeve muzeore, rikostruksione infrastukturore në nivel qëndror dhe vendor për institucionet e artit dhe kulturës si edhe një sërë projektesh artistike-kulturore, nëpërmjet:
    - *Mirëmbajtjes dhe restaurimit të 155 monumenteve në të gjithë vendin.*

- *Sigurimit të muzeve dhe parqeve arkeologjike me infrastrukturë të përmirësuar për të ofruar shërbim cilësor ndaj vizitorëve.*
- *Realizimit të rreth 70 aktiviteteve të trashëgimisë materiale, jomateriale dhe të diversitetit kulturor në subjekte dhe në institucionet e varësisë.*
- *Inventarizimit dhe katalogimit të pasurive kulturore, duke rregjistruar 30 500 objekte në Fondin Kombëtar të Pasurive Kulturore.*
- *Ngritjes së Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe" dhe hapja për publikun në datën 23.05.2017.*
- *Përfundimit të projektit "Rehabilitimi i Manastirit të Shën Mërisë për përdorim muzeal dhe rrethinat e sitit arkeologjik të Apolonisë Fier"*
- *Realizimit të 87 projekteve artistike me fondet e programit të "Artit dhe Kulturës".*
- *Vijimin e punimeve për Rikonstruksionin e Teatrit Kombëtar Operas dhe Baletitn që pritet të përfundojë në vitin 2019*
- *Vijimin e punimeve për Qëndrën Kombëtare Kulturore "Skena e Re" që përfundon në vitin 2018.*
- *Përfundimit të Rikonstruksionit të godinës së teatrit "Migjeni".*
- *Përshtatjes së ish godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve me qëllim akomodimin e organeve të Vettingu-ut.*

Buxheti Vendor 2017

Përmes buxhetit vendor të vitit 2017 u konsoliduan efektet e reformës administrativo-territoriale në disa drejtime:

- Përmirësimi i procesit të decentralizimit të financave vendore, në drejtim të rritjes së financimit me rreth 7.5 miliard lekë (financimi i funksioneve të reja 6.7 miliard lekë, rehabilitimi i skemave ujitëse dhe kulluese 380 milion lekë, 400 milionë lekë rritja e pagave për funksionet e transferuara, 20 milionë lekë investime për funksionin e mbrojtjes nga zjarri) dhe konsolidimit të kuadrit ligjor në funksion të mirëmenaxhimit të financave publike në nivel vendor.
- Me buxhetin e vitit 2017, u promovua zhvillimi i qëndrueshëm në nivel vendor dhe rajonal, nëpërmjet financimeve infrastrukturore nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.
- Përmirësimi i qëndrueshmërisë, thjeshtësisë dhe barazisë në sistemin e transfertave, së bashku me rritjen e transparencës.
- U miratua ligji "Për financat e vetëqeverisjes vendore", me një një rol të rëndësishëm të:
  - *Forcimit të rregullave për procesin buxhetor dhe disiplinën fiskale e financiare në menaxhimin e financave vendore, si dhe rolit më të madh mbikqyrës të Ministrisë së Financave në këtë drejtim;*
  - *Rritjes së aftësisë së parashikueshmerisë së burimeve financiare publike në nivel vendor;*
  - *Sigurimit dhe konsilodimit të një dialogu efektiv ndërmjet dy niveleve të qeverisjes për ndarjen e detyrave dhe burimeve.*
  - *Unifikimit dhe standartizimit të procedurave të buxhetit vendor me qeverisjen qendrore;*
  - *Përcaktimit të rregullave për menaxhimin e situatave të vështirësive financiare;*

- *Rritjes së parashikueshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së transfertave ndërqeveritare;*
- *Rregullimit të procedurave për menaxhimin e situatave të bllokimit të miratimit të buxheteve nga këshillat e vetëqeverisjes vendore;*

III.4 Ndryshimet në buxhetin e vitit 2017

Gjatë vitit 2017, buxheti i shtetit u ndryshua me dy Akte Normative dhe më specifikisht:

✓ Akti Normativ Nr.2 datë 16.08.2017 *"Për disa ndryshime në Ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017":*

- Hartimi i këtij akti normativ u bazua në performancën makro-fiskale e buxhetore të 6mujorit të parë të vitit 2017, si edhe në parashikimin e pritshëm të treguesve deri në fund të vitit buxhetor 2017. Ai siguroi ruajtjen e parametrave kryesore të buxhetit fillestar 2017, përsa kohë që deficiti buxhetor mbeti i pandryshuar. Njëkohësisht, bëri të mundur arritjen e tre objektivave të rëndësishëm lidhur me: (i) garantimin e ofrimit të shërbimeve publike, (ii) rritjen e efiçencës së përdorimit të burimeve publike, (iii) rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit, Synimet kryesore që kerkonte të realizonte dhe realizoi Qeveria nëpërmjet këtij Akti Normativ, konsistuan kryesisht në:
  - *Përshpejtimin e projekteve të investimeve publike me impakt të qënësishëm pozitiv në rritjen ekonomike, me qëllim arritjen e nivelit të programuar të saj për vitin 2017;*
  - *Rritjen e huamarrjes neto nga sektori energjitik, për të mundësuar përmbushjen e nevojës për energji elektrike deri në fund të 2017, duke konsideruar situatën e vështirë klimaterike që karakterizoi gjysmën e parë të vitit 2017.*

✓ Akti Normativ Nr.3 datë 6.11.2017 *"Për disa ndryshime në Ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017, të ndryshuar":*

- Formimi i Qeverisë së re dalë pas zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të 25 Qershorit 2017, kulmoi në riorganizmin e Këshillit të Ministrave dhe për rrjedhojë ristrukturimin e përbërjes së tij. Kësisoj, bazuar në VKM-të e reja të fushave të përgjegjësive respektive, disa ministri pushuan së ekzistuari duke u ripozicionuar nëpër ministritë e reja përthithëse, si nga pikëpamja organike ashtu edhe nga ajo buxhetore. Ky ripozicionim ishte e domosdoshme të legjitimohej dhe institucionalizohej nëpërmjet rishikimit të ligjit të buxhetit për vitin 2017. Kësisoj, ky Akt i dytë Normativ i buxhetit të vitit 2017, mundësoi përmbushjen e disa angazhimeve të Qeverisë, të tilla si:
  - *Institucionalizimin dhe zbatimin e plotë në terma të ligjit të buxhetit, të fushave të reja të përgjegjësive përcdo ministri linje, nëpërmjet reflektimit të ndryshimeve organike dhe buxhetore, pas miratimit të Qeverisë së re.*
  - *Ligjërimin e akomodimit organik dhe buxhetor të strukturave të reja të Vettingut, përkatësisht i tre Komisioneve respektive të ngritura për këtë qëllim.*
  - *Shlyerjen në kohë të detyrimeve ekzistuese financiare kontraktuale të institucioneve buxhetore në zërat e fondeve korente, nëpërmjet rialokimeve buxhetore të propozuara, që akomodojnë disa nga nevojat e evidentuara nga institucionet*

buxhetore, gjë që ndikoi në reduktimin e mundësisë së krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura deri në fund të vitit 2017.

- *Përfshirjen në termat e Aktit Normativ nr.3, të një propozimi përjashtimor për v.2017 lidhur me kompesimin e ish-të përndjekurëve politikë, me fokus shlyerjen 100% të këstit të tetë dhe të fundit të kategorisë parësore të përfituesve të gjallë.*
- *Shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të institucioneve buxhetore deri në fund të v.2017, me fokus kryesor pagesën e TVSH&Kosto Lokale për sektorin e infrastrukturës rrugore dhe atë të ujësjellës-kanalizimeve, nëpërmjet akordimit të fondeve të dedikuara për të shlyer një pjesë të mirë të tyre. Kjo, si rezultat i hapësirës së krijuar nga fondet e lira dhe rialokimet e tjera, në funksion të rritjes së efiçencës së përdorimit të fondeve buxhetore, si korente por sidomos atyre kapitale.*

Është me rëndësi të theksohet që ndryshimet e propozuara, nuk cënuan nivelin e planifkuar të treguesve kryesorë makroekonomik dhe fiskal, duke ruajtuar deficitin në nivele të pandryshueshme e duke garantuar objektivin e Qeverisë për qëndrueshmëri fiskale.

IV. ANALIZA E ZËRAVE TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2017

IV.1 Të Ardhurat e Përgjithshme

Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për periudhën 12-mujore 2017, arritën në 430.4 miliard lekë, me një realizim ndaj planit vjetor 98.6%, duke shënuar rritje 5.7% ose 23.4 miliard lekë më shumë se viti paraardhës. Në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), totali i të ardhurave të buxhetit të shtetit përfaqëson 27.7% të saj, nga 27.6% që përfaqësonte në vitin 2016. Rritja me 0.1% e kontributit të të ardhurave të buxhetit të shtetit në raport me Produktin e Brendshëm Bruto për vitin 2017, është tregues i rëndësishëm i përmirësimit të përformancës së mbledhjes së të ardhurave në kuadër të reformës së konsolidimit të financave publike. Kjo rritje vjen kryesisht nga impakti i rritjes ekonomike dhe nga përmirësimi në administrimin e taksave. Impakt pozitiv në rritjen e të ardhurave, kanë sjellë gjithashtu përpjekjet intensive për uljen e informalitetit në ekonomi si edhe rritja e nivelit të pajtueshmërisë së tatimpaguesve me ligjin, përmes parimit të vetëkorrigjimit.

Të ardhurat totale të buxhetit të shtetit, përbëhen nga "Ndihmat" që zënë 3% të totalit të të ardhurave, nga të ardhurat "Tatime dhe Dogana" që zënë 68%, nga të ardhurat e "Pushtetit Lokal" 4%, nga të ardhurat "Fondet Speciale" që zënë 20% dhe nga të ardhurat "JoTatimore" që zënë 5%.

Grafiku 1 Të Ardhurat e Përgjithshme (në miliardë LEK), sipas kategorive kryesore



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Analiza e të ardhurave për periudhën Janar-Dhjetor 2017

Të ardhurat nga ndihmat për periudhën Janar-Dhjetor 2017 janë 11.1 miliard lekë nga 14.6 miliard lekë të një viti më parë, duke pësuar rënie në masën 24% ose 3.6 miliard lekë më pak dhe me një realizim ndaj planit në masën 80% ose 2.7 miliard lekë më pak.

Grafiku 2 Të Ardhurat nga Ndihmat (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Të ardhurat tatimore, ku përfshihen të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat nga pushteti lokal dhe të ardhurat nga fondet speciale, për periudhën 12-mujore arritën në vlerën 398.6 miliard lekë, me një realizim ndaj planit vjetor në masën 100% apo 0.43 miliard lekë më shumë dhe me rritje kundrejt vitit të kaluar në masën 7.8% ose 28.7 miliard lekë.

Grafiku 3 Të Ardhurat Tatimore (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Të ardhurat nga "Tatime dhe Dogana", (nuk përfshihen të ardhurat nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore) kontribuojnë në buxhetin e shtetit me rreth 18.9% të PBB-së, me një realizim ndaj

planit vjetor në nivelin 98%. Krahasuar me një vit më parë, të ardhurat nga tatimet dhe Doganat janë rritur me +17.6 miliard lekë ose 6.4% më shumë.

Grafiku 4 Të Ardhurat nga Tatimet dhe Doganat (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Të ardhurat nga pushteti vendor u realizuan në 18.4 miliard lekë, rreth 20% apo 3 miliard lekë më shumë se të ardhurat e planifikuara për vitin 2017 dhe 23.4% (+3.5 miliard lekë) më shumë krahasuar me 12-mujorin e një viti më parë. Zërat që përbëjnë të ardhurat nga pushteti vendor janë: Tatimi mbi pasurinë (ndërtesat), Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe Taksat lokale, ku janë arkëtuar përkatësisht 4.9 miliard lekë, 0.3 miliard lekë dhe 13.3 miliard lekë.

Grafiku 5 Të ardhurat nga Pushtetit Vendor (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Të ardhurat nga "Fondet Speciale" rezultuan 86.8 miliard lekë, me një realizim ndaj planit në nivelin 104% ose 3.4 miliard lekë më shumë dhe 7.6 miliard lekë apo 9.7% më shume sesa një vit më parë. Zërat që përbëjnë të ardhurat nga "Fondet Speciale" janë: Sigurimi Shoqëror, Sigurimi Shëndetësor dhe të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve, përkatësisht 74 miliard lekë, 11.6 miliard lekë dhe 1.2 miliard lekë.

Grafiku 6 Të ardhurat nga Fondet Speciale (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Të ardhurat jo-tatimore rezultojnë 20.7 miliard lekë nga 22.5 miliard të një viti më parë, me një rënie vjetore prej 8% ose 1.8 miliard lekë më pak dhe me një realizim ndaj planit në masën 85% ose 3.7 miliard lekë më pak. Zërat që përbëjnë të ardhurat jotatimore janë: Transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë, të ardhurat nga institucionet buxhetore, dividendi dhe tarifa shërbimeve dhe të tjera, të cilat kanë mbledhur përkatësisht 0.9 miliard lekë, 13.7 miliard lekë, 0.2 miliard lekë, 2.3 miliard lekë dhe 3.6 miliard lekë.

Grafiku 7 Të Ardhurat Jo-Tatimore (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Administrata doganore dhe tatimore për periudhën Janar-Dhjetor 2017

Administrata doganore ka mbledhur rreth 158.5 miliard lekë, 798 milion lekë ose 0.5% më shumë se parashikimi për vitin 2017, dhe rreth 10 miliard lekë më shumë se një vit më parë, me rritje 6.8%. Pothuajse të gjithë zërat e të ardhurave që mblidhen nga administrata doganore kanë shënuar rritje krahasuar me vitin 2016 dhe respektivisht TVSH 7.2%, Akciza 7.7%, dhe Taksa doganore 5.8%. Ndërsa renta minerare ka pësuar rënie në masën 16.8% krahasuar me vitin e kaluar. Krahasuar me planifikimin vjetor, të ardhurat doganore (përveç Akcizës e cila nuk e ka

realizuar planin me 3.4%) paraqiten me rritje, përkatësisht TVSH 2%, Renta 11% dhe Taksa Doganore +1.4%.

Grafiku 8 Të Ardhurat Doganore, sipas natyrës së taksave (në milionë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Të ardhurat nga administrata tatimore (përfshirë kontributet) rezultojnë 217.7 miliard lekë nga 202.3 miliard lekë të një viti më parë, me një rritje vjetore prej 7.6% ose 15.4 miliard lekë. Ndërsa të ardhurat nga kontributet janë rritur me 10.5% mbi baza vjetore dhe 3.5% ose 2.8 miliard lekë më shumë se planifikimi. Krahasuar me vitin paraardhës, të gjitha llojet e të ardhurave tatimore kanë pasur ecuri pozitive. Konkretisht TVSH 3.4%, Tatimi mbi fitimin 8.6%, Tatimi mbi të ardhurat personale 2.2%, Taksat nacionale 9.6%.

Grafiku 9 Të Ardhurat Tatimore, sipas natyrës së taksave (në milionë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Nga të dhënat për 12-mujorin 2017, lidhur me kontributin e sektorëve të ekonomisë në totalin e të ardhurave nga administrata tatimore rezulton se peshën kryesore e zë sektori i *"Shërbimeve"* dhe sektori i *"Tregtisë"*, përkatësisht 52% dhe 20%.

Grafiku 10 Të ardhurat tatimore, sipas sektorëve (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera

- **Taksimi Indirekt**
  - *Tatimi mbi Vlerën e Shtuar*

Të ardhurat nga T.V.SH edhe në vitin 2017 zënë peshë të rëndësishme në të ardhurat buxhetore, duke përfaqësuar 9% të Produktit të Brendshëm Bruto ose sa 1/3 e totali të të ardhurave tatimore. Në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar janë mbledhur për 12-mujorin 2017, 139.5 miliard lekë, duke shënuar një rritje kundrejt vitit të kaluar në masën 6.2% ose 8.2 miliard lekë. Të ardhurat e mbledhura nga TVSH në import *janë 104,6 miliard lekë, ose 7 miliard lekë më shumë se në vitin paraardhës.* Të ardhurat nga TVSh-ja në doganë përbëjnë rreth 75% të të ardhurave totale nga TVSh-ja, kjo edhe për shkak të importit të lartë të energjisë elektrike dhe pagesës së TVSH-së në import, por edhe të importeve të materialeve nga Projekti TAP. Ndërkohë të ardhurat e mbledhura nga TVSH brenda vendit janë 35 miliard lekë, me rritje kundrejt vitit të kaluar 3.4% ose 1.2 miliard lekë. Pozitiv është fakti së janë rritur rimbursimet e TVSH-së për subjektet, kryesisht ato eksportues dhe investues. Performanca e të ardhurave nga TVSH është ndikuar nga disa faktorë:

- ✓ *Rritja e importit të energjisë elektrike si rezultat i rënies së prodhimit vendas dhe disiplinimit të konsumit, ka dhënë efekt pozitiv në të ardhurat nga TVSH.*
- ✓ *Rritja e prodhimit vendas të karburantit ka ulur importin e këtij produkti dhe si rrjedhojë të ardhurat nga TVSH- ja në import. Karburanti prodhim vendas mbuloi rreth 27.2% të konsumit gjatë 12 mujorit të vitit 2017 krahasuar me 4.1% që ishte ky tregues vitin e kaluar. Efekti negativ për shkak të sasisë, është zbutur nga rritja e çmimeve ndërkombëtare të karburanteve. Ndërkohë rritja çmimit të karburantitit në bursat ndërkombëtare ku kuotohen këto produkte, ka dhënë rezultat pozitiv.*

- ✓ *Rritja e importit të metaleve bazë dhe artikujve prej tyre me rreth 10.8 mijë ton, dhe rritja e çmimit ndërkombëtar ka sjell rriitje në të ardhurat nga TVSH në import nga ky grup produkt.*
- ✓ *Fillimi i ndryshimit në muajt e fundit të vitit të kursit të këmbimit të monedhës vendase krahasuar me Euro-n dhe USD, cka impaktoi vlerën e tatueshme në import.*
- ✓ *Rimbursimi i TVSh-së për periudhën 12-mujore ka arritur 13.9 miliard lekë, me një rritje kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar prej 56.3% ose 5 miliard lekë.*

Tabela 7 Të dhëna Janar-Dhjetor 2017, krahasuar me 2016

Produktet	Sasia	Arsyet
Energji elektrike	1,564,597 MegaVator	Rritje e importit me 102%, si rezultat i rënies së prodhimit vendas krahasuar me vitin 2016.
Karburant import	(107,054 ton)	Efekti negativ për shkak të sasisë, është zbutur nga rritja e çmimeve ndërkombëtare të karburanteve. Rritja e çmimit të karburantitit në bursat ndërkombëtare ku kuotohen këto produkte, ka dhënë rezultat pozitiv.
Metalet Bazë dhe artikujt prej tyre	10,800 ton	Efekti pozitiv si rezultat i rritjes së sasisë së importuar dhe çmimeve ndërkombëtare.

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Të dhënat 12mujore të vitit 2017 mbi shpërndarjen sektoriale të TVSh-së brenda vendit, tregojnë se *"Shërbimet"*, *"Tregtia"*, *"Ndërtimi"* dhe *"Prodhimi"* kanë patur peshën kryesore.

Grafiku 11 TVSH-ja brenda vendit, sipas sektorëve (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Akciza

Të ardhurat nga Akciza për periudhën Janar–Dhjetor 2017 arritën në rreth 45.1 miliard lekë; 3.2 miliard lekë apo 7.7% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016; Të ardhurat nga kjo taksë u realizuan nën nivelin e planifikuar, me rreth 3.4% ose 1.6 miliard lekë. Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata për periudhën ka qenë si vijon:

- ✓ *Sasia e karburanteve (import + prodhim vendas) për periudhën Janar – Dhjetor 2017 është 554,426 ton, me rritje vjetore prej 5%.*
- ✓ *Sasia e cigareve të importuara për periudhën Janar–Dhjetor 2017 është 3,106 ton, me rritje vjetore prej 7%.*
- ✓ *Sasia e birrës (import + prodhim vendas) për periudhën Janar – Dhjetor 2017 është 83,642 mijë litra, me rritje vjetore prej 17%.*

Tabela 8 Importi i mallrave kryesore të akcizës 2016-2017

Mallrat e forta	Njësia e matjes	Janar- Dhjetor		Diferenca	
		2016	2017	në njësi fizike	në %
Cigare	Ton	2,907	3,106	199	7%
Birrë (import+prodhim Vendi)	Mijë litra	71,530	83,642	12,112	17%
Gaz i Lëngët	Ton	103,670	120,072	16,402	16%
Karburant (Import+Prodhim Vendi)	Ton	529,116	554,426	25,309	5%
Kafe	Ton	8,895	8,486	-409	-5%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Grafiku 12 Akciza në vite (miliard LEK) dhe sipas natyrës së mallrave (import&prodhim vendas) (në %)





Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

- *Taksat doganore*

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën Janar–Dhjetor 2017 janë rreth 6.5 miliard lekë; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, të ardhurat nga kjo taksë janë rritur me 355 milion lekë ose 5.8% dhe 1.4% ose 92 milion lekë më shumë se plani. Faktor kryesor në përmirësimin e performancës është rritja e importit të taksuar me 6% krahasuar me Janar–Dhjetor 2016 si dhe përmirësimi i kontrollit doganor. Ndërkohë, në kuadrin e angazhimeve

ndërkombëtare të vendit tonë në lidhje me tregtinë, ka vazhduar reduktimi apo zerimi i nje sërë tarifash doganore për mallra me origjinë të caktuar.

- *Taksat nacionale*

Të ardhurat nga taksat nacionale për periudhën janë realizuar në vlerën 36.2 miliard lekë nga 37.6 miliard lekë të parashikuara për periudhën Janar – Dhjetor 2017, me mosrealizim ndaj planit në masën 3.8% ose 1.4 miliard lekë. Krahasuar me vitin e kaluar, të ardhurat nga taksat nacionale janë rritur me 9.6% apo 3.2 miliardë lekë më shumë. Faktor kryesor me ndikim në këtë realizim kanë qenë të ardhurat nga rivlerësimi i pasurive të paluajtshme rreth 3.6 miliard lekë.

- **Taksimi direkt**

- *Tatimi mbi të ardhurat personale*

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 32.1 miliard lekë për periudhën Janar-Dhjetor 2017, me rritje kundrejt vitit të kaluar në masën 2.2% ose 692 milion lekë dhe me realizim ndaj planit në masën 89% ose 3.8 miliard lekë më pak. Të ardhurat nga të punësuarit e sektorit publik dhe privat, krahasuar me vitin e kaluar janë rritur me 14%. Numri i kontribuesve për muajin dhjetor 2017, është rritur me afërsisht 37 mijë kontribues ose 6.2%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Referuar mosrealizimit ndaj planit, ndikim ka pasur reduktimi i pagesës së tatimit në burim për shitjet e pasurive të paluajtshme për shkak të "Ligjit të Rivlerësimit", me efekt – 2,8 miliard lekë. Gjithashtu, stimuli monetar i aplikuar nga Banka e Shqipërisë, përmes uljes së normës bazë të interesit, është reflektuar në ulje të të ardhurave nga interesat dhe tatimit të lidhur me to. Sipas burimit të të ardhurave individuale që taksohen, bazuar në të dhënat për 12-mujorin 2017, situata pasqyrohet në grafikun më poshtë:

Grafiku 13 TAP, në vite (në miliardë LEK) dhe sipas zërave (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

- *Tatim Fitimi*

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 12-mujorin 2017 arritën në rreth 31.6 miliard lekë nga 29.1 miliard të mbledhura një vit më parë, me një rritje prej 8.6% ose 2.5 miliard lekë më shumë.

Krahasuar me planin këto të ardhura kanë pasur një performancë pozitive me rreth 8.4% ose 2.4 miliard lekë.

Grafiku 14 Tatimi mbi Fitimin, në vite (në miliardë LEK) dhe sipas sektorëve (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Ndikim kryesor në këtë rezultat ka patur, rritja e ndërgjegjësimit të taksapaguesve për deklarimin real të të ardhurave të realizuara, aksionit kundër informalitetit në ekonomi dhe intensifikimit të komunikimit të Administratës Tatimore me tatimpaguesit.

- *Renta Minerare*

Të ardhurat nga renta minerare në eksport janë realizuar në vlerën 2.3 miliard lekë, 16.8% ose 471 milion lekë më pak krahasuar me 12 mujorin e vitit 2016 dhe 11.1% ose 233 milion lekë më shumë se plani. Të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto janë ulur me 874 milion lekë për shkak të rënies së sasisë së eksportuar, me rreth 406 mijë ton, e destinuar kjo për përpunim vendas dhe janë rritur me 383 milion lekë për shkak të rritjes së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare krahasuar me Janar-Dhjetor 2016, duke sjellë rritje të rentës për njësi nga 2.2 lekë/kg në 2.9 lekë/kg. Ndërkohë, sasia e mineraleve të eksportuara është rritur me 7.3% krahasuar me Janar-Dhjetor 2016.

- **Të ardhurat e fondeve speciale**

Të ardhurat nga fondet speciale për periudhën Janar-Dhjetor 2017 arritën në 86.8 miliard lekë me një realizmin në masën 104% kundrejt planit dhe 10% ose 7.6 miliard lekë më shumë krahasuar me 2016. Ky grup të ardhurash përbën rreth 20% të totalit të të ardhurave të përgjithshme për këtë periudhë, ku rreth 86 miliard lekë janë kontribute të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe 1.2 miliard lekë të ardhura për kompensimin në vlerë të pronarëve. Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur rreth 74 miliard lekë, 7.3 miliard lekë ose 11% më shumë sesa 2016 dhe nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 11.6 miliard lekë, 1 miliard ose 7% më shumë se 2016. Përsa i takon bazës së taksueshme, nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën 12-mujore rezulton se në total ka një rritje të numrit

mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve krahasuar me mesataren e 2016. Numri i kontribuesve për muajin dhjetor 2017, është rritur me afërsisht 37 mijë kontribues ose 6.2%, krahasuar me 2016.

Grafiku 15 Kontribuesit aktiv, sipas llojit të biznesit dhe sektorëve ekonomik (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018);

Peshën më të madhe, për numër mesatar kontribuesish e zë biznesi i madh dhe ndërmarrjet shtetërore buxhetore, përkatësisht 51% dhe 22%. Në sektorin shtetëror vihet re një rritje e këtij treguesi me 2% në ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore, dhe 1% në ndërmarrjet shtetërore buxhetore. Edhe në sektorin privat ky tregues ka shënuar rritje dhe konkretisht 7% në biznesin e madh, 18% në biznesin e vogël me TVSH dhe 8% në biznesin e vogël pa TVSH. Duke e analizuar nga këndvështrimi i sektorëve të ekonomisë, krahasuar me vitin e kaluar, ky tregues ka pësuar këto ndryshime: sektori i "Shërbimeve" është rritur me 5%, sektori i "Prodhimit" është rritur me 9%, sektori "Ndërtimit" është rritur me 5%, sektori i "Tregtisë" është rritur me 7% dhe sektori i Transpotit është rritur me 3%.

IV.2 Shpenzimet e Përgjithshme

Shpenzimet e përgjithshme publike, për vitin 2017, arritën në rreth 461.4 miliardë LEK me një realizim në masën 98.7 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe 97.3 përqind të planit vjetor sipas Aktit Normativ Nr.3 datë 06.11.2017 (Planit të Rishikuar). Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016 ky zë ka rezultuar 6.4 përqind më i lartë ose rreth 27.7 miliardë LEK më shumë.

Shpenzimet korrente dhe ato kapitale, kanë shënuar një realizim të kënaqshëm, respektivisht në masën rreth 98 përqind dhe 92 përqind të planit vjetor fillestar, si dhe 97.2 përqind e rreth 93.4 përqind të planit vjetor të rishikuar.

Tabela 9 Treguesit fiskal të konsoliduar për vitin 2017 (në milion LEK).

Emertimi	Dhjetor 2017			Diferenca		
	Plan Vjetor AN3	Fakt	Fakt-Plan Vjetor AN3	ne % mbi Plan Vjetor AN3	Plani Vjetor Buxheti Fillestar	% e realizimit vjetor sipas Buxhetit Fillestar
Te Ardhurat e Pergjithshme	442,901	430,397	-12,504	97.2%	436,401	98.6%
Shpenzimet e Pergjithshme	474,101	461,410	-12,691	97.3%	467,600	98.7%
Shpenzimet Korente	*393,371*	*382,287*	*-11,084*	*97.2%*	*390,169*	*98.0%*
Shpenzimet Kapitale	*73,330*	*68,455*	*-4,875*	*93.4%*	*74,431*	*92.0%*
Deficit/Suficit	-31,200	-31,012	188	99.4%	-31,199	99.4%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Tabela 10 Treguesit fiskal vjetor të konsoliduar 2017 vs 2016 (në milion LEK).

Emertimi	Fakt Dhjetor 2016	Plani 2017 Buxhet Fillestar	Plan 2017 AN3	Fakt 2017	Diferenca				Diferenca	
					Fakt 2017 Plan B.F 2017	Fakt 2017 Plan AN3 2017	Ne % ndaj Plan B.F 2017	Ne % ndaj Plan AN.3 2017	Fakt 2017 Fakt 2016	Ne % ndaj Fakt 2016
Te Ardhurat e Pergjithshme	407,021	436,401	442,901	430,397	-6,004	-12,504	98.6%	97.2%	23,376	105.7%
Shpenzimet e Pergjithshme	433,697	467,600	474,101	461,410	-6,190	-12,691	98.7%	97.3%	27,713	106.4%
Shpenzimet Korente	*368,720*	*390,169*	*393,371*	*382,287*	*-7,882*	*-11,084*	*98.0%*	*97.2%*	*13,567*	*103.7%*
Shpenzimet Kapitale	*59,478*	*74,431*	*73,330*	*68,455*	*-5,976*	*-4,875*	*92.0%*	*93.4%*	*8,977*	*115.1%*
Deficit/Suficit	-26,676	-31,199	-31,200	-31,012	187	188	99.4%	99.4%	-4,336	116.3%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Grafiku 16 Shpenzimet e përgjithshme dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet korrente në raport me planin fillestar të vitit 2017, paraqesin një realizim prej rreth 98 përqind dhe 97.2 përqind të planit vjetor të rishikuar, duke rezultuar në rreth 382.3 miliardë LEK. Zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korente janë përkatësisht:

- ✓ *shpenzimet e personelit me rreth 97.1 përqind të planit vjetor fillestar dhe 96.9 përqind të planit vjetor të rishikuar,*
- ✓ *shpenzimet për fondet speciale me 100 përqind të planit vjetor fillestar dhe rreth 99.3 përqind të planit vjetor të rishikuar,*
- ✓ *shpenzimet operative mirëmbajtje me rreth 97.2 përqind të planit vjetor fillestar dhe rreth 96.6 përqind të planit vjetor të rishikuar.*

Grafiku 17 Shpenzimet korente dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet e Personelit gjatë vitit 2017, përfaqësuan rreth 19 përqind të totalit të shpenzimeve korente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 72.6 miliardë LEK, realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në planin vjetor fillestar në masën rreth 97.1 përqind dhe 96.9 përqind të planit vjetor të rishikuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, ky zë është 7.6 përqind më i lartë ose 5.1 miliardë më shumë.

Grafiku 18 Shpenzimet e Personelit dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për Paga, në fund të vitit 2017 u realizuan në masën rreth 62.6 miliardë LEK, duke qenë 7.5 përqind më të larta se e njëjta periudhë e vitit 2016, ose rreth 4.4 miliardë LEK më shumë. Për rrjedhojë, edhe shpenzimet për sigurime shoqërore rezultuan në masën rreth 7.9 përqind më të larta se një vit më parë. Realizimi faktik i këtyre zërave së bashku, është në nivelin rreth 97.1 përqind kundrejt planit fillestar dhe 96.9 përqind të planit vjetor të rishikuar.

Grafiku 19 Shpenzimet e pagave dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për Interesa, gjatë vitit 2017 kanë përfaqësuar 8.3 përqind të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën rreth 76 përqind të planit vjetor fillestar dhe 84.2 përqind të planit vjetor të rishikuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, ky zë ka rezultuar 12 përqind më i ulët, me një kursim nominal në masën rreth 4.4 miliardë LEK.

Grafiku 20 Shpenzimet për Interesa (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet Operative & Mirëmbajtje, gjatë vitit që lamë pas, kanë shënuar një realizim në masën rreth 43.4 miliardë LEK, me rreth 97.2 përqind e planit vjetor fillestar dhe rreth 96.6 përqind e planit vjetor të rishikuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, ky zë ka rezultuar 2 përqind më i ulët ose 888 milion LEK më pak.

Grafiku 21 Shpenzimet operative dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për Subvencione, në fund të vitit 2017, arritën nivelin rreth 2.3 miliardë LEK, me një realizim në masën rreth 99.2 përqind të planit fillestar dhe 98.8 përqind të planit të rishikuar. Kundrejt vitit 2016, shpenzimet për subvencione rezultojnë 33.9 përqind më të larta ose 585 milion LEK më shumë.

Grafiku 22 Shpenzimet për Subvencione dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për Fondet Speciale për vitin 2017 rezultuan në nivelin rreth 162.1 miliardë LEK, me një realizim 100 përqind kundrejt planit vjetor fillestar dhe rreth 99.3 përqind kundrejt planit të rishikuar. Përkatësisht:

- ✓ *Shpenzimet për Sigurime Shoqërore* u realizuan në masën rreth 119.1 miliardë LEK, me një realizim në masën rreth 101.3 përqind të planit fillestar dhe 100.4 përqind të planit të rishikuar.
- ✓ *Shpenzimet për sigurime shëndetësore* në rreth 39.1 miliardë LEK me një realizim në masën rreth 102.5 përqind të planit fillestar dhe 102 përqind të planit të rishikuar.
- ✓ *Shpenzimet për kompensimin e pronarëve* në rreth 3.97 miliardë LEK me një realizim në masën rreth 104.6 përqind të planit fillestar dhe po ashtu të planit të rishikuar.

Grafiku 23 Shpenzimet për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për Papunësinë për vitin 2017 janë realizuar në masën rreth 43 përqind e planit vjetor fillestar dhe 57.6 përqind e planit vjetor të rishikuar. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2016 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën rreth 50 përqind, ose 345 milion LEK në terma nominalë.

Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK) në vitin 2017 u realizuan në masën rreth 101 përqind të planit vjetor fillestar dhe atij të rishikuar. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2016 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 3.4 përqind ose 688 milion LEK më shumë në terma nominalë.

Kompensimi për ish-të Përndjekurit Politikë, në fund të vitit 2017 arriti nivelin rreth 2.3 miliard LEK, me një realizim në masën 115 përqind e planit vjetor fillestar ose 298 milion lekë më shumë dhe 98 përqind ose 54 milion lekë më pak se plani vjetor i rishikuar. Ecuria e shpenzimeve për këtë zë është e lidhur ngushtë me ritmin dhe korrektësinë e aplikimit dhe kompletimit të dosjeve nga ana e përfituesve, proces i cili kërkon një kohë të konsiderueshme.

Grafiku 24 Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike, PAK dhe Papunësinë (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Huadhënia neto, në fund të vitit 2017 arriti nivelin faktik rreth 9.2 miliard LEK me një realizim në masën 7.7 miliard LEK më shumë se plani vjetor fillestar ose rreth 4.7 miliard LEK më shumë se plani vjetor i rishikuar. Kjo përsa kohë që, në vijim të kriterit të FMN për të qenë në përputhje me standartet ndërkombëtare, të dhënat faktike vjetore të këtij zëri përfshijnë jo vetëm realizmin e huadhënies ndaj sektorit energjitik, por edhe të gjitha nënhuatë ndaj sektorëve të tjerë. Disbursimet për energjinë kanë qenë 4.9 miliardë lekë, ndërsa për ujësjellësat 3.07 miliardë lekë. Në total për këto dy zëra disbursimi gjatë 2017 ka qenë 7.9 miliardë lekë.

Shpenzimet kapitale, në vijim të analizës së ecurisë së realizimit të investimeve publike, për vitin 2017 është konstatuar një realizim në masën rreth 68.46 miliardë LEK duke përbërë rreth 92 përqind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë sipas buxhetit fillestar dhe rreth 93.4 përqind sipas planit vjetor të rishikuar. Respektivisht:

- ✓ *projektet e investimeve me financim të brendshëm kanë shënuar një realizim në masën rreth 45.6 miliardë LEK ose 97.7 përqind të planit fillestar dhe 94.9 përqind të planit të rishikuar. Investimet nga të ardhurat e Arsimit të Lartë kanë shënuar një realizim në masën 588 milionë lekë. Pra, së bashku me këtë zë, në total realizimi për financimin e brendshëm është 46.1 miliardë lekë.*
- ✓ *ato me financim të huaj janë realizuar në masën rreth 22.3 miliardë LEK ose rreth 83.2 përqind e planit vjetor fillestar dhe rreth 90.7 përqind të planit vjetor të rishikuar.*

Grafiku 25 Shpenzimet Kapitale dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Grafiku 26 Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Grafiku 27 Detajimi i Shpenzimeve Buxhetore (në milion LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Grafiku 28 Të ardhurat, shpenzimet dhe deficiti - Buxhet fillestar vs AN.3 vs Fakt 2017 (në milion LEK).



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet për Pushtetin Vendor, gjatë vitit 2017 kanë përbërë rreth 12.2 përqind të shpenzimeve korente. Për vitin 2017 këto shpenzime janë realizuar në masën rreth 113.7 përqind e planit vjetor fillestar ose 100.2 përqind e planit vjetor të rishikuar. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2016 ky nivel rezulton rreth 2.9 miliardë më i lartë ose 6.7 përqind më shumë.

Grafiku 29 Shpenzimet e Pushtetit Vendor dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet e pushtetit vendor janë një tregues i rëndësishëm i financave publike që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shërbimet publike të ofruara. Ndër vite ato janë një tregues në rritje dhe kjo vjen si pasojë e rritjes së nivelit të shërbimeve dhe funksioneve që pushteti vendor ofron për qytetarët. Rritja e nivelit të shpenzimeve e shoqëruar me rritje të cilësisë së shërbimve është forma më e mirë për të ndikuar drejtpërdrejt me punë publike në jetën e qytetarëve. Përmes analizës së buxhetit vendor do të kuptojmë ndryshimet në vite të mënyrës së menaxhimit të shpenzimeve vendore dhe cili ka qënë efekti në treguesit e buxhetit vendor të konsoliduar.

Buxheti vendor për vitin 2017 ishte planifikuar 3 përqind e PBB dhe krahasuar me vitin 2013 është rritur me 1 përqind të PBB, ndërkohë që për periudhën 2006 - 2013 ishte rritur nga 0.1 deri në 0.4 përqind e PBB. Rritja e buxhetit vendor me më shumë se sa rritja e buxhetit të shtetit dhe rritja e konsiderueshme ndaj PBB-së, tregon rëndësinë dhe vlerësimin që i është kushtuar procesit të decentralizmit dhe zbatimit të reformës administrativo-territoriale me mbështetje financiare pas vitit 2016. Në vlerë absolute buxheti vendor ka një rritje për afërsisht rreth 3 miliard lekë në vitin 2017 më shumë se viti 2016, ndërkohë që ritmi i rritjes së këtyre shpenzimeve ka ardhur në rënie nga 28% në vitin 2016 në 7% në vitin 2017. Ky ndryshim vjen për shkak se në buxhetin e vitit 2016 rritja e shpenzimeve buxhetore vjen si rrjedhim i transferimit të funksioneve të reja në buxhetin vendor i cili u shoqëruar me një faturë fianciare rreth 6.7 miliard lekë.

Shpenzimet e pushtetit vendor sipas strukturës kanë pësuar luhatje të vogla por në tërësi struktura ka mbetur e njëjtë. Duke iu referuar grafikut të mëposhtëm pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet kapitale të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe pas tyre vijnë shpenzimet për paga.

Grafiku 30 Shpenzimet e Pushtetit Vendor sipas strukturës (në milionë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Gjatë vitit 2017, si viti i dytë i plotë zbatimit të reformës administrativo-territoriale si dhe fillimit të zbatimit të ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore, janë ndërmarrë hapa të rëndësishme për rritjen e qendrueshmërisë dhe kapacitetit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore. Rritja e të ardhurave krahasuar me vitin 2016 si dhe rritja e shpenzimeve për investime janë një dëshmi e qartë e një tendence pozitive në menaxhimin e financave publike vendore. Më poshtë

paraqitet në mënyrë të përmbledhur tabela e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike vendore.

Tabela 11 Të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit vendor, sipas natyrës

Të dhëna progresive (në milionë LEK)					
Nr	E M Ë R T I M I	Fakt 12 mujori		Diferenca	
		2017	2016	2017/2016	% e 2017 kundrejt 2016
I.	**Të ardhura nga Pushteti vendor**	**18.447**	**14.951**	**3.496**	**123%**
I.1	Taksa mbi pasurinë	4.879	4.678	201	104%
I.2	Taksa e biznesit të vogël	296	598	-302	49%
I.3	Taksa Lokale	13.273	9.675	3.598	137%
II.	**Shpenzime nga Pushtetit Vendor**	**46.487**	**43.655**	**2.832**	**106%**
II.1	**Shpenzime Korente**	30.204	26.880	3.324	112%
	Personeli	19.118	15.827	3.291	121%
	Shpenzime Oper. Mirmbajtje	10.132	10.136	-4	100%
	Subvencione	142	108	34	132%
	Te tjera	812	809	3	100%
II.2	**Shpenzime Kapitale**	**16.283**	**16.775**	**-492**	**97%**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Shpenzimet Vendore për Personelin përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të njësive të vetëqeverisjes vendore. Për vitin 2017, këto shpenzime janë realizuar në masën 19.1 miliard lekë ku krahasuar me vititn 2016, janë më të mëdha. Rritja e këtyre shpenzimeve për vitin 2017, argumentohet me faktin se në buxhetin e vitit 2017 njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë rritur sasinë dhe cilësinë e shërbimeve publike Në vijim të transferimit të funksioneve të reja në vitin 2016 është bërë shtimi dhe plotësimi i disa funksioneve me numër punonjësish të rinj si shërbimi zjarrëfikës, ujitja dhe kullimi, pyjet etj. Gjithashtu gjatë vitit 2017, paralelisht me ndryshimet e nivelit të pagave në adminsitratën qëndrore kanë ndryshuar pagat në nivel vendor, kjo ka bërë që në vitin 2017 të kemi edhe një rritje të nivelit të pagave në raport me vitin 2016. Në këto kushte duke parë të dhënat e realizimit faktik të buxhetit 2017 pas reformës adminsitrativo territoriale njësitë vendore kanë nisur konsolidimin e shpenzimeve të personelit. Këto ndryshime reflektohen drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së nëpunësve vendorë dhe sigurisht nivelit të shërbimeve ndaj qytetarëve që njësia ofron.

Shpenzimet Vendore Operative janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve për vitin 2017 rezultojnë pothuajse në të njëjtin nivel të vitit 2016. Shpenzimet operative përbëjnë rreth 33% të shpenzimeve korrente në total për vitin 2017, një pjesë kjo jo e vogël për buxhetin njësive vendore. Nga sa më sipër, vëmë re se në buxhetin faktik 2017 edhe pse është rritur niveli i funksioneve dhe shërbimeve ndaj qytetarëve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, shpenzimet që ato kanë realizuar ndaj totalit kanë zbritur konsiderueshëm. Kjo tregon që administrata vendore ka zhvilluar punën me një efiçensë më të lartë duke bërë që këto shpenzime operative të zënë një hapësirë me të vogël në buxhetin vendor.

Shpenzimet Vendore për Subvencione dhe të tjera janë shpenzimet që zhvillojnë njësitë vendore për të subvencionuar dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Në këto kushte nga sa përcaktohet në tabelën mësipërme në raport me vitin 2016, këto shpenzime në vitin 2017 kanë

rritje në zërin subvencione me 28% dhe kanë qëndruar në të njëjtat niveli në zërin të tjera në masën rreth 8 milion lekë. Këto ndryshime janë rezultat i procesit të riorganizimit dhe të shtrirjes së re që kanë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Shpenzimet Kapitale Vendore janë një zë mjaft i rëndësishëm jo vetëm për faktin që përbëjnë pjesën më të madhe të buxhetit vendor por edhe për shkak sepse këto shpenzime janë ato çfarë prek drejtpërdrejt qytetari. Nga tabela e mësipërme vëmë re që shpenzimet për investime për vitin 2017 janë 16 miliard lekë, shifër e konsiderueshme për buxhetin vendor. Kjo ka mundësuar që gjatë vitit 2017 të ndjehet konsiderueshëm sasia e investimeve vendore në raport me një vit më parë. Rritja e këtyre shpenzimeve në buxhetin i vitit 2017 tregon qartë që pushteti vendor më shtrirjen e gjërë territoriale tashmë ka më shumë potencial investimi dhe zhvillimi. Në analizat dhe monitorimin e buxhetit vendor është nxitur vazhdimisht rritja e peshës së investimeve në raport me shpenzimet e personelit.

Në përfundim, buxheti i vitit 2017 për njësitë e vetëqeverisjes vendore, garantoi konsolidimin e të ardhurave dhe shpenzimeve që ata kanë në dispozicion. Gjithashtu, në kuadrin e përmirësimit të proceseve të menaxhimit financiar vendor tashmë njësitë e vetëqeverisjes vendore u përmirësuan jo vetëm treguesit sasiorë të buxhetit vendor, por edhe cilësia e menaxhimit financiar vendor, me tregues konkret dhe të matshëm të performacës së shërbimeve. Mbështetur mbi të dhënat e buxhetit faktik 2017, mund të themi se tashmë për financat vendore është një fillim i ri i mënyrës se si menaxhohet procesi i mbledhjes së të ardhurave, i përdorimit të këtyre të ardhurave, i transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin dhe zbatimin e buxhetit vendor. Njësitë e vetëqeverisjes vendore tashmë janë në rrugën e duhur të konsolidimit fiskal të të ardhurave dhe rritjes së cilësisë së alokimit të shpenzimeve vendore për ofrimin e një jete më të mirë për qytetarët.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR), për vitin 2017, është miratuar në vlerën 9.5 miliardë lekë. Me Aktin Normativ nr.2 datë 16.08.2017 *"Për disa ndryshime në Ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017"*, vlera e FZHR-së për infrastrukturën vendore u pakësua me 600 milionë lekë. Me Aktin Normativ nr.3 datë 06.11.2017 *"Për disa ndryshime në Ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar"*, vlera e FZHR-së për infrastrukturën vendore u pakësua me 1.5 miliard lekë. Përmes këtyre fondeve, gjatë vitit 2017, është financuar:

- *Programi "Zhvillimi i Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale"*

Për financimin e projekteve të infrastrukturës vendore dhe rajonale (në vazhdim dhe të reja) është përdorur fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2017. Financimi i projekteve të FZHR-së-infrastruktura vendore dhe rajonale për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për vitin 2017, kap vlerën 6.735 miliardë lekë. Këto investime kanë patur një realizim faktik në masën 88.4 përqind ose rreth 5.952 miliard lekë. Gjithashtu, në programin "Zhvillimi i Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale", për njësitë e qeverisjes qendore janë alokuar 665 milionë lekë gjatë vitit 2017, për projekte të reja dhe në vazhdim. Alokimet kryesore të këtyre fondeve kanë qenë si vijon:

- ✓ Për Këshillin e Ministrave në total janë alokuar 307.7 milionë lekë, të cilat janë realizuar në masën 99.3 përqind, ose rreth 305.6 milionë lekë.

- ✓ Për grupin 87 'Institucione të Tjera Buxhetore" janë alokuar në total 65.6 milionë lekë, të cilat janë realizuar në masën 100 përqind.
- ✓ Për " Fondin Shqiptar të Zhvillimit" , janë alokuar në total 291.5 milionë lekë, të cilat janë realizuar në masën 100 për qind.

V. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK DHE REALIZIMI I OBJEKTIVAVE

Borxhi publik gjatë vitit 2017 përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me objektivat Makro-Fiskale, buxhetin e planifikuar për vitin 2017 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB). Niveli i borxhit publik në raport me PBB u vlerësua me rënie për të dytin vit radhazi. Vlerësimet paraprake sinjalizojnë një rënie të Borxhit Publik në raport me PBB me rreth 2.5 pikë përqindje. Ndërkohë, në linjë me buxhetin e vitit 2017 u realizua me sukses huamarrja, e cila mundësoi rifinancimin e borxhit ekzistues si dhe financimin e deficitit të planifikuar. Nëpërmjet burimeve të brendshme dhe të huaja, huamarrja u realizua përkatësisht në nivelin 79% dhe 131% të planit vjetor. Rritja e financimit në drejtim të atij të huaj, u realizua në kuadër të shfrytëzimit të burimeve të favorshme të financimit, si edhe të mirëmenaxhimit të likuiditetit, pasi një pjesë e likuiditetit do të përdoret për përmbushjen e nevojave të vitit fiskal pasardhës. Objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit gjatë vitit 2017 u realizuan me sukses, si në kuadër të optimizimit të raporteve ndërmjet kostove dhe risqeve, ashtu edhe në kuadër të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë.

Në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, huamarrja në tregun e brendshëm u përqendrua kryesisht tek titujt afatgjatë dhe me norma interesi fikse. Ndërkohë, përqendrimi i huamarrjes së huaj në burimet e financimit me natyrë dypalëshe dhe shumëpalëshe, mundësoi uljen e kostove të huamarrjes, si edhe uljen e presionit për hua në tregun e brendshëm. Gjatë vitit 2017, jo vetëm kostot për njësi, por edhe kostot e përgjithshme të huamarrjes u ulën ndjeshëm krahasuar me vitin e mëparshëm. Në këtë aspekt, vlen të theksohet rënia e shpenzimeve për interesa të Borxhit Shtetëror me rreth 4.4 miliard Lek krahasuar me vitin e kaluar.

Në vazhdim të angazhimit të marrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar të titujve shtetërorë, si edhe krijimin e kushteve për zhvillimin e tregut sekondar, përgjatë vitit 2017 është vijuar me aktivitete të cilat kanë pasur si qëllim rritjen e efiçencës, likuiditetit dhe transparencës në tregun e brendshëm të titujve shtetërorë. Kërkesa për tituj shtetërorë megjithëse mbetet ende jo shumë e diversifikuar dhe e bazuar kryesisht tek sektori bankar, në vitin 2017 ka qenë e kënaqshme dhe është shoqëruar me një diversifikim të moderuar në drejtim të institucioneve financiare dhe atyre jo financiare.

Normat e interesit të titujve shtetërorë gjatë vitit 2017 kanë pësuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2016, por megjithatë ato vazhdojnë të jenë në nivele relativisht të ulëta krahasuar me mesataren e tre viteve të mëparshme.

VI. SHTOJCAT

VI.1 Shtojca 1 – Zbatimi dhe monitorimi i parimeve dhe rregullave fiskal

Ligji Nr.57 datë 02.06.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar" (referuar në vijim si Ligji Organik i Buxhetit - LOB), në nenin 4/1 sanksionon disa parime dhe rregulla fiskale për mirë-menaxhimin e financave publike në Shqipëri. Ky seksison paraqet zbatueshmërinë e këtyre parimeve dhe rregullave fiskalë përgjatë vitit 2017.

Përcaktimi ligjor (1):

Neni 4/1, pika (1.a) i LOB sanksionon që në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto.

Zbatimi i ligjit (1):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2017 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela më poshtë paraqet me shifra specifike përputhshmërinë e sejcilit ligj të buxhetit për vitin 2017 me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2017

Ligj Nr. 130, dt. 15.12.2016		Ligj Nr.2/2017, dt. 16.08.2017 (A.N)		Ligj Nr.3/2017, dt. 6.11.2017 (A.N)	
Borxhi i vlerësuar për vitin 2016 (% PBB)	Borxhi i planifikuar për vitin 2017 (% PBB)	Borxhi i vlerësuar për vitin 2016 (% PBB)	Borxhi i planifikuar për vitin 2017 (% PBB)	Borxhi i vlerësuar për vitin 2016 (% PBB)	Borxhi i planifikuar për vitin 2017 (% PBB)
71.8%	69.1%	71.0%	68.9%	71.0%	68.9%

***Shënim**: Niveli i borxhit faktik i rezultuar në fund të 2017 nuk është relevant për sa i përket zbatueshmërisë ligjore të këtij neni/pike të LOB. Ky nen sanksionon vetëm nivelin e planifikuar të borxhit për 2017 dhe jo atë të rezultuar faktikisht në fund të vitit. Niveli faktik i rezultuar në fund të vitit është informues mbi efektshmërinë e LOB sa i takon uljes faktike të borxhit, por nuk është relevant sa i takon zbatueshmërisë/përputhshmërisë me ligjin.*

Sa i takon efektshmërisë së këtij rregulli fiskal në LOB lidhur me uljen e borxhit gjatë vitit 2017 edhe ajo rezulton të ketë qenë "e plotë", pasi niveli i borxhit faktik për vitin 2017 (sipas shifrave të disponueshme deri në këtë moment të hartimit të këtij raporti) rezulton 70% e PBB. Kjo konsiston në një ulje prej rreth 2.4 pikë përqindje të borxhit publik total nga niveli prej 72.4% që ishte në vitin 2016.

Përcaktimi ligjor (2):

Neni 4/1, pika (1.b) i LOB përcakton që përjashtim nga sanksionet e pikës së mësipërme të këtij neni (pikës "a") mund të bëhet vetëm në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në nenin 4/4 të këtij LOB.

Zbatimi i ligjit (2):

Gjatë vitit 2017 nuk ka qenë rasti i aplikimit të kësaj klauzole përjashtuese.

Përcaktimi ligjor (3):

Neni 4/1, pika (1.c) i LOB sanksionon që vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin "Perspektiva Ekonomike Botërore" (Ëorld Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit.

Zbatimi i ligjit (3):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2017 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela më poshtë paraqet me shifra specifike përputhshmërinë e sejcilit ligj të buxhetit për vitin 2017 me këtë përcaktim të LOB.

Ligj Nr. 130, dt. 15.12.2016				Ligj Nr.2/2017, dt. 16.08.2017 (A.N)				Ligj Nr.3/2017, dt. 6.11.2017 (A.N)			
PBB sipas FMN[1] (miliard Lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliard Lekë)		PBB sipas FMN[2] (miliard Lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliard Lekë)		PBB sipas FMN[3] (miliard Lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliard Lekë)	
2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
1,504	1,597	1,502	1,596	1,505	1,600	1,502	1,596	1,473	1,555	1,473	1,555

(1) WEO-Tetor 2016; (2) WEO-Prill 2017; (3) WEO-Tetor 2017

***Shënim**: Vlerat faktike të PBB të vitit 2017 të vlerësuara dhe publikuara nga INSTAT nuk janë relevante për sa i përket zbatueshmërisë ligjore të këtij neni/pike të LOB. Ky nen/pikë sanksionon vetëm limitin e sipërm sa i takon PBB të parashikuar dhe përdorur gjatë planifikimeve të çdo ligji vjetor buxheti (pra, jo më i lartë se sa parashikmi respektiv i FMN). Ndërkohë që PBB faktike (pra, sipas INSTAT) e rezultuar në fund të vitit është informuese sa i takon efektshmërisë së LOB lidhur me "realizmin" e parashikimeve të PBB, dhe veçanërisht eleminin e devijimeve "optimiste" sistematike (të përsëritura disa vite rresht).*

Përcaktimi ligjor (4):

Neni 4/1, pika (1.ç) i LOB sanksionon që në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Zbatimi i ligjit (4):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2017 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela më poshtë paraqet me shifra specifike përputhshmërinë e sejcilit ligj të buxhetit për vitin 2017 me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2017		
Vlera e buxhetuar e zërit "Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit, etj"		
Ligj Nr. 130, dt. 15.12.2016	Ligj Nr.2/2017, dt. 16.08.2017 (A.N)	Ligj Nr. 130, dt. 15.12.2016
4 miliard Lekë ose 0.9% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	4 miliard Lekë ose 0.9% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	4 miliard Lekë ose 0.8% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji

Përcaktimi ligjor (5):

Neni 4/1, pika (1.d) i LOB sanksionon që në çdo ligj vjetor fillestar të buxhetit, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, kur rritja reale e Produktit të Brendshëm Bruto, e parashikuar në raportin respektiv "Perspektiva Ekonomike Botërore", të FMN-së, është të paktën 5 për qind, atëherë deficiti i përgjithshëm nuk mund të jetë më i lartë se 2 për qind e Produktit të Brendshëm Bruto, përveç rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të nenit 4/4, të këtij ligji.

Zbatimi i ligjit (5):

Në cdo fazë të hartimit dhe miratimit të ligjeve vjetore të buxhetit për vitin 2017 kjo pikë nuk ka qenë rasti të jetë kufizuese për sa i takon sanksionit ligjor që ajo përcakton, pasi në asnjë nga raportet "Perspektivës Ekonomike Botërore" të FMN-së të publikuar gjatë vitit 2017 nuk parashikohej një rritje reale për vitin 2017 të paktën 5%. Rrjedhimisht, të gjitha ligjet vjetore të buxhetit të hartuara dhe miratuara për vitin 2017 kanë qenë në përputhje me këtë pikë.

Shënim: *Kjo pikë ka si synim të ankorojë në mënyrë kundra-ciklike politikën fiskale. Pra, nëse ekonomia parashikohet të rritet "përtej potencialit të natyrshëm" të saj, që në rastin konkret ky prag është kuantifikuar në LOB si "rritja reale e parashikuar nga FMN të paktën 5%", atëherë në këtë rast kjo pikë ankoron politikën fiskale drejt një konsolidimi më të lartë në terma të borxhit publik, duke vendosur një limit direkt mbi deficitin e targetuar në jo më shumë se 2% e PBB. P.sh., një rast hipotetik, ilustrues, nëse do të ndodhte që në një vit të caktuar rritja reale do të ishte 5% dhe nëse deficiti do të ankorohej sipas kësaj pike 2% (maksimumi i lejueshëm në këtë rast), duke supozuar një normë inflacioni (deflator) 3% dhe variablat e tjerë të pandryshuar, atëherë borxhi publik përgjatë vetëm atij viti do të reduktohej me rreth 4 pikë përqindje. Ndërkohë pika (ç) në nenin 4/4 përcakton rastin e kundërt të pikës më sipër, pra përcakton një opsion manovrimi ekspansionist të politikës fiskale për të ndikuar në stabilizimin e ciklit të ekonomisë nëse do të ndodhte një rast ku ekonomia të gjendej "në një pikë tejet të dobët të saj", e cila është kuantifikuar në LOB si "rritje reale e parashikuar nga FMN në 1% ose më e ulët". Por në këtë rast, që të mund të përdoret ky opsion lehtësues për stabilizim kundra-ciklik duhet që gjithashtu të jetë siguruar*

një farë niveli relativisht i qëndrueshëm i borxhit publik, i cili në këtë pikë të LOB kuantifikohet si niveli poshtë 60% të PBB.

Përcaktimi ligjor (6):

Neni 4/1, pika (1.dh) i LOB sanksionon që në në fazat monitoruese të buxheteve faktike, nëse për shkak të rishikimeve të mundshme të PBB-së nominale ose për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit, që përdoren për vlerësimin e stokut faktik të borxhit publik, rezulton se raporti i borxhit publik ndaj PBB-së nuk është më i ulët, kundrejt nivelit të vitit pararendës, atëherë, si rregull këto devijime duhet të kompensohen në planifikimet e viteve buxhetore pasuese.

Zbatimi i ligjit (6):

Në fund të vitit 2017 niveli i borxhit faktik ka rezultuar më i ulët se sa niveli që shënonte në vitin 2016, specifikisht (deri në këtë moment të përgatitjes së këtij raporti) borxhi në vitin 2016 shënonte 72.4% ndërsa në fund të 2017 shënon 70%. Rrjedhimisht, kjo pikë nuk është relevante për sa i takon planifikimive në buxhetet pasuese.

Shënim: *Gjithsesi, kjo pikë nuk është relevante sa i takon përputhshmërisë me LOB për vitin që analizohet aktualisht, konkretisht viti 2017, por ajo ka implikime që duhen adresuar në ligjet e buxheteve të viteve të tjera në vijim nëse ndodh rasti që parashikohet në këtë pikë të LOB.*

Përcaktimi ligjor (7):

Neni 4/1, pika (2) i LOB sanksionon që të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Zbatimi i ligjit (7):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2017 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Së pari, në asnjë ligj vjetor të buxhetit 2017 nuk janë parashikuar të ardhura shtesë nga privatizimet. Së dyti, të ardhurat nga privatizimet të realizuara gjatë vitit 2017 kanë qenë në fakt marxhinale, në vlerën e rreth 0.4 miliard Lekë, por gjithsesi përdorimi i tyre ka qenë në përputhje të plotë me përcaktimet e këtij ligji. Kjo indikohet nga fakti se ndërkohë që programimi në buxhetin fillestar për huamarrjen e brendshme neto ishte rreth 20.5 miliard Lekë, huamarrja e brendshme faktike në fund të vitit rezulton konsiderueshëm më poshtë në rreth 16.3 miliard, pra me një diferencë negative prej rreth 4.2 miliard e cila kapërcen disa herë vlerën e realizuar të privatizimeve dhe rrjedhimisht indikon se të ardhurat prej tyre janë përdorur të gjitha për uljen e borxhit publik, në përputhje me përcaktimet e kesaj pike të LOB.

Përcaktimi ligjor (8):

Neni 4/1, pika (3) i LOB sanksionon që ndryshimet e ligjeve tatimore, me efekte në të ardhurat buxhetore, bëhen një herë në vit, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal. Ligjet tatimore konsultohen paraprakisht me përfaqësuesit e biznesit dhe grupe të tjera interesi, në strukturat e ngritura për këtë qëllim.

Zbatimi i ligjit (8):

Amendimet e ligjeve tatimore me efekt në të ardhurat e buxhetit për vitin 2017 janë inicuar në fillim të 6-mujorit të dytë 2016. Paketa e ndryshimeve ligjore i është nënshtruar diskutimit dhe marrjes së mendimeve nga Ministritë e linjës, si dhe nga organizatat përfaqësuese dhe grupet e interesuara të biznesit, duke reflektuar kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

Paketa fiskale është miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave në tetor dhe është miratuar nga Kuvendi në dhjetor 2017. Efektet e paketës fiskale janë marrë në konsideratë në planifikimin e të ardhurave tatimore të buxhetit 2017, buxhet i cili u miratua pas miratimit të ndryshimeve në paketën fiskale.

Përcaktimi ligjor (9):

Neni 4/1, pika (4) i LOB sanksionon që masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Zbatimi i ligjit (9):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2017 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela më poshtë paraqet me shifra specifike përputhshmërinë e sejcilit ligj të buxhetit për vitin 2017 me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2017

Ligj Nr. 130, dt. 15.12.2016		Ligj Nr.2/2017, dt. 16.08.2017 (A.N)		Ligj Nr.3/2017, dt. 6.11.2017 (A.N)	
Deficiti i targetuar (miliard Lekë)	Shpenzimet kapitale të targetuara (miliard Lekë)	Deficiti i targetuar (miliard Lekë)	Shpenzimet kapitale të targetuara (miliard Lekë)	Deficiti i targetuar (miliard Lekë)	Shpenzimet kapitale të targetuara (miliard Lekë)
31.2	74.4	31.2	74.1	31.2	73.3

Shënim: *Edhe kjo pikë e LOB jep përcaktime ligjore të detyrueshme për fazën planifikuese të buxhetit, ndërkohë që nuk është sanksionuese për rezultatin faktik në mbyllje të vitit. Megjithatë, për informacion mbi efektivitetin e këtij rregulli fiskal, rezulton se edhe rezultati faktik i fund-vitit 2017 ishte në përputhje të plotë me atë ç'ka synon kjo pikë e LOB, pra mbajtjen e investimeve publike të qeverisë qëndrore jo më pak se sa deficiti buxhetor (huamarrje plus privatizime), rregull i cili njihet ndryshe edhe si ''rregulli i artë'' i buxhetit. Konktretisht në fund të vitit deficiti i përgjithshëm buxhetor faktik ishte 31 miliardë Lekë, ndërkohë që shpenzimet kapitale faktike ishin 68.5 miliardë Lekë.*

Përcaktimi ligjor (10):

Implikim ligjor specifik për vitin 2017 si vit elektoral (zgjedhje të përgjithshme)

Neni 4/3 sanksionon që në vitet buxhetore, gjatë të cilave mbahen zgjedhjet e përgjithshme, ekzekutimi i deficitit buxhetor të qeverisjes së përgjithshme, përveç rasteve të jashtëzakonshme, të parashikuara në nenin 4/4, të këtij ligji, bëhet në përputhje me përcaktimet e këtij neni si më poshtë:

a) *ekzekutimi i deficitit deri në fund të tremujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 30 për qind e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor;*
b) *ekzekutimi i deficitit deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 55 për qind e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor;*
c) *ekzekutimi i deficitit deri në fund të nëntëmujorit të parë të vitit buxhetor nuk mund të jetë më i lartë se 80 për qind e deficitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor.*

Zbatimi i ligjit nr. 10:

Gjatë vitit 2017, i cili ka qenë një vit ku janë mbajtur zgjedhje të përgjithshme dhe rrjedhimisht aplikohet përcaktimi ligjor i mësipërm, ekzekutimi i deficiti buxhetor ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim. Tabela më poshtë paraqet me shifra specifike përputhshmërinë me këtë përcaktim të LOB.

Ekzekutimi i deficitit faktik kundrejt kufizimeve të LOB përgjatë 2017 si vit elektoral

Janar-Mars, 2017		Janar-Qershor, 2017		Janar-Shtator, 2017	
Limiti ligjor i deficitit (miliard Lekë)	Deficiti faktik (miliard Lekë)	Limiti ligjor i deficitit (miliard Lekë)	Deficiti faktik (miliard Lekë)	Limiti ligjor i deficitit (miliard Lekë)	Deficiti faktik (miliard Lekë)
Deficit vjetor * 30% -31.2 * 30% = -9.4	Suficit = +6.4	Deficit vjetor * 55% -31.2 * 55% = -17.2	Suficit = +2.7	Deficit vjetor * 80% -31.2 * 80% = -29.4	Deficit = -2.5

VI.2 Shtojca 2 – Efektet e Paketës Fiskale 2017

Masat	Efekti i parashikuar i paketës	Parashikimi i Buxhetit 2017*	Diferenca Parashikimi 2017/Fakt 2016	Diferenca Fakt 2017/Fakt 2016	Faktorët	Efektet
Nivel i reduktuar i akcizës në 2500 lekë/kg për duhanin e prodhuar brenda vendit me gjethe të duhanit nga bimë të kultivuara në Shqipëri.	+75 milion lekë	+30 milion lekë	+25.8 milion lekë	+25.8 milion lekë	Rritje të deklarimit të prodhimit vendas. Janë deklaruar afërsisht 11 ton më shumë se në 2016.	Për vitin 2017 akciza në duhanin vendas rezulton në rritje, 26 milion lekë më shumë se akciza e vitit 2016.
Vendosja e Akcizës për Gazin e Lëngët (GLN) në masën 8 lekë/litër, në rastet kur përdoret si lëndë djegëse për motorr automjetesh.	+0.6 miliard lekë	+1.6 miliard lekë (Akciza 1 miliard lekë dhe TVSH 0.6 miliardë lekë)	1 miliard lekë	+1 miliard lekë (0.7 miliard akcizë dhe 0.3 miliard TVSH)	Importi i gazit të lëngët për përdorim nga automjetet, vlerësohet 95 mijë ton për vitin 2017.	Të ardhurat buxhetore, janë rritur 1 miliard lekë, nga të cilat 0.7 miliard lekë akcizë dhe 0.3 miliard TVSH.
Ulet kufiri i vlerës së automjeteve që konsiderohen mjete luksi nga 7 milionë lekë në 5 milionë lekë.	+19 milionë lekë	+19 milionë lekë	-	+58 milion lekë	Rritje e makinave luksoze të regjistruara për vitin 2017, krahasuar me vitin 2016 në 1,541 makina.	Të ardhurat nga taksa fillestare e regjistrimit të makinave luksoze dhe taksa e përvitshme e makinave luksoze, janë 58 milion lekë më shumë se në vitin 2016.

**Parashikimi i Buxhetit 2017 është projektuar në muajin Shtator 2016.*

VI.3 Shtojca 3 – Të ardhurat e Pushtetit Vendor

Një komponent shumë i rëndësishëm i zbatimit të reformës administrativo-territoriale është përmirësimi i menaxhimit të financave publike vendore. Në këtë kuadër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes njësisë përgjegjëse për monitorimin e buxhetit vendor në mënyrë të vazhdueshme ka bërë përpjekje për mbështetje ligjore dhe teknike të këtij procesi. Dëshmi e kësaj përpjekje është edhe miratimi i Ligjit nr.68 datë 27.04.2018 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i cili përbën një hap të madh ligjor në drejtim të menaxhimit dhe konsolidimit financiar në nivel vendor. Ndryshimet strukturore dhe sasiore janë analizuar dhe ndjekur hap pas hapi si në nivel makro të pushtetit vendor ashtu edhe sipas njësive të vetëqeverisjes vendore.

Gjatë dekadës së fundit janë bërë ndryshime në ligjet për taksat dhe tarifat vendore, të cilat kanë ndikuar në të ardhurat e buxheteve vendore. Këto ndryshime kanë kanë synuar rritjen e të ardhurave për buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore. Procesi i decentralizimit është një proces dinamik dhe i vazhdueshëm që synon rritjen e autonomise së komuniteteve vendore në funksion të përdorimit me sa më efektivitet të fondeve publike. Po ashtu procesi i decentralizimit në këndvështrimin e politikave fiskale synon rritjen e autonomisë fiskale dhe për rrjedhojë edhe të të ardhurave vendore. Këto ndryshime të bëra gjatë viteve të fundit kanë synuar rritjen e diskrecionit të njësive të vetëqeverisjes vendore për të caktuar bazën dhe nivelin e taksave dhe së dyti rritjen e kapaciteteve të mbledhjes dhe administrimit të taksave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në mënyrë të vazhdueshme njësitë e reja të vetëqeverisjes vendore janë asistuar gjatë vitit 2017 për zbatimin e ligjit që rregullon financat e vetëqeverisjes vendore për përmiresimin e menaxhimit financiar në nivel vendor. Buxheti i vitit 2017 është buxheti më i lartë sa i përket madhësisë së transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave të veta të mbledhura nga taksat dhe tarifat vendore. E gjitha kjo rritje buxheti ka shkuar në favor të shërbimeve dhe investimeve publike të komuniteteve vendore.

Të ardhurat e Pushtetit Vendor dhe kapaciteti fiskal

Buxheti vendor i vitit 2017 është rreth 7 për qind më i lartë sesa ai i vitit 2016, ndërkohë që shpenzimet e buxhetit të shtetit nuk kanë pësuar ndonjë rritje të konsiderueshme në këto dy vite. Nga ana tjetër në vitin 2017 të ardhurat e veta të pushtetit vendor janë rritur me rreth 23% në raport me një vit më parë. Kjo rritje e ndjeshme e të ardhurave vendore do të analizohet në mënyrë të detajuar sipas llojit të burimit nga është krijuar. Për vitin 2017, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura (tatimore dhe jo-tatimore) në masën 18.4 miliard lekë, shifër kjo që është 3.5 miliard lekë më shumë ose gati 23 për qind më e lartë se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë vitit 2016. Edhe në raport me planin vjetor konstatojmë që ka një realizim të lartë të të ardhurave të pushtetit vendor. Rritja e potencialit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore për të siguruar të ardhura nga taksat vendore paraqitet përmes trendit gjithnjë e në rritje të këtyre të ardhurave në grafikun e mëposhtëm. Në tërësi por edhe sipas burimit të krijimit të të ardhurave vendore, të gjithë treguesit janë në një rritje të ndjeshme kryesisht të të ardhurave lokale.

Grafiku 31 Të ardhurat sipas burimit, për njësitë vendore



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Ndër vite të ardhurat e pushtetit vendor kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu edhe në strukturën e burimit të këtyre të ardhurave, por vitet e fundit këto ndryshime kanë patur ritme të ndjeshme rritëse. Të ardhurat nga taksat lokale janë ato që zënë pjesën më të madhe ose 72% të shumës totale të të ardhurave të vitit 2017. Kjo konfirmon edhe një herë që, procesi i decentralizimit dhe kryesisht reformat në financat vendore në buxhetin e vitit 2017 kanë dhënë një efekt të madh, ku tashmë njësitë e vetëqeverisjes vendore mbledhin më shumë të ardhura nga taksat dhe tarifat e veta vendore dhe sigurisht ofrojnë më shumë shërbime cilësore publike.

Parë në këtë këndvështrim rritja e efektshërisë së mbledhjes së taksave nga pushteti vendor bën që ato të sigurojnë një nivel më të lartë decentralizimi dhe gjithashtu kjo tregon që efektshmëria e mbledhjes së këtyre taksave është rritur në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu duke ju referuar totalit të këtyre të ardhurave tendencat rritëse janë qartazi të evidentueshme, ku në raport me vitin 2016, janë mbledhur 23% më shumë të ardhura ose në vlerë absolute 3.5 miliard lekë. Kjo rritje e konsiderueshme në të ardhurat e përgjithshme të pushtetit vendor i referohet kryesisht rritjes që vjen nga taksat lokale dhe pas saj të ardhurat nga taksa mbi pasurinë.

Grafiku 32 Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit e pushtetit vendor



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Taksa mbi pasurinë përbën një burim të rëndësishmë të të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes vendore. Sipas treguesve fiskal të vitit 2017, taksa mbi pasurinë zë rreth 26% e totalit të të ardhurave që sigurojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ndër vite ashtu si paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm kjo taksë ka qënë në luhatje të vazhdueshme me ulje dhe ngritje nga viti në vit. Nga ana tjetër vihet re një rritje e masës së taksës së mbledhur në vitin 2016 dhe 2017. Në raport me vitin 2016 gjatë vitit 2017 janë mbedhur rreth 200 milion lekë më shumë të ardhura nga taksa mbi pasurinë nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore. Nga kjo taksë pushteti vendor ka siguruar më shumë të ardhura se një vit më parë ndërkohë që ritmi i ndryshimit të të ardhurave nga kjo taksë ka qënë vazhdimisht në luhatje nga viti në vit.

Grafiku 33 Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Taksa e biznesit të vogël është një taksë ku pushteti vendor ka përfituar në mënyrë konstante një shumë ndër vite. Në këtë këndvështirm konstatohet qartë që shuma e përfituar nga pushteti vendor ndër vite ka ndryshime të vogla që nuk kanë ndikuar buxhetin vendor. Megjithatë, në vitin 2016 kemi rënie drastike të të ardhurave vendore nga ky burim për arsye të ndryshimit të zerimit dhe uljes së tatimit për këtë taksë. Në raport me planin vjetor prej 483 milion lek, gjatë vitit 2017 të ardhurat nga kjo taksë u realizuan në masën 296 milion lekë duke u paraqitur me një mosrealizim prej rreth 187 milion lekë ose 38.7%. Në buxhetin e vitit 2016 u reduktua përqindja që përfitonte pushteti vendor nga Taksa e Biznesit të Vogël dhe kjo paraqitet qartë edhe në grafikun e mëposhtëm ku të ardhurat nga kjo taksë u reduktuan me 71% në raport me vitin 2015 dhe me 51% në vitin 2017 në raport me vitin 2016. Për këtë reduktim u morën masat e nevojshme nga qeverisja qendrore duke e kompesuar plotësisht këtë taksë me shtesën në trasfertën e pakushtëzuar.

Grafiku 34 Të ardhurat nga taksa e biznesit të vogël



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Të ardhurat nga taksat lokale janë më të lartat dhe për rrjedhojë më të rëndëshmet për qeverisjen vendore. Prandaj duke ju referuar vlerave faktike të buxhetit 2017 ky grup taksash në totalin e të ardhurave vendore zë 72% të saj. Në këtë mënyrë për sa paraqitet në grafikun e mëposhtëm në raport me vitin 2016 të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor në vitin 2017 janë rreth 3.6 miliard lekë më shumë dhe sigurisht që në raport me vitin 2015 rritja është rreth 131%. Kjo rritje e konsiderueshme është pasqyrë e qartë e reformës së suksesshme administrativo territoriale e cila ka bërë të mundur që me njësitë e reja të vetëqeverisjes vendore efekshmëria e mbledhjes të taksave lokale të rritet dhe njësitë në kushtet e administrimit të një territori më të madh të zotërojnë më shumë burime e më shumë mundësi për investime. Të ardhurat nga taksat lokale përbëjnë një zë mjaft të rëndësishëm që mbulon efektet financiare të ushtrimit të funksioneve të pushtetit vendor dhe gjithashtu rritja e këtij burimi të ardhurash është tregues i rëndësishëm i autonomisë financiare që kanë krijuar njësitë e reja të vetëqeverisjes vendore vendore në buxhetin e vitit 2017.

Grafiku 35 Të ardhurat nga taksa lokale



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

VI.4 Shtojca 4 – Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës

Buxheti i vitit 2017, ka financuar 127 programe buxhetore dhe ka synuar realizimin e 1347 produkteve të 11 ministrive të linjës dhe fondeve speciale. Gjithashtu, këto shpenzime kanë financuar edhe buxhetin e 61 bashkive dhe 12 qarqeve.

Në përgjithësi evidentohet një performancë relativisht e mirë e realizimit të produkteve buxhetore nga ministritë e linjës. Nga 1347 produkte të parashikuara për vitin 2017, janë realizuar plotësisht 1174 produkte ose 87.1 përqind; realizuar pjesërisht 109 produkte ose 8 përqind dhe nuk janë realizuar vëtëm 64 produkte ose 4.75 përqind nga të planifikuarat në vitin 2017.

Tabela në vijim jep në mënyrë të përmbledhur, sa mësipër cituar:

Nr	Ministria e Linjes	Produktet (ne numër)			
			Realizuar		
		Planifikuar	Plotesisht	Pjeserisht	Pa realizuar
1	Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	67	57	10	-
2	Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	122	57	33	32
3	Ministria e Financave dhe Ekonomise	663	658	5	0
4	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	77	60	9	8
5	Ministria e Kultures	15	4	11	-
6	Ministria e Shendetesise dhe Mbrotjes Sociale	74	50	9	15
7	Ministria e Drejtesise	43	31	10	2
8	Ministria per Evropen dhe Punet e Jashtme	44	42	2	-
9	Ministria e Brendshme	115	98	16	1
10	Ministria e Mbrojtjes	55	50	3	2
11	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	72	67	1	4
	TOTALI	**1347**	**1174**	**109**	**64**

Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2017, performanca e treguesve buxhetorë për këto katër programe kryesore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2017	Fakti 2017	Përqindja e realizimit			
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	8,633,786	86,847	6,858,779	58,249	79.4	67.1
	Financimi i huaj		15,000		1,171		7.8
2.	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	20,819,536	942,733	20,318,353	802,813	97.6	85.2
	Financimi i huaj		199,000		152,770		76.8
3.	Shërbime të Shëndetit Publik	2,774,255	57,242	2,517,157	56,658	90.7	99.0
	Financimi i huaj		0		**0**		0.0
4.	Përkujdesi Social	21,681,103	73,304	21,540,596	71,609	99.4	97.7
	Financimi i huaj		50,000		50,000		100

Në programin **"Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor"** janë realizuar objektivat e:

- Përmirësimit të ofrimit të shërbimit shëndetësor, nëpërmjet zgjerimit të skemës së rimbursimit të medikamenteve për të gjithë popullatën, të siguruar ose jo;
- Përmirësimit të shërbimeve parandulese dhe të diagnostifikimit të hershëm të sëmundjeve, nëpërmjet përfshirjes në kontrollin mjekësor periodik të popullatës;
- Plotësimit të infrastrukturës së nevojshme të sistemit të informacionit dhe të infrastrukturës së qendrave shëndetësore, nëpërmjet rikonstruksionit dhe blerjes së pajisjeve të reja për 5 poliklinika në Tiranë, Korçë, Gjirokastër, etj;
- Përmirësimit të shërbimeve parandaluese dhe të diagnostifikimit të hershëm të sëmundjeve për popullatën e rregjistruar tek mjeku i familjes, duke përfshirë edhe kujdesin ndaj nënës dhe fëmijës;
- U ulën ndjeshëm tarifat për vizita dhe trajtime tek mjekët specialistë për personat e pasiguruar; 600,000 qytetarë të pasiguruar përfitojnë nga vizitat falas tek mjeku i familjes dhe tarifat e ulura në kujdesin shëndetësor të specializuar, si edhe nga skema e rimbursimit falas për sëmundshmërinë kronike;

Këto objektiva janë arritur nëpërmjet realizimit të produkteve, si më poshtë:

- ✓ "Sigurimi i mbulimit me barna ", me një kosto faktike prej 4,600 milion lekë nga transferta buxhetit të shtetit dhe 5,488 milion lekë nga të ardhurat e FSKSH. Kështu janë miratuar në listën e barnave të rimbursueshme 576 barna nga 490 në vitin 2015
- ✓ "Mbulimi me kujdesin parësor ", me një kosto faktike prej 1,306 milion lekë nga transferta buxhetit të shtetit dhe 6,707 milion lekë nga të ardhurat e FSKSH dhe kanë realizuar vizita tek mjeku i familjes, gjatë vitit 2017, rreth 6.434.350 pacientë nga 6.100.000 të planifikuara. Funksionoi shërbimi i urgjencës në pikat turistike gjatë sezonit turistik. Mbi 300,000 qytetarë, pjestarë të 80 mijë familjeve të varfëra ose me të ardhura të pakta përfitojnë kujdes mjekësor falas nga mjeku i familjes.
- ✓ "Kryerja e Chek-Up", ku gjatë vitit 2017 kanë kryer chek-up rreth 475 mijë pacientë me nje kosto faktike prej 876 milion lekë.

Në programin **"Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor"** janë realizuar objektivat e:

- Mbulimit të popullatës me kujdes mjekësor spitalor;
- Funksionimit të plotë të urgjencës kardiake 24/7 dhe urgjencës cerebrale në QSUT;
- Uljes së kohës së përgjigjes në urgjencë;
- Krijimit të Qendrë Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, qendra e komandë-kontrollit, e cila prej 3 prillit 2017 i shërben 680 mijë banorëve të kryeqytetit;
- Plotësimin e nevojave të spitaleve me infrastrukturë ndërtimore,

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për vitin 2017, është realizuar, si më poshtë:

- ✓ "Trajtimi i pacientëve të shtruar në spitale", ku janë shtruar 284.260 pacientë me një kosto faktike, prej 16,189 milion lekë.

- ✓ "Pacientë të trajtuar nga paketat spitalore", ku janë trajtuar 7814 pacientë, me një kosto faktike, prej 1,092 milion lekë, nga 6000 pacientë të planifikuar me me një kosto prej 1,140 milion lekë.
- ✓ "Trajtimi i pacientëve në spitalet psikiatrike", ku janë trajtuar 1450 pacientë, me një kosto faktike, prej 649 milion lekë, nga 1400 pacientë të planifikuar me një kosto 624 milion lekë.
- ✓ "Pacientë të trajtuar me dializë", ku janë trajtuar 1100 pacientë me një kosto faktike, prej 1,806 milion lekë, duke rritur aksesin e pacientëve për shërbimin e dializës nëpërmjet ofrimit në 5 qendra të reja.
- ✓ "Ndërtimi i maternitetit të ri në Sarandë", me një kosto faktike prej 96 milion lekë
- ✓ "Blerje pajisje mjeksore për spitalin Sarandë", me një kosto faktike prej 59 milion lek
- ✓ "Blerje pajisje mjeksore për shërbimin spitalor", me një kosto faktike prej 22 milion lekë
- ✓ "Barna dhe pajisje mjeksore të rregjistruara" me një kosto faktike , prej 113 milion lekë

Në programin **"Shërbime të Shëndetit Publik"** janë realizuar objektivat e:

- Sigurimit të qëndrueshmërisë së mbulesës vaksinare, për vaksinat e kalendarit të vaksinimit;
- Reduktimit të numrit të shpërthimeve epidemike me burim ndotjen e ujit;
- Rritjes së përputhshmërisë ligjore dhe ndështkimin e parregullsive të evidentuara nëpërmjet sigurimit të kryerjes së inspektime shëndetësore;
- Depistimit të grave për kancerin e gjirit.

Këto objektiva, për vitin 2017, janë realizuar nëpërmjet realizimit të produkteve, performanca e të cilave paraqitet si më poshtë:

- ✓ "Inspektime të kryera nga inspektoriatet" është realizuar me një kosto faktike prej 264 milion lekë dhe janë kryer 37.751 inspektime nga 40.000 të planifikuara për tu kryer me një kosto prej 310 milion lekë.
- ✓ "Blerja dhe monitorimi i vaksinave" është realizuar me një kosto faktike prej 240 milion lekë dhe janë vaksinuar rreth 233.700 mijë femijë nga 240 mijë të planifikuar per t'u vaksinuar me një kosto prej 326 milion lekë.
- ✓ "Monitorimi i situatave epidemiollogjike", është realizuar me një kosto faktike prej 2,004 milion lekë dhe janë kryer rreth 3100 kontrolle për të monitoruar agjentët mjedisore për ujrat, ambjentin, ushqyerjen, shëndetin në punë, duke respektuar standartet e BE-se, nga 3100 te planifikuar me një kosto prej 2,455 milion lekë. Kjo ka sjellë reduktimin e vazhdueshëm të numrit të shpërthimeve epidemike me burim ndotjen e ujit në jo më shumë se 2 herë në vit për 2017, krahasuar me mesatarisht me 4 herë në vit për 2012-2013.
- ✓ "Depistimi i grave për kancerin e gjirit", ku janë depistuar 4.250 gra me një kosto faktike prej 9,4 milion lekë.
- ✓ "Ndërtime dhe rikonstruksione", është realizuar me një kosto faktike prej 11 milion lekë.
- ✓ "Blerje pajisje kompjuterike e mobilimi" është realizuar me një kosto faktike prej 45 milion lekë .

Në programin **"Kujdesit Social"** janë realizuar objektivat e:

- Rritjes së efikasitetit dhe transparencës së skemës të ndihmës ekonomike nëpërmjet administrimit të regjistrit elektronik kombëtar dhe përdorimit të sistemit të pikëzimit;
- Reformimit të sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar, duke vënë në zbatim sistemin e ri të vlerësimit sipas Modelit Social dhe duke ulur përqindjen e rasteve abuzive të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuar;
- Ngritjes së një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit social në njësitë e qeverisjes vendore dhe ofrimi i modeleve të reja të shërbimeve sociale;
- Zhvillimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për mbrojtjen sociale;
- Rritjes së kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në fusha që përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së ndihmës ekonomike dhe përmirësimi i shërbimeve të kontrollit/auditit për të reduktuar numrin e abuzimeve.

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për vitin 2017, është realizuar, si më poshtë:

- ✓ "Familje përfituese të ndihmës ekonomike", është realizuar me një kosto faktike prej 4,859 milion lekë për 81.198 familje përfituese nga 78.000 familje të planifikuara me një kosto prej 5,293 milion lekë, si rrjedhojë e akordimit të ndihmës ekonomike të plotë dhe jo të pjesshme, sipas numrit të individëve në çdo familje.
- ✓ Rritje e fondit nga 3% në 6% për pushtetin vendor për të trajtuar rastet që nuk mund të përfitojnë nga sistemi elektronik;
- ✓ Dy dhe trefishim i masës së ndihmës ekonomike që përfitojnë familjet në nevojë, krahasuar me 2013;
- ✓ Pagesë shtesë për fëmijët që ndjekin shkollën dhe vaksinohen;
- ✓ Shpërblime për 80 mijë familje në nevojë për festat e fundvitit;
- ✓ Shmangia e abuzivitetit në skemën e ndihmës ekonomike në masën 23% të skemës krahasuar me 2013;
- ✓ "Persona me aftësi të kufizuar përfitues nga programi i aftësisë së kufizuar" është realizuar me një kosto faktike prej 15,854 milion lekë për 139.258 persona përfitues, nga 160.000 individë të planifikuar me një kosto prej 16,500 milion lekë. Kjo u arrit nëpërmjet:
  - *Indeksimit të përfituesve me nivelin e inflacionit;*
  - *Skemës së re të vlerësimit për aftësinë e kufizuar bazuar në modelin bio-psiko-social sipas standardeve ndërkombëtare të OBSH-së;*
  - *Përgatitja e kritereve të reja të vlerësimi të aftësisë së kufizuar që i përgjigjet më mirë nevojave të individëve;*
  - *900 paraplegjikë dhe tetraplegjikë kanë përfituar pajisje asistive falas në sajë të partneritetit me shoqërinë civile.*
  - *Personat me aftësi të kufizuara kanë përfituar edhe pagesë shtesë në fund të çdo viti.*
  - *Për herë të parë që nga viti 2014, skema e aftësisë së kufizuar është tërësisht e audituar duke ulur abuzivizmi me 8,7% .*

- *Që prej vitit 2014 personi me aftësi të kufizuara punësohet dhe pagesa e aftësisë së kufizuar nuk i ndërpritet për shkak të punësimit (për 4 vite);*

✓ "Fëmijë që përfitojnë shërbime në institucionet e përkujdesit", është realizuar me një kosto faktike prej 217 mijë lekë për 219 persona, nga 300 individë të planifikuar me një kosto prej 221 mijë lekë. Është rritur numri i fëmijëve në familje kujdestare duke garantuar rritjen e fëmijeve në familje në vend të institucioneve

✓ "Të moshuar të trajtuar me shërbime të përkujdesit", është realizuar me një kosto faktike prej 173 mijë lekë për 359 persona, nga 400 individë të planifikuar me një kosto prej 181 mijë lekë.

✓ "Gra dhe vajza në rrezik trafikimi të trajtuara me shërbime rezidenciale publike" është realizuar me një kosto faktike prej 217 mijë lekë për 219 persona, nga 300 individë të planifikuar me një kosto prej 221 mijë lekë.

✓ "Gra dhe vajza të dhunuara që marrin shërbime rezidenciale" është realizuar me një kosto faktike prej 22 mijë lekë për 11 persona, nga 70 individë të planifikuar me një kosto prej 22 mijë lekë.

Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Performanca e treguesve buxhetorë për tetë programet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2017	Fakti 2017	% e realizimit			
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	263,827	7,000	260,028	-	98.56	-
2.	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,621,939	70,533	1,513,741	34,214	93.33	48.51
	Financimi i huaj		147,740		168,150		113.81
3.	Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	723,649	715,854	677,365	714,481	93.60	99.81
	Financimi i huaj		1,330,353		1,330,081		99.98
4.	Zhvillimi Rural duke mbesht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.	1,069,320	639,202	1,044,188	618,510	97.65	96.76
	Financimi i huaj		816,958		324,925		39.77
5.	Keshillimi dhe Informacioni Bujqesor	205,925	9,680	198,100	8,179	96.20	84.49
6.	Menaxhimi qendrueshem i tokes bujqesore	25,000	-	24,915	-	99.66	
7.	Mbeshtetje per Peshkimin	93,250	21,100	92,746	947	99.46	4.49
8.	Administrimi i ujrave	113,214	15,000	108,482	14,999	95.82	99.99
	Financimi i huaj		137,657		122,072		88.68
	TOTAL	**4,116,124**	**3,911,077**	**3,919,565**	**3,336,558**		

Në programin e **"Zhvillimit rural..."**, janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 1,987,623 (në mijë lekë), të tilla si:

- "Ruajtja e resurseve gjenetike në fermë ", i cili është realizuar për 2 667 krere nga 2 870 krere të planifikuar, me një kosto faktike 5 526 mijë lekë.

- "Produktet shqiptare të sektorit bujqësor, blegtoral dhe agropërpunimit, të promovuara", është realizuar përmes pjesëmarrjes në 3 panaire nga 14 të planifikuara, me një kosto faktike 9 218 mijë lekë.
- "Fermerë përfitues të skemave kombëtare" kanë qenë 1 165 fermerë dhe agrobiznese me një kosto faktike 406 588 mijë lekë.
- "Sipërfaqe të trajtuara kundër mizës së ullirit" janë trajtuar 5 600 ha me kosto faktike 201 584 mijë lekë.
- "Dëmshpërblim i fermerëve për dëme nga dermatoza nodulare" janë dëmshpërblyer 1 912 krerë me kosto faktike 331 703 mijë lekë.
- "Vrojtimet statistikore" janë realizuar 4, me kosto faktike 8 022 mijë lekë.
- "Fara dhe Fidan të analizuar, testuara dhe certifikuara" janë kryer 9 832 150 nga 10 000 000 të planifikuara.
- "Vreshta dhe Ullishte të rregjistruara" janë rregjistruar 11 237 njësi nga 10 000 të planifikuara.
- "Përmirësim të kushteve dhe standarteve të jetesës për fermerët" janë realizua 12 projekte me një kosto faktike prej 1 376 540 mijë lekë.

Në programin **"Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit"**, janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 1,716,105 (në mijë lekë), ku ndër to përmendim:

- "Analiza për mbetjet në kafshë" janë realizuar 1 600 copë me një kosto faktike prej 3 089 në mijë lekë.
- "Analiza për mbetje në ujrat e brendshme të molusqeve bivale" janë kryer 1 400 copë me kosto faktike prej 25 979 mijë lekë.
- "Monitorim semundjesh në kafshë" janë kryer 4 monitorime me kosto faktike 10 000 mijë lekë.
- "Vaksinimi të imtave kundër brucelozës REV-1" janë vaksinuar 828 737 krerë me një kosto faktike 115 427 mijë lekë.
- "Gjurmim për tuberkulozë tek gjedhi" janë gjurmuar 1 000 krerë.
- "Vaksinim gjedhi për sëmundjen e plasjes" janë vaksinuar 15 000 krerë me një kosto faktike 381 mijë lekë.
- "Vaksinim të imta për sëmundjen e plasjes" janë vaksinuar 90 000 krerë me një kosto faktike 3 558 mijë lekë.
- "Eleminimi i kafshëve të dëmtuara, infektuara nga TBC, plasje dhe terbimi" janë eleminuar 150 krerë, me një kosto faktike prej 148 285 mijë lekë.
- "Përmirësim i sigurisë ushqimore dhe veterinarisë" janë realizuar 5 projekte me financim të huaj me një kosto prej 165 355 mijë lekë.

Në programin **"Këshillimi dhe informacioni bujqësor"**, janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 206,279 (në mijë lekë), ku përmendim:

- "Karta dhe paketa teknologjike me elementë të përmirësuar të ofruara" janë realizuar 15 me një kosto faktike prej 117 000 mijë lekë.

- "Fermerë të kontaktuar dhe ofruar shërbime ekstensioni" janë kontaktuar 66 200 fermerë me kosto faktike 51 309 mijë lekë.
- "Të ardhura të realizuara nga QTTB" janë realizuar 28 779 mijë lekë nga 31 950 që parashikohej.
- "Magazina të rikonstruktuara" janë rikonstruktuar 1 860 m^2 në QTTB Korçë, me kosto faktike 3 523 mijë lekë.
- "Blerje agregatë bujqësorë" janë blerë 5 agregatë bujqësorë nga QTTB Lushnje me kosto faktike 1 673 mijë lekë.

Në programin "**Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit**", janë parashikuar disa produkte me një kosto totale prej 1,391,846 mijë lekë, ndër to përmendim:

- "Mirëmbajtja e rrjetit kryesor kullues" janë pastuar nga depozitimet e dherave dhe bimëve 220 km rrjet i kanaleve kryesore me një kosto prej 243 836 mijë lekë.
- "Mirëmbajtja e rrjetit kryesor ujitës" janë pastuar nga depozitimet e dherave dhe bimëve 158 km rrjet i kanaleve kryesare me një kosto prej 81 185 mijë lekë.
- "Argjinatura të rehabilituara" janë rehabilituar 3.2 km nga 3.3 të parashikuara argjinatura me një kosto faktike prej 98 049 mijë lekë dhe 3.2 km argjinature e re/rikonstruktuar.
- "Shërbimi i kullimit me ngritje mekanike hidrovore" është mundësuar shërbimi i kullimit ngritje mekanike me hidrovor në sasinë 700 milionë m3 nga 600 milion që ishte parashikuar, me një kosto faktike prej 347 651 mijë lekë.

Infrastruktura dhe Energjia

Performanca e treguesve buxhetorë për tre programet kryesore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, paraqitet si më poshtë:

në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2017		Fakti 2017		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Transporti Rrugor	1,978,582	12,591,248	1,960,420	12,134,169	99.1%	96.4%
	- Financimi i huaj		7,965,410		9,136,004		
2.	Mbështetje për Energjinë	1,157,000	1,528,600	1,151,347	1,450,353	99.5%	94.9%
	-Financimi i huaj		595,000		543,176		
3.	Furnizimi me ujë dhe Kanalizime	1,059,000	4,472,643	1,027,861	4,194,098	97%	93.8%
	-Financimi i huaj		5,926,200		6,391,436		

Në programin **"Transporti Rrugor"** është realizuar objektivi madhor i forcimit dhe integrimit me rrjetin rajonal TEN-T, përmes dyfishimit të numrit të lidhjeve ndërkombëtarë tokësorë me Kosovën, Maqedoninë, Greqinë dhe Malin e Zi, i cili do të dyfishonte transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të mallrave, përfundimn e korridoreve me të gjitha korsitë dhe parametrat teknikë deri në v. 2020, duke përfshirë arterie strategjike. Ky objektiv është realizuar nëpërmjet

dy grup produktesh të mëdha të programit, specifikisht Ndërtimi i Rrugëve dhe Rikonstruksioni i Rrugëve, realizimi i produkteve të së cilave paraqitet si mëposhtë:

- Për grup produktin "Ndërtimi i Rrugëve" janë realizuar fonde në masën 4,795 milion lekë, nëpërmjet:
  - ✓ Ndërtimit të 1.7 km rruge tip A2 me katër korsi (2x2), me një kosto prej 454 milion lekë, pra një realizim prej 96% të planit për këtë tip rruge. Disa nga objektet e rëndësishme, të realizuara nga ky produkt janë:
    - *By pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë, nga loti 7 deri në lotin 11,*
    - *Rruga Kukës-Morinë Loti 1, dublimi,*
    - *Vendosja e mbikalimeve për këmbësorë në aksin Plepa-Kavajë-Rrogozhinë.*

  - ✓ Ndërtimit të 2.76 km rruge tip A2' 2x2 me trotuar dhe ndriçim, me kosto prej 2,390 milion lekë, pra 92% të planit për këtë tip rruge. Vihet re se kostoja për njësi ka një luhatje prej 35,492 lekësh për njësi, më shumë se vlera e planifikuar. Disa nga objektet e rëndësishme, që janë në proces nga ky produkt janë:
    - *Unaza e Re e Tiranës,segmenti Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës,*
    - *Rruga e Porto Romanos, Durrës Loti 1,*
    - *Nyja lidhëse e rrugës Milot-Lezhë, Rrëshen, Thumanë,*
    - *Unaza e jashtme Tiranë, pjesa verilindore,*
    - *Rikonstruksion segmenti rrugor Kodër-Kamëz Tapizë...etje*

  - ✓ Ndërtimit të 1.91 km rruge tip B1' me dy korsi, me kosto prej 397 milion lekë, pra 99% të planit për këtë tip rruge. Disa nga objektet e rëndësishme, në të cilat punohet me ritme të parashikuara janë:
    - *Rruga Lushnjë-Berat, loti2+ shtesë punimesh, loti 3 + shtesë punimesh*
    - *Rruga e Arbërit loti2*
    - *Rruga Kardhiq-Delvinë loti1, loti 2, loti3*
    - *Rruga Milot-F. Krujë (dublimi i superstradës) loti3*

  - ✓ Ndërtimit të 3.94 km rruge tip C2 me dy korsi, me kosto prej 1,552 milion lekë, pra 99% të planit për këtë tip rruge. Disa nga objektet e rëndësishme, në të cilat punohet me ritme të parashikuara janë:
    - *Rruga kanali i Cukës-Butrint loti1,*
    - *Rruga mbingritja e Viroit dhe hyrja e qytetit Gjirokastër*
    - *Ndërtimi i aksit Skrapar-Përmet, loti1,*
    - *Ndërtim rrugët paralele superstrada Tiranë – Vorë krahu i majtë (vazhdimi)+shtesë kontrate,*
    - *Rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare*
    - *Ndërtim mbrojtja nga lumi km 16+200 aksi rrugor Elbasan-Librazhd + shtesë punimesh*
    - *Ndërtim mbrojtja nga lumi km 9+500 rruga e re Milot-Skuraj.*

- Për grup produktin "Rikonstruksion i rrugëve", janë realizuar fonde në masën 3,825 milion lekë, nëpërmjet:
  - ✓ Sistemim asfaltimit të 37,56 km rrugë. Janë në proces ndërtimi disa objekte të rëndësishme si:
    - *Riveshje dhe sistemim asfaltim Elbasan-Banjë loti1, loti2, loti3,*
    - *Sistemim asfaltim rruga Tri Urat – Leskovik*
    - *Sistemim asfaltim rrugët lidhëse me bregdetin (Llogara-Sarandë) loti1+shtesë punimesh...etje*

Në programin "Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime" është realizuar mbulimi me shërbimin e furnizmit me ujë për popullatën. Realizimi i produkteve me synim arritjen e këtij objektivi, i cili është parashikuar që deri në vitin 2027 raporti mesatar i mbulimit me shërbimin e furnizmit me ujë për popullatën e vednit pritet të jetë 99%, paraqitet si mëposhtë :

- Realizimi i 156,875 ml, linja të reja ujësjellësi për furnizimin me ujë (A/II), me një kosto prej 2,190 milion lekë. Vihet re një luhatje kostoje prej 4 lekë/ml më shumë se vlera e parashikuar.
- 8,205 ml rrjet kanalizimesh të ujrave të zeza, me një kosto prej 290 milion lekë. Luhatja e kostos për këtë produkt arrin në vlerën 13 lekë/ml.
- Paisja me një impiant trajtimi për ujrat e zeza, me kosto prej 204 milion lekë.

Luhatjet e kostos për njësi vijnë për arsye se pagesa asnjëherë nuk ecën paralel me volumin e punëve të kryera.

Gjithashtu janë realizuar objektet e mëposhtme nëpërmjet **financimi të huaj**:

- Realizimi i 182,557 ml, linja të reja ujësjellësi për furnizimin me ujë (B/I), me një kosto prej 2,250 milion lekë.
- Realizimi i 131,667 ml, linja të reja të furnizimit me ujë (B/II), me një kosto prej 363 milion lekë.
- 56,224 ml rrjet kanalizimesh të ujrave të zeza, me një kosto prej 2,699 milion lekë.
- Paisja me një impiant trajtimi për ujrat e zeza, me kosto prej 2,340 milion lekë.

Në programin "Mbështetje për Energjinë" është realizuar qëllimi dhe objekti i programit lidhur me "*Garantimi dhe furnizimi me burime të sigurta energjitike me kosto minimale, ruajtja e mjedisit nga efektet negative për shkak të zhvillimit të sektorit energjitik, diversifikimi i furnizimit me burime energjitike dhe integrim në rrjetet energjitike rajonale dhe Europiane, duke nxitur investimet në këtë sektor*". Ky objektiv është arritur nëpërmjet realizimit të produkteve, si më poshtë:

- Hartimi i rregulloreve, raporteve, kryerja e studimeve dhe konsulencave me synim rritjen e përpunimit të naftës bruto në vend dhe rritjen e cilësisë së nënpdukteve të saj.
- Hartimi i bilanceve, kryerja e konsulencave dhe operacioneve me qëllim reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike, për të siguruar furnizim me energji elektrike në mënyrë të pandërprerë të gjithë konsumatorët

- Krijimi i institucionit Agjensia e Eficencës së Energjisë, 2 ambiente të pajisur me masa eficiente si edhe një kontratë konsulence me synim promovimin e energjisë së rinovueshme.

Turizmi dhe Medisi

Performanca e treguesve buxhetorë për tre programet kryesore në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit paraqitet si më poshtë:

në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2017		Fakti 2017		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Mbrojtja e Mjedisit	477,632	1,650,564	440,932	1,600,813	92.3%	97%
	- Financimi i huaj	-	303,000	-	549,404		
2.	Administrimi i Pyjeve	479,084.5	185,497	426,825	131,090	89.1%	70.7%
	-Financimi i huaj	-	-	115,000	114,022		
3.	Zhvillimi i Turizmit	153,089	186,200	125,118.9	78,700.7	81.7%	42.3%
	-Financimi i huaj	-	-	-	-		

Në programin **"Mbrojtja e Mjedisit"** janë realizuar objektivat e politikës së programit, të cilat specifikisht kanë të bëjnë me:

- Rritjen e sasisë së mbetjeve që shkojnë në landfille,
- Përmirësimin e cilësisë së ujrave bregdetare,
- Zgjerimin e aftësive ripërtëritëse të ekosistemit për të menaxhuar më efektivisht riskun e përmbytjeve.

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet realizimit të produkteve si më poshtë:

- ✓ Ndërtimi dhe vendosja në punë e impiantit të grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve në qytetin e Elbasanit, gjithashtu ndërtimi i landfillit sanitar të mbetjeve egzistuese të qytetit të Elbasanit.
- ✓ Janë në proces realizimi dy projekte të mëdha si Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet ne Fier, ku kostoja për realizimin e projektit përgjatë vitit 2017 arrin në vlerën 590 milion lekë ose 13.1% e vlerës totale të projektit që pritet të përfundojë në vitin 202, projekti tjetër lidhur me inceneratorin e Elbasanit është realizuar për vitin 2017 në masën 505.26 milion lekë, projekt ky që pritet të përfundojë në vitin 2020.
- ✓ Realizimi i sistemit për menaxhimin e mbetjeve të ngurta me një kosto vjetore prej 17 milion lekë,
- ✓ Janë trajtuar 50ha tokë me shërbime kulturale në Elbasan, me një kosto prej 1.8 milion lekë.
- ✓ Është realizuar ndërtimi i impiantit të pastrimit të grykderdhjes së lumit Ishëm dhe rikualifikimi i vijës bregdetare prej 40 ha, e shoqëruar më një kosto prej 242.83 milion lekë.
- ✓ Hartimi i Planit Kombëtar për Përshtatje dhe kontraktimi i ekspertit ndërkombëtar për adaptimin e bazuar në ekosistem, me një kosto prej 15.46 milion lekë.
- ✓ Është ulur niveli i zhurmave nga 3 herë mbi mestaren urbane, në 2 herë me mesataren e ndotjes së zhurmave në nivel evropian.

Në programin **"Administrimi i Pyjeve"** janë hartuar dhe zbatuar politika lidhur me:

- Menaxhimin e qendrueshëm të pyjeve dhe kullotave,
- Zhvillimin e një ekonomie të gjelbër,
- Koordinimin në nivel qendror, rajonal dhe lokal të praktikave më të miranë fondin pyjor dhe kullosor, efiçiente nga pikpamja ekonomike, miqësore me mjedisin dhe të pranuara nga shoqëria.

Objektivat e programit janë realizuar nëpërmjet realizimit të produkteve, si më poshtë:

- ✓ Gjatë viti 2017 janë trajtuar 50 ha toke me shërbime kulturale në Lurë, me një kosto prej 1.86 milion lekë.
- ✓ Gjelbërimi dhe rehabilitimi i një sipërfaqe prej 70 ha, me kosto në vlerë 62.71 milion lekë.
- ✓ Janë regjistruar 304,000 ha si fond pyjor dhe kullosor publik, eshoqeruar kjo me një kosto prej 36.37 milion lekë.

Në programin **"Zhvillimi i Turizmit"** janë hartuar dhe zbatuar politika lidhur me:

- Promovimin e investimeve në zonat me prioritet zhvillimin e turizmit,
- Përmirësimin e identitetit Shqiptar të turizmit në rajon e më gjerë nëpërmjet një strategjie të re marketingu për turizmin, duke synuar rritjen e numrit total të turisteve,
- TVSH për turizmin u ul në 6% për vitin 2017 duke krijuar lehtësira dhe rritur të ardhurat për operatorët e turizmit.

Kultura

Performanca e treguesve buxhetorë për dy programet e Ministrisë së Kulturës paraqitet si mëposhtë:

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2017		Fakti 2017		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	445 941	64 366	435 449	58 442	97.6%	90.7%
	- Financimi i huaj		18 800		-		
2.	Arti dhe Kultura	774 095	513 400	767 089	484 915	99%	94.4%
	-Financimi i huaj		350 000		-		

Në programin **"Trashëgimia Kulturore"** është realizuar promovimi, ruajtja, konservimi, restaurimi i objekteve dhe fondeve muzeore si dhe edukimi përmes trashëgimisë dhe aktiviteteve në funksion të saj. Këto objektiva janë arritur nëpërmjet realizimit të produkteve si më poshtë:

- "Përmirësimi infrastrukturës për muze dhe parqe arkeologjike", me një kosto faktike prej 160.9 milion leke, ku:
  - ✓ Muzetë Kombëtar Krujë, Muzeu Kombëtar "Onufri", Berat, Parku Arkeologjkik Apoloni, Kalaja Gjirokastër, Kalaja Shkodër, janë përfituese të projektit të AADF për vendosjen e biletarive elektronike të cilat që prej muajit Tetor 2017 operojnë me bileta për vizitorët përmes këtij sistemi.Ka filluar digjitalizimi i koleksioneve dhe zbatimi i teknologjisë ndërvepruese në hapësirat e tre muzeve kombëtar Muzeut Kombëatr ikonografik "Onufri", Berat; Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar , Korçë si dhe pavioni ikonografik në Muzeun Historik Kombëtar.

- ✓ Janë organizuar aktivitete promovuese në Muzeun Kombëtar Marubi me qëllim publikimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si ekspozita dhe ëorkshope.
- ✓ Janë organizuar aktivitete në Muzeun Historik Kombëtar si restaurim i një sërë objektesh, nërhyrjet konservuese të disa objekteve duke përfshirë dhe 9 objekte arkeologjike.
- ✓ Realizuar ekspozita në kuadër të 50-vjetorit të vdekjes së studiueses bizantologe Vitori Puzanova në Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar Korçë.
- ✓ Realizimi i aktiviteteve me karakter promovues, edukues në Qendren Kombëtare të Muzeumeve Berat, në muzetë kombëtare "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" dhe Entografik, Kruje, Muzeu Pavarësia Vlorë,
- ✓ Realizimi i punimeve restauruese të parqeve të Butrintit dhe Apolonisë.

- "Dy objekte të restauruara të gatshme si produkt për publikun" me një kosto faktike prej 48.1 milion lekë. Janë realizuar restaurimi dhe muzealizimi i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe", dhe rehabilitimi i Manastirit të Shën Mërisë për përdorim muzeal dhe rrethinat e sitit arkeologjik të Apolonisë Fier.
- "Monumenete kulture të mirëmbajtura dhe inspektuara në mënyrë të vazhdueshme", me nje kosto faktike prej 226 milion lekë. Gjatë vitit 2017 janë kryer punime mirëmbajtje, kosolidimi, pastrim vegjetacioni dhe restaurimi në rreth 145 objekte Monumente Kulture nga DRKK Durrës, Berat, Shkodër, Korçë, Gjirokastër, Vlorë.
- "65 aktivitete te organizuara ne rang vendi" me një kosto faktike prej 46.9 milion lekë. Ministria e Kulturës dhe institucionet e trashëgimisë kulturore kanë organizuar dhe mbështetur një seri veprimtarish lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të ekspozuara në site ose të sjellë pranë publikut apo dhe të ekspozuara në ambientet e Ministrisë së Kulturës si:
  - ✓ Projekte me thirrje si "Ringjallja e e teknikave të realizimit të xhubletës", projekti "Tirana si xhade", projekti "EMATHIA", botim, konferencë shkencore në gjurmë të trashëgimisë në krahinën e Matit, projekti "Fustanella festival", projekti "Përmeti Multikulturor", festival ndërkombëtar folklorik.
  - ✓ Aktivitete për 29 shtatorin dhe Ditët Europiane të Trashëgimisë nëpër DRKK.
  - ✓ Aktivitete në kuadër të programit "Miku i Monumentit", janë zhvilluar nga Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale.
  - ✓ "500 elemente të trashëgimisë materiale e jomateriale te inventarizuara" me një kosto faktike prej 9.6 milion lekesh. Në funksion të arritjes së objektivit "Krijimi i një Sistemi informatik Kombëtar të Administrimit të Trashëgimisë Kulturore me qëllim indentifikimin, katalogimin dhe ruajtjen e saj, është kryer inventarizimi dhe katalogimi e 30 424 objekteve.

Në programin **"Arti dhe Kultura"** janë realizuar projekte artistike kulturore të cilët kanë siguruar gjithëpërfshirje në jetën sociale kulturore, në veçanti ato projekte të cilat kanë në fokus krijimtarinë artistike, edukimin dhe zhvillimin e audiencave si dhe integrimin gjinor. Ky objektiv është arritur nëpërmjet realizimit të produkteve, si më poshtë:

- "Investimeve të reja të skenave teatrore bashkekohore" me nje kosto faktike prej 484.9 milion lekë. Eshtë drejt përfundimit procesi i punës së këtyre investimeve në institucionet e

artit dhe kulturës si TKOB, Teatri Migjeni i cili ka perfunduar; Teatri Andon Zako Cajupi Korce; Skena e re është drejt perfundimit; Godina e Vetingut ka perfunduar.

- "Aktiviteteve artistike në 10 institucione qëndrore të Artit dhe Kulturës" me nje kosto faktike prej 653.7 milion lekë.Kështu:
  - ✓ *Janë realizuar projekte artistike me program aktivitetesh jashtë territorit të Shqipërisë, të cilët kanë treguar rritje të nivelit artistik dhe nivelit të përfaqësimit përmes promovimit të produktit artistik shqiptar dhe nxitjes së konkurrencës mes protagonistëve në fushën e art kulturës.*
  - ✓ *Programi "Arti dhe Kultura", vijon integrimin dhe përfshirjen e buxhetimit gjinor në PBA 2017-2019, si një nga objektivat me prioritet të lartë ligjor.*
- "Aktivitete artistiko kulturore të inicuara nga MK, sipas prioriteteve institucionale dhe integriteti gjinor" me një kosto faktike prej 73.9 milion lekë. Realizimi i ketij produkti lidhet me përzgjedhjen e 127 projekt-propozimeve nga 230 të shqyrtuara për vitin 2017, në Art dhe Kulturë.
- "Përfaqësimi në programe dhe evenimente ndërkombëtare", me nje kosto faktike prej 33.7 milion lekë duke siguruar rritjen e bashkëpunimeve dhe përfaqësimeve të artit dhe artistëve shqiptarë në evenimente dhe skena ndërkombëtare.

Politika e Jashtme

Performanca e treguesve buxhetorë për pesë programet kryesore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2017		Fakti 2017		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	120,002	26,800	114,815	25,543	96	95
2.	Mbeshtetje diplomatike jashte shtetit	2,161,300	22,200	2,113,931	22,200	98	100
3.	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	219,500	-	191,683	-	87	-
4.	Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm	9,365	-	-	-	-	-
5.	Mbeshtetje institucionale për procesin e Integrimit	31,009	55,128	9,924	21,122	32	38
	TOTAL	**2,541,176**	**104,128**	**2,430,353**	**68,865**		

Programi "**Mbështetje diplomatike jashtë vendit**", synon:

- Nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit të gjithanshëm,
- Mbrojtjen dhe avancimin e interesave kombëtare e shtetërore dhe përkujdesin për interesat e qytetarëve shqiptarë në shtetet dhe organizatat ndërkombëtare ku ato janë akreditуar.

Në këtë program janë realizuar disa produket me kosto faktike 2,136,131 mijë lekë. Ndër produktet kryesore përmendim:

- ✓ "Mbështetja e përfaqësive diplomatike dhe konsullore me personel dhe kushte të përshtashme pune dhe jetese",
- ✓ "Mbështetja e përfaqësive diplomatike dhe konsullore me llogjistikën e nevojshme për përmbushjen e funksionit të tyre".

Programi "**Aktiviteti diplomatik dhe konsullor**" ka për qëllim:

- Zgjerimin, intensifikimin, diversifikimin, thellimin dhe pasurimin e marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje, partnerët strategjikë, në rajon, Europë, dhe vende të tjera të botës.

Në këtë program janë realizuar disa produkte me kosto faktike 191 683 mijë lekë, ku përmendim:

- ✓ "Zhvillimi i dialogut politik",
- ✓ "Lobim për negociata",
- ✓ "Veprimtari diplomatike me vendet e Evropës e Azisë qëndrore dhe zhvillimit të dialogut politik",
- ✓ "Veprimtari diplomatike me vendet e rajonit dhe zhvillimit të dialogut politik",
- ✓ "Pjesëmarrje aktive në përputhje me përgjegjësitë e vendit si antare në OKB, UNESCO, UNAOC, si antare në Frankofonisë, OSBE, KiE".

Rendi dhe Siguria Publike

Performanca e treguesve buxhetorë për dy programet kryesore të Ministrisë së Brendshme paraqitet si më poshtë:

në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2017		Fakti 2017		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Policia e Shtetit	14,174,013	923,859	14,101,988	833,313	99.5%	90.2%
	Financimi i huaj	-	540,000	-	386,059		
2.	Emergjencat Civile	281,992	1,700	234,220	-	83.1%	-

Në programin **"Policia e Shtetit"** janë realizuar katër qëllimet e mëdha të politikës së programit, që specifikisht kanë të bëjnë me hetimin e krimeve, sigurinë publike, kufi-migracioni dhe shërbimet mbështetëse. Këto katër nën-programe janë realizuar nëpërmjet realizimit të produkteve si më poshtë:

- Nënprogrami "Hetimi i krimeve", i cili synon ofrimin e shërbimit investigativ më të mirë të mundshëm, koordinimit të veprimtarisë në luftën kundër krimit të org. trafiqeve të paligjshme, akteve terroriste, krimit ekonomiko-financiar dhe korrupsionit, me qëllim krijimin e një shoqërie me standarde të larta të sigurisë në vend për të siguruar një jetë më të mirë për shtetasit. Me një kosto faktike (duke përfshirë edhe të ardhurat jashtë limitit) prej 3,047,279 mijë lekë, është arritur:

  - ✓ Forcimi i koordinimit ndërinstitucional në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, zvogëlimi i kërcënimeve të terrorizmit nëpërmjet vlerësimit të rrezikut për të mbajtur në kontroll të situatës kriminale, duke planifikuar rritjen e shërbimeve konvencionale në 142 raste me një kostim prej 397,106 mijë lekë.
  - ✓ Prova shkencore me interceptime telefonike janë realizuar 67 raste që arrijnë verën 309,962 mijë lekë.
  - ✓ Krijimi i një mjedisi të sigurtë për shoqërinë përmes reduktimit të ofertës dhe eksesit ndaj drogave për përdorim të paligjshëm, duke realizuar 824 operacione antidrogë, të cilat arrijnë një kosto prej 333,123 mijë lekë.
  - ✓ Realizimi i hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve, korrupsionit dhe terrorizmitme duke arritu kështu uljen e veprave penale me 1.8 vepra

për 100 mijë banorë dhe rritjen e fuqisë zbuluese të veprave penale me të vrasjes me 1.3%.

- ✓ Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në tërësi dhe gjinisë femërore në veçanti janë realizuar 11 operacione me kosto prej 84,600 mijë lekë, duke synuar rritjen me 15 % deri në vitin 2020 te nr. Të hetimeve.
- ✓ Reduktimi i korrupsionit parandalimi dhe goditja e pastimit të parave duke realizuar 58 hetime përgjatë vitit 2017 me një kostim prej 191,116 mijë lekë dhe 45 hetime për pastrimin e parave me një vlerë prej 194,747 mijë lekë.

- Nënprogrami "Siguria Publike", i cili synon rritjen progresive të parametrave të rendit dhe sigurisë publike duke përafruar standardet e organizatës së policisë me BE-në, shërbimet policore të jenë për zgjidhjen e problemeve ndaj komunitetit. Me një kosto faktike (duke përfshirë edhe të ardhurat jashtë limitit) prej 8,700,037 mijë lekë, është arritur që:
  - ✓ Numri i shërbimeve të patrullave të përgjithshme ka pësuar një rritje në krahasim me vitin 2016, arrin një vlerë prej 5,194 shërbime që kapin një kosto prej 2,345,553 mijë lekë.
  - ✓ Janë realizuar 7,096 shërbime të policisë rrugore që shoqërohen me një kosto prej 2,334,735 mijë lekë.
  - ✓ Për fushatën kundër përdorimit të drogës në shkolla janë realizuar 25 takime përgjatë vitit 2017, me një kosto prej 117,713 mijë lekë.
  - ✓ Jane marrë 2,284 raste mbrojtëse ndaj grave dhe vajzave me një kosto 50,568 mijë lekë.
- Nënprogrami "Kufi-Migracioni", i cili synon vendosjen e një menaxhimi efektiv, eficient të sigurtë; për plotësimin e standardet Schengen të BE-së. Me një kosto faktike (duke përfshirë edhe të ardhurat jashtë limitit) prej 2,466,425 mijë lekë, është arritur:
  - ✓ Numri i operacioneve të sigurisë në kufi është 37 operacione të kryera të shoqëruara me një kosto prej 124,652 mijë lekë.
  - ✓ Janë realizuar 993 hetime kundër krimit ndërkufitarë me një shpenzim faktik prej 57,622 mijë lekë.
- Nënprogrami "Shërbimeve mbështetëse", i cili synon përmirsimin e kushteve të punës e të teknologjisë për plotësimin e infrastrukturës të strukturave operacionale dhe mbështetëse me synim realizimin e objektivave strategjike të Policisë së shtetit, rritjen e standardeve të menaxhimit të burimeve njerëzore. Formimi dhe kualifikimi i punonjësve të policisë, sipas standardeve të policive Europine; Reformim i Arsimit Policor, duke përafruar legjislacionin më atë të BE-së". Me një kosto faktike (duke përfshirë edhe të ardhurat jashtë limitit) prej 1,174,307 mijë lekë, është arritur:
  - ✓ Janë blerë 545 paisje armatimi me një kosto totale prej 155,655 mijë lekë.
  - ✓ 48 raste të femrave përfaqësuese në nivelet drejtuese të policisë.
  - ✓ Punonjës policorë në trajnim të vazhdueshëm, janë trajnuar 300 punonjës më një kosto prej 20,340 mijë lekë.
  - ✓ Janë trajnuar 170 specialistë për sigurinë publike dhe hetimin e krimeve.

Në programin **"Emergjencat Civile"** është realizuar parandalimi, mbrojtja, reagimi dhe rikthimi në gjendje normale dhe rritja e masve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Ky objektiv është arritur nëpërmjet realizimit të produkteve, si më poshtë:

- ✓ Janë ndihmuar financiarisht 1.300 shtetas për banesat e dëmtuara, me një kosto totale prej 113,539 mijë lekë.
- ✓ Janë realizuar 94 ndërhyrje operacionale përgjatë vitit 2017, me një kosto prej 27,319 mijë lekë.
- ✓ Numri i riaftësimit të objekteve të dëmtuara nga fatkeqësit arrin në 20, me një kosto prej 53,600 mijë lekë.

Drejtësia

Performanca e treguesve buxhetorë për tetë programet kryesore në Ministrinë Drejtësisë, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2017		Fakti 2017		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	454,726	454,380	384,921	281,126	85	62
2.	Publikimet Zyrtare	55,000	-	42,959	-	78	-
3.	Mjekësia Ligjore	80,224	21,000	75,535	20,902	94	100
4.	Sistemi i Burgjeve	4,823,009	402,700	4,670,317	377,930	97	94
5.	Shërbimi i Përmbarimit gjyqësor	134,000	10,000	123,205	2,224	92	22
6.	Shërbimi për Çështjet e Birësimit	13,500	300	12,219	255	91	85
7.	Agjencia e trajtimit të pronave ALUIZNI	2,046,525	100,209	1,704,142	41,884	83	42
8.	Shërbimi i Provës	140,660	-	125,857	-	89	-
	TOTAL	**7,747,644**	**988,589**	**7,139,155**	**724,321**		

Në programin "**Sistemi i burgjeve**" për 12 mujorin e vitit 2017 janë realizuar produkte, me një kosto faktike 5,048,247 mijë lekë, përmendim:

- "Trajtimi me normë ushqimore i të dënuarve dhe paraburgosurve" janë trajtuar 5 867 të burgosur me një kosto faktike prej 434 113 mijë lekë.
- "Staf i trajnuar nga qëndra e trajnimit" janë trajnuar 350 punonjës me një kosto faktike prej 3 160 mijë lekë.
- "Të dënuar të trajtuar me shërbim shëndetësor" janë trajtuar 550 të burgosur të sëmurë me një kosto faktike prej 321 086 mijë lekë.
- "Mbajtja e të burgosurve dhe paraburgosurve në kushte sigurie nga trupa policore" janë 5 867 punonjës me uniforme me një kosto faktike prej 1 937 370 mijë lekë.
- "Trajtimi i të dënuarve të mitur në ambjente të përshtatshme të vuajtjes ë dënimit" janë trajtuar 53 të mitur të dënuar me një kosto faktike prej 72 033 mijë lekë.
- "Trajtimi i të dënuarave femra në kushte të vecanta në abjentet e vuajtjes së dënimit" janë trajtuar 88 të dënuara femra me një kosto faktike prej 99 945 mijë lekë.

Në programin "**Agjencia e Trajtimit të Pronave**" janë realizuar produkte me kosto faktike prej 1,746,026 mijë lekë, ndër produktet përmendim:

- "Trajtimi me vendim i kërkesave për kalimin në pronësi të oborreve në përdorim" nga 220 vendime janë trajtuar 167, me një kosto faktike 17 407 mijë lekë.
- "Mbrojtja e interesave të ATP në proçeset gjygjësore" nga 700 të planifikuara janë ndjekur 865 raste gjygjësore me kosto faktike 17 407 mijë lekë.
- "Trajtimi i kërkesave ndër vite për njohje pronësie" nga 5 000 të planifikuara janë realizuar 2 529 vendime me kosto faktike 69 630 mijë lekë.

- "Shpërndarja e fondeve për kompesim financiar për pronarët e pasurive që preken nga ndërtimet informale" nga 800 të planifikuara janë realizuar 1.760 subjekte me kosto faktike 568 503 mijë lekë.

Financat, Ekonomia, Punësimi dhe Arsimi Profesional

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në përqindje për vitin 2017 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për të gjithë programet, paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2017		Fakti 2017		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	396,295	249,539	350,273	106,814	88.4%	42.8%
	Financimi i huaj		432,979		544,140		125.7%
2	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	523,603	10,000	451,993	5,364	86.3%	53.6%
3	Ekzekutimi i Pagesave te Ndryshme	372,491		372,206		99.9%	
4	Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	2,393,515	68,746	2,288,752	17,162	95.6%	25.0%
	Financimi i huaj		0		4,406		
5	Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	3,238,201	171,491	3,176,490	69,287	98.1%	40.4%
	Financimi i huaj		366,714		270,262		73.7%
6	Lufta kundër Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	76,937	3,000	64,407	2,845	83.7%	94.8%
7	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	256,150	53,800	228,503	17,183	89.2%	31.9%
	Financimi i huaj		220,000		151,112		68.7%
8	Mbështetje për Mbikq. e Tregut, Infrast. e Cilës. dhe Pron. Industr.	303,364	9,545	235,816	3,118	77.7%	32.7%
9	Sigurimi Shoqëror	49,337,850		48,709,607		98.7%	
10	Tregu i Punës	1,704,453	87,900	1,407,468	76,713	82.6%	87.3%
11	Inspektimi në Punë	187,858	3,000	168,267	0	89.6%	0.0%
12	Arsimi i Mesëm Profesional	1,638,949	824,710	1,491,068	614,554	91.0%	74.5%
	Financimi i huaj		138,000		56,176		40.7%
13	Strehimi	300,000	196,836	294,771	165,335	98.3%	84.0%
	Financimi i huaj		1,500		909		60.6%
	TOTALI	**60,729,665**	**2,837,761**	**59,239,620**	**2,105,379**	**97.5%**	**74.2%**

Në programin "***Arsimi i Mesëm Profesional***", me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2017 janë shënuar arritje cilësore dhe sasiore, konkretisht:

- Gjatë vitit 2017 arriti në 36 përqind niveli i nxënësve të cilët vazhdojnë arsimin e mesëm në drejtimin e arsimit professional;
- Rritje me 5 përqind e investimeve në AFP-të në laboratorë, pajisje, kurrikulat, material mësimore etj, rritja me 25 përqind në krahasim me 1 vit më parë të nxënësve që regjistrohen në shkollat AP;
- U krijua Këshilli kombëtar i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe komiteteve sektoriale me përfaqësim të partnerëve sociale dhe me një minimum përfaqësimi të femrave në masën 30 përqind;
- Shndërrimi i ofruesve në nivel rajonal (21) në qendra polifunksionale, në funksion të optimizimit të rrjetit të ofruesve, promovimi i një sistemi modern dhe gjithpërfshirës;

Në programin "***Punësimi***", fondet e nxitjes së punësimit janë pesëfishuar, në krahasim me 5 vite më parë duke arritur vlerën e 490 milionë lekë në vitin 2017. Me këtë financim është arritur që:

- Numri i punëkërkuesve të papunë që trajtohen nga skemat e nxitjes së punësimit ka një rritje të konsiderueshme dhe konkretisht 5264 persona është numri i të punësuarve nga shtresat dhe grupet e veçanta.
- Janë zgjeruar fushat e zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit deri në vitin 2017 në fusha të tilla si: industria prodhuese, industria e turizmit, teknologjia e informacionit, aktivitete të lidhura me bujqësinë dhe blektorinë, dhe industritë të tjera prioritare.
- Programi i Pagesës së Papunësisë zbatohet nga Zyrat Rajonale Vendore të Punësimit. Numri i pjesëmarrësve në këtë skemë për vitin 2017 është mesatarisht 2178 persona.
- Programi i formimit profesional që zbatohet nga 10 Drejtori Rajonale të Formimit Profesional, ka trajnuar 17297 kursantë, nga të cilët 9461 persona janë punëkërkues të papunë, klientë të zyrave të punës.

Në programin "***Zhvillimi Ekonomik***", përmes buxhetit të alokuar për vitin 2017 është arritur:

- Krijimi i Komitetit Kombëtar për politikën tregtare dhe lehtësimin e tregtisë, krijuar me Urdhër Kryeministri, si një platformë e përbashkët diskutimi midis institucioneve shtetërore dhe biznesit për të gjitha politikat e hapjes së tregut dhe të lehtësimit të tregtisë.
- Miratimi i planit kombëtar për lehtësimit e tregtisë 2017-2020 dhe ndërtimi i faqes zyrtare të komitetit me informacion për rregullat e tregtisë dhe aktivitetit e komitetit.
- Vlerësimi i hapësirave për marrëveshje të reja të tregtisë së lirë më vendet e Magrebit. Është në përfundim analiza e plotë e impaktit tregtar
- Finalizimi i procesit të miratimit të Protokollit Shtesë 5 për lehtësimin tregtisë në kuadër të marrëveshjes CEFTA. Protokolli është dërguar në KM për të vijuar me procesin e ratifikimit.

Mbrojtja

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në përqindje për vitin 2017 për Ministrinë e Mbrojtjes, paraqiten si mëposhtë:

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2017		Fakti 2017		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,079,482	27,500	1,067,276	25,000	98.9%	90.9%
2	Forcat e Luftimit	4,795,923	1,307,181	4,768,746	1,250,938	99.4%	95.7%
3	Arsimi Ushtarak	542,581	9,322	520,550	9,060	95.9%	97.2%
4	Mbështetja e Luftimit	4,645,903	190,310	4,586,308	65,770	98.7%	34.6%
5	Mbështetje për Shëndetësinë	923,103	5,000	900,105	4,905	97.5%	98.1%
		11,986,992	1,539,313	11,842,985	1,355,673	98.8%	88.1%

Nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura, treguesit kryesorë të përformancës renditen:

- Lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakut.
- Implementimi në mënyrë cilësore i detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja dhe anëtarësia në organizma të niveleve të larta ndërkombëtare si: NATO, EAPC, RACVIAC, Karta e Atlantikut, etj; i realizuar nëpërmjet nënshkrimit të 19 marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të partneritetit mes vendeve, rritjes së sigurisë në rajon e më gjerë.
  - Modernizimi me armatim të lehtë dhe municione për Forcat e Armatosura, sistemet e mbështetjes për zjarr apo vendosja e kamerave Infra të Kuqe stacionare të integruara me sistemin SIVHD.

RAPORT MBI BORXHIN PUBLIK 2017

PËRMBLEDHJE

Borxhi publik gjatë vitit 2017 përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me objektivat Makro-Fiskale, buxhetin e planifikuar për vitin 2017 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit *(SAMB)*.

Në përputhje me objektivat Makro-Fiskale, niveli i borxhit publik në raport me PBB[1] u vlerësua me rënie për të dytin vit radhazi. Vlerësimet paraprake sinjalizojnë një rënie të Borxhit Publik në raport me PBB me rreth 2.5 pikë përqindje.

Ndërkohë, në linjë me buxhetin e vitit 2017 u realizua me sukses huamarrja, e cila mundësoi rifinancimin e borxhit ekzistues si dhe financimin e deficitit të planifikuar.
Nëpërmjet burimeve të brendshme dhe të huaja, huamarrja u realizua përkatësisht në nivelin 79% dhe 131% të planit vjetor[2]. Rritja e financimit në drejtim të atij të huaj, u realizua në kuadër të shfrytëzimit të burimeve të favorshme të financimit, si edhe të mirëmenaxhimit të likuiditetit, pasi një pjesë e likuiditetit do të përdoret për përmbushjen e nevojave të vitit fiskal pasardhës.

Objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit gjatë vitit 2017 u realizuan me sukses, si në kuadër të optimizimit të raporteve ndërmjet kostove dhe risqeve, ashtu edhe në kuadër të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë.
Në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, huamarrja në tregun e brendshëm u përqendrua kryesisht tek titujt afatgjatë dhe me norma interesi fikse.
Ndërkohë, përqendrimi i huamarrjes së huaj në burimet e financimit me natyrë dypalëshe dhe shumëpalëshe, mundësoi uljen e kostove të huamarrjes, si edhe uljen e presionit për hua në tregun e brendshëm.
Gjatë vitit 2017, jo vetëm kostot për njësi, por edhe kostot e përgjithshme të huamarrjes u ulën ndjeshëm krahasuar me vitin e mëparshëm. Në këtë aspekt, vlen të theksohet rënia e shpenzimeve për interesa të Borxhit Shtetëror me rreth 4.4 miliard Lek krahasuar me vitin e kaluar.

Në vazhdim të angazhimit të marrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar të titujve shtetërorë, si edhe krijimin e kushteve për zhvillimin e tregut sekondar, përgjatë vitit 2017 është vijuar me aktivitete të cilat kanë pasur si qëllim rritjen e efiçencës, likuiditetit dhe transparencës në tregun e brendshëm të titujve shtetërorë.
Kërkesa për tituj shtetërorë megjithëse mbetet ende jo shumë e diversifikuar dhe e bazuar kryesisht tek sektori bankar, në vitin 2017 ka qenë e kënaqshme dhe është shoqëruar me një diversifikim të moderuar në drejtim të institucioneve financiare dhe atyre jo financiare.
Normat e interesit të titujve shtetërorë gjatë vitit 2017 kanë pësuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2016, por megjithatë ato vazhdojnë të jenë në nivele relativisht të ulëta krahasuar me mesataren e tre viteve të mëparshme.

---

[1] Referuar Kuadrit Makroekonomik e Fiskal 2019-2021, të miratuar me VKM Nr. 25, datë 17.01.2018.
[2] Referuar Buletinit të Statistikave Fiskale të Qeverisë për periudhën Janar-Dhjetor 2017.

Gjatë vitit 2018 menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit *(kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm)*, në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si edhe mbajtjes nën kontroll të kostove të borxhit.

Në tregun e brendshëm, nëpërmjet titujve afatshkurtër kryesisht do të synohet rifinancimi me sukses i titujve ekzistues që maturohen, si dhe menaxhimi aktiv i nevojave për likuiditet. Ndërkohë, nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të mbulohet financimi i deficitit në përputhje me kufizimet e tregut. Struktura e financimit të brendshëm do të jetë fleksibël për sa i përket përzgjedhjes së titujve shtetërorë, në varësi të kushteve të tregut *(niveli i kërkesës, normat e interesit, etj.)*, duke synuar në këtë mënyrë optimizimin e kostove në përputhje me objektivat e vendosura për të menaxhuar risqet e portofolit të borxhit.

Financimi i huaj do të shërbejë si një plotësues i mirë i burimeve të brendshme dhe përveç të tjerash edhe si optimizues i kostove të borxhit.
Burimet kryesore të financimit do të jenë huatë me terma pjesërisht të buta për projektet ekzistuese, projektet e reja të konsideruara si prioritare nga Qeveria, si edhe huatë e akorduara nga institucionet financiare ndërkombëtare për të mbështetur politikat zhvillimore të vendit. Gjithashtu, gjatë vitit 2018 në rast se kushtet e tregjeve ndërkombëtare do të jenë të favorshme do të vijohet me emetimin e një Eurobond-i, i cili do të mundësojë përmirësimin e strukturës së borxhit në kuadër të menaxhimit të riskut të rifinancimit në periudhën afatmesme, uljen e presionit për huamarrje në tregun e brendshëm, si edhe sigurimin e valutës së nevojshme për shlyerjen e ripagesave të vitit 2018, si dhe pjesërisht ato të vitit 2019.

1. Ecuria e Stokut të Borxhit Publik

Në fund të vitit 2017, Borxhi Publik u vlerësua në nivelin 1,088.1 miliard Lek ose 70.0% e PBB. Krahasuar me fundin e vitit të kaluar, niveli i borxhit publik në raport me PBB ka shënuar një rënie prej 2.5 pp, ku faktorët kryesorë kanë qenë ngadalësimi i ritmeve të rritjes së borxhit në krahasim me ato të PBB, si edhe mbiçmimi i monedhës vendase në raport me monedhat e tjera që kompozojnë portofolin e borxhit në valutë.

Paraqitje Grafike 1 (a): *Borxhi publik në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2013-2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Niveli i borxhit të brendshëm dhe atij të jashtëm në raport me totalin e borxhit publik janë përkatësisht rreth 53% dhe 47%, duke ruajtur pothuajse të njëjtat raporte me fundin e vitit të kaluar, si edhe duke qenë në linjë me objektivat e vendosura në SAMB në kuadër të menaxhimit të riskut të kursit të këmbimit *(Ref. Aneksi II, Tabela 1.1)*.

Peshën më të madhe në stokun e borxhit publik vazhdojnë ta mbajnë instrumentet e tregtueshme *(bono thesari, obligacione, eurobond)* dhe huatë e huaja me destinacion financimin e projekteve.

Gjatë vitit 2017, nga pikëpamja e kompozimit të borxhit publik karakteristike ka qenë rritja e peshës së huave me financim të huaj të akorduara në formën e mbështetjes buxhetore, si edhe reduktimi i peshës së garancive shtetërore.

Paraqitje Grafike 1 (b): *Përbërja e borxhit të Qeverisjes Qendrore në raport me totalin (2013-2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Borxhi i garantuar është ulur me rreth 3.6 miliard Lek krahasuar me fundin e vitit 2016, kryesisht për shkak të nivelit më të lartë të ripagesave në raport me disbursimet.

Ndërkohë, borxhi i Pushtetit Lokal vazhdon të qëndrojë në nivele të ulëta *(rreth 753 milion Lek),* ose pothuajse në të njëjtat nivele me fundin e vitit 2016. Niveli i ulët i borxhit të Pushtetit Lokal reflekton kapacitetin e ulët që kanë njësitë e Qeverisjes Vendore për të përballuar shpenzime të krijuara nga borxhe të reja. Gjatë vitit 2017 nuk ka pasur asnjë kërkesë nga njësitë e Qeverisjes Vendore për huamarrje të re.

2. Përbërja e Borxhit Shtetëror

Gjatë vitit 2017, ashtu si edhe gjatë vitit paraardhës, në përputhje me politikat menaxhuese për uljen e ekspozimit ndaj risqeve, ka vazhduar tendenca e rritjes së peshës së titujve afatgjatë në portofolin e borxhit të brendshëm. Në veçanti, rritje më të madhe ka pasur në kategorinë e obligacioneve me afat maturimi mbi 5 vjet. Gjithashtu, pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme është reduktuar ndjeshëm, duke qenë se gjatë vitit 2017 nuk ka pasur asnjë emetim të këtyre titujve.
Ndryshimet e lartpërmendura në portofolin e borxhit të brendshëm kanë pasur ndikim pozitiv, kryesisht në aspektin e reduktimit të riskut të rifinancimit dhe atij të normave të interesit.

Paraqitje Grafike 2 (a): *Kompozimi i borxhit të brendshëm shtetëror sipas maturitetit dhe tipit të interesit*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Për sa i përket portofolit të borxhit të jashtëm, karakteristike ka qenë rritja e peshës së stokut me norma interesi koncesionale, e cila ka mundësuar optimizimin e kostove dhe diversifikimin e burimeve të financimit.

Paraqitje Grafike 2 (b): *Kompozimi i borxhit të jashtëm shtetëror sipas koncesionalitetit dhe tipit të instrumenteve (2013-2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Përbërja e borxhit shtetëror sipas monedhave në fund të vitit 2017 paraqitet pothuajse e njëjtë me atë të vitit të kaluar. Pjesën më të madhe të portofolit e zë monedha vendase me 51.3%, ndjekur nga monedha Euro me 31.9% dhe USD me 11.2%.

Portofoli i borxhit të brendshëm vazhdon të dominohet kryesisht nga monedha vendase dhe vetëm 2.8% e tij përbëhet nga monedha Euro. Ndërkohë, portofoli i borxhit të jashtëm kompozohet tërësisht nga monedha të huaja dhe mbizotëron me 64.4% monedha Euro, e ndjekur nga USD me 23.7%.

Paraqitje Grafike 2 (c): *Kompozimi i borxhit shtetëror sipas monedhës (Dhjetor 2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

3. Portofoli i Borxhit të Garantuar

Në fund të vitit 2017 portofoli i borxhit të garantuar vlerësohet në 49.9 miliard Lek *(3.2% e PBB)* ose 4.6% e portofolit të borxhit të Qeverisjes Qendrore. Krahasuar me vitin e kaluar, borxhi i garantuar është reduktuar në vlerë nominale me 3.6 miliard Lek për shkak të nivelit relativisht më të lartë të ripagesave në raport me disbursimet, si edhe për shkak të efektit të kursit të këmbimit, i cili buron nga mbiçmimi i monedhës vendase në raport me monedhat e huaja që kompozojnë këtë portofol. Ky reduktim kryesisht rezulton në portofolin e garancive të emetuara në favor të kreditorëve të huaj, ndërkohë garancitë e brendshme pothuajse nuk paraqesin ndryshim.
Garancitë në tregun e brendshëm përfaqësojnë 60.4% të totalit të stokut të borxhit të garantuar ose 30.1 miliard Lek. Këto garanci garantojnë linja kredie afatshkurtra dhe me norma interesi tregtare, të cilat i janë akorduar Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare *(KESH sh.a.)*. Në dallim nga garancitë e brendshme, garancitë e huaja paraqesin një risk më të ulët, pasi garantojnë kredi afatgjata dhe kryesisht me norma interesi koncesionale.

Më shumë se 80% e totalit të garancive shtetërore vazhdojnë t'i përkasin *Sektorit të Energjisë*. Përqendrimi i lartë i garancive në drejtim të këtij sektori është në përputhje me objektivat e Qeverisë për të mbështetur *Sektorin e Energjisë*, me qëllim që të përmirësojë performancën financiare dhe të rrisë efiçencën.

Paraqitje Grafike 3: *Garancitë shtetërore sipas sektorëve ekonomikë (2016-2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

4. Realizimi i Huamarrjes

Huamarrja gjatë vitit 2017 u realizua me sukses, duke mundësuar rifinancimin e borxhit ekzistues, mbulimin e nevojave të Qeverisë për likuiditet dhe financimin e deficitit buxhetor të planifikuar. Nevoja për hua *(në terma bruto)* në raport me PBB është ulur me 1.4 pp, duke reflektuar një ulje në ekspozimin e riskut fiskal që buron nga borxhi dhe sinjalizuar hyrjen e financave publike në trajektoren e konsolidimit.

Paraqitje Grafike 4: *Huamarrja bruto në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2013-2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

4.1. Huamarrja e Brendshme

Gjatë vitit 2017, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 323.0 miliard Lek, nga të cilat 306.6 miliard Lek kanë shërbyer për rifinancimin e titujve ekzistues dhe pjesa tjetër për financimin e deficitit buxhetor.
Në linjë me objektivin për reduktimin e ekspozimit të risqeve, gjatë vitit 2017 është rritur financimi nëpërmjet titujve afatgjatë nga 27.0% në 32.6%.

Tabela 4.1: *Huamarrja e brendshme bruto (2016-2017)*

Huamarrja e Brendshme Bruto	2016		2017	
	Vlera (në mld Lek)	%/Total	Vlera (në mld Lek)	%/Total
Burime të Brendshme	**342.0**	**100.0%**	**323.0**	**100.0%**
i. Bono Thesari	249.6	73.0%	217.7	67.4%
ii. Obligacione	92.4	27.0%	105.3	32.6%

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Financimi neto është siguruar tërësisht nëpërmjet titujve afatgjatë dhe njëkohësisht është shoqëruar me maturim të titujve afatshkurtër. Ndikimin më të madh në realizimin e financimit të brendshëm e ka pasur obligacioni 10 vjeçar, ndjekur nga obligacioni 7 dhe 5 vjeçar. *(Ref. Aneksi II, Tabela 2.1)*
Kostot shtesë nga mbështetja e gjerë e financimit në titujt afatgjatë vlerësohen të jenë relativisht të ulëta, pasi primet e aplikuara për këtë kategori titujsh kanë qenë në nivele minimale. Pavarësisht kostove shtesë, në periudhën afatmesme dhe afatgjatë kjo strategji financimi pritet të ketë ndikim pozitiv mbi kostot, pasi mbi 75% e emetimeve të titujve afatgjatë janë realizuar me norma interesi fikse, ndërkohë që ka pritshmëri për rritje të normave të interesit.

4.2. Huamarrja e Huaj

Gjatë vitit 2017 huamarrja e huaj është realizuar në vlerën 58.7 miliard Lek, nga e cila rreth 53.5% u realizua nëpërmjet burimeve shumëpalëshe të akorduara në formën e mbështetjes buxhetore dhe 46.5% nëpërmjet huave të akorduara për financimin e projekteve ekzistuese.

Tabela 4.2: *Huamarrja e huaj bruto sipas burimeve të financimit (2016-2017)*

Burimet e Huamarrjes	2016		2017	
	Vlera (në mld Lek)	%/Total	Vlera (në mld Lek)	%/Total
Burime të Jashtme	**40.1**	**100.0%**	**58.7**	**100.0%**
i. Mbështetje Buxhetore	21.1	52.7%	31.4	53.5%
ii. Eurobond	0.0	0.0%	0.0	0.0%
iii. Kredi për financim projektesh	19.0	47.3%	27.2	46.5%
Total Huamarrja	**382.1**	**100.0%**	**381.6**	**100.0%**

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Huamarrja e huaj gjatë vitit 2017 ka qenë relativisht më e lartë krahasuar me vitin e kaluar, kryesisht si rezultat i shfrytëzimit të mbështetjes buxhetore në masë të gjerë dhe ecurisë së mirë të disbursimeve të kredive për projektet me financim të huaj. Shfrytëzimi i lartë i mbështetjes buxhetore u realizua kryesisht për të optimizuar kostot e borxhit, si edhe për të kryer një menaxhim aktiv të likuiditetit dhe të detyrimeve të borxhit që do të gjenerohen gjatë vitit 2018. Niveli i lartë i disbursimeve të kredive për projektet me financim të huaj ka ardhur si rezultat i implementimit të shpejtë të projekteve, kryesisht në sektorët: transport, energji dhe ujësjellës-kanalizime.

Më shumë se gjysma e huamarrjes së huaj bruto *(51.6%)* u realizua nëpërmjet huave me terma koncesionale, në përputhje me objektivat strategjike për mbajtjen e kostove së borxhit nën kontroll.

Paraqitje Grafike 4.2: *Huamarrja e huaj bruto sipas koncesionalitetit (2013-2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

5. Kostot dhe Risqet

Gjatë vitit 2017, ka vazhduar tendenca e uljes së kostove së borxhit dhe përmirësimit të treguesve të riskut. Shërbimi i borxhit ka rezultuar me ulje gjatë kësaj periudhe, kryesisht si rezultat i efektit të rënies së normave të interesit gjatë viteve paraardhëse. Struktura e borxhit ka shfaqur përmirësim, kryesisht në aspektin e reduktimit të ekspozimit ndaj riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit. Përmirësimi i risqeve është i lidhur ngushtë me rritjen e peshës së borxhit afatgjatë dhe me reduktimin e borxhit me norma interesi të ndryshueshme. Gjatë viteve të fundit, përmirësimi i ndjeshëm i raportit ndërmjet kostove dhe risqeve ka ardhur jo vetëm si rezultat i mirëmenaxhimit në përputhje me objektivat strategjike, por edhe si rezultat i kushteve të favorshme të tregut dhe faktorëve makroekonomikë të vendit, të tilla si:

- Ulja e normës bazë të interesit në tregun e brendshëm dhe atë të huaj, si rezultat i politikave monetare lehtësuese të bankave qendrore;
- Disponueshmëria në nivele të konsiderueshme e burimeve të huaja të financimit me terma koncesionale;
- Kërkesa relativisht e lartë për titujt afatgjatë me norma interesi fikse;
- Qëndrueshmëria e monedhës vendase ndaj monedhës Euro dhe lëvizja përgjithësisht në kahe të kundërta e monedhave EUR dhe USD.

5.1. Kostot

Krahasuar me vitin 2016, shpenzimet për interesa të borxhit shtetëror ranë me 4.4 miliard Lek, duke u vlerësuar në 31.9 miliard Lek, 2.1% e PBB ose 8.0% e të ardhurave tatimore. Reduktimi i shpenzimeve për interesa i atribuohet rënies së normave të interesit në tregun e brendshëm, kryesisht gjatë tre viteve paraardhëse për obligacionet dhe gjatë vitit 2016 për bonot e thesarit.

Paraqitje Grafike 5.1 (a): *Shpenzimet për interesa të borxhit shtetëror (2013-2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Nga ana tjetër, kosto mesatare e borxhit të brendshëm shtetëror *(yield-i mesatar i ponderuar)* gjatë vitit 2017 është ulur me 4 pb krahasuar me fundin e vitit 2016, megjithëse në portofolin e

borxhit është rritur ndjeshëm pesha e borxhit afatgjatë, duke reflektuar një përmirësim në raportin ndërmjet kostos dhe riskut.

Paraqitje Grafike 5.1 (b): *Jetëgjatësia dhe kosto mesatare e portofolit të borxhit të brendshëm shtetëror*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

5.2. Risqet

Gjatë vitit 2017 ekspozimi i portofolit të borxhit ndaj risqeve është arritur të menaxhohet me sukses, në linjë me objektivat strategjike afatmesme. Ulja e peshës së titujve afatshkurtër dhe atyre me norma interesi të ndryshueshme në portofolin e borxhit të brendshëm, ka qenë faktori mbizotërues në uljen e riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit. Ndërkohë, qëndrimi i borxhit në valutë në të njëjtin nivel ka mundësuar mbajtjen nën kontroll të riskut të kursit të këmbimit.

Risku i rifinancimit është përmirësuar ndjeshëm pasi në harkun kohor të një viti jetëgjatësia e borxhit të brendshëm është rritur me 27 ditë duke prekur nivelin e 780 ditëve në fund të vitit 2017, krahasuar me 753 ditë në fund të vitit 2016. Ndërkohë, vlera e instrumenteve që maturohen në harkun kohor të një viti është ulur nga 53.5% në dhjetor 2016 në 50.0% në dhjetor 2017.

Paraqitje Grafike 5.2 (a): *Profili i amortizimit të borxhit të brendshëm shtetëror (2016-2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Risku i normave të interesit gjithashtu është përmirësuar, pasi pesha e instrumenteve që rivlerësojnë normën e interesit në harkun kohor të një viti është ulur nga 62.6% në dhjetor 2016 në 56.7% në dhjetor 2017.

Tabela 5.2: *Treguesit e riskut të normave të interesit (2015-2017)*

Treguesi	2015	2016	2017
Borxh me normë fikse[3]/total	43.2%	47.5%	55.6%
Borxhi i rivlerësuar në një vit	67.7%	62.6%	56.7%
Koha mesatare në rivlerësim (KMR)	1.8	2.0	2.2

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Në këtë drejtim, ndikim ka pasur reduktimi i peshës së titujve afatshkurtër dhe atyre me norma interesi të ndryshueshme në portofolin e borxhit të brendshëm, përkatësisht me 3.7 pp dhe 3.9 pp. Ulja e ekspozimit ndaj këtij risku ka ulur ndjeshmërinë e borxhit ndaj goditjeve të normave të interesit, duke reduktuar burimet që Qeveria duhet të angazhojë në raste të tilla.

Risku i kursit të këmbimit gjatë vitit 2017 është mbajtur mbajtur nën kontroll dhe brenda objektivave të përcaktuara në SAMB. Stoku i borxhit në valutë në raport me totalin e borxhit shtetëror pothuajse qëndron i pandryshuar *(48.7% nga 48.6% në vitin 2016)*.
Raportet e borxhit shtetëror në valutë me eksportet dhe rezervat valutore edhe gjatë vitit 2017 paraqiten të qëndrueshme, duke dëshmuar për një rritje *(në vlerë absolute)* të borxhit në valutë me ritme proporcionale me ato të rezervave valutore dhe eksporteve.

Paraqitje Grafike 5.2 (b): *Raporti i borxhit shtetëror në valutë me eksportet dhe rezervat valutore (2013-2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Risku i likuiditetit gjatë vitit 2017 është reduktuar ndjeshëm dhe nevojat e Qeverisë për likuiditet janë menaxhuar me sukses pa krijuar kosto shtesë në buxhet.
Nevojat për likuiditet janë përmbushur pa ushtruar presion në tregun e brendshëm të titujve shtetërorë, ndërkohë që është mundësuar krijimi i një rezerve monetare e cila do të mbulojë pjesërisht nevojat për likuiditet të Qeverisë në vitin 2018.

[3] Nuk përfshihen bonot e thesarit. Pavarësisht faktit që janë instrumente me norma interesi fikse, në aspektin e riskut të normave të interesit kanë karakteristika të njëjta me instrumentet me norma të ndryshueshme.

Treguesit që vlerësojnë riskun e likuiditetit kanë pësuar një përmirësim të ndjeshëm, kryesisht si rezultat i masave të marra në kuadër të reduktimit të riskut të rifinancimit. Raportet e shpenzimeve për interesa të borxhit shtetëror dhe borxhit shtetëror afatshkurtër[4] ndaj të ardhurave tatimore janë reduktuar ndjeshëm, përkatësisht me 1.8 dhe 6.3 pp.

Paraqitje Grafike 5.2 (c): *Shpenzimet për interesa dhe borxhi shtetëror afatshkurtër në vlerë absolute dhe relative ndaj të ardhurave tatimore (2013-2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

6. Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetërorë

Tregu primar i titujve shtetërorë gjatë vitit 2017 përgjithësisht është karakterizuar nga zhvillime pozitive, ndër të cilat mund të përmenden: i) kërkesa e tregut për tituj shtetërorë në nivele të kënaqshme, e cila ka arritur të mbulojë nevojat e Qeverisë për huamarrje në përputhje me objektivat strategjike; ii) rritja e kërkesës në drejtim të kategorisë së *Institucioneve Financiare (jo-banka)* dhe *Institucioneve Jo-financiare*; dhe iii) qëndrimi i normave të interesit të titujve shtetërorë në nivele të krahasueshme me ato të vitit 2016.

6.1. Ecuria e ankandeve dhe kërkesa për titujt shtetërorë

Gjatë vitit 2017 kërkesa për tituj shtetërorë ka rezultuar në vlerën 422.5 miliard Lek, nga të cilat 275.2 miliard Lek i përkasin bonove të thesarit dhe 147.4 miliard Lek obligacioneve *(Ref. Aneksi II, Tabela 4.0)*.

Kërkesa gjatë vitit 2017 ka qenë relativisht më e lartë se oferta e Qeverisë për tituj shtetërorë duke rezultuar në një raport të përgjithshëm mbulimi prej 1.24. Gjithsej gjatë vitit 2017 janë realizuar 59 ankande, nga të cilat vetëm në 17 ankande nuk është plotësuar oferta e Qeverisë.

[4] I referohet borxhit shtetëror të brendshëm dhe të huaj me maturitet të mbetur deri në një vit.

Paraqitje Grafike 6.1 (a): *Raporti i mbulimit të ankandeve të titujve shtetërorë (2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Kërkesa në rritje për tituj shtetërorë në kategorinë e *Institucioneve Financiare (jo-banka)* dhe *Institucioneve Jo-financiare* ka qenë e lartë për shkak të normave të interesit më të favorshme që ofrojnë titujt shtetërorë krahasuar me alternativat e tjera të investimit. Ndërkohë, kërkesa e lartë nga *Sektori Bankar* vjen si rezultat i riskut më të ulët që ofrojnë titujt shtetërorë krahasuar me instrumentin e kredisë. Ulja e kërkesës për tituj shtetërorë nga *Banka e Shqipërisë* është në linjë me iniciativën për uljen e volumit të titujve shtetërorë të tregtuar me norma interesi jo-konkuruese në tregun primar, me qëllim stimulimin e aktivitetit të tregut sekondar.

Paraqitje Grafike 6.1 (b): *Kërkesa për tituj shtetërorë sipas investitorëve (2016-2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Tendenca e kërkesës reflektohet edhe në drejtim të mbajtësve të borxhit të brendshëm. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2017 ka pasur një rritje të përqendrimit të titujve shtetërorë në portofolin e *Sektorit Bankar* dhe *Institucioneve Financiare*, si edhe një rënie në portofolin e *Bankës së Shqipërisë* dhe *Individëve*. Reduktimi i portofolit të *Individëve*, megjithëse në vlerë modeste, është ndikuar kryesisht nga niveli i ulët i normave të interesit.

Paraqitje Grafike 6.1 (c): *Mbajtësit e borxhit të brendshëm shtetëror (2013-2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

Në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës së tregut primar dhe stimulimit të tregut sekondar, gjatë vitit 2017 kanë vazhduar të ndërmerren aktivitete të cilat kanë pasur si objektiv reduktimin e fragmentimit të kërkesës dhe krijimin e madhësive *benchmark* për titujt afatgjatë.

Në drejtim të uljes së fragmentimit të kërkesës është tërhequr gradualisht obligacioni 3 vjeçar dhe plotësisht obligacioni 7 vjeçar me norma interesi të ndryshueshme, pasi numri i lartë i titujve me karakteristika të ngjashme rrit konkurrencën ndërmjet tyre dhe rrjedhimisht fragmenton kërkesën.

Ndërkohë, në drejtim të krijimit të madhësive *benchmark* është vijuar me konsolidimin e numrit të titujve shtetërorë, duke ulur frekuencën e emetimeve të titujve të rinj dhe duke shtuar rihapjet e titujve ekzistues.

Paraqitje Grafike 6.1 (d): *Ecuria e ankandeve të titujve shtetërorë (2014-2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

6.2. Ecuria e normave të interesit

Gjatë vitit 2017 normat e interesit të titujve shtetërorë *(me përjashtim të normave të obligacioneve 3 dhe 10 vjeçare)* përgjithësisht kanë pasur një tendencë të moderuar rritëse. Megjithatë, kjo rritje ka qenë brenda pritshmërive dhe nuk ka pasur ndikim në koston mesatare

të portofolit të borxhit të brendshëm. Në fund të vitit 2017 kosto mesatare vlerësohet pothuajse në të njëjtat nivele me fundin e vitit 2016, përkatësisht 4.33% dhe 4.37 % .

Paraqitje Grafike 6.2: *Kurba e yield-it për titujt shtetërorë (2015-2017)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)*

ANEKSI I

AKRONIME DHE FJALOR SHPJEGUES

AKRONIME

BSH	Banka e Shqipërisë
DMM	Ditët Mesatare në Maturim
EUR	Euro
JPY	Jeni Japonez
KMM	Koha Mesatare në Maturim
KMR	Koha Mesatare në Rivlerësim
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PBG	Policy Based Guarantee
PP	Pikë Përqindje
PB	Pikë Bazë
SAMB	Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit
USD	Dollari i Shteteve të Bashkuara
YMP	Yield-i Mesatar i Ponderuar

FJALOR SHPJEGUES

Benchmark: Një instrument i tregtueshëm në frekuenca të shpeshta kohore dhe në vlera të konsiderueshme. Norma e këtij instrumenti shërben si referencë për vlerësimin e normave të instrumenteve të tjera (p.sh. Bono Thesari 12-mujore).

Borxh: Referuar si "Borxh Total" ose "Totali i detyrimeve të borxhit", konsiston në të gjitha detyrimet që janë instrumente të borxhit.

Borxh i brendshëm: Detyrimet e borxhit të rezidentëve të një vendi ndaj rezidentëve të po atij vendi.

Borxh i jashtëm: Detyrimet e borxhit të rezidentëve të një vendi ndaj jo rezidentëve.

Borxhi publik i garantuar: Detyrimet e borxhit të sektorit publik dhe privat, shërbimi i të cilit është i garantuar me marrëveshje nga njësitë e sektorit publik.

Borxh afatgjatë: Borxh me afat maturimi më të lartë se një vit.

Disbursim: Transaksioni i sigurimit të burimeve financiare.

Eurobond: Një obligacion *(titull financiar)* me afat maturimi më shumë se një vit i emetuar dhe tregtuar në tregjet ndërkombëtare financiare, jashtë kufijve të vendit që e emeton atë.

Instrument borxhi: Është një pretendim financiar që kërkon kthim të principalit dhe/ose pagesa të interesit nga debitori në favor të kreditorit në datat e ardhshme.

Huamarrës: Pala e përcaktuar në marrëveshjen e kredisë, e cila në të ardhmen do të angazhohet për shlyerjen e borxhit të marrë.

KMM: Tregues i riskut të rifinancimit për borxhin. KMM është periudha mesatare e shprehur në ditë ose në vite, që i duhet portofolit të borxhit për t'u maturuar. Sa më larg në kohë të jetë e projektuar data e maturimit të një instrumenti, aq më i ulët është risku i rifinancimit dhe aq më e lartë është vlera e këtij treguesi.

KMR: Tregues i riskut të normave të interesit për borxhin. Jep informacion lidhur me ekspozimin e portofolit të borxhit kundrejt ndryshimit të normave të interesit. KMR interpretohet si koha mesatare *(në vite)* që i duhet portofolit të borxhit për të ripërcaktuar normën e interesit. Sa më e madhe të jetë sasia e instrumenteve afatshkurtër dhe sasia e instrumenteve me norma interesi të ndryshueshëm në portofolin e borxhit, aq më i madh është risku i normave të interesit dhe aq më i vogël është ky tregues dhe anasjelltas.

Kredi: Është një instrument financiar që krijohet kur një kreditor i jep hua fondet direkt një debitori nëpërmjet një marrëveshje të pranuar nga palët.

Kreditor: Entiteti që siguron para ose burime të cilat huamarrësi detyrohet t'i shlyejë sipas termave të përcaktuara në marrëveshje.

Kreditorë shumëpalësh: Tipi i kreditorëve si Banka Botërore, FMN, etj.

Kredi koncesionale: Kredi me terma më të favorshme se ato të tregut.

Kreditorë dypalësh: Tipi i kreditorëve si qeveritë dhe agjencitë e tyre.

Kreditorë privatë: Kreditorët që nuk janë as qeveri as agjenci të sektorit publik. Këto përfshijnë mbajtësit privatë të titujve shtetërorë, bankat private dhe institucionet e tjera financiare.

PBG: Është garanci e cila emetohet nga Banka Botërore dhe garanton plotësisht ose pjesërisht një borxh me qëllim mundësimin e një kostoje më të favorshme se ajo e ofruar nga tregu.

Raport mbulimi: Raporti ndërmjet shumës së kërkuar *(nga investitorët)* dhe shumës së ofruar *(nga shteti)* në ankandet e titujve shtetërorë. Shërben për të vlerësuar nivelin e plotësimit të ankandeve dhe gjendjen e likuiditetit.

Risku i kursit të këmbimit: I referohet ndikimit të lëvizjes së kursit të këmbimit të një monedhe, mbi nivelin e borxhit dhe shërbimin e tij në një masë të caktuar mbi pritshmëritë.

Risku i likuiditetit: Risk i lidhur me humbjen e aftësisë së buxhetit të shtetit për të likuiduar detyrimet korrente dhe të ekzekutojë në kohë shpenzimet buxhetore. Me qëllim minimizimin e këtij risku, shteti duhet të ketë akses mbi një sasi të caktuar asetesh likuide me qëllim garantimin e fondeve në raste krizash të përkohshme, ku gjatë të cilave bëhet e vështirë ose me kosto të lartë, sigurimi i tyre.

Risku i normave të interesit: Risku që pagesat e shërbimit të borxhit të ndryshojnë si rrjedhojë e lëvizjes së normave të interesit. Ky risk krijohet nga nevoja për të shërbyer borxhin që maturohet dhe pagesat e kuponëve të instrumenteve me norma të ndryshueshme në të ardhmen.

Risku operacional: Risku i lidhur me rritjen e kostos së menaxhimit të borxhit ose me rritjen e nivelit të risqeve të tjera si rezultat i gabimeve njerëzore, dëmeve të pajisjeve elektronike, dëmeve natyrore, etj.

Risku i rifinancimit: Risku i lidhur me aftësinë për të emetuar instrumente ose marrë hua me qëllim rifinancimin dhe shërbimin e borxhit aktual. Sa më i madh të jetë volumi i shumave që maturohen dhe sa më i afërt në kohë, aq më i lartë është risku i rifinancimit dhe anasjelltas. Risku i rifinancimit ndikohet nga niveli i borxhit ekzistues dhe profili i amortizimit. Rritja e maturitetit të borxhit dhe shpërndarja në kohë e maturimeve kontribuon në reduktimin e riskut të rifinancimit.

Stoku i borxhit: Balanca e principalit të borxhit në një moment të dhënë të kohës.

Shërbim borxhi: Pagesat e principalit dhe interesit në përputhje me termat e përcaktuara në marrëveshje.

Tregu primar: Është hapësira fizike ose funksionale në të cilin Shteti Shqiptar emeton për herë të parë titujt.

Treg sekondar: Është hapësira fizike ose funksionale ku kryhen transaksionet me titujt pasi janë emetuar në tregun primar.

Tituj shtetërorë: Janë bonot e thesarit dhe obligacionet shtetërore të emetuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në përputhje me Ligjin Nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjin Nr. 9879, datë 21.02.2008, "Për titujt"; si edhe aktet nënligjore.

ANEKSI II

TË DHËNA SHTESË

1. STOKU I BORXHIT PUBLIK DHE QEVERISJES QENDORE

Tabela 1.0: *Stoku i Borxhit Publik (2013-2017)* *(në milion Lek)*

	2013	2014	2015	2016	2017
Borxhi Publik	885,083	977,957	1,043,212	1,066,566	1,088,095
Borxhi i Qeverisjes Qendrore	884,692	977,102	1,042,272	1,065,709	1,087,342
Borxhi i Pushtetit Lokal	391	855	940	857	753
PBB	1,350,053	1,395,305	1,427,799	1,472,791	1,555,202
Borxhi Publik/PBB	65.56%	70.09%	73.06%	72.42%	69.96%
Borxhi i Qeverisjes Qendrore/PBB	65.53%	70.03%	73.00%	72.36%	69.92%
Borxhi i Pushtetit Lokal/PBB	0.03%	0.06%	0.07%	0.06%	0.05%

Tabela 1.1: *Stoku i Borxhit të Qeverisjes Qendrore (2013- 2017)* *(në milion Lek)*

	2013	2014	2015	2016	2017
Borxhi i Qeverisjes Qendrore	884,692	977,102	1,042,272	1,065,709	1,087,342
Borxhi i Brendshëm	520,786	564,673	551,374	561,120	577,056
Borxhi i Jashtëm	363,906	412,429	490,898	504,589	510,286

Tabela 1.2: *Stoku i Borxhit të Qeverisjes Qendrore (2013- 2017)* *(në milion Lek)*

	2013	2014	2015	2016	2017
Borxhi i Qeverisjes Qendrore	884,692	977,102	1,042,272	1,065,709	1,087,342
Borxhi Shtetëror	833,368	922,562	986,242	1,012,241	1,037,457
Borxhi Shtetëror i Garantuar	51,324	54,540	56,030	53,468	49,885

Tabela 1.3: *Kompozimi i stokut të borxhit të Qeverisjes Qendore (2015-2017)*

Kompozimi	2015		2016		2017	
	mln Lek	% / Totalit	mln Lek	% / Totalit	mln Lek	% / Totalit
I. Sipas Maturitetit Origjinal	**1,042,271**	**100.0%**	**1,065,709**	**100.0%**	**1,087,342**	**100.00%**
I. Afatshkurtër	**223,824**	**21.5%**	**239,694**	**22.5%**	**225,164**	**20.7%**
Tituj Shtetërorë	223,824	21.5%	209,409	19.6%	195,047	17.9%
Kredi	0.0	0.0%	30,286	2.8%	30,117	2.8%
II. Afatgjatë	**818,447**	**78.5%**	**826,015**	**77.5%**	**862,178**	**79.3%**
Tituj Shtetërorë	358,887	34.4%	382,279	35.9%	411,720	37.9%
Kredi	459,560	44.1%	443,736	41.6%	450,459	41.4%
II. Sipas Monedhës	**1,042,271**	**100.0%**	**1,065,709**	**100.0%**	**1,087,342**	**100.0%**
Monedhë Kombëtare	526,875	50.6%	540,614	50.7%	552,054	50.8%
Monedhë e Huaj	515,396	49.4%	525,095	49.3%	535,288	49.2%
III. Sipas Residencës	**1,042,271**	**100.0%**	**1,065,709**	**100.0%**	**1,087,342**	**100.0%**
Kreditorë Vendas	566,060	54.3%	583,933	54.8%	599,478	55.1%
Kreditorë të Huaj	476,211	45.7%	481,776	45.2%	487,863	44.9%
IV. Sipas Tipit të Interesit*	**1,011,833**	**97.1%**	**1,035,424**	**97.2%**	**1,057,230**	**97.2%**
Interesa Fikse	691,971	66.4%	738,313	69.3%	758,266	69.7%
Interesa të Ndryshueshme	319,862	30.7%	297,111	27.9%	298,964	27.5%
V. Sipas Koncesionalitetit*	**1,011,833**	**97.1%**	**1,035,424**	**97.2%**	**1,057,230**	**97.2%**
Interesa Koncesionale	235,862	22.6%	252,257	23.7%	257,883	23.7%
Interesa Tregtare	775,971	74.5%	783,167	73.5%	799,347	73.5%

**Nuk përfshihet borxhi i brendshëm i garantuar.*

2. HUAMARRJA SHTETËRORE

Tabela 2.0: *Huamarrja shtetërore nga burime të brendshme dhe të jashtme në terma bruto (2016-2017)*

Burimet e Huamarrjes	2016		2017	
	Vlera (në mld Lek)	%/Total	Vlera (në mld Lek)	%/Total
Burime të Brendshme	**342.0**	**100.0%**	**323.0**	**100.0%**
i. Bono Thesari	249.6	73.0%	217.7	67.4%
ii. Obligacione	92.4	27.0%	105.3	32.6%
Burime të Jashtme	**40.1**	**100.0%**	**58.7**	**100.0%**
i. Mbështetje Buxhetore	21.1	52.7%	31.4	53.5%
ii. Eurobond	0.0	0.0%	0.0	0.0%
iii. Kredi për financim projektesh	19.0	47.3%	27.2	46.5%
Total Huamarrja	**382.1**	**100.0%**	**381.6**	**100.0%**

Tabela 2.1: *Huamarrja e brendshme sipas titujve shtetërorë në terma neto dhe bruto (2017)*

Lloji i Titullit	2017			
	Emetim (në mld Lek)	Maturim (në mld Lek)	Huamarrja Neto (në mld Lek)	Huamarrja Neto (në %)
Gjithsej Tituj Shtetërorë (I+II)	**323.0**	**306.6**	**16.4**	**100.0%**
I. Tituj Afatshkurtër	**217.7**	**232.1**	**-14.4**	**-87.6%**
Bono Thesari në Lek	217.7	232.1	-14.4	-87.6%
Bono Thesari në Euro	0.0	0.0	0.0	0.0%
II. Tituj Afatgjatë	**105.3**	**74.5**	**30.8**	**187.6%**
Obligacione 2 vjeçare	55.7	43.6	12.1	74.0%
Obligacione 3 vjeçare	3.0	7.2	-4.2	-25.9%
Obligacione 5 vjeçare	28.4	23.7	4.7	28.6%
Obligacione 7 vjeçare	8.4	0.0	8.4	51.3%
Obligacione 10 vjeçare	9.8	0.0	9.8	59.6%

3. KOSTOT DHE RISQET

Tabela 3.0: *Shërbimi i borxhit shtetëror (2013–2017)* *(në milion Lek)*

	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej Shërbimi i Borxhit (I+II)	**56,109**	**57,782**	**100,336**	**58,257**	**57,672**
I. Interesat e Borxhit Gjithsej	**43,335**	**39,937**	**38,642**	**36,259**	**31,904**
Interesat e Borxhit të Brëndshëm	35,890	31,696	27,385	25,526	21,415
Interesat e Borxhit të Jashtëm	7,445	8,241	11,258	10,733	10,489
II. Principali i Borxhit të Jashtëm	**12,774**	**17,845**	**61,693**	**21,998**	**25,769**
Shërbimi Borxhit gjithsej/PBB (I+II)	**4.16%**	**4.14%**	**7.03%**	**3.96%**	**3.71%**
I. Interesat e Borxhit Gjithsej/PBB	**3.21%**	**2.86%**	**2.71%**	**2.46%**	**2.05%**
Interesat e Borxhit Brëndshëm/PBB	2.66%	2.27%	1.92%	1.73%	1.38%
Interesat e Borxhit Jashtëm/PBB	0.55%	0.59%	0.79%	0.73%	0.67%
II. Principali i Borxhit të Jashtëm/PBB	0.95%	1.28%	4.32%	1.49%	1.66%

** Krahas shërbimit të borxhit shtetëror përfshihet edhe shërbimi i borxhit që Qeveria ka paguar në favor të entiteteve për të cilat është emetuar Garanci Shtetërore.*

Paraqitje Grafike 3.1: *Profili i amortizimit të borxhit të brendshëm shtetëror (2016-2017)*



Paraqitje Grafike 3.2: *Profili i amortizimit të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm shtetëror (2017)*



Tabela 3.3: *Treguesit e riskut të normave të interesit (2015-2017)*

Treguesi	2015	2016	2017
Borxh me normë fikse*/totalit	43.2%	47.5%	55.6%
Borxhi i rivlerësuar në një vit	67.7%	62.6%	56.7%
Koha mesatare në rivlerësim	1.83	2.01	2.20

* *Përjashtohen titujt afatshkurtër, pasi kanë karakteristika të ngjashme risku me titujt me norma të ndryshueshme.*

4. TREGUESIT E TREGUT PRIMAR TË TITUJVE SHTETËRORË

Tabela 4.0: *Treguesit e ecurisë së kërkesës dhe ofertës në tregun primar të titujve shtetërorë (2016-2017)*

Periudha	Treguesi	B.Thesari	Obligacione	Gjithsej
2016	Nr i ankandeve	42	32	74
	Kërkesa *(në mld Lek)*	301.5	138.8	440.2
	Oferta *(në mld Lek)*	262.2	103.5	365.7
	Raporti i mbulimit	1.15	1.34	1.20
2017	Nr i Ankandeve	32	27	59
	Kërkesa *(në mld Lek)*	275.2	147.4	422.5
	Oferta *(në mld Lek)*	227.1	112.90	340.0
	Raporti i Mbulimit	1.21	1.31	1.24

5. KOMPOZIMI I BORXHIT TË JASHTËM

Paraqitje Grafike 5.0: *Stoku i borxhit të jashtëm shtetëror sipas monedhave (2016- 2017)*



Paraqitje Grafike 5.1: *Stoku i borxhit të jashtëm qendror sipas tipit të interesit (2012–2017)*



	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Interes Fix	1,871.43	1,440.03	1,525.22	2,021.54	2,031.71	1,951.18
Interes i ndryshueshëm	690.52	1,155.59	1,417.76	1,554.34	1,699.63	1,887.00

Paraqitje Grafike 5.2: *Stoku i borxhit të jashtëm qendror sipas koncesionalitetit (2012-2017)*



	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Koncesionale	1,237.60	1,213.33	1,519.21	1,718.11	1,865.39	1,939.70
Jo-koncesionale	1,324.35	1,382.29	1,423.77	1,857.78	1,865.95	1,898.48

6. DISBURSIMET E BORXHIT TË JASHTËM

Tabela 6.0: *Disbursimet sipas kreditorëve (2012-2017)* *(në milion Euro)*

	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Shumëpalësh	220.03	132.49	313.53	171.71	211.16	385.93
Dypalësh	57.81	52.55	71.49	103.02	81.05	53.20
Kreditorë Privat	0.00	0.00	0.00	701.08	14.86	0.60
GJITHSEJ	277.84	185.04	385.02	975.81	307.06	439.73

**Përfshihen disbursimet e borxhit shtetëror dhe shtetëror të garantuar.*

Tabela 6.1: *Disbursimet sipas sektorëve ekonomik (2012-2017)* *(në milion Euro)*

Sipas sektorëve ekonomikë	2012	2013	2014	2015	2016	2017
ADMINISTRATA SHTETËRORE	-	4.64	4.64	1.03	1.40	0.89
ARSIMI	9.12	0.71	0.39	1.25	1.00	0.25
BILANCI I PAGESAVE	-	-	-	-	-	-
BUJQËSI, UJITJE				1.79		
ENERGJETIKË	17.82	19.89	31.63	45.51	27.22	51.77
IMPORT MALLRASH DHE PAUSJESH						
INDUSTRI E LEHTË	-	-	-	-	-	-
INFRASTRUKTURË URBANE DHE RURALE	0.56	6.17	8.47	16.88	23.70	24.34
KLUBI I PARISIT DHE RISKEDULIME TË TJER	-	-	-	-	-	-
MBËSHTETJE PËR BUXHETIN			218.73	801.51	153.17	234.30
MBROJTJA	1.79	2.27	-	-	-	-
MBROJTJA E MJEDISIT	1.05			0.42	0.78	0.02
PYJE	-	-	-	-	-	-
SHËNDETËSI	10.75	0.47	6.87	10.18	1.05	0.57
SIGURIME SHOQ./TREGU I PUNËS	1.80	2.66	-	-	-	-
STREHIM	0.43	0.00	-	1.34		
TELEKOMUNIKACION	-	-	-	-	-	-
TRANSPORT	193.22	129.15	76.37	52.43	41.32	79.70
TRANSPORTI AJROR	-	-	-	-	-	-
TRANSPORTI HEKURUDHOR						
UJËSJELLËSA/KANALIZIME	25.48	16.55	37.38	31.67	42.38	45.15
ZHVILL. SEK.PRIVAT	13.79			7.00		
TË TJERA	-	-	-	-	-	2.13
ZHVILLIMI RURAL	2.03	2.54	1.32	1.33	0.23	0.60
MEDIA TELEVIZIVE	-	-	-	3.46	14.85	-
GJITHSEJ	277.84	185.04	385.02	975.81	307.06	439.73

**Përfshihen disbursimet e borxhit shtetëror dhe shtetëror të garantuar.*

RAPORT

MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË TË BUXHETIT TË SHTETIT DHE TË FONDIT TË KONTIGJENCËS, PËR VITIN 2017

I. Fondi Rezervë

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit nr.9936 datë 26.6.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar"*, buxheti i shtetit përfshin edhe një fond rezervë i cili përdoret për rastet e financimit të shpenzimeve, që nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Gjatë vitit 2017 shuma e Fondit Rezerve të buxhetit të shtetit është miratuar dhe ndryshuar përkatësisht si vijon:

- *Me Ligjin nr.130 datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017", në shumën 1.5 miliardë lekë.*
- *Me Aktin Normativ nr.2 datë 16.08.2017 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", në shumën 2.7 miliardë lekë*
- *Me Aktin Normativ nr.3 datë 6.11.2017 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017, të ndryshuar", në shumën 2.4 miliardë lekë.*

Deri në datën 31 dhjetor të vitit 2017, fondi rezervë i buxhetit të shtetit është përdorur nëpërmjet 28 Vendimeve të Këshillit të Ministrave, në shumën prej rreth 2 301.8 milionë lekësh, nga 2.4 miliard lekë të planifikuara, ose në rreth 95.9 përqind të tij.

Tabela 1: Përdorimi i fondit rezervë për vitin 2017 (në milionë lekë)

Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit 2017	Miratuar me ligj për vitin 2017	Përdorur me VKM gjatë vitit 2017	Mbetur pa përdorur në fund të 2017	Përqindja (Përdorur/Planifikuar)
	2 400	2 301.8	98.2	95.9

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Deri në datën 31 Dhjetor 2017, nga fondi rezervë i planifikuar për vitin 2017, i përdorur nëpërmjet VKM-ve, rezulton se:

- ✓ *Rreth 2 080.9 milionë lekë ose 90 përqind e tij, për shpenzime të tjera korente (shpenzime operative dhe transferta të brendshme);*
- ✓ *Rreth 132.1 milionë lekë ose 6 përqind e tij, për investime publike; dhe*
- ✓ *Rreth 88.9 milionë lekë ose 4 përqind e tij, janë përdorur për shpenzime personeli.*

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet struktura e përdorimit të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit për vitin 2017.

Grafiku.1 Përdorime të Fondit Rezervë, viti 2017 (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë(2018);

Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të përdorimit të këtij fondi, sipas institucioneve, deri në fund të vitit 2017.

Tabela 2: Përdorimi i fondit rezervë, sipas institucioneve përfituese (në 000/lekë)

Kodi instit.	Emërtimi i institucionit	Numri i VKM-ve të miratuara	Fondi i përdorur	
			Vlera (000/lekë)	Në % ndaj totalit
03.	Kryeministria	1	40 000	1.7%
10.	Ministria e Financave dhe Ekonomise	7	38 880	1.7%
11.	Ministria e Arsimit dhe Sportit	1	75 499	3.3%
12.	Ministria e Kulturës	1	3 300	0.1%
13.	Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	1	176 000	7.6%
15.	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	1	11 500	0.5%
16.	Ministria e Brendshme	5	375 276	16.3%
17.	Ministria e Mbrojtjes	1	56 690	2.5%
24.	Kontrolli i Lartë i Shtetit	2	104 700	4.5%
40.	Partitë Politike	1	65 000	2.8%
63.	Veprimtaria Mbikqyrjes dhe Rivleresimit ne Sistemin e Drejtësisë	1	88 892	3.9%
73.	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	2	75 290	3.3%
87.	Institucione të tjera Qeveritare	1	14 979	0.7%
06.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (për MEI)	1	1 000 000	43.4%
06.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Për MZHU)	1	175 874	7.6%
	TOTALI	**28**	**2 301 880**	**95.9**

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2018)

Në mënyrë analitike rezulton se:

- ✓ Rreth 40 milionë lekë ose rreth 1.7 përqind e fondit rezervë të përdorur gjatë vitit 2017, i është dhënë Kryeministrisë nëpërmjet një vendimi për investime.
- ✓ Rreth 38.9 milionë lekë, ose rreth 1.7 përqind e fondit rezervë i është dhënë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet shtatë vendimeve, si shtesë fondi në planin e buxhetit të vitit 2017 për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evriopiane per te drejtat e njeriut si edhe per financimin e kontratës së qirasë midis DPD e shoqerise "Continental Group sh.a".
- ✓ Rreth 75.4 milionë lekë ose 3.3 për qind e fondit rezervë i është dhënë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për financimin e pistës së atletikës në stadiumin 'Loro Borici', Shkodër.
- ✓ Rreth 3.3 milion lekë ose 0.1 për qind e fondit rezervë i është dhënë Ministrisë së Kulturës, për përballimin e shpenzimeve per organizmin e aktiviteteve për kryerjen e ceremonialit funebër në nderim të të ndjerit D. Agolli.
- ✓ Rreth 176 milionë lekë ose 7.6 për qind e fondit rezervë i është dhënë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shpërblimin e disa kategorive për festat e fundvitit.
- ✓ Rreth 11.5 milionë lekë ose 0.5 për qind e fondit rezervë i është dhënë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për dhënien e ndihmës financiare, per Qeverinë e SHBA-ve, për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga erërat e forta dhe përmbytjet në Shtator 2017.
- ✓ Rreth 375.3 milionë lekë ose 16.3 për qind e fondit rezervë i është dhënë Ministrisë së Brendshme me pesë VKM, për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore, për dëmshpërblimet e disa familjeve për shkak të dëmtimit të banesave, për shpërblimin e disa punonjësve të angazhuar në situatën emergjente si edhe për dhënien e ndihmës familjes se një inspektori policie i vrarë në krye të detyrës.
- ✓ Rreth 56.7 milionë lekë ose 2.5 për qind e fondit rezervë i është dhënë Ministrisë së Mbrojtjes për shpërblimin e disa punonjësve të angazhuar në situatën emergjente.
- ✓ Kontrollit të Lartë të Shtetit i është dhënë fondi prej 104.7 milionë lekësh ose rreth 4.5 për qind e fondit rezervë për shpenzime për investime.
- ✓ Rreth 65 milionë lekë janë dhënë partive politike për financimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore.
- ✓ Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i është akorduar fondi prej 88.9 milionë lekë për financimin e shpenzimeve të zgjedhjeve.

- ✓ Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare i është akorduar shuma prej 14.9 milion lekësh ose 0.7% e fondit rezervë të akorduar.
- ✓ Është akorduar fondi prej 1 miliardë lekësh për blerje nga importi të energjisë elektrike.
- ✓ Për zhvillimin urban janë akorduar rreth 175.8 milionë lekë.

Mbështetur në sa mësipër rezulton se, në datën 31 dhjetor 2017, gjendja e fondit rezervë të buxhetit të shtetit, e papërdorur, rezulton të jetë 98.2 milionë lekë.

II. Fondi Kontigjencë

Fondi Kontigjencë për risqet e borxhit, në masën prej 4 miliardë lekë, është miratuar sipas nenit 10 të Ligjit nr.130 datë 15.12.2016 "*Për buxhetin e vitit 2017*".

Ndërkohë, sipas nenit 13 të Ligjit nr.130 datë 15.12.2016 "*Për buxhetin e vitit 2017*", përcaktohet se: "*...Kontigjenca për risqet e borxhit prej 4 000 milionë lekësh përdoret për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit...*".

Në datën 31 Dhjetor 2017, kjo Kontigjencë rezulton e papërdorur.

Perdorimet e Fondit Rezerve te Buxhetit te Shtetit per vitin 2017

Nr.	Min./Inst	VKM. Nr. Date	*Mirratuar me ligjin nr.130 date 16.12.2016 "Per buxhetin e viti 2017, i ndryshuar* EMERTIMI I VKM	Shuma 3,400,000	Ekzekutuar	NDARJA E FONDIT REZERVE SIPAS ARTIKUJVE 600	601	602	603	604	605	606	230	231	Totali
1	Gr.16	Nr.22 date 18.01.2017	"Per një shtesë fonde në buxhetin e v.2017, miratuar për Ministrinë e Brendshme. Nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për vitrinat e ngjarjes së 21 Janarit 2011"	180,011	180,011			180,011							180,011
2	Gr.94	Nr.63 date 02.02.2017	"Për një shtesë fonde në buxhetin e v.2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban""Për një shtesë fonde në buxhetin e v.2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban""Për një shtesë fonde në buxhetin e v.2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban"	148,500	148,500			148,500							148,500
3	Gr.12	Nr.75 date 04.02.2017	"Per kryerjen e kompesimit shfetenor (pashmangshmerise per organizimin e aktiviteteve per kryerjen e ceremonialit funeral, me ndermim te te ndjerit Dritero Agolli" "Per kryerjen e kompesimit shfetenor (pashmangshmerise per organizimin e aktiviteteve per kryerjen e ceremonialit funeral, me ndermim te te ndjerit Dritero Agolli"	0	0										0
4	Gr.24	Nr.136 date 01.03.2017	"Për një shtesë fonde në buxhetin e v.2017, miratuar për Kontrollin e Larte te Shtetit""Për një shtesë fonde në buxhetin e v.2017, miratuar për Kontrollin e Larte te Shtetit""Për një shtesë fonde në buxhetin e v.2017, miratuar për Kontrollin e Larte te Shtetit"	93,000	93,000									93,000	93,000
5	Gr.10	Nr.162 date 08.03.2017	"Per ekzekutimin e Vendimit te Gjykates Evropiane per te drejtat e njeriut , date 10.11.2016, per ceshtjen "Cesa dhe Fetesa kunder Shqiperise", (per kerkesen nr.1537/15 dhe kerkesen nr.3604/16)												0
6	Gr.10	Nr.163 date 08.03.2017	"Per ekzekutimin e Vendimit te Gjykates Evropiane per te drejtat e njeriut , date 06.10.2016, per ceshtjen "Shanu kunder Shqiperise", (per arkivimin nr.3370/09)												0
7	Gr.10	Nr.164 date 08.03.2017	"Per ekzekutimin e Vendimit te Gjykates Evropiane per te drejtat e njeriut , date 10.11.2016, per ceshtjen "Dino kunder Shqiperise", (per kerkesen nr.4976/13) "Per ekzekutimin e Vendimit te Gjykates Evropiane per te drejtat e njeriut , date 10.11.2016, per ceshtjen "Dino kunder Shqiperise", (per kerkesen nr.4976/13)												0
8	Gr.10	Nr.165 date 08.03.2017	"Per ekzekutimin e Vendimit te Gjykates Evropiane per te drejtat e njeriut , date 08.12.2016, per ceshtjen "Grabova kunder Shqiperise", (per kerkesen nr.3544/14)	2,640	2,640			2,640							2,640
9	Gr.94	Nr.204 date 15.03.2017	"Për një shtesë fonde në buxhetin e v.2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban, dhe transformim e tij nga MZHU të Bashkia Tiranë, per realizimi e pagesave, se detyrimi te preparimbetur per shkoqenine "Ullajnen" "	27,374	27,375								27,374		27,374
10	Gr.11	Nr.302 date 05.04.2017	"Per financimin e pistes se atletikes ne stadiumin "Loro Boriçi" Shkoder""Per financimin e pistes se atletikes ne stadiumin "Loro Boriçi" Shkoder""Per financimin e pistes se atletikes ne stadiumin "Loro Boriçi" Shkoder"	75,499	75,499					75,499					75,499
11	Gr.73	Nr.386 date 03.05.2017	"Per nje shtese fondi ne buxhetin e viti 2017, miratuar per KQZ, per financimin e shpenzimeve te zgjedhjeve per kuvendin e Republikes se Shqipenise, te 18 Qershorit 2017, dhe financimin e fushates zgjedhore te subjekteve perfaqesor pesemarrese ne keto zgjedhje si dhe per financimin e zgjedhjeve vendore per kryetar te	140,290	140,290			140,290							140,290
12	Gr.40	Nr.388 date 03.05.2017	"Per nje shtese fondi ne buxhetin e viti 2017, miratuar per KQZ, per financimin e shpenzimeve te zgjedhjeve per kuvendin e Republikes se Shqipenise, te 18 Qershorit 2017, dhe financimin e fushates zgjedhore te subjekteve perfaqesor pesemarrese ne keto zgjedhje, si dhe per financimin e zgjedhjeve vendore per kryetar te	65,000	65,000					65,000					65,000
13	Gr.12	Nr.400 date 03.05.2017	"Per nje shtese fondi ne buxhetin e viti 2017, miratuar per Ministrine e Kultures, per mbulimin e shpenzimeve financiare qe u krijen ne kuader te organizimit te aktiviteteve per kryerjen e ceremonialit funeral me ndermim te te ndjerit Dritero Agolli"	3,300	3,300			3,300							3,300
14	Gr.73	Nr.476 date 09.06.2017	"Per nje shtese fondi ne buxhetin e viti 2017, miratuar per KQZ, per monitorimin e fushates zgjedhore te partive politike me zgjedhjet per kuvendin e Republikes se Shqipenise, me 25 Qershor 2017"	10,000	10,000			10,000							10,000
15	Gr.15	Nr.484 date 13.06.2017	"Per dhenien e ndihmes financiare, nga Kushti i Ministrave i Republikes se Shqipenise per Gevenine e SHBA-ve, per lehtesimin e pasqyre te cenieve te shkaktuara nga erresi e forta dhe permbytjet ne Shtator 2017"	11,500	11,500						11,500				11,500
16	Gr.93	Vendimi te Kuvendit 92/Vend/2017	"Per miratimin e struktures organizative, organikes dhe kualifikimit te pagave te personelit te Kolegjit te Pasatem te Apelimit, te Komisionerit te Pavarur te kualifikimit dhe te Komisionerit Publike"	88,892	88,892	83,057	5,835								88,892
17	Gr.93	Nr.539 date 04.10.2017	"Per mbeshtetje financiare te sektorit te energjise per blerje nga importi te energjise elektrike, per v.2017""Per mbeshtetje financiare te sektorit te energjise, per blerje nga importi te energjise elektrike, per v.2017""Per mbeshtetje financiare te sektorit te energjise, per blerje nga importi te energjise elektrike, per v.2017"	1,000,000	1,000,000					1,000,000					1,000,000
18	Gr.24	Nr.567 date 18.10.2017	"Per nje shtese fondi ne buxhetin e viti 2017, miratuar per KLSH""Per nje shtese fondi ne buxhetin e viti 2017, miratuar per KLSH""Per nje shtese fondi ne buxhetin e viti 2017, miratuar per KLSH"	11,700	11,700									11,700	11,700
19	Gr.10	Nr.568 date 27.10.2017	"Per miratimin e kontrates se qirase se ringjizuar ndermjet Drejtorise se Pergatitjeve te Doganave dhe shoqeris"Continental Group SHA""Per miratimin e kontrates se qirase se ringjizuar, ndermjet Drejtorise se Pergatitjeve te Doganave dhe shoqeris"Continental Group"SHA"	19,255	19,255			19,255							19,255
20	Gr.16	Nr.570 date 16.11.2017	"Per nje shtese fonde per buxhetin e v.2017 per bashkine Patos dhe Rrogozhine, per demshperdarimet e familjeve banesat e te cilave jane demtuar nga tkurrjet e tokes"	73,992	73,992					73,992					73,992
21	Gr.97	Nr.574 date 22.11.2017	"Per nje shtese fondi ne buxhetin e viti 2017, miratuar per DSHQ""Per nje shtese fondi ne buxhetin e viti 2017, miratuar per DSHQ""Per nje shtese fondi ne buxhetin e viti 2017, miratuar per DSHQ"	14,979	14,979				14,979						14,979
22	Gr.93	Nr.708 date 01.12.2017	"Per nje shtese fondi ne buxhetin e viti 2017, miratuar per Kryemenaxhine" (AMA) "Per nje shtese fondi ne buxhetin e viti 2017, miratuar per Kryemenaxhine" (AMA) "Per nje shtese fondi ne buxhetin e viti 2017, miratuar per Kryemenaxhine" (AMA)	40,000	40,000					40,000					40,000
23	Gr.16	Nr.743 date 13.12.2017	"Per nje shtese fondi dhe nje ndryshim ne VKM nr.22 date 18.01.2017 "Per nje shtese fonde ne buxhetin e v.2017, miratuar per MPB, nga buxhetit i shtetit per shlyerjen e detyrimeve qe rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqesore per vitrinat e ngjarjes se 21 janarit 2011"	129,673	129,673			129,673							129,673
24	Gr.13	Nr.746 date 13.12.2017	"Per shperdarjen e disa kategorive te vecanta per feslat e fundvitit , 2017""Per shperdarjen e disa kategorive te vecanta per feslat e fundvitit , 2017""Per shperdarjen e disa kategorive te vecanta per feslat e fundvitit , 2017"	176,000	176,000							176,000			176,000
25	Gr.16	Nr.747 date 13.12.2017	"Per nje shtese fondi miratuar per MM dhe te MPB, nga buxhetit per shperdarjen e disa punojave te strukturave te forcave armatosura dhe policine e shtetit te angazhuar ne situatën emergjente te krijuar ne disa zona te vendit nga permbytja"	6,600	6,600							6,600			6,600
26	Gr.17	Nr.747 date 13.12.2017	"Per nje shtese fondi miratuar per MM dhe te MPB, nga buxhetit per shperdarjen e disa punojave te strukturave te forcave armatosura dhe policine e shtetit te angazhuar ne situatën emergjente te krijuar ne disa zona te vendit nga permbytja"	56,690	56,690							56,690			56,690
27	Gr.73	Nr.752 date 20.12.2017	"Per disa ndryshime ne VKM nr.388 date 03.05.2017 "Per nje shtese fondi ne buxhetin e v.2017, miratuar per KQZ, per financimin e shpenzimeve te zgjedhjeve per Kuvendin e Republikes se Shqipenise , te 18 Qershorit 2017, dhe financimin e fushates zgjedhore te subjekteve perfaqesor, pesemarrese ne keto zgjedhje, te	-75,000	-75,000			-75,000							-75,000
28	Gr.16	Nr.787 date 29.12.2017	"Per dhenie ndihme financiare familjes se inspektor Ervin Robert Hasholl, ish punonjes policie , i cili ka humbur jeten ne krye te detyres""Per dhenie ndihme financiare familjes se inspektor Ervin Robert Hasholl, ish punonjes policie , i cili ka humbur jeten ne krye te detyres"	5,000	5,000							5,000			5,000
29	Gr.10	Nr.808 date 29.12.2017	"Per ekzekutimin e vendimit te gjykates evropiane per te drejtat e njeriut, date 20.04.2017 per çeshtjen "Ana Vezo dhe te tjere kunder Shqiperise" (per kerkesen nr.1619/13	15,800	15,800			15,800							15,800
30	Gr.10	Nr.809 date 29.12.2017	"Per ekzekutimin e vendimit te gjykates evropiane per te drejtat e njeriut, date 03.12.2015 per çeshtjen "Bici kunder Shqiperise" (per arkivimin nr.5250/07) "Per ekzekutimin e vendimit te gjykates evropiane per te drejtat e njeriut, date 03.12.2015 per çeshtjen "Bici kunder Shqiperise" (per arkivimin nr.5250/07)	1,135	1,135			1,135							1,135
															0
			TOTALI I PERDORIMEVE	2,301,880	2,301,880	83,057	5,835	555,654	14,979	1,254,491	11,500	244,290	27,374	164,700	2,301,880
			MBETUR PA PERDORUR	98,120	98,120										



RAPORT MBI FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK NË NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME PËR VITIN 2017

Ky raport është përgatitur nga: Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

LISTA E SHKURTIMEVE

AB	Auditimi i Brendshëm
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Europian
KBFP	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
KB	Kontrolli i Brendshëm
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NPA	Nëpunës i Parë Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
DH/AB	Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm
DH/MFK	Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin
NJQP	Njësi e Qeverisjes së Përgjithshme
NJQQ	Njësi e Qeverisjes Qendrore
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
GMS	Grupi për Menaxhimin Strategjik
RSH	Republika e Shqipërisë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i konsoliduar për sistemet e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Shqipëri, hartohet si një kërkesë ligjore duke ofruar një përmbledhje vjetore të aktiviteteve të njësive të qeverisjes së përgjithshme në fushën e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, arritjet dhe mangësitë e evidentuara në vitin e mëparshëm duke sugjeruar dhe ofruar rekomandime për njësitë publike për përmirësime të mëtejshme. Në këtë raport janë marrë në konsideratë objektivat e parashikuara në shtyllën pesë të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, mbi reformat në fushën e kontrollit të brendshëm. Ky dokument strategjik ka për qëllim garantimin e një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik. Ky qëllim mund të arrihet vetëm nëpërmjet një sistemi të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe rritjes profesionale të auditimit të brendshëm në të gjitha njësitë publike.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2017, në përputhje me këtë dokument strategjik të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe rekomandimeve të SIGMA-s dhe PEFA-s 2017, u ndërmorrën një sërë aktivitetesh, të detajuara në këtë raport, për të përmirësuar cilësinë e kontrollit të brendshëm në sektorin publik.

Një fokus i veçantë gjatë këtij viti i është kushtuar trajnimit dhe ofrimit të asistencës në fushën e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në të gjitha njësitë e sektorit publik dhe në veçanti në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët u asistuan nga USAID lidhur me implementimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Gjatë vitit 2017, janë realizuar 5 cikle trajnimi 3-ditore, vetëm me punonjës nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku morën pjesë rreth 131 pjesëmarrës. Realizimi i trajnimeve është një domosdoshmëri për rritjen e ndërgjegjësimit të nivelit të lartë menaxherial si dhe stafit të institucioneve mbi ekzistencën e këtyre sistemeve konform legjislacionit në fuqi, si dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar si transparenca, efektiviteti, efiçenca dhe ekonomia në përdorimin e fondeve publike. Vlen të theksojmë, gjithashtu, se gjatë këtij viti, vihet re një rritje e interesit të njësive publike të cilat kërkojnë asistencë dhe trajnime nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Gjithashtu, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, ka mundësuar ofrimin e trajnimeve me qëllim informimin e niveleve të ndryshme të menaxhimit lidhur me përgjegjshmërinë menaxheriale, mënyrën e implementimit dhe funksionimit të kontrollit të brendshëm financiar publik si edhe zbatimin në praktikë të elementeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të rritur kapacitetet e administratës publike në zbatimin korrekt të kërkesave ligjore. Njëkohësisht, po në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, janë zhvilluar trajnimet e vijueshme profesionale të auditimit të brendshëm, ku janë trajnuar 313 audituesë të brendshëm në detyrë, me njohuritë dhe praktikat më të mira të fushës së auditimit të brendshëm.

Për vitin 2017, edhe si rezultat i trajnimeve të zhvilluara, pothuajse të gjitha njësitë publike përdorin elementët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për të përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm për të arritur objektivat dhe rezultatet e dëshirueshme nga ana e tyre. Nga analiza e përgjithshme e rreth 130 njësive publike, u konkludua që efektiviteti i përgjithshëm i sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në këto institucione për vitin 2017 është 3.41/4.00[1], duke evidentuar progres në krahasim me vitin 2016, i cili ka qënë 3.16/4.00.

[1] Efektiviteti i sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit llogaritet mbi bazën e pyetësorëve të vetëvlerësimit i cili përmban 39 pyetje. Çdo pyetje vlerësohet me pikë nga 1-4, ku vlerësimi minimal është 1 dhe vlerësimi maksimal është 4. Efektiviteti i përgjithshëm i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit llogaritet si mesatare e pikëve të pyetësorit të vetëvlerësimit për të gjitha njësitë publike të marra në analizë.

Si çdo vit, janë analizuar treguesit e performancës për ministritë e linjës dhe bashkitë, për të cilat bazuar dhe në monitorimin në vend, vihet re një progres për sa i përket implementimit në praktikë të instrumentave të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Megjithatë, ka ende hapësira për përmimrësim, kryesisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë nevojë për asistencë të mëtejshme.

Ndërkohë, këtë vit, për herë të parë është përfshirë në analizë dhe vlerësimi i indikatorëve të performancës për institucionet e pavarura (43 institucione) si dhe i 11 njësive shpenzuese me buxhet të konsiderueshëm. Treguesit e mësipërm dëshmojnë për ekzistencën e kontrolleve efektive të ndërmarra nga ana e këtyre institucioneve, ku mesatarisht efektiviteti i tyre është rreth 90%. Megjithatë, në disa indikatorë apo tregues specifik lind nevoja për marrjen e masave për përmirësime të vazhdueshme në periudhat e ardhshme, kryesisht në komponentin e menaxhimit të riskut.

Gjithashtu, vlen të theksojmë se nga monitorimet e kryera në vend, vërehet një rritje e ndërgjegjësimit të nëpunësve autorizues mbi paraqitjen e situatës reale në pyetësorët e vetëvlerësimit, të plotësuar nga ana e tyre për pesë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike ka zhvilluar trajnimin e vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik, në të cilin janë trajtuar tema specifike mbi përgjegjësinë menaxheriale, rolin e audituesve në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, analiza dhe vlerësimi i riskut të njësive publike, vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë së veprimtarisë audituese, për ngritjen dhe përditësimin e kapaciteteve të njësive të auditimit. Për vitin 2017, pothuajse të gjithë njësitë e auditimit të brendshëm, në fund të çdo auditimi, japin opinion të përgjithshëm në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe vlerësojnë nivelin e riskut të subjekteve të audituara. Nga audituesit vlerësohet se sistemet e kontrollit të brendshëm kanë përmirësim të vazhdueshëm, por ende ka vend për përmirësime.

Ndërkohë, gjatë këtij viti, një aspekt ndaj të cilit po tregohet një vëmendje e veçantë është edhe përgjëgjshmëria menaxheriale e drejtuesve të niveleve të ndryshme të njësive publike. Në mbështetje të ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, drejtuesit e njësive publike kanë detyrimin të zbatojnë parimet e menaxhimit financiar në lidhje me administrimin e fondeve publike, si dhe arritjen e objektivave dhe kryerjen e aktivitete të lidhura me to, në mënyrë të ligjshme, transparente, ekonomike, efikase dhe efektive. Përgjegjshmëria menaxheriale ka të bëjë gjithashtu edhe me respektimin e hierarkisë, llogaridhënien para drejtuesve (përgjegjësinë ndaj mbikqyrësve), procesin e delegimit si dhe përgjegjësinë ndaj detyrave të caktuara, ndaj vartësve dhe ndaj institucioneve të vartësisë. Në këtë kuadër, Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka parashikuar të miratojë gjatë vitit 2018 një udhëzim specifik mbi delegimin e detyrave të punonjësve në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Për vitin 2017, gjatë monitorimit të institucioneve të kryer nga kjo drejtori, vërehet një rritje e ndërgjegjësimit nga titullarët e këtyre institucioneve për përdorimin e mjeteve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, gjë që evidenton një përgjegjshmëri menaxheriale në rritje.

Në vija të përgjithshme, raporti përbëhet nga 6 kapituj kryesorë. Kapitulli i parë i raportit fokusohet në rezultatet nga vlerësimi i monitorimit të performancës së njësive publike. Në kapitullin e dytë trajtohet vlerësimi i sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në njësitë publike, bazuar në analizën e pyetësorëve të vetëvlerësimit. Kapitulli i tretë pasqyron rezultatet e monitorimit të kryer pranë 20 institucioneve të përzgjedhura në bazë të metodologjisë së vizitave në terren. Në vazhdim, në kapitullin 4, është paraqitur analiza e performancës të disa njësive shpenzuese me buxhet të madh. Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik, gjetjet dhe rekomandimet kryesore të audituesve lidhur me mangësitë dhe përmirësimet e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqiten në kapitullin e 5 të këtij raporti dhe në kapitullin e 6 të tij, përshkruhen aktivitetet e drejtorisë së Kontrollit të

Brendshëm Financiar Publik dhe plani i veprimit për zhvillimet e mëtejshme në periudhën afatmesme në sistemet e Kontrollit të Brendshëm.

Konstatimet kryesore sipas komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2017

1 Mjedisi i kontrollit – Përcaktimi i funksionit të Koordinatorit dhe Koordinatorit të Deleguar të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, hartimi i planit të zhvillimit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, dy elementë kyç në implementimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm në njësitë publike.

Mjedisi i kontrollit është komponenti i parë i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe me peshë më të madhe në këtë fushë krahasuar me komponentët e tjerë, për shkak të elementëve që ai përfshin si: struktura organizative, ndarja e detyrave, planet strategjike apo vjetore të punës, delegimi i detyrave, politikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, etika personale dhe profesionale, etj. Lidhur me këtë komponent vlen të theksojmë se ofrimi i asistencës dhe udhëzimeve nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ndaj koordinatorëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit apo koordinatorëve të deleguar të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit ka sjellë një rritje të angazhimit të tyre në implementimin sa më efektiv të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Gjatë vitit 2017, 47 njësi publike kanë hartuar një plan zhvillimi për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, duke evidentuar problematikat e tyre si dhe aktivitetet përkatëse që ata do të ndërmarrin për përmirësimin e këtij sistemi. Hartimi dhe përdorimi i planit të zhvillimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit si një instrument i punës së përditshme të stafit dhe menaxherëve të njësive publike, do të ndihmojë në përcaktimin më të saktë të objektivave strategjike dhe operacionale të njësisë dhe në realizimin me efektiv të tyre në periudhat në vazhdim, duke përmirësuar proceset e vendimmarrjes, të politikave, procedurave dhe hartimit të strategjisë. Megjithatë, mbeten ende problematika për t'u adresuar, të tilla si: trajtimi i çështjeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në takimet e Grupit të Menaxhimit Strategjik apo mungesa e ndërgjegjësimit të stafit të institucioneve mbi konceptimin dhe aplikimin e delegimit sipas ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe devijimi i rregullave të delegimit të dokumentuar, duke ndikuar në veprimtarinë e përditshme të institucioneve. Gjithashtu, një aspekt shumë i rëndësishëm që lidhet me këtë komponent, është dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional i punonjësve në njesitë publike dhe kryesisht i stafit që punon në strukturat e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

2 Menaxhimi i riskut – Caktimi i koordinatorit të deleguar të Riskut në pjesën më të madhe të njësive publike ka nxitur përmirësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit të riskut.

Ngritja dhe funksionimi i Grupit të Menaxhimit të Riskut është kushti kryesor për të siguruar një proces real të menaxhimit të riskut në drejtim të realizimit të objektivave të njësisë. Bazuar në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", Nëpunësi Autorizues i institucionit, në rolin e koordinatorit të riskut, ka përgjegjësinë kryesore për realizimin e këtij procesi kaq të rëndësishëm. Nga informacioni që është marrë në vazhdimësi nga njësitë publike, pjesa më e madhe e tyre (rreth 60 njësi publike) kanë emëruar koordinatorin e deleguar të riskut. Ky koordinator, së bashku me Grupin e Menaxhimit të Riskut, kanë si detyrë shpërndarjen e njohurive mbi procesin e menaxhimit të riskut për të gjitha nivelet e administrimit si dhe organizimin e trajnimeve për të gjithë stafin e njësisë publike, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi monitorimin për minimizimin e risqeve. Nga ana tjetër, mund të konkludojmë që ka përmirësime në drejtim të përgatitjes së strategjisë së menaxhimit të risqeve

si dhe të regjistrit të risqeve, e cila evidentohet nëpërmjet rritjes së numrit të institucioneve që e kanë përfunduar si dokument, por që ende nuk përdoret si një mjet që ndihmon menaxhimin në arritjen e objektivave apo auditimin e brendshëm në identifikimin e fushave me risk më të lartë. Gjithashtu, një element tjetër problematik vazhdon të jetë fakti se risqet me impakt të lartë në institucionet përkatëse, nuk janë objekt i diskutimeve të Grupit të Menaxhimit Strategjik.

3 Aktivitetet e kontrollit – Mungesa e manualeve të proceseve të punës si dhe procedurave të shkruara të sakta mbi ndarjen e detyrave brenda njësive publike ndikon në efektivitetin e sistemit të përgjegjshmërisë menaxheriale.

Nga analiza e këtij viti, u konstatua se pjesa më e madhe e institucioneve i kushtojnë vëmendjen e duhur kërkesave ligjore që lidhen me aktivitetet e kontrollit, por ende ka nevojë për përmirësime të mëtejshme në përgatitjen e manualeve apo udhëzimeve për rregullimin e veprimtarive të brendshme të institucionit, si: procedura të shkruara për mbledhjen dhe rakordimin e të ardhurave, hartimin dhe zbatimin e planit financiar, për krijimin e detyrimeve kontraktuale (përcaktimi i afateve, aktorëve, kompetencat dhe përgjegjësitë), sigurimin e ndarjeve të detyrave gjatë aktiviteteve për planifikimin e prokurimit, zbatimit, monitorimit e ekzekutimit të kontratave për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, procedura për zbatimin e parregullsive, etj.

Vlen të theksojmë se proceset që lidhen me përgatitjen e manualeve të proceseve të punës dhe gjurmëve të auditimit, si kërkesa të nenit 16 të ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit ende nuk janë bërë praktikë procedurale e punës së institucioneve, pavarësisht përmirësimeve të dukshme në disa institucione, ku kryesisht janë ndërtuar gjurmë auditimi në fushën e prokurimeve dhe disa harta procesesh pune kryesisht nga strukturat e financës. Gjithashtu, sikurse edhe në vitet e kaluara, vërehet që në praktikë ka një konfuzim mes përshkrimit të procesit të punës me përshkrimin e pozicionit të punës.

Nga ana tjetër, në lidhje me menaxhimin e aseteve publike, vihet re një progres i dukshëm të këtij elementi, ku shumica e institucioneve, përveç mbështetjes në udhëzimin bazë nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar, kanë hartuar dhe rregullore apo udhëzime specifike mbi inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre. Gjithashtu, përsa i përket procesit të regjistrimit të aseteve publike, mund të përmendim që 5 institucione kanë arritur të ndërtojnë një regjistër të plotë të aseteve publike, pas realizimit të procesit të inventarizimit, verifikimit të asetit si dhe rivlerësimit të kostove të tij.

Në bazë të vlerësimeve të pyetësorëve, një pjesë shumë e vogël e institucioneve kanë sisteme të mirëfillta të Teknologjisë së Informacionit dhe sidomos Back-up, ndaj theksi në vijim duhet të jetë zhvillimi i këtyre sistemeve me qëllim përmirësimin e aktiviteteve parandaluese të kontrollit dhe back-up-ve për këto sisteme.

Në përputhje me rezultatet e evidentuara më sipër, gjetjet e auditimit të brendshëm rekomandojnë përmirësimin e sistemeve me karakter organizativ, përgatitjen e gjurmëve të auditimit, përmirësimin e sistemit të prokurimeve publike dhe sistemin e raportimit financiar dhe kontabilitetit si dhe korrigjimin e parregullsive dhe parandalimin e shkeljeve mbi pronën publike.

4 Informimi dhe Komunikimi – Nevoja për përmirësim të mëtejshëm të sistemeve të Tekonologjisë së Informacionit si dhe rrjetit të brendshëm të strukturuar të marrjes dhe dhënies së informacionit ndërmjet nivelevetë ndryshme hierarkike, në funksion të arritjes së objektivave dhe menaxhimit të mirë të fondeve publike.

Në lidhje me këtë komponent konstatohet se njësitë publike nuk kanë zhvilluar ende një sistem komunikimi dhe informacioni të përshtatshëm, specifik për institucionin e tyre. Vihet re se ende ka nevojë për krijimin e të dhënave të centralizuara për kontratat apo detyrimet kontraktuale, për sigurimin e evidencave të ndryshme në lidhje me to, jo vetëm nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë, por edhe nëpërmjet sistemeve të tjera të Teknologjisë së Informacionit si: Financa 5 apo Alpha Web buxhetor. Mungesa e një rrjeti të brendshëm të strukturuar të marrjes, dhënies dhe sigurimit të informacionit ndërmjet niveleve të ndryshme hierarkike, vështirëson punën e përditshme dhe vendimmarrjen brenda institucionit.

Raportimi sistematik duke qenë se është një kërkesë thelbësore e përgjegjshmërisë menaxheriale, duhet të mbulojë arritjet, treguesit e performancës, mangësitë dhe përdorimin e burimeve, pra menaxhimi duhet të ketë një sistem informacioni i cili i siguron atyre informacion rregullisht mbi arritjen e objektivave. Ata duhet të bëhen plotësisht të vetëdijshëm për përgjegjësitë që kanë dhe çfarë duhet të raportojnë lidhur me këto përgjegjësi, sepse ajo që vihet re në disa njësi publike është fakti që punonjësit e tyre shpesh herë nuk dinë ku t'i raportojnë parregullsitë apo problemet që dalin gjatë kryerjes së aktiviteteve. Për këtë arsye, fokusi në të ardhmen mbetet ndërgjegjësimi i menaxherëve mbi domosdoshmërinë e informimit dhe raportimit, nëpërmjet seminareve apo trajnimeve të ndryshme.

Vihet re se njësitë publike kanë përfshirë elementë të komunikimit në rregulloret e tyre të brendshme. Megjithatë çdo njësi publike ka veprimtarinë dhe kompleksitetin e saj specifik, prandaj niveli i lartë drejtues duhet të marrë nismën për trajtimin e këtyre çështjeve nëpërmjet një rregulloreje të veçantë për komunikimin dhe informimin, i cili është shumë i rëndësishëm jo vetëm për vendimet brenda institucionit, por edhe në shkëmbimin e informacionit jashtë tij. Vërehet se në disa institucione janë bërë hapa drejt ndërtimit të një rregulloreje në fushën e Teknologjisë së Informacionit.

5 Monitorimi – Rritja e ndërgjegjësimit të nivelit të lartë menaxherial mbi rëndësinë e hartimit të raporteve periodike gjithëpërfshirëse si dhe fokusimi i njësisë së auditimit të brendshëm në çështjet që lidhen me performancën e njësisë publike.

Nga monitorimi i kryer, vlerësojmë se frekuenca dhe mënyra e raportimit apo monitorimit duhen përmirësuar dhe të mos jetë e fokusuar vetëm në raportime financiare, por edhe në monitorime të performancës në funksion të arritjes së objektivave, përgatitjes dhe zbatimit të politikave të mira, sjelljes dhe efektivitetit të nëpunësve cilvilë në menaxhimin e fondeve/burimeve publike, kryerjen e funksioneve rregullatore, implementimit të politikave publike, të cilët janë janë faktorë përcaktues të cilësisë së qeverisjes së një njësie publike.

Gjithashtu, konstatohet se ka patur progres në lidhje me krijimin e njësive të reja të auditimit të brendshëm, kryesisht për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura, të cilat ofrojnë shërbimet e tyre në monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Pavarësisht këtij progresi, ka ende nevojë për rritjen e fokusimit drejt auditimit të performancës së njësive publike, si dhe përmirësime në lidhje me pavarësinë e funksionit të auditimit të brendshëm dhe rritjes së kapaciteteve të audituesve.

Konstatimet kryesore në veprimtarinë e auditimit të brendshëm për vitin 2017

Zhvillimet e fundit, reformat në fushën e financave publike dhe angazhimet në luftën anti korrupsion, i kanë rezervuar auditimit të brendshëm një pozicion të rëndësishëm dhe tepër kritik për një qeverisje të mirë dhe efektive të njësive publike. Në një ambjent me kërkesa në rritje për përgjegjshmëri dhe trasparencë në përdorimin e fondeve dhe ofrimin e shërbimeve

publike, maksimizimi i vlerës së auditimit të brendshëm ngrihet si një domosdoshmëri dhe prioritet i lartë në zhvillimet e mëtejshme.

Vlera e shërbimit të auditimit të brendshëm krahas vlerësimeve objektive dhe të pavarura matet nga aftësia e tij për të nxitur dhe udhëhequr ndryshime pozitive dhe përmirësime të mëtejshme. Një maksimizim i funksionit të auditimit të brendshëm do të thotë rezultate, përmirësim dhe vlerë.

1 Finalizimi i kuadrit rregullator si mbështetje e rëndësishme e auditimit të brendshëm dhe organizimi i programeve bashkëkohore të zhvillimit profesional të audituesve të brendshëm.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në rolin e saj bashkërendues, harmonizues dhe monitories të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, gjatë tre viteve të fundit, ka finalizuar ndryshimin dhe përditësimin e gjithë bazës ligjore dhe nënligjore të fushës, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuara dhe problematikat e identifikuara në mënyrë zyrtare nga njësitë e auditimit të brendshëm. Ky kuadër i plotë rregullator është një mbështetje e fuqishme për veprimtarinë e strukturave të auditimit të brendshëm që funksionojnë në sektorin publik.

Fokusi i veprimtarisë gjatë viteve të fundit ka qenë organizimi dhe menaxhimi i programeve sa më bashkëkohore të trajnimit të vijueshëm profesional, si detyrim ligjor për audituesit e brendshëm në detyrë. Në përgatitjen e këtyre programeve janë analizuar kërkesat individuale të audituesve.

Për të siguruar që trajnimet të ishin sa më të dobishme dhe frytdhënëse, programet e trajnimeve, duke marrë në konsideratë mjedisin aktual me të cilin përballen njësitë publike, janë orientuar në tema specifike mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, prokurimin publik, ndryshimet e auditimit të jashtëm, të brendshëm dhe inspektimit financiar, analiza dhe trajtimi i detyrimeve të prapambetura, prezantimi i ndryshimeve në kuadrin rregullator, tema bashkëkohore mbi fokusin e auditimit të brendshëm në sektorin publik, etj. Këto trajnime përveç pjesës teorike kanë trajtuar raste studimore, punë në grupe, si dhe shkëmbimin e eksperiencat profesionale të audituesve ndërmjet njëri-tjetrit.

Këto programe trajnimi vlerësohen që kanë patur një efekt pozitiv në procesin e përditësimit të njohurive të audituesve. Efektet pozitive të njohurive të përfituara gjatë këtyre trajnimeve kanë dhënë frytet e tyre në mënyrën e konceptimit të angazhimeve të auditimit, si dhe në mënyrën e planifikimit dhe raportimit të rezultateve. Nga analiza e veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm konstatohet se ka rritje në cilësinë e rekomandimeve të lëna për zbatim, kjo falë programeve të trajnimit të vijueshëm profesional.

Gjatë dy viteve të fundit është implementuar një proces i ri çertifikimi në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare, të pranuara. Në risitë e programit të çertifikimit mund të përmendim materialet e trajnimit të fokusuara plotësisht në fushën e auditimit të brendshëm, numrin e limituar të pjesëmarrësve, lektorët e mirëtrajnuar, mënyrën e organizimit me testimin e njohurive me testet paraprake, të shoqëruar me provimin me shkrim, në të cilin është përmbledhur gjithë materiali dhe rastet studimore që do të prezantohen nga kandidatët.

Procesin e çertifikimit të audituesve të brendshëm për sezonin 2016-2017 e ndoqën 42 pjesëmarrës dhe në fund të procesit u çertifikuan si "Auditues të brendshëm në sektorin publik" 37 auditues të brendshëm, që sot po japin kontributin e tyre dhe një frymë të re në njësitë publike ku janë të punësuar.

Procesi i çertifkimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik për sezonin 2017-2018 u miratua me urdhër të Ministrit të Financave nr. 34, datë 14.04.2017. Në këtë proces aplikuan 74 kandidatë, por vetëm 51 prej tyre plotësuan kriteret sipas përcaktimeve ligjore për të ndjekur

këtë proces. Aktualisht kanë mbaruar provimet për 6 Modulet Bazë dhe ka përfunduar faza e parë e provimit me shkrim. Ky proces çertifikimi përmbyllet në muajin Korrik 2018.

2 Zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe evidentimi i fushave të cilat kërkojnë përmirësime.

Që në momentin e hyrjes së konceptit të auditimit të brendshëm në legjislacionin shqiptar, krijimin dhe funksionimin e auditimit nuk ka pasur një metodologji të miratuar për vlerësimin e cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Gjatë këtij viti, u miratua me urdhër të Ministrit të Financave nr. 22, datë 06.03.2017 "Metodologjia për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik", një metodologji bashkëkohore dhe në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të pranuara. Implementimi i kësaj metodologjie u realizua nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me mbështetjen dhe bashkëpunimin e ekspertëve të SIGMA.

Gjatë vitit u realizuan pesë vlerësime të jashtme të cilësisë, ku kryesisht u monitorua përshtatshmëria me kuadrin rregullator e veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm në dy ministri linje, një njësi varësie, si dhe dy bashki.

Nga këto vlerësime u konstatua një përputhshmëri e pjesshme me standardet e auditimit, ku në njësitë vendore vihet re një nivel më i ulët në lidhje me respektimin e standardeve. Në përfundim të këtyre vlerësimeve u përcaktuan gjetjet dhe u adresuan rekomandimet për fushat që kërkonin përmirësim në të ardhmen. Rekomandimet u fokusuan në implementimin e plotë të procedurave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të rishikuar, në përcaktimin e indikatorëve të performancës dhe hartimin e programeve të përmirësimit të cilësisë, i cili duhet të mbulojë të gjithë aspektet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, në vlerësimin e fuksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në fokusimin në të ardhmen në planifikimin dhe realizimin e auditimeve të performancës, etj. Vlerësimet e jashtme të cilësisë do të vazhdojnë të jenë në fokus të punës së strukturës përgjegjëse të harmonizimit të auditimit të brendshëm.

3 Plani i auditimit të brendshëm është realizuar në masën 100%. Megjithëse realizohen auditime të performancës në të ardhmen veprimtaria audituese duhet të jetë më shumë e fokusuar në këtë lloj auditimi.

Gjatë këtij viti, njësitë e auditimit të brendshëm kanë realizuar 1,360 angazhime auditimi nga 1,358 angazhime të planifikuara (mbas reflektimit të ndryshimeve nga njësitë), të cilat në përqindje konsistojnë në 100,1% të planit të miratuar për këtë periudhë. Gjatë këtij viti, evidentohet një ndryshim i pranueshëm nga plani fillestar i miratuar, kjo vlerësohet si planifikim më i mirë i burimeve në dispozicion nga ana e drejtuesve të Njësive të Auditimit të Brendshëm, fakt që ndikon në rritje të vazhdueshme të cilësisë së auditimeve të kryera.

Nga analiza ka rezultuar se janë realizuar një numër i konsiderueshëm auditimesh të kombinuara dhe auditimesh përputhshmërie, kurse llojet e tjera të auditimit janë në nivel më të reduktuar. Në realizimin e veprimtarisë audituese vihet re një numër i auditimeve të pa planifikuara, të kërkuara nga titullarët e njësive publike. Për rrjedhojë, përfshirja e auditimeve të paplanifikuara ndikon në mos realizimin e auditimeve të planifikuara të performancës. Gjithashtu, mos realizimi i këtyre auditimeve ka të bëjë edhe me mungesën e njohurive praktike të audituesve për këtë lloj auditimi.

4 Audituesit e brendshëm vlerësojnë se sistemet e kontrollit të brendshëm janë në përmirësim të vazhdueshëm.

Njësitë e auditimit të brendshëm, në përmbushje të misionit të veprimtarisë së tyre, kanë dhënë opinion mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, bazuar në vlerësimin e këtyre sistemeve. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm ka konsistuar jo vetëm në pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat por ka përfshirë si veprimet financiare, jo financiare të organizatës dhe vlerësimin nëse fondet publike janë alokuar dhe përdorur me efektivitet, eficencë dhe ekonomi.

Nga analiza e veprimtarisë të auditimit vihet re se gjatë vitit 2017, funksionimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë publike është në përmirësim të vazhdueshëm. Për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm audituesit janë përqendruar kryesisht në masat e kontrollit, në planet e organizimit, në metodat dhe procedurat për administrimin e mjeteve monetare e materiale, në zbulimin pa vonesë të anomalive, gabimeve dhe parregullsive në informacionet kontabël dhe financiare, si dhe shpërdorimet dhe dëmtimet me qëllim parandalimin e tyre në të ardhmen.

Për vlerësimin sa më efikas të këtyre sistemeve, në programet e trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve janë trajtuar rregullisht tema specifike mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, të cilat kanë dhënë efekte mbi mënyrën e perceptimit të këtij komponenti nga ana e audituesve të brendshëm.

5 Rritja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga njësitë e auditimit të brendshëm dëshmon kuptimin e rolit të kësaj veprimtarie për arritjen e objektivave të njësive publike.

Nga rekomandime të dhëna nga njësitë e auditimit të brendshëm janë pranuar nga menaxhimi 99,6% e tyre dhe zbatueshmëria e tyre rezulton në masën 55% ose 8% më shumë se një vit më parë. Rekomandimet e dhëna kanë synim përmirësimin e sistemeve në të cilat janë fokusuar, uljen e nivelit të riskut dhe dhënien e këshillave për titullarët për parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen. Është e njohur që përgjegjësia e zbatimit të rekomandimeve rëndon mbi vetë drejtuesit e subjekteve të audituara, por nga ana tjetër përgjegjësia e auditimit të brendshëm nuk kufizohet vetëm në dhënien, por dhe në monitorimin e vazhdueshëm të rekomandimeve të lëna, pasi performanca e veprimtarisë audituese vlerësohet në një masë të madhe nga ky faktor.

Njësitë e auditimit të brendshëm monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme rekomandimet e lëna, pasi rezultatet e punës audituese varen në një masë të madhe nga ky faktor. Gjatë procesit të monitorimit është evidentuar se niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2016, të monitoruara gjatë vitit 2017, ka arritur në 68% (nga 47% të monitorimit të mëparshëm).

Nga analiza e veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm gjatë këtij viti konstatohet se ka rritje në cilësinë e rekomandimeve të lëna për zbatim, një faktor i rëndësishëm që ka ndikuar për këtë janë temat specifike të trajtuara në trajnimet e vijueshme profesionale.

6 Njësitë publike nuk mbulohen tërësisht me shërbimin e auditimit të brendshëm dhe ende ekzistojnë vende vakante dhe mungesë kapacitetesh në njësitë e auditimit të brendshëm.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë monitoron në mënyrë të vazhdueshme organizimin, funksionimin, dhe shtrirjen e shërbimit të auditimit të brendshëm, në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, si dhe adreson domosdoshmërinë e krijimit të këtij shërbimi tek titullarët përkatës. Nga analiza e raporteve vjetore të njësive të auditimit të brendshëm vihet re një numër relativisht i konsiderueshëm i njësive të auditimit të brendshëm që funksionojnë në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi, ose me më pak se tre auditues ose me staf të pa kualifikuar (40 njësi me mungesë stafi, 10 njësi me drejtues të auditimit të brendshëm të paçertifikuar, 4 njësi me më shumë se 1/3 të punonjësve të paçertifikuar), gjë e cila ndikon në realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm sipas përcaktimeve ligjore.

Shërbimi i auditimit të brendshëm nuk shtrihet në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe konkretisht nga 26 institucione të pavarura vetëm 11 prej tyre janë të mbuluar me shërbimin e auditimit të brendshëm me njërën nga format e përcaktuara në ligj.

7 Në fokus të auditimit të brendshëm vlerësimi i situatës së detyrimeve në njësitë publike si dhe dhënia e rekomandimeve në lidhje me eleminimin e këtyre detyrimeve.

Gjatë hartimit të planeve strategjike dhe vjetore të veprimtarisë audituese për periudhën 2018-2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka kërkuar njësive të auditimit të brendshëm të përfshijnë angazhime auditimi me objektiv analizimin e situatës në njësitë publike përkatëse në lidhje me detyrimet e prapambetura. Nga analiza e planit të konsoliduar të veprimtarisë së auditimit të brendshëm vlerësohet se pjesa më e madhe e njësive të auditimit kanë planifikuar dhe do të kenë në fokus të veprimatrisë situatën në lidhje me detyrimet e prapambetura.

Duke pasur në fokus mirëmenaxhimin e fondeve nga njësitë publike, dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, një temë specifike: "*Roli i auditimit të brendshëm për parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura*", është përfshirë dhe do të trajtohet gjatë programit të trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm gjatë vitit 2018.

8 Komitetet e Auditimit të Brendshëm kanë monitoruar dhe mbështetur veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si përgjegjëse për bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik ka analizuar funksionimin e Komiteteve të Auditimit të Brendshëm tw krijuara nw njwsitw publike.

Nga kjo analizë evidentohet se gjatë kësaj periudhe këto komitete kanë funksionuar bazuar në përcaktimet e akteve ligjore, duke shqyrtuar dhe dhënë rekomandime për përmirësimin e kartës së auditimit, planit strategjik dhe vjetor, si dhe për raportin vjetor të veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm.

Nëpërmjet raporteve të auditimit kanë monitoruar funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë publike përkatëse, si dhe përputhshmërinë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm. Për të gjitha vlerësimet kanë dhënë rekomandime dhe këshilla për titullarin e njësisë publike.

KAPITULLI I- VLERËSIMI I MONITORIMIT TË PERFORMANCËS SË NJËSIVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

Në mbështetje të Urdhrit të Monitorimit të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015, është punuar për vlerësimin e performancës së institucioneve, për vitin 2017, konkretisht të Ministrive të linjës dhe të bashkive, bazuar në tregues të përzgjedhur si më poshtë:

Tabela 1. Indikatorët dhe burimet e të dhënave sipas Drejtorive në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit	Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit	Drejtoria e Harmonizimit për MFK	Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	**6.** Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	**11.** Cilësia e mjedisit të brendshëm	**16.** Përgatitja profesionale e audituesve të brendshëm
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	**7.** Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	**12.** Cilësia e menaxhimit të riskut	**17.** Raportimi në kohë i audituesve të brendshëm në MFE
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara thesari	**8.** Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	**13.** Cilësia e veprimtarive të kontrollit	**18.** Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	**9.** Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	**14.** Cilësia e sistemit të komunikimit dhe informacionit	**19.** Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	**10.** Krijimi i detyrimeve të reja	**15.** Cilësia e monitorimit	**20.** Kapacitetet e burimeve njerëzore të auditimit të brendshëm

Bazuar në vlerësimet e indikatorëve të mësipërm nga drejtoritë përkatëse, është realizuar rankimi i ministrive të linjës, të cilat pas ndryshimeve strukturore të ndodhura në tetor të vitit 2017, janë grupuar në 11 ministri kryesore.

Më poshtë, paraqitet rankimi i ministrive të linjës për vitin 2017.

Tabela 2. Rankimi i Ministrive të Linjës sipas indikatorëve të performancës për vitin 2017

Rankimi	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2017*
1	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	530
2	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	510
3	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	500
3	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	500
3	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	500
4	Ministria e Brendshme	495
4	Ministria e Mbrojtjes	495
5	Ministria e Drejtësisë	485
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	480
7	Ministria e Kulturës	470
8	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	465

Një vështrim i përgjithshëm për disa prej treguesve kryesorë të analizuar paraqitet si vijon:

1.1 Analiza për Ministritë e Linjës:

1. Treguesi i parë i analizuar nga Drejtoria e Thesarit është **"Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar"**, i cili për vitin 2017 është vlerësuar mesatarisht në nivelin 16 pikë nga 30 pikë të mundshme (ose 53%), duke reflektuar një performancë mesatare të tij. Evident është fakti që shumica e ministrive kanë nje vlerësim mesatar të këtij indikatori (vlerësuar me 15 pikë) dhe vetëm Ministria e Financave dhe Ekonomisë është vlerësuar me 25 pikë. Kjo ka ndikuar në performancën e vitit 2017, që për këtë tregues është më e ulët sesa e një viti më parë.
2. Indikatori **"Anulimi i kontratave gjatë një viti"** është vlerësuar mesatarisht me 28.6 pikë (ose 95%)e nivelit referues. Nga analiza rezulton se të gjitha ministritë janë vlerësuar me 25 ose 30 pikë, duke reflektuar një performancë shumë të kënaqshme për këtë tregues, me një realizim prej 95%, më të lartë se vitin e kaluar.
3. Për vitit 2017, indikatori **"Urdhër shpenzimet e refuzuara nga ana e Thesarit"** është vlerësuar maksimalisht me 30 pikë, duke evidentuar faktin që të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura.
4. **"Dorëzimi në kohë i kontratave në thesar"** është një tregues shumë i rëndësishëm. Për periudhën analizuese, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 6.4 pikë (ose 21%) të nivelit referues. Krahasimisht me vitin 2016, ky rezultat paraqitet në nivele më të ulëta, duke qënë se të gjitha ministritë kanë marrë një vlerësim relativisht të ulët, nga 0 deri në 10 pikë.
5. Një indikator tjetër i marrë në analizë është **"Urdhër-prokurimet e paautorizuara".** Për vitin 2017, ky indikator është realizuar në masën 100% që i referohet një niveli mesatar prej 30 pikë. Krahasimisht me vitin 2016, evidentohet një performancë më e mirë me një rritje prej 13%.
6. Treguesi **"Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente",** për vitin 2017 pasqyron një performancë të mirë, duke qënë se është vlerësuar mesatarisht me 23 pikë nga 30 pikë të mundshme (ose 77%) të nivelit referues të vlerësimit. Nga analiza rezulton se mosrealizimi i shpenzimeve korrekte nga ardhur kryesisht nga mosrealizimi i fondeve për paga, sigurime, shërbime dhe transferta, që vjen për shkak të mosplotësimit të vendeve vakante në strukturën organizative të ministrive.
7. Treguesi **"Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale",** evidenton për një performancë mesatare për vitin 2017, duke qënë se është vlerësuar mesatarisht me 16 pikë. Kryesisht,

në mosrealizimin e këtij indikatori ka ndikuar mosrealizimi i financimit të huaj, sidomos në Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të cilat janë vlerësuar përkatësisht me 10 dhe 5 pikë. Ministria që është vlerësuar maksimalisht për këtë indiaktor është ajo e Turizmit dhe Mjedisit.

8. **"Saktësia dhe konsistenca e raportimeve"** është indikatori që paraqitet me realizimin më të lartë nga të gjithë indikatorët e buxhetit, vlerësuar mesatarisht me 29.1 pikë. Të gjitha ministritë paraqiten me një performancë shumë të mirë dhe janë vlerësuar, kryesisht, me pikët maksimale.
9. **"Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve"** është një indikator, që për periudhën analizuese rezulton me një vlerësim mesatar të kënaqshmëm prej 26.8 pikë. Ky rezultat tregon që institucionet kanë bërë një planifikim të orientuar të buxhetit të tyre, duke u munduar për të patur sa më pak rialokime gjatë vitit buxhetor.
10. **"Krijimi i detyrimeve të prapambetura"** është një tregues, i cili tregon ecurinë e institucioneve në drejtim të likuidimit të të gjitha shprenzimeve brenda vitit buxhetor. Për vitin 2017, ministritë janë vlerësuar mesatarisht me 12.3 pikë ose 41% të nivelit referues. Ky rezultat tregon që ende minsitritë kanë probleme përsa i përket aspektit të likuidimit të shpenzimeve të tyre brenda vitit buxhetor. Në këtë kuadër, Minsitria e Financave dhe Ekonomisë ka marrë një sërë masash për rritjen e monitorimit të këtyre detyrimeve.

Bazuar në vlerësimet e indikatorëve të mësipërm nga drejtoritë përkatëse, është realizuar rankimi i bashkive, të cilat janë ndarë në dy grupe të mëdha. Ndarja në dy grupe e tyre është bërë bazuar në ekzistencën ose jo të njësisë së auditimit të brendshëm në strukturën e njësive të qeverisjes vendore. Brenda grupit të bashkive që kanë njësi auditimi është bërë rankimi për bashkitë që janë qendër qarku, duke u krahasuar dhe me vitin 2016 (në pikë dhe rankim), si dhe rankimi për bashkitë e tjera. Pra, bazuar në kriteret e sipërpërmendura, rankimi i bashkive vijon si më poshtë:

✓ ***Rankimi i bashkive që kanë njësi auditimi në strukturë***

Tabela 3. Rankimi i Bashkive kryesore qendër qarku, sipas indikatorëve të performancës, krahasuar me vitin 2016

Rankimi	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2016(+/-)*	*Ndryshimi në pikë krahasuar me vitin 2016(+/-)*	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2017*
1	↑ (2)	(25)	Bashkia Korçë	430
2	↓ (1)	(-15)	Bashkia Shkodër	415
3	↓ (2)	(0)	Bashkia Durrës	405
4	↑ (5)	(0)	Bashkia Berat	395
5	↓ (3)	(-15)	Bashkia Elbasan	385
6	↑ (9)	(+25)	Bashkia Dibër	375
7	↑ (8)	(+10)	Bashkia Kukës	365
8	↓ (7)	(-20)	Bashkia Gjirokastër	355
8	↓ (4)	(-36)	Bashkia Tiranë	355
9	↓ (6)	(-35)	Bashkia Fier	345
10	↓ (7)	(-35)	Bashkia Vlorë	340
11	↓ (9)	(-20)	Bashkia Lezhë	330

Tabela 4. Rankimi i Bashkive të tjera që kanë njësi auditimi, sipas indikatorëve të performancës, krahasuar me vitin 2016

Rankimi	Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2016(+/-)	Ndryshimi në pikë krahasuar me vitin 2016(+/-)	Institucioni	Vlerësimi në pikë për vitin 2017
1	↑ (11)	(+55)	Bashkia Maliq	400
2	↑ (6)	(+15)	Bashkia Dropull	395
2	↓ (1)	(-45)	Bashkia Kamëz	395
2	↑ (5)	(+10)	Bashkia Krujë	395
3	↑ (4)	(-5)	Bashkia Memaliaj	390
3	↑ (7)	(+25)	Bashkia Sarandë	390
4	↑ (7)	(+15)	Bashkia Gramsh	385
5	↓ (2)	(-45)	Bashkia Patos	380
6	↑ (7)	(+5)	Bashkia Divjakë	375
6	↑ (8)	(+15)	Bashkia Lushnjë	375
6	↑ (9)	(+20)	Bashkia M. e Madhe	375
6	↑ (9)	(+20)	Bashkia Ura Vajgurore	375
6	↓ (3)	(-40)	Bashkia Vorë	375
7	↑ (10)	(+20)	Bashkia Fushë Arrëz	370
8	- (-)	(-)	Bashkia Mirditë*	365
9	↑ (17)	(+45)	Bashkia Roskovec	360
9	- (-)	(-)	Bashkia Selenicë*	360
10	↓ (6)	(-25)	Bashkia Skrapar	355
10	↑ (9)	(0)	Bashkia Vau Dejës	355
11	↑ (15)	(+25)	Bashkia Finiq	350
11	- (-)	(-)	Bashkia Klos*	350
11	↑ (14)	(+20)	Bashkia Librazhd	350
12	↑ (19)	(+50)	Bashkia Kolonjë	345
12	↑ (14)	(+15)	Bashkia Pogradec	345
12	↓ (11)	(0)	Bashkia Pustec	345
13	- (13)	(+5)	Bashkia Bulqizë	340
14	↑ (15)	(+10)	Bashkia Himarë	335
14	↓ (12)	(-5)	Bashkia Libohovë	335
15	↓ (12)	(-10)	Bashkia Mat	330
16	↑ (20)	(+35)	Bashkia Devoll	325
16	↑ (22)	(+95)	Bashkia Shijak	325
17	↓ (16)	(-5)	Bashkia Mallakastër	315
18	↓ (17)	(-10)	Bashkia Tepelenë	305
19	↓ (18)	(0)	Bashkia Kavajë	300
19	↑ (23)	(+105)	Bashkia Tropojë	300
20	↑ (21)	(+15)	Bashkia Kuçovë	295
21	- (-)	(-)	Bashkia Prrenjas*	285

*Bashki që kanë krijuar Njësi të Auditimit të Brendshëm

✓ ***Rankimi i bashkive që nuk kanë njësi auditimi në strukturë***

Tabela 5. Rankimi i Bashkive që nuk kanë njësi auditimi, sipas indikatorëve të performancës, krahasuar me vitin 2016

Rankimi	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2016(+/-)*	*Ndryshimi në pikë krahasuar me vitin 2016(+/-)*	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2017*
1	- (1)	(+5)	Bashkia Cërrik	260
2	- (2)	(-10)	Bashkia Belsh	240
2	↑ (9)	(+45)	Bashkia Delvinë	240
2	- (2)	(-10)	Bashkia Pukë	240
3	↓ (1)	(-30)	Bashkia Konispol	225
4	↓ (2)	(-30)	Bashkia Has	220
5	↓ (3)	(-30)	Bashkia Poliçan	215
6	↑ (8)	(0)	Bashkia Kurbin	205
7	↓ (6)	(-20)	Bashkia Përmet	200
8	- (8)	(-35)	Bashkia Këlcyrë	170
9	↑ (12)	(+5)	Bashkia Peqin	150
10	↑ (11)	(-50)	Bashkia Rrogozhinë	100

Një vështrim i përgjithshëm për disa prej treguesve kryesorë të analizuar paraqitet si vijon:

1.2 Analiza për Bashkitë:

1. Treguesi **"Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar"** për vitin 2017 mesatarisht është vlerësuar me 15.1 pikë nga 30 pikë të mundshme ose ka një realizim prej 50.3%. Këto vlerësime tregojnë për një performancë mesatare të këtij treguesi, ku pjesa më e madhe e bashkive janë vlerësuar në intervalin 10-20 pikë krahasuar me një vit më parë ku ky indikator vlerësohej mesatarisht me 21.1 pikë. Pra, mund të konkludojmë që bashkitë kanë ende problematika në zbatimin e afatave kohore për dërgimin e faturave në thesar.
2. Edhe për këtë vit, vlerësimet më të mira, Bashkitë i kanë arritur në treguesin **"Anulimi i kontratave gjatë një viti"**, i cili ka një shkallë të lartë realizimi prej 95.6%, ku pikët mesatare të vlerësuara të këtij treguesi janë 28.7 pikë. Shumica e bashkive (52 prej tyre) kanë vlerësim maksimal të këtij indikatori dhe asnjë bashki nuk është vlerësuar me 0 apo 5 pikë. Në përgjithësi, mund të themi që situata e këtij indikatori në njësitë e qeverisjes vendore paraqitet në nivele shumë të kënaqshme dhe ka një përmirësim të lehtë në krahasim me realizimin prej 92% në vitin 2016.
3. Indikatori tjetër i analizuar është **"Urdhër shpenzimet e refuzuara nga ana e Thesarit"**. Pikët mesatare të marra nga bashkitë për këtë indikator janë 27.8 pikë, duke evidentuar një realizim prej 92.6%, më të lartë se vitin e kaluar. Nga të gjitha institucionet vendore, shumica prej tyre (47) është vlerësuar maksimalisht me 30 pikë dhe asnjë bashki nuk është vlerësuar me 0, 5 ose 10 pikë. Pra, situata e këtij indikatori paraqitet në nivele shumë të kënaqshme.
4. **"Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar"** është një tjetër indikator i rëndësishëm i gjeneruar nga Drejtoria e Thesarit. Bashkitë, mesatarisht, janë vlerësuar me 10.7 pikë, ku kemi 29 bashki të cilat janë vlerësuar me 0 dhe 5 pikë. Realizimi i këtij treguesi është 35.5%, mjaft i ulët krahasuar me vitin me vitin e kaluar (64%), duke evidentuar faktin që institucionet vendore, në shumicën e rasteve, nuk arrijnë të dorëzojnë kontratat në thesar brenda afatit 3-ditor të caktuar.
5. **"Urdhër prokurimet e paautorizuara"** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit

Publik (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, për njësitë vendore, ky indikator është vlerësuar mesatarisht me 28.3 pikë dhe ka një realizim prej 94.2%. Krahasimisht me vitin 2016, ky indikator ka një përmirësim të lehtë duke konkluduar në një performancë shumë të kënaqshme nga ana e institucioneve. Pjesa më e madhe e bashkive (55 prej tyre) janë vlerësuar maksimalisht me 30 pikë dhe vetëm 2 bashki janë vlerësuar me 0 dhe 5 pikë.

Këtë vit, për herë të parë, është realizuar vlerësimi i performancës së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Institucionet e Pavarura. Gjithsej janë analizuar 26 Institucione të pavarura. Specifikisht, në këtë analizë nuk janë përfshirë të dhënat për indikatorin e thesarit, "Urdhër prokurimet e paautorizuara" dhe për indikatorin e buxhetit, "Shlyerja e detyrimeve të prapambetura", indikatorë për të cilët nuk disponojmë të dhëna.

Në lidhje me indikatorët e auditimit të brendshëm, janë përfshirë vlerësimet vetëm për institucione të cilat realizojnë shërbimin e auditimit nëpërmjet akt marrëveshjeve, dhe ato të cilat kanë krijuar njësi auditimi në strukturat përkatëse. Ndërsa për institucionet e tjera, këta tregues janë vlerësuar me 0 pikë.

Për sa i përket vlerësimit të indikatorit "Raporti fakt/plan të shpenzimeve kapitale", përjashtim bën vetëm Këshilli i Lartë e Drejtësisë, institucion i cili nuk ka realizuar shpenzime kapitale për vitin 2017.

Vlerësimi maksimal potencial i mundshëm për institucionet e pavarura është 540 pikë.

Më poshtë, paraqitet renditja e Institucioneve të Pavarura duke i ndarë në dy grupe: 1) Institucione që realizojnë funksionin e auditimit të brendshëm me akt marrëveshje dhe institucione të cilat kanë krijuar njësi të auditimit të brendshëm në strukturat e tyre; 2) Institucione të cilat nuk kanë njësi auditimi të brendshëm dhe nuk e kanë kryer këtë funksion as me akt marrëveshje.

✓ ***Rankimi i Institucioneve të Pavarura që realizojnë auditim të brendshëm***

Tabela 6. Rankimi i Institucioneve të Pavarura që realizojnë auditim të brendshëm për vitin 2017

Rankimi	***Institucioni***	***Vlerësimi në pikë për vitin 2017***
1	Autoriteti i Konkurrencës*	495
2	Qendra Kombëtare e Kinematografisë*	490
3	Agjensia Telegrafike Shqiptare*	485
3	Prokuroria e Përgjithshme	485
4	Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	475
5	Shërbimi Informativ Shtetëror	470
5	Instituti Statistikës	470
6	Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi dokumentet ish-sigurimit*	465
7	Kuvendi	455
7	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit*	455
8	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave*	425

* Institucione të pavarura që realizojnë shërbimin e Auditimit të Brendshëm me akt-marrëveshje.

✓ ***Rankimi i Institucioneve të Pavarura që nuk realizojnë auditim të brendshëm***

Tabela 7. Rankimi i Institucioneve të pavarura që nuk kryejnë shërbime të auditimit të brendshëm

Rankimi	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2017*
1	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	370
1	Inspektorati i Lartë i Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	370
2	Kontrolli Lartë i Shtetit	360
2	Avokati i Popullit	360
3	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	355
4	Shkolla e Magjistraturës	345
5	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	340
6	Akademia e Shkencës	330
7	Presidenca	315
7	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	315
8	Gjykata Kushtetuese	310
9	Agjencia për Mbështetje për Shoqërinë Civile	295
10	Këshilli i Lartë i Drejtësisë*	280
10	Kryeministria	280
11	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	265

*Institucione të pavarura që nuk kanë të dhëna për indikatorin "Raporti fakt/plan të shpenzimeve kapitale"

1.3 Analiza për Institucionet e Pavarura

1. Treguesi i parë është **"Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar"** për vitin 2017 mesatarisht është arritur në nivelin 21.15 pikë ose 93 % të faturave janë dërguar në kohë për pagesë në thesar, duke reflektuar një performancë relativisht të mirë. Theksojmë faktin që ka institucione me performancë maksimale në këtë tregues si Kryeministria, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit.
2. Indikatori **"Anulimi i kontratave gjatë një viti"** është realizuar me 30 pikë mesatare ose 100% e nivelit referues. Performanca e vitit 2017 në mënyrë të dukshme është mjaft e mirë për këtë tregues.
3. Për vitit 2017, indikatori **"Urdhër shpenzimet e refuzuara nga ana e Thesarit"** është realizuar maksimalisht me 28.4 pikë (ose 98%), pra në një nivel afër maksimales të realizimit të tij duke vënë në dukje një përgjegjshmëri të lartë të stafit të institucionheve të pavarura.
4. **"Dorëzimi në kohë i kontratave në thesar"** është një tregues shumë i rëndësishëm. Për periudhën analizuese ky tregues është realizuar mesatarisht 15.57 pikë që përfaqëson 58% nivelit referues.
5. Treguesi **"Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente"**, për vitin 2017 pasqyron një performancë të mirë. Treguesi "Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente" është realizuar në nivel mesatar me 20.96 pikë ose 89% të nivelit referent të vlerësimit. Nga të gjitha institucionet këtu mund të përmendim ato me vlerësime të larta si :Presidenca, SHISH, KLSH, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Autoriteti i Konkurencës.
6. Treguesi **"Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale"**, Treguesi në fjalë për vitin 2017 është realizuar në nivel mesatar 19.4 pikë ose 82%, çka tregon një performancë të mirë përsa i përket realizimit të këtij treguesi. Përjashtim bën vetëm Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i cili nuk ka patur investime publike për vitin 2017.

7. **"Saktësia dhe konsistenca e raportimeve"** është indikatori që paraqitet me realizimin maksimal të nivelit referues për vitin 2017. Të gjitha institucionet paraqiten me një performancë shumë të mirë dhe janë vlerësuar me pikët maksimale prej 29 pikësh, pra 98%.
8. **"Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve"** është një indikator që për periudhën analizuese rezulton me një nivel prej 28.3 pikë ose 84%. Për periudhën analizuese institucionet kanë bërë kujdes për një planifikim të orientuar të buxhetit të tyre si dhe kanë bërë më pak rialokime gjatë vitit buxhetor.

Për sa është specifikuar më lartë, nga analiza e indikatorëve arrijmë në konkluzionin se kemi një realizim të kënaqshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik mbi realizimin në kohë dhe sipas kërkesave të elemtëve që lidhen sidomos me aktivitete e kontrollit. Në disa indikator lind nevoja për marrjen e masave për përmirësime në periudhat e në vazhdim, ku mund të theksojmë nevojën për përmirësim të indikatorit të thesarit "Dorëzimi në kohë i kontratave në thesar".

Për herë të parë për vitin 2017, është bërë një vlerësim i performancës së MFK-së për institucionet e Grupit 87, në varësi Kryeministrisë për vitin 2017, ku përfshihen në total 17 Institucione. Në këtë analizë nuk janë përfshirë të dhënat për indikatorin e thesarit, "Urdhër prokurimet e paautorizuara" dhe për indikatorin e buxhetit, "Shlyerja e detyrimeve të prapambetura", indikatorë për të cilët nuk disponojmë të dhëna.

Në lidhje me indikatorët e auditimit të brendshëm është kryer vlerësimi vetëm për tre institucione të Grupit 87, të cilët e realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm nëpërmjet akt-marrëveshjeve, ndërsa për institucionet e tjera të cilët nuk e kanë realizuar në asnjë formë funksionin e auditimit të brendshëm, këta tregues janë vlerësuar me 0 pikë. Konkretisht, institucionet që kanë realizuar shërbimin e auditimit të brendshëm nëpërmjet një akt-marrëveshje janë: Autoriteti Kombëtar i Çertifikimit Elektronik/Sigurisë Kibernetike, Autoriteti Shtetëror Gjeohapësinor, Sekretariati Teknik i Ujit.

Ndërsa Komiteti Shtetëror i Minoriteteve dhe Komiteti Shtetëror i Kulteve janë institucione të cilat nuk kanë Investime publike për vitin 2017, pra nuk mund ti përcaktohen pikë për indikatorin e buxhetit mbi "Raportin fakt/plan të shpenzimeve kapitale gjatë vitit".

Vlerësimi maksimal potencial i mundshëm për institucionet e pavarura është është 540 pikë. Bazuar në kriteret e sipërpërmendura, rankimi i këtyre institucioneve vijon si më poshtë:

Tabela 8. Rankimi i institucioneve të Grupit 87, në varësi të Kryeministrisë, për vitin 2017

Rankimi	***Institucioni***	***Vlerësimi në pikë për vitin 2017***
1	Autoriteti Kombëtar i Çertifikimit Elektronik/Sigurisë Kibernetike*	440
2	Autoriteti Shtetëror Gjeohapsinor (ASIG) *	420
3	Sekretariati Teknik i Ujit*	415
4	Inspektoriati Qendror	355
5	Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Rajonal	325
6	Agjencia e Zhvillimit të Territorit	315
6	Agjencia Ofrimit të Shërbimeve Publike (ADISA)	315
6	Agjencia e Zhvillimit Rajonal 4	315
7	Departamenti i Administratës Publike	310
7	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	310
8	Agjencia e Prokurimit Publik	300

8	Komiteti Shtetëror i Kulteve#	300
9	Agjensia Kombëtare e Shoqerisë së Informacionit	295
10	Drejtoria Sigurimit të Informacionit Klasifikuar	285
11	Agjencia Autonome e Auditimit te Fondeve të BE	260
12	Agjencia për Hapje, Dialog dhe Bashkeqeverisje	255
13	Komiteti Shtetëror i Minoriteteve #	245

* Institucione që realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm me akt-marrëveshje
# Institucionet që nuk kanë të përfshira në vlerësim pikë për indikatorin e buxhetit "Raporti fakt/plan të shpenzimeve kapitale gjatë vitit"

1.4 Analiza për institucionet e Grupit 87, në varësi të Kryeministrisë

1. Treguesi i parë është **"Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar"** për vitin 2017 mesatarisht është arritur në nivelin 18.5 pikë nga 30 pikë pra një realizim prej 88%. Konkludohet se 12% e faturave nuk janë dërguar në kohë për pagesë në thesar, duke reflektuar një performancë relativisht të mirë. Evident është fakti që ka institucione me performancë maksimale në këtë tregues si Autoriteti Kombëtar i Çertifikimit Elektronik/Sigurisë Kibernetike.
2. Indikatori **"Anulimi i kontratave gjatë një viti"** është realizuar me 30 pikë mesatare ose 100% e nivelit referues pra kemi 0% të mos realizimit të këtij indikatori. Si rrjedhojë performanca e vitit 2017 është në nivelin maksimal për këtë tregues.
3. Për vitit 2017, indikatori **"Urdhër shpenzimet e refuzuara nga ana e Thesarit"** është realizuar maksimalisht me 28.8 pikë, pra 99% duke reflektuar për një përgjegjshmëri nga stafi i institucioneve të grupit 87 për të realizuar maksimalisht këtë indikator.
4. **"Dorëzimi në kohë i kontratave në thesar"** është një tregues shumë i rëndësishëm. Për periudhën analizuese ky tregues është realizuar mesatarisht 0.2 pikë që përfaqëson 3% të realizimit të tij dhe që do të thotë se këtë tregues e kemi gati 97 % të pa realizuara, pra një nivel shumë i ulët.
5. Treguesi **"Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente",** për vitin 2017 pasqyron një performancë të mirë. Treguesi "Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente" është realizuar në nivel mesatar me 17 pikë ose 83% të nivelit referent të vlerësimit. Kjo tregon se performanca e institucioneve në drejtim të realizimit të shpenzimeve buxhetore korrente ka ardhur në rritje. Nga të gjitha institucionet, këtu mund të përmendim, Presidencën, SHISH, KLSH, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Autoritetin e Konkurencës.
6. Treguesi **"Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale",** Treguesi në fjalë për vitin 2017 është realizuar në nivel mesatar 16.3 pikë ose 83%. Në këtë performancë është vetëm Komiteti Shtetëror i Kulteve dhe Komitetit Shtetëror i Minoriteteve të cialt nuk kanë patur shpenzime kapitale për vitin 2017.
7. **"Saktësia dhe konsistenca e raportimeve"** është indikatori që paraqitet me realizimin maksimal të nivelit referues për vitin 2017. Të gjitha institucionet paraqiten me një performancë shumë të mirë dhe janë vlerësuar me pikët maksimale prej 27 pikësh, pra 97%.
8. **"Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve"** është një indikator që për periudhën analizuese rezulton me një nivel prej 29 pikë ose 99%. Në periudhën analizuese institucionet kanë bërë kujdes për një planifikim të orientuar të buxhetit të tyre si dhe kanë bërë më pak rialokime gjatë vitit buxhetor.

Opinion i Përgjithshëm

Nga analiza e përgjithshme e këtyre indikatorëve, ne mund të arrijmë një konkluzion paraprak mbi komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Treguesit e mësipërm lidhen kryesisht me komponentin e aktivitetit të kontrollit, që përfshin ekzistencën e rregullave dhe procedurave të shkruajtura të proceseve kryesore si: të prokurimeve, të kontratave, urdhër-shpenzimeve, etj. Nga analiza e përgjithshme, rezulton që ka kontrolle efektive të ndërmarra nga ana e institucioneve, ku mesatarisht efektiviteti i tyre për njësitë e qeverisjes së përgjithshme është 87%. Megjithatë, në disa indikator apo tregues specifik lind nevoja për marrjen e masave për përmirësime të vazhdueshme në periudhat e ardhshme.

KAPITULLI II- MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI

2.1 Analiza e sistemit sipas pesë komponentëve të MFK bazuar në vetëvlerësimin e njësive publike

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një koncept i rëndësishëm, por i kuptueshëm me vështirësi për nivelin e lartë menaxherial ashtu dhe për stafin e institucioneve publike. Ky sistem duhet të jetë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar si transparenca, efiçenca apo efektiviteti dhe ekonomia. Vlerësimi i këtij sistemi, në institucionet publike të vendit tonë, bazohet në pyetësorin e vetëvlerësimit dhe në raportet mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik. Në bazë të këtij vetvlerësimi, situata e komponentëve të MFK paraqitet si më poshtë:

2.1.1 Mjedisi i Kontrollit

Komponenti "Mjedisi i kontrollit" është komponenti i parë i pyetësorit dhe përbëhet nga një numër më të madh pyetjesh (16 të tilla) krahasimisht me komponentët e tjerë, të cilat sipas problematikave që fokusojnë janë të grupuara në pesë grupime që përbëjnë nënkomponentët. Ky komponent përbëhet nga dy aspekte kryesore: strukturat formale dhe aspektet e sjelljes individuale; dhe të dy duhet të ndërveprojnë. Menaxhimi ka rolin kyç në miratimin dhe mbështetjen e mjedisit të kontrollit.

Sipas përkatësisë nënkomponentët i referohen këtyre problematikave:

- vendosjen e objektivave dhe politikave;
- vlerat etike dhe profesionalizmin e menaxhereve;
- strukturën organizative;
- filozofinë dhe stilin e punës së drejtuesit;
- politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore.

Përpunimi i të dhënave të grumbulluara nga pyetësori i vetëvlerësimit të shprehur në tregues krahasues paraqitet si vijon:

Grafiku 1. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit sipas pyetësorit të vetëvlerësimit





Treguesit evidentojnë se situata për efektivitetin e mjedisit të kontrollit për vitin 2017 në përgjithësi, rezulton me rritje (91.1%) dhe gjithashtu nesë i referohemi dy niveleve të larta të vlerësimit (vlerësimi përkatësisht me 3 dhe 4 pikë, grafiku nr. 1), për vitin 2017, në të gjitha institucionet publike përgjigjet pozitive zënë 94.3% dhe janë në nivel më të lartë në krahasim me vitin 2016 (92.7%).

Nëse do t'iu referohemi të dhënave specifike për secilin institucion rezulton se në nivel ministrie treguesi i efektivitetit të mjedisit të kontrollit, për periudhën referente, ka një rritje me1% krahasuar me arritjet e vitit 2016, në nivel bashkie ka një përmirësim prej 3% dhe për institucionet e pavarura (ku përfshihet edhe Grupi 87 në varësi të Kryeministrisë) një rritje me 2.4 %. Këto rezultate janë të mbështetura në vetëvlerësimin e institucioneve dhe kjo reflekton

edhe një shkallë subjektivizmi të njohur statistikisht. Rritja e lehtë në vlerat e pyetësorit të vetëvlerësimit tregon për një rritje të ndërgjegjësimit të institucioneve për të reflektuar me vërtetësi, realitetin e implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe gjithashtu vjen si rezultat i monitorimit të realizuar nëpër institucione nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Në vijim janë paraqitur rezultatet e analizës së pyetjeve sipas nënkomponentëve përkatës.

- *Vendosja e objektivave*

"*Vendosja e objektivave*" si element përbërës i mjedisit të kontrollit, është analizuar bazuar në deklaratën e misionit, ekzistencës së një strategjie të miratuar objektivash dhe prioritetesh si dhe në planin e veprimit për arritjen e objektivave strategjike. Referuar grafikut të mëposhtëm, vërehet se 88.1% e institucioneve publike kanë vlerësuar pozitivisht situatën për elementët përbërës, të cilët i referohen vendosjes së objektivave. Krahasimisht me arritjet e vitit 2016, në periudhën referente është vënë re një ulje e lehtë prej 0.6%, gjë që tregon se institucionet publike kanë ngritur një bazë të shëndoshë të këtij nënkomponenti dhe janë bërë më të ndërgjegjshëm në reflektimin e realitetit në përgjigjet e vetvlerësimit duke mos u përgjigjur me subjektivitet dhe të paraqitnin një rritje më të lartë të këtij nënkomponenti. Nga vetvlerësimi i analizuar, konstatohet që efektiviteti i vendosjes së objektivave në institucionet publike për vitin 2017 për Ministritë është 93.75%, Bashkitë 76.75% dhe për Institucionet e Pavarura (ku përfshihet edhe Grupi 87 në varësi të Kryeministrisë) 92.25 %. Në krahasi me vitin 2016 për të tre llojet e institucioneve rezultojnë: rritje për ministritë me 1.25%, për bashkitë me 1.15%; për institucionet e pavarura dhe grupin 87, një rënie me 0.75%.

- *Etika personale dhe profesionale*

"Etika" synon në një sjellje të orjentuar në institucion drejt objektivave të mirëpërcaktuara të tij. Ndaj është përgjegjësi e menaxherëve të institucioneve të të gjitha niveleve të fokusojnë zbatimin e kompetencave profesionale si dhe të caktojnë procedura për raportimin e parregullsive dhe t'i zhvillojnë ato në vazhdimësi duke mundësuar një zbatim sa më rigoroz të tyre. Vendosja e rregullave dhe procedurave etike mundëson efektivitetin e zbatimit të tyre dhe rrit shkallën e përgjegjshmërisë nga ana e punonjësve. Në lidhje me ekzistencën e procedurave për raportimin e gabimeve, mashtrimit dhe parregullsive, pjesa më e madhe e institucioneve (rreth 96.8% e tyre) pranojnë se kanë procedura përkatëse për secilin rast, në krahasim me vitin 2016, e cila është vlerësura 93.6% (pra një rritje në total të vlerësimeve pozitive me 3.2%). Zbatimi i kërkesave të rregullave dhe procedurave etike për vitin 2017, paraqitet në nivele të kënaqshme si për ministritë, bashkitë dhe institucionet e pavarura (ku përfshihet edhe Grupi 87 në varësi të Kryeministrisë), me një vlerësim respektivisht 97.50 %, 87% dhe 98.25%, çka evidenton një situatë në rritje me vlerësimin e arritur në vitin 2016. Megjithatë, pavarësisht situatës vlerësuese pozitive, nga ana e institucioneve vërehen edhe mangësi organizative, pasi nuk është kuptuar sa duhet fakti se efektiviteti i zbatimit të rregullave etike rritet në mënyrë të ndjeshme nëse institucioni ka rregulla dhe procedura të shkruara (të dokumentuara). Ekzistenca e rregullave të shkruara rrit profesionalizmin e menaxherit të institucionit duke mundësuar në çdo rast krahasimin e sjelljes faktike me standartet e shkruara, dhe për më shumë rrit përgjegjshmërinë menaxheriale.

- *Struktura organizative*

"Struktura organizative" është një angazhim i rëndësishëm i menaxherit të çdo institucioni pasi përfaqëson një renditje hierarkike të elementëve përbërës të drejtimit të organizatës në përshtatshmëri me karakteristikat e saj. Titullari i çdo institucioni publik duhet të ngrejë një strukturë organizative duke evidentuar marrdhëniet, lidhjet e ndërvartësitë reciproke midis njësive të kësaj strukture për hartimin dhe zbatimin e strategjisë së institucionit. Struktura organizative është korniza me anë të së cilës planifikohen, zbatohen, kontrollohen dhe raportohen aktivitetet e njësisë. Prania e strukturës organizative bën të mundur arritjen e

objektivave në pajtim me funksionet e ngarkuara sipas kuadrit ligjor. Ajo duhet të paraqitet në formë të dokumentuar duke evidentuar qartë rregullat për përcaktimin dhe ndarjen detyrave, detyrimeve dhe përgjegjësive si dhe hierarki dhe linja të përshtatshme raportimi, fakte këto të rëndësishme për rritjen e përgjegjshmerisë menaxherila të të gjitha niveleve menaxhuese. Përpunimi i të dhënave të grumbulluara nga vetëvlerësimi i institucioneve, evidenton se rreth 96.4% institucioneve kanë një strukturë organizative që përputhet me madhësinë dhe aktivitetin e tyre si dhe përcakton qartë detyrat dhe përgjegjësitë e departamenteve përkatëse (i referohemi vlerësimit me 4 dhe 3 pikë). Analiza evidenton se efektiviteti i këtij nënkomponenti për vitin 2017 përgjithësisht paraqitet lehtësisht i ritur në nivelin 95.7%, në krahasim me atë të vitit 2016. Edhe në grup institucionesh vletësimi i këtij nënkomponenti rezulton me rritje. Respektivisht efektiviteti i këtij treguesi për ministritë, bashkitë dhe institucionet e pavarura (ku përfshihet edhe Grupi 87 në varësi të Kryeministrisë) raportohet në nivele më të larta se ato të vitit 2016 dhe përkatësisht me vlerësim 93%, 86.8 % dhe 90.5 %, ndërsa për vitin 2017 janë përkatësisht 94.25%, 88%, 95.5%.

- *Filozofia e menaxhimit të drejtuesve*

"Filozofia e menaxhimit të drejtuesve" reflekton pikëpamjet, parimet dhe njohuritë kryesore të drejtuesit rreth mënyrës së veprimit mbi organizimin e punonjësve dhe aktiviteteve. Efektiviteti i filozofisë së menaxhimit të drejtuesve është i kushtëzuar edhe nga stili filozofisë së menaxhimit i cili mundëson arritjen e qëllimeve të caktuara dhe njëkohësisht përfaqëson një barrierë për marëdhënie të mira njerëzore. Vlen të theksohet se çdo drejtues ka një stil specifik të reagimit ndaj problemeve.

Një ndër elementët pozitiv që vihet re është zhvillimi i takimeve të rregullta të menaxherëve të institucioneve për diskutimin e çështjeve themelore të menaxhimit të njësisë publike ku ata bëjnë pjesë. Në disa njësi publike frekuenca dhe mënyra e organizmit të takimeve janë të përshkruara në rregulloret e brendshme të institucioneve. Gjithashtu një ndër elementet thelbësorë përbërës të stilit menaxherial është dhe delegimi i detyrave. Delegimi i mundëson menaxherit angazhimin në detyra edhe më të rëndësishme në një periudhë të dhënë. Megjithatë menaxheri mbetet personi që do të mbajë përgjegjësi në vazhdimësi për veprimet e vartësve. Një ndër elementët e rëndësishën i përshkruar dhe përcaktuar në ligjin e fushës edhe delegimi i funksionit të koordinatorit të riskut dhe të menaxhimit financiar dhe të kontrollit si një instrument për nivelet e larta menaxhuese në realizimin e funksioneve ligjore, e cila do të ndihmojë sistemin në rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale.
Aktualisht nga përgjigjet e pyetësorëve të vetëvlerësimit, 96% e institucioneve kryejnë procedura delegimi sipas kërkesave të ligjit të MFK. Rastete më të shpeshta janë konstatuar delegimet në mungesë sipas kërkesave të Kodit të Procedurave Administrative dhe jo delegim sipas kërkesave të nenit 9, 12 dhe 15 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndyshuar " Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin". Megjithatë është vënë re një rritje e ndërgjegjësimit për të përdorur delegimin si një instrument të rëndësishëm të realizimit të funksioneve ligjore, sidomos të koordinatorit të riskut dhe të koordinatorit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, të rregulluar si funksione edhe me baza nënligjore.
Efektiviteti i stilit të punës të drejtuesve paraqitet në nivele pozitive si për ministritë, ashtu dhe për bashkitë dhe institucionet e pavarura (përfshi edhe Grupin 87). Konkretisht efektiviteti i stilit të punës i arritur gjatë vitit 2017 ka rezultuar respektivisht 95%, 86% dhe 95% në krahasim me vitin 2017 që kanë rezultuar respektivisht me 94.3% Ministritë, 84% Bashkitë, 93.5% Institucionet e Pavarura bashkë me Grupin 87 në varësi të Kryeministrisë.

- *Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.*

"Politikat dhe praktikat burimeve njerëzore" lidhen me rekrutimin transparent, emërimin, trajnimin e vazhdueshëm, vlerësimin korrekt të performancës, avancimin në detyrë bazuar në rezultatet e performancës si dhe me veprimet disiplinore të punonjësve të institucioneve publike. Politikat e burimeve njerëzore përbëjnë mbështetjen kryesore për mbarëvajtjen e çdo

institucioni, pasi ato kanë kapacitetin për të vepruar dhe ndryshuar me qëllim sigurimin e mbështetjes së nevojshme për arritjen e objektivave të organizatës.
Efektiviteti i politikave të burimeve njerëzore për vitin 2017 njohin rritje krahasimisht me ato të vitit 2016. Institucionet e renditura kanë arritje respektivisht me 96% për ministrit, 82.75% për Bashkitë dhe 93.75% për Institucionet e Pavarura (përfshi Grupin 87 të Kryeministrisë). Nga analiza e pyetësorëve të vetvlerësimit, 94.3% e institucioneve kanë politika favorizuese në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore.
Në përfundim, rezulton se situata paraqitet më pozitive për ministritë dhe institucionet e pavarura se sa në bashkitë (edhe pse vihet re një rritje për vitin 2017), të cilat kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme të mjedisit të kontrollit në përgjithësi. Kjo vjen si rezultat edhe i gjetjeve të njësive të auditimit të brendshëm, të cilët konsiderojnë si fushë me risk të lartë sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore si rrjedhojë e mungesës së ndarjes së detyrave, si dhe rekrutimit të punonjësve pa kërkesat, aftësitë dhe nivelin e kërkuar të kualifikimeve.

Grafiku 2. Analiza e nënkomponentëve të mjedisit të kontrollit për vitin 2017



Mangësitë e konstatuara

Evidencimi i qartë i mangësive është i rëndësishëm pasi funksioni kryesor i evidencimit nuk është thjesht për të theksuar mangësitë, por nëpërmjet të gjykimit të arrihet në ndihmë për arritjen e standarteve të parashikuara në ligjin e MFK. Disa nga mangësitë e vërejtura mund të përmblidhen si vijon:

1. Grupi për Menaxhimin Strategjik nuk funksionon në drejtim të trajtimit të çështjeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit si dhe për rrjedhojë mospasqyrimi i veprimtarisë së kësaj strukture në dokumentacionin përkatës.
2. Mungesa e ndërgjegjësimit të niveleve të ndryshme të menaxhimit të institucioneve mbi konceptimin dhe aplikimin e delegimit sipas ligjit të MFK dhe devijimi i rregullave të delegimit të dokumentuar. Mungesa e delegimit në mënyrë të vazhdueshme evidenton njëkohësisht edhe mungesën e besimit nga ana e Nëpunësve autorizues/zbatues për delegimin e përgjegjësive tek vartësit funksionalë, çka mundëson angazhime në detyra më të rëndësishme në kohë të caktuara.

3. Mungesa e dokumentimit të objektivave të planit operacional të institucionit, gjë që vështirëson gjetjen e mundësive për arritjen dhe matjen e tyre. Mungesa e një plan zhvillimi në përputhje me objektivat të institucionit çon në një mungesë të organizimit dhe ul mundësinë e vlerësimit mbi performancën e tij.

2.1.2 Menaxhimi i Riskut

Menaxhimi i Riskut është një komponentët shumë i rëndësishëm për arritjen e objektivave të njësive publike dhe është pjesë integrale e gjithë procesit të menaxhimit. Ky proces lidhet me identifikimin, vlerësimit, kryerja e kontrolleve të nevojshme si dhe monitorimin e risqeve me të cilat përballet njësia publike në arritjen e objektivave të saj, për ta mbajtur ekspozimin ndaj riskut në një nivel të pranueshëm për institucionin. Menaxhimi i riskut duhet të integrohen brenda kulturës së organizatës dhe kjo do të përfshijë si nivelin e lartë menaxherial ashtu dhe stafin e organizatës. Ajo duhet të përkthejë strategjinë e riskut brenda objektivave taktike dhe operacionale, dhe të caktojë përgjegjësitë e menaxhimit të riskut në të gjithë organizatë. Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut", është një dokument i cili ndihmon njësitë publike në ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut si dhe përcakton qartë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë fushë.

Grafiku 3. Vlerësimi i Menaxhimit të Riskut sipas pyetësorit të vetëvlerësimit





Për komponentin e menaxhimit të riskut në pyetësorin e vetëvlerësimit janë evidentuar përgjigjet e gjashtë pyetjeve që kanënë fokusin e tyre delegimin e disa funksioneve të kordinatorit të riskut (NA), formalizimin e menaxhimit të riskut në një dokument që të jetë gjithpërfshirës dhe i diskutuar deri në nivelin e GMS , që eshtë regjistri i risqeve dhe strategjia e risqeve. Bazuar në përgjigjet e pyetësorit të vetëvlerësimit për komponentin e menaxhimit të riskut sipas vlerësimit të tyre në pikë rezulton se institucionet që nuk e kanë filluar këtë proces ose janë në hapat e para (pika1,2 e grafikut) janë rreth 30% të totalit të NJQP që i takojnë 38 institucione. Vlen të theksohet se nga 30% e institucioneve që kanë dhënë përgjigje negative, pra që nuk kanë strategji menaxhimi të riskut rrjedhimisht dhe regjistra të risqe, 90% prej tyre janë njësi të qeverisjes vendore. Në rreth 25% të NJQP, Nëpunësit Autorizues në rolin e kordinatorit të riskut vazhdojnë të mos delegojnë disa funksione që lidhen me menaxhimin e riskut dhe është kryesisht në ato NJQP që nuk e kanë zhvilluar sistemin e menaxhimit të riskut. Gjithashtu, problematikë tjetër në lidhje më këtë çështje është se GMS nuk mbështetet me materiale të formalizuara për menaxhimin e risqeve strategjike, të cilat do të ndihmonin në marrjen e vendimeve efektive dhe arritjen e objektivave të institucionit.

Efektiviteti i menaxhimit të riskut në % përfaqëson totalin e pikëve për këtë komponent kundrejt vlerësimit maksimal që është katër(4). Nga grafiku i mësipërm konstatohet që ka diferenca ndërmjet niveleve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe konkretisht njësitë e qeverisjes vendore kanë një efektivitet prej 69.5%, më të ulët se ministritë dhe institucionet e

pavarura, të vlerësuara përkatësisht me 83.8% dhe 81.5%. Duke parë ecurinë e tre viteve vlerësojmë që kemi një rritje të efektivitetit të këtij treguesi në të tre nivelet e njësive të qeverisjes së përgjithshme.
Nga vlerësimi i pyetësorëve si dhe monitorimi i realizuar konstatohet që ka edhe institucione të cilat kanë pasur regjistrat e risqeve të formalizuar në vitet e mëparshme por që për vitin 2017 nuk është kryer një proces i tillë, gjë që tregon se ky proces nuk është ngritur në sistem por është lënë në përgjegjësi individuale dhe jo e formalizuar si një proces i qëndrueshëm. Pra, si përfundim, mund të themi se menaxhimi i riskut është një komponent thelbësor në implementimin e një sistemi modern të MFK, për të cilin institucionet publike kanë nevojë për asistencë teknike dhe rritje ndërgjegjësimi në periudhën në vijim.

Mangësitë e konstatuara

1. Megjithëse janë bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të ngritjes dhe funksionimit sistemit të menaxhimit të risqeve ka akoma institucione ku ky proces nuk ka filluar, pasi drejtuesit e këtyre nuk janë të ndërgjegjësuar për implementimin e menaxhimit të risqeve në njësitë e tyre. Gjithshtu ka dhe institucione që menaxhimi i risqeve është i fokusuar vetëm në strukturat e financës duke mos u shtrinë në të gjithë institucionin.
2. Ka një rritje të ndërgjegjësimit për rëndësinë e përgatitjes së regjistrit të riskut dhe strategisë së riskut, por jo në të gjitha institucionet këto dokumente janë diskutuar në Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe të jenë finalizuar me identifikimin e risqeve strategjike dhe ndërmarrjen e aktiviteteve të kontrollit për minimizimin e tyre.
3. Nëpunësit Autorizues ngurrojnë të delegojnë disa funksione dhe detyra që lidhen me menaxhimin e riskut tek një punonjës i financës, sipas përcaktimeve të nenit 10, pika 2 të ligjit 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, dhe ta përdorin këtë dokument si orientues për funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut.
4. Bazuar në sa më sipër, vihet re mungesë marrje përgjegjësie/delegim kompetencash dhe si rrjedhim, mungesë monitorimi për minimizimin e risqeve nga niveli i lartë menaxherial.

2.1.3 Aktivitetet e Kontrollit

Grafiku 4 Vlerësimi i Aktiviteteve të Kontrollit sipas pyetësorit të vetëvlerësimit





Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet, që synojnë reduktimin e risqeve me synimin për të arritur objektivat e organizatës, si dhe për të nxitur zbatimin e vendimeve të titullarit. Në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, titullarët e institucioneve duhet të marrin parasysh përfitimet që këto aktivitete pritet të japin, sikurse dhe kostot për futjen dhe zbatimin e tyre. Aktivitetet e kontrollit duhet të përfshihen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit më vonë, do të ishte më e kushtueshme dhe më pak eficiente. Njësitë publike deklarojnë se kanë përmbushur kërkesat

ligjore minimale dhe kanë vënë në zbatim kontrolle të përshtatshme në fushat e mëposhtme si: ekzistencën e rregullave/udhëzimeve të brendshme për përshkrimin e proceseve kryesore operacionale dhe financiare, ndarjen e detyrave, delegimin e detyrave dhe përgjegjësive.

Në bazë të të dhënave statistikore të ilustruara nga grafikët e mësipërm, vlerësimet pozitive për vitin 2016 (vlerësimi me 3 dhe 4 pikë) përbëjnë 83.9% të institucioneve publike të cilët deklarojnë se përdorin aktivitete kontrolli për reduktimin e risqeve dhe arritjen e objektivave, ndërsa për vitin 2017 rerzulton një vlerë prej 84.2 % e institucioneve publike që janë përgjigjur pozitivisht pra që ushtrojnë aktivitetet e kontrollit sipas kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Ky komponent paraqitet në nivele të kënaqshëm për të gjitha NJQP, ku ministritë karakterizohen nga një efektivitet prej 94.8%, bashkitë 80.8% dhe institucionet e pavarura (ku përfshihet edhe Grupi 87 i Kryeministrisë) 84.8% dhe vihet re një një rritje në tërësi për vitin 2017.

Efektiviteti për të gjitha njësitë publike, nga vetëvlerësimi rezulton me një ulje të lehtë pra 87.6% për vitin 2017 në krahasim me 88.26% për vitin 2016 për të cilën mund të konkludojmë se është rritur ndërgjegjësimi i institucioneve publike për të reflektuar me realitet masën e implementimit të sistemit të MFK në pyetësorët e vetëvlerësimit. Gjithashtu në këtë drejtim ka ndihmuar edhe procesi i monitorimeve të kryera nga ana e stafit të Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit.

- *Ndarja e detyrave*

Çdo njësi publike është e detyrueshme të ketë brenda saj një hierarki të menaxhimit, me titullarin e njësisë që ka përgjegjësinë kryesore për miratimin e politikave dhe rregullave të brendshme të KB, dhe pastaj përgjegjësitë individuale menaxheriale që shpërndahen tek NA, NZ dhe çdo menaxher brenda njësisë (përfshi edhe drejtuesit e njësive të vartësisë). Ky proces menaxhimi duhet të dokumentohet plotësisht duke përfshirë shkallën e çdo kompetence individuale të menaxherit, niveli i vendimarrjes së menaxherit dhe mënyra e raportimit.

Për këtë nënkpmponent vlen të theksohet se për përshkrimet e pozicioneve të punës ekziston një bazë ligjore dhe një praktikë e mirë në këtë drejtim. Në pjesën më të madhe të njësive publike ekzistojnë përshkrimet e punës. Ato përfshihen në rregulloret e brendshme ose në kontratat e punës. Ndryshimet e vazhdueshme të strukturave si dhe të formatimit të drejtorive kërkojnë dhe rishikimin në vazhdimësi të rregulloreve të brendshme të institucioneve si rrjedhojë edhe rishikimet e pozicioneve të punës. Nga monitorimi i kryer në vazhdimësi është konstatuar që në pjesën më të madhe të institucioneve nuk është bërë rishikimi i rregulloreve të brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore të tyre ose janë në fazë drafti të pa miratuara nga titullari i institucionit publik. Si rrjedhojë nuk janë rishikuar edhe përshkrimet e punës dhe ndarjet e detyrave. Ndarja e pamjaftueshme e detyrave, për shkak të mungesës së stafit në strukturat e financës apo dhe të administratës në përgjithësi, të shkaktuara nga kufizimet buxhetore dhe qarkullimi i lartë i tij, ndikon negativisht në efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike në vendin tonë.

- *Përshkrimi i proceseve të punës*

Instrumenti që ndihmonë në realizimin e këtij nënkomponenti është pregatitja e manualeve të proceseve të punës. Përgatitja e manualeve të proceseve të punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit. Vërehet që në praktikë ka një moskuptim të domosdoshmërisë së ekzistencës së përshkrimit të proceseve të punës. Jo vetëm kaq, por shpeshherë përshkrimi i procesit të punës ngatërohet me përshkrimin e pozicionit të punës. Për të bërë të mundur që çdo institucion të përgatisë manualin e proceseve të punës DH/MFK ka përgatitur një format standard dhe ka asistuar në ndërtimin e manualeve të proceseve të punës

duke i trajnuar në vazhdimësi dhe duke pilotuar institucione të caktuara për të ndihmuar në kuptimin dhe ndërtimin e tyre.

➢ *Menaxhimi i aktiveve*

Në praktikë ka probleme në fushën e menaxhimit të aktiveve, sidomos përsa i përket vendimarrjes për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike. Në bazë të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" të ndryshuar, çdo NJQP ka detyrimin e përgatitjes së udhëzimeve specifike për njësitë e tyre. Kjo përsa i përket organizimit të brendshëm të procesit të vlerësimit dhe kompetencave në daljen nga përdorimi të aktiveve të tyre. Bazuar në përgjigjet e pyetësorëve të vetvlerësimit të institucioneve, i gjithë procesi i menaxhimit të aktiveve realizohet kryesisht sipas udhëzimit bazë nr. 30 të ndryshuar dhe jo sipas udhëzimeve specifike të tyre. Megjithatë, nga monitorimet e vitit 2017, rezulton se është rritur numri i institucioneve që kanë ndërtuar udhëzime specifike për menaxhimin e aktiveve dhe që janë ndërgjegjësuar në rëndësinë e hartimit të një rregullimi specifik të menaxhimit të aktiveve. Sipas gjetjeve të auditimit të brendshëm, sistemi i menaxhimit të aktiveve konsiderohet me risk të lartë për shkak të mosregjistrimit të aktiveve pranë ZVRPP, mungesës së hartimit të regjistrit të aktiveve apo mospajisjes me çertifikatë të aktiveve afatgjata materiale.

Mangësitë e konstatuara:

1. Moskuptimi i domosdoshmërisë së identifikimit të proceseve të punës për objektivat e institucionit të dokumentuar në harta procesesh pune, e cila do të ndihmonte edhe në vijimin e hartimit të manualeve të proceseve të punës.
2. Moskuptimi i domosdoshmërisë së hartimit të manualeve të proceseve të punës. Gjithashtu ngatërimi i asaj çfarë përmban dhe nënkupton manuali i proceseve të punës me përshkrimin e pozicioneve të punës.
3. Mbështetja në çështjet e menaxhimit të aktiveve vetëm në udhëzimin bazë nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", duke mos hartuar akte nënligjore specifike në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe veprimtarinë e institucioneve megjithëse vihet re një rritje në lidhje me hartimin e ndonjë udhëzimi të brendshëm mbi enaxhimin e aktiveve.
4. Sistemi i privatizimit, shitjes, qiradhënies, sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar si dhe sistemi i pagave dhe pagesave vlerësohen me nivel të lartë risku për shkak të mungesës së zbatimit korrekt të procedurave ligjore të këkruara për kto aktivitete kontrolli.

2.1.4 Informimi dhe Komunikimi

Grafiku 5. Vlerësimi i Informimit dhe Komunikimit sipas pyetësorit të vetëvlerësimit





Komunikimi në vetvete përfshin shkëmbimin e informacioneve të dobishme ndërmjet personave dhe institucioneve për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara. Informacioni i duhet komunikuar titullarit dhe nëpunësve të tjerë, në formën dhe në kohën e duhur, për t'i ndihmuar ata në përmbushjen e përgjegjësive të tyre. Nga përgjigjet e NJQP mbi çështje specifike si vënia në dispozicion e informacionit mbi arritjen e objektivave, dhe informacionit të nevojshëm për kryerjen e detyrave, si dhe mbi ekzistencën e kanaleve të komunikimit për parregullsitë, vërehen për sa më lartë aspekte të kënaqshme në këtë fushë. Në përgjithësi, institucionet i kanë të trajtuara këto çështje nëpërmjet rregullores së brendshme të tyre.

Në bazë të të dhënave statistikore të ilustruara nga grafikët e mësipërm, vlerësimet pozitive për vitin 2017 (vlerësimi me 3 dhe 4 pikë) përbëjnë 95.6 % të institucioneve publike të cilët deklarojnë se përdorin Komunuikimin dhe informimin sipas kërkesave të MFK dhe në kohë e në mënyrën e duhur, ndërsa për vitin 2016 rerzulton një vlerë prej 97.5 % e institucioneve publike që janë përgjigjur pozitivisht për këtë komponent, dhe evidontohet një rënie e lehtë me 1.9%.

Përsa i përket analizës ndërmjet institucioneve, vihet re një rritje e ndjeshme e efektivitetit të këtij komponenti në krahasim me vitin 2016. Vlerësimi i përgjithshëm, për vitin 2017, i komponentit të Informimit dhe Komunikimit është për ministritë në vlerën 94.5%, bashkitë 88.25%, institucionet e pavaruara (përfshi këtu edhe Grupin 87 të Kryeministrisë) 94.5%, duke reflektuar një rënietë lehtë në krahasim me vitin 2016. Kjo rënie e lehtë reflekton rritjen e ndërgjegjshmërisë së institucioneve publike mbi paraqitjen e situatës realë të implementimit të kërkesave të MFK, dhe gjithashtu është rezultat i monitorimeve të vazhdueshme nga ana e DH/MFK.

Theksojmë se nga ana e drejtuesve dhe stafit të institucioneve vazhdonë të mos kuptohet termi i sistemit të informacionit dhe komunikimit, i cili nuk përfshin vetëm sisteme IT apo elektronike, por një rrjet të brendshëm të strukturuar të marrjes dhe dhënies së informacionit ndërmjet niveleve të ndryshme hierarkike në funksion të arritjes së objektivave dhe menaxhimit të mirë të fondeve.

Mangësitë e konstatuara

1. Mungesa e sitemeve specifike të IT (programeve) megjithëse vihet re një rritje e ndërgjegjësimit për përdorimin e tyre.
2. Raportimet e brendshme, kryesisht janë vetëm të natyrës financiare dhe nuk përfshijnë informacione të tjera që lidhen me treguesit e performancës së nevojshme për menaxhimin.
3. Mungesë e një sitemi back up-i për ruajtjen e informacionit.

2.1.5 Monitorimi

Grafiku 6. Vlerësimi i Monitorimit sipas pyetësorit të vetëvlerësimit





Komponenti i pestë i kontrollit të brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të institucionit, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit apo nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura.
Fokusi këtë vit, si në pyetësorët e vetëvlerësimit ashtu edhe në raportet vjetore, ka qenë raportimi periodik i drejtorive të ndryshme tek titullari, monitorimi i progresit të arritjes së objektivave dhe përmbushja e pritshmërive në lidhje me aktivitetin e njësisë së auditimit të brendshëm.
Mbi bazën e analizës së kryer, konstatojmë se 87.9% (institucione që kanë vlerësuar këtë komponent me 3 dhe 4) e institucioneve kryejnë një monitorim të rregullt mbi ecurinë e aktiviteteve të ndërmarra prej tyre, në krahasim me vitin 2016 ku vetëm 87% e institucioneve kanë dhënë një vlerësim pozitiv për këtë komponent.
Në bazë të të dhënave statistikore të ilustruara nga grafikët e mësipërm, efektiviteti i sistemit të monitorimit paraqitet në nivele të njëjta krahasuar me vitin 2016. Mund të vërehet një ulje mjaft e lehtë prej 0.2% për ministritë, ndërsa bashkitë dhe institucionet e pavarura janë vlerësuar respektivisht me 80.8% dhe 84.8%, ndërkohë që në vitin 2016 vlerësoheshin me 80% dhe 84.3%.
Vlen të theksohet fakti se, krahasuar me vitin e kaluar, përqindja e institucioneve të cilat e kanë vlerësuar këtë komponent me 1 dhe 2 pikë, është ulur. Kjo tregon për një përmirësim të mënyrës dhe intervaleve të raportimit të drejtuesve tek titullari mbi arritjen e objektivave si dhe krijimin dhe përmirësimin e funksionit të njësive të auditimit të brendshëm në njësitë publike.
Për sa i përket shërbimit të auditimit të brendshëm, gjatë viti 2017, katër bashki kanë krijuar njësi të auditimit të brendshëm, tregues i cili ndikon në rritjen e efektivitetit të komponentit të monitorimit me qëllimin kryesor përmirësimin e efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm.
Si përfundim, për sa i përket këtij komponenti, gjykojmë se në bazë të të dhënave statistikore lidhur me vetëvlerësimin e sistemit të MFK dhe monitorimeve të realizuara në terren, vërehet një ndërgjegjësim i menaxherëve lidhur me plotësimin sa më objektiv të pyetësorit të vetëvlerësimit të MFK dhe paraqitjen reale të situatës së sistemit të monitorimit në njësitë e sektorit publik.

Mangësitë e konstatuara

1. Nevoja për krijmin e shërbimit të auditimit të brendshëm me qëllim vlerësimin dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Opinion i Përgjithshëm

Nga analiza e detajuar e komponentëve të MFK, evidentohet që pjesa me e madhe e njësive të qeverisjes së përgjithshme, kanë implementuar me sukses elementët përkatës të mjedisit të kontrollit dhe informimit dhe komunikimit. Kryesisht, progres ka patur në hartimin e politikave efektive për zhvillimin e kontrollit të brendshëm si dhe në plotësinë e kuadrit rregullator të kontrollit të brendshëm. Problematike paraqitet implementimi në praktikë i elementëve të sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe procesi i delegimit të përgjegjësive nga niveli i lartë menaxherial.
Gjithashtu, edhe për këtë vit, theksojmë se institucionet kanë nevojë për marrjen e masave për përmirësimin e procesit të menaxhimit të riskut. Rekomandohet që këto masa të ndërmerren nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, veçanërisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat paraqiten me efektivitet më të ulët se njësitë e tjera publike, për shkak të mungesës së rregullshmërisë dhe plotësisë në praktikat e procesit të menaxhimit të riskut.

KAPITULLI III – MONITORIMET E KRYERA NË VITIN 2018 PËR VLERËSIMIN E SISTEMIT TË MFK-SË PËR VITIN 2017

Në bazë të pikës 2, neni 26, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (DH/MFK) është përgjegjëse për monitorimin sistematik të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) në njësitë e sektorit publik.

Në këtë kontekst, vizitat në terren janë pjesë e procesit të monitorimit, të cilat kryhen nga stafi i DH/MFK, për të verifikuar besueshmërinë e informacioneve të përfshira në pyetësorët e vetëvlerësimit, si dhe për të mbledhur informacion me qëllim përmirësimin e metodologjisë dhe standardeve të punës.

Ky proces monitorimi ka si synim nga njëra anë inkurajimin e njësisë publike për të kryer një vetëvlerësim të hollësishëm dhe të besueshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe nga ana tjetër do të shërbejë si një mekanizëm që ndihmon DH/MFK për të siguruar një lidhje të qartë ndërmjet çështjeve të përgjithshme të MFK dhe dokumenteve konkrete ose aktiviteteve që duhet të ekzistojnë apo të ndërmerren në njësinë publike. Synim tjetër i vizitave në terren do të jetë gjithashtu edhe rritja e ndërgjegjësimit mbi konceptet e MFK-së në njësitë publike, nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me punonjësit e DH/MFK.

Gjatë muajit prill të vitit 2018, janë realizuar monitorime në 20 institucione (ministri, bashki dhe institucione të pavarura), të cilat janë përzgjedhur sipas procedurës të përshkruar më poshtë:

- Ndahen njësitë publike në grupe duke u bazuar tek ndarja e detyrave brenda DH/MFK (njësitë qendrore, institucionet e pavarura, bashkitë)
- Llogaritet numri i njësive publike që do të monitorohen nga çdo punonjës i DH/MFK, duke ndarë ditët e punës në dispozicion për një vit të caktuar që DH/MFK ka planifikuar të shpenzojë për vizitat në terren, si dhe duke u nisur nga kohëzgjatja e një vizite në terren.
- Zgjidhen njësitë publike mbi bazën e rezultatit të përgjithshëm të vetë-vlerësimit duke përdorur përqindjen e mëposhtme: 50% njësi publike nga grupi i "performuesve të dobët", 25% nga "performuesit mesatar", 25% nga "performuesit e mirë". Këto përqindje mund të ndryshojnë me kalimin e kohës.

Konkretisht, nga monitorimet e zhvilluara kanë rezultur gjetjet e mëposhtme sipas 3 kategorive të institucioneve.

✓ Ministritë e Linjës

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Gjatë monitorimit të realizuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë u evidentua që ky institucion duhet të rrisë shkallën e përgjegjshmërisë për implementimin e kërkesave të kontrollit. Rezultatet e monitorimit janë si më poshtë vijon:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë zhvillon aktivitetin e vet bazuar në strategjinë e përgjithshme të financave publike si dhe në strategjitë sektoriale, mbi këtë bazë çdo strukturë e ministrisë harton, realizon dhe monitoron objektivat vjetore. Në programin buxhetor afatmesëm miratohen çdo vit minisioni dhe politikat e ministrisë.
- Rregullorja e brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Financave " është miratuar me Urdhërin nr, 178, datë 29.01.2016. Kjo rregullore duhet të jetë

objekti i rishikimit për tju përshtatur ndryshime të reja strukturore dhe funksionale të institucionit, bazuar në Urdhërin nr. 161, datë 5.10.2017 të Kryeministrit, për miratimin e strukturës së re të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

- Sistemi për menaxhimin e risqeve nuk ka qënë funksional për vitin 2017, mbasi nuk u paraqit dokumenti i regjistrit të risqeve për të gjithë institucionin, megjithëse regjistra të riqeve të disa drejtorive të ndryshme ekzistonin, por jo dokumenti i konsoliduar. Theksojmë se ky proces në vitet e mëparshme ka funksionuar duke u finalizuar me miratimin e regjistrit dhe raportit te risqeve nga niveli i lartë menaxhues.
- Bazuar në Urdhërin nr. 120, datë 9.12.2016 të Ministrit të Financave, të gjitha strukturat e ministrisë dhe njësitë vartëse të saj hartuan manualet e proceseve të punës për të gjitha proceset kryesore të punës. Këto dokumenta u depozituan në drejtorinë e burimeve njerëzore.
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" dhe nuk ka ndonjë udhëzim specifik si dhe në një urdhër të brendshëm mbi kryerjen e inventarizimit të aktiveve dhe detyrimeve;

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Gjatë monitorimit të realizuar në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme u evidentua që ky institucion duhet të rrisë shkallën e përgjegjshmërisë për implementimin e kërkesave të kontrollit. Rezultatet e monitorimit janë si më poshtë vijon:

- Struktura e institucionit është miratuar nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrisë nr. 159, datë 05.10.2017 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme";
- Rregullorja për disiplinën dhe qarkullimin e brendshëm në godinën e institucionit është miratuar në prill të vitit 2017, por gjykojmë që është e nevojshme rishikimi i kësaj rregulloreje për t'u përshtatur me strukturën e re të miratuar në tetor të vitit 2017;
- Misioni i këtij institucioni është paraqitur në dokumentin e Projektbuxhetit Afatmesëm.
- Prioritetet e institucionit janë të paraqitura në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020;
- Institucioni ka VKM-në nr. 816, datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullores së shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë" si dhe Urdhrin nr. 80, datë 08.02.2018 "Për miratimin e skemës së indeksimit dhe ekspertizës së dokumentave në MEPJ";
- Është miratuar një manual konsullor, në ndihmë të shërbimit konsullor të Republikës së Shqipërisë;
- Ekzistojnë përshkrimet e punës për çdo punonjës si edhe kryhen vlerësimet periodike.
- Nuk janë ndërtuar hartat e proceseve të punës;
- Nuk janë ndërtuar gjurmët e auditimit;
- Nuk kishte manual të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;
- Regjistri i riskut ishte përgatitur nga çdo drejtori dhe ishte konsoliduar në një dokument të vetëm;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" si dhe në një urdhër të brendshëm mbi kryerjen e inventarizimit të aktiveve dhe detyrimeve;
- Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të brendshëm të titullarit.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Gjatë monitorimit të kryer në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, rezultoi një ndërgjegjësim i lartë mbi kontrollin e brendshëm nga ana e nivelit drejtues të këtij institucioni si dhe stafit të tij. Kjo vjen si rrjedhojë e përfshirjes së kësaj ministrie në cilësinë e institucionit pilot gjatë Projektit të Binjakëzimit "Implementimi i një Sistemi Modern për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Inspektimin Financiar Publik në Shqipëri", i financuar nga fondet IPA 2012, zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të Austrisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Francës.
Në varësi të kërkesave dhe instrumenteve bazë të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, përfundimet e arritura vijojnë si më poshtë:

- Misioni i këtij institucioni është paraqitur në dokumentin e Projektbuxhetit Afatmesëm;
- Prioritetet e institucionit janë të paraqitura në Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, për periudhën 2014–2020 (Vendimi nr. 11, datë 11.1.2016) dhe Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022 (Vendimi nr. 710, datë 01.12.2017);
- Të gjithë menaxherët dhe institucionet e varësisë informohen nëpërmjet komunikimit shkresor për përmbajtjen e deklaratës së misionit dhe objektivat e përcaktuara;
- Struktura e institucionit është miratuar nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit nr. 173, datë 10.10.2017, datë "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë";
- Rregullorja e brendshme është miratuar me shkresën nr. 2457, datë 09.03.2017, por gjykojmë që është e nevojshme rishikimi i kësaj rregulloreje për t'u përshtatur me strukturën e re të miratuar në fund të vitit 2017;
- Plani vjetor i punës, sipas formateve të përcaktuara, është hartuar dhe zbatohet vetëm nga disa drejtori ndërkohë që është i nevojshëm hartimi i tij nga të gjitha drejtoritë dhe miratimi i këtij plani nga nëpunësi autorizues;
- Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të brendshëm të titullarit nr. 135, datë 24.03.2017 dhe mbledhjet e këtij grupi dokumentohen me minuta takimi;
- Ekzistojnë përshkrimet e punës për çdo punonjës si edhe kryhen vlerësimet periodike;
- Gjatë vitit 2017, është hartuar një draft i Strategjisë së Riskut i cili nuk është miratuar nga Titullari;
- Regjistri i riskut ishte përgatitur nga çdo drejtori dhe ishte konsoliduar në një dokument të vetëm;
- Hartat e proceseve të punës dhe manuali i proceseve të punës janë hartuar vetëm për disa drejtori ndërkohë që po punohet për hartimin e tyre edhe nga drejtoritë e tjera duke bërë përditësimet e nevojshme në bazë të strukturës së re të miratuar;
- Gjurmët e auditimit janë hartuar për procesin e Projektbuxhetit Afatmesëm dhe Buxhetit Vjetor;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike";
- Ky institucion ka një sistem komunikimi mjaft efektiv. Në të gjitha rastet titullarët informohen me memo, ndërsa me institucionet e vartësisë informimi dhe komunikimi realizohet me anë të kanaleve elektronike të komunikimit (e-mail) dhe shkresave zyrtare.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Gjatë monitorimit të realizuar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural u evidentua që ky institucion duhet të rrisë shkallën e përgjegjshmërisë për implementimin e kërkesave të kontrollit të brendshëm. Rezultatet e monitorimit janë si më poshtë vijon:

- Struktura e re e institucionit është miratuar;

- Rregullorja e brendshme e institucionit është e miratuar në përputhje me strukturën e vitit 2017 dhe ndërkohë institucioni ka ndërtuar një draft rregullore të re për vitin 2018 (për të reflektuar ndryshimet strukturore) dhe pritet miratimi i saj;
- Prioritetet e institucionit janë të paraqitura në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, 2014-2020;
- Ekzistojnë përshkrimet e punës për çdo punonjës si edhe kryhen vlerësimet periodike;
- Janë ndërtuar plane vjetore të punës për secilën drejtori dhe janë miratuar nga Nëpunësi Autorizues;
- Nuk janë ndërtuar hartat e proceseve të punës;
- Nuk janë ndërtuar gjurmët e auditimit;
- Nuk janë ndërtuar manuale të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;
- Regjistri i riskut është përgatitur nga çdo drejtori por nuk ishte i konsoliduar në një dokument të vetëm të miratuar;
- Nuk është ndërtuar një strategji për menaxhimin e riskut;
- Koordinatori i Riskut dhe Koordinatori i MFK, nuk është deleguar me urdhër të miratuar nga Nëpunësi Autorizues sipas kërkesave të ligjit të MFK;
- Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të brendshëm të titullarit, por në këtë grup nuk ka asnjë evidencë që në të të jenë diskutar çështje të menaxhimit financair dhe të kontrollit;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" dhe gjithashtu është ndërtuar edhe udhëzim specifik për menaxhimin e aktiveve brenda ministrisë;

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Gjatë monitorimit të kryer në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, evidentohet fakti se ky institucion duhet të rrisë shkallën e përgjegjshmërisë ndaj implementimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Në varësi të kërkesave dhe instrumenteve bazë të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, përfundimet e arritura vijojnë si më poshtë:

- Misioni i këtij institucioni është paraqitur në dokumentin e Projektbuxhetit Afatmesëm si dhe në VKM për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- Struktura e institucionit është miratuar nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit nr. 165, datë 05.10.2017, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit";
- Rregullorja e brendshme e institucionit është miratuar në fillim të vitit 2016. Për shkak të ristrukturimit, intitucioni është në fazën miratuese të rregullores së re;
- Është pozitiv fakti që për vitin 2017 nuk ka raportim të shkeljes së etikës;
- Gjatë vitit 2017 ka pasur delegim në mungesë të funksioneve të Sekretarit të Përgjithshëm bazuar në Kodin e Procedurave Administrative;
- Nuk ka një regjistër risku të konsoliduar për të gjithë institucionin;
- Nuk janë ndërtuar hartat e proceseve të punës;
- Nuk janë ndërtuar gjurmët e auditimit;
- Nuk ka manual të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" dhe nuk ka ndonjë udhëzim specifik.
- Për sa i përket sistemit të informimit dhe komunikimit, në të gjitha rastet titullarët informohen me memo. Ndërsa me institucionet e vartësisë informimi dhe komunikimi

realizohet me anë të kanaleve elektronike të komunikimit (e-mail) dhe shkresave zyrtare.

✓ **Bashkitë**

Bashkia Durrës

Gjatë monitorimit të kryer në Bashkinë Durrës evidentohet fakti se ky institucion duhet të rrisë më tej shkallën e përgjegjshmërisë ndaj implementimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Më konkretisht mund të evidencojmë informacionin e mëposhtëm:

- Bashkia Durrës ka një Strategji të zhvillimit të territorit, në të cilën ka evidentuar objektivat dhe prioritetet e bashkisë;
- Struktura organizative e institucionit është miratuar me vendim të kryetarit të bashkisë;
- Rregullorja e brendshme e institucionit mbi funksionimin, organizimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së bashkisë është miratuar me një vendim të kryetari të bashkisë për vitin 2017 në përputhje me strukturën e vitit 2017;
- Delegimi i detyrave funksionon si në mungesë bazuar në Kodin e Proçedurave administrative dhe në detyrë, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.
- Në institucion ekzistojnë përshkrimet e punës dhe vlerësimet e punës;
- Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të brendshëm të titullarit si dhe janë mbajtur minuta takimi gjatë realizimit të mbledhjeve të GMS-së;por në to nuk evidentohet trajtimi i ndonjë çështjeje që lidhet me MFK;
- Regjistri i riskut është hartuar vetëm nga drejtoria e financës, dhe nuk është i konsoliduar dhe miratuar nga ana e titullarit si një i vetëm;
- Nuk është ndërtuar një strategji për menaxhimin e riskut;
- Janë të ndërtuara planet vjetore të punës të mbështetura në objektivat e përcaktuara dhe janë miratuara nga titullari për vitn 2017;
- Nuk janë ndërtuar hartat e proceseve të punës;
- Nuk janë ndërtuar gjurmët e auditimit;
- Nuk janë ndërtuar manual të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" dhe nuk ka ndonjë udhëzim specifik.
- Sistemi i komunikimit dhe informimit në Bashkinë Durrës vlerësohet pozitivisht. Në të gjitha rastet, titullari informohet me memo ose nëpërmjet raporteve të ndryshme të prodhuara nga drejtoritë përkatëse. Nga ana e bashkisë administrihen sisteme IT për të cilat ka edhe sistem back-up.

Bashkia Elbasan

Gjatë monitorimit të realizuar në Bashkinë Elbasan u evidentua që ky institucion ka një ndërgjegjësim të lartë mbi kontrollin e brendshëm nga ana e menaxherëve të lartë të këtij institucioni dhe stafit të tij për implementimin e kërkesave të kontrollit. Rezultatet e monitorimit janë si më poshtë vijon:

- Bashkia Elbasan ka një strategji të zhvillimit të territorit, në të cilën ka evidentuar objektivat dhe prioritetet e bashkisë;
- Bashkia Elbasan ka hartuar dhe miratuar rregullore specifike të brendshme për njësitë e saj të varësisë. Gjithashtu, është hartuar dhe miratuar rregullorja e brendshme e vetë

institucionit, e cila përmban të gjitha procedurat dhe rregullat mbi funksionimin e institucionin, kodin e etikës, të komunikimin kompetencat dhe detyrat e administratës.
- Është hartuar plani vjetor i punës për çdo drejtori, por sugjerojmë konsolidimin e tij në një dokument të vetëm dhe të miratuar nga titullari;
- Është miratuar struktura organizative e bashkisë Elbasan, në të cilën specifikohen pozicionet dhe niveli i pagës;
- Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik nëpërmjet një Urdhri të kryetarit të bashkisë;
- Delegimi i detyrave funksionon vetëm në mungesë bazuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe në detyrë, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.
- Janë hartuar hartat e proceseve të punës për disa procese kryesore të drejtorisë së financës;
- Nuk kishte manual të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;
- Nuk janë ndërtuar gjurmët e auditimit;
- Bashkia ka njësi auditimi, e cila ka ndërmarrë angazhim auditimi për vitin 2017;
- Regjistri i riskut ishtë përgatitur nga çdo drejtori dhe ishte konsoliduar në një dokument të vetëm, por sugjerojmë miratimin e tij nga ana e kryetarit;
- Është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut të bashkisë Elbasan;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" dhe nuk ka ndonjë udhëzim specifik.

Bashkia Gjirokastër

Gjatë monitorimit në Bashkinë Gjirokastër rezultoi një ndërgjegjësim i lartë mbi kontrollin e brendshëm nga ana e menaxherëve të lartë të këtij institucioni dhe stafit të tij. Rezultatet e monitorimit në vend të këtij institucioni janë si më poshtë vijon:
- Institucioni ka hartuar një strategji të zhvillimit të turizmit të qytetit të Gjirokastër së bashku me planin e veprimit për periudhën kohore 2011-2021. Gjithashtu, bashkia ka miratuar dhe planin e përgjithshëm vendor, nëpërmjet një vendimi të kryetarit të bashkisë;
- Plani vjetor i punës për vitin 2017 është hartuar vetëm për drejtorinë e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar, ndaj sugjerojmë hartimin dhe konsolidimin e këtij plani për të gjitha drejtoritë e bashkisë;
- Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik nëpërmjet një urdhri të brendshëm të kryetarit të bashkisë si dhe janë mbajtur minuta takimi gjatë mbledhjes së zhvilluar në vitin 2017;
- Struktura organizative e institucionit është e miratuar për vitin 2017;
- Ekzistojnë përshkrimet e punës për çdo punonjës si edhe kryhen vlerësimet periodike;
- Rregullorja e brendshme e këtij institucioni mbi organizimin, funksionimin dhe detyrat e administratës së bashkisë është miratuar në vitin 2016, nëpërmjet një vendimi të kryetarit të bashkisë si dhe është miratuar një rregullore e pjesshme specifike për organizimin, funksionimin dhe detyrat në drejtorinë e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar nërpërmjet një urdhri të nxjerrë në vitin 2017; .
- Delegimi i detyrave funksionon në mungesë bazuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe në detyrë, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar;
- Regjistri i riskut ishtë përgatitur vetëm nga drejtoria e financës, ndaj sugjerojmë përgatitjen e tijj nga çdo drejtori si dhe konsolidimin dhe miratimin nga kryetari në një dokument të vetëm;
- Nuk janë ndërtuar hartat e proceseve të punës;
- Nuk janë ndërtuar gjurmët e auditimit;
- Nuk kishte manual të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;

- Ky institucion nuk ka përgatitur strategjinë e menaxhimit të riskut të konsoliduar;
- Bashkia ka njësi auditimi, e cila ka ndërmarrë angazhim auditimi për vitin 2017;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" si dhe mbi një rregullore specifike të miratuar nga kryetari i bashkisë.

Bashkia Krujë

Gjatë monitorimit të kryer në Bashkinë Krujë evidentohet fakti se ky institucion duhet të rrisë më tej shkallën e përgjegjshmërisë ndaj implementimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Më konkretisht mund të evidencojmë informacionin e mëposhtëm:

- Bashkia Krujë ka një strategji të zhvillimit të territorit, në të cilën ka evidentuar objektivat dhe prioritetet e bashkisë;
- Rregullorja e brendshme e institucionit mbi funksionimin, organizimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së bashkisë është miratuar me një vendim të kryetarit të bashkisë;
- Struktura organizative e institucionit është miratuar me vendim të kryetarit të bashkisë;
- Delegimi i detyrave funksionon si në mungesë bazuar në Kodin e Proçedurave administrative dhe në detyrë, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.
- Në institucion ekzistojnë përshkrimet e punës dhe vlerësimet e punës;
- Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të brendshëm të titullarit si dhe janë mbajtur minuta takimi gjatë realizimit të mbledhjeve të GMS-së;
- Koordinatori i MFK-së është përcaktuar dhe deleguar tek përgjegjësi i sektorti të financës;
- Regjistri i riskut është hartuar nga drejtoritë brenda bashkisë, por nuk është i konsoliduar dhe miratuar nga ana e titullarit;
- Nuk janë ndërtuar hartat e proceseve të punës;
- Nuk janë ndërtuar gjurmët e auditimit;
- Nuk kishte manual të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;
- Institucioni ka miratuar një strategji të menaxhimit të riskut nëpërmjet një vendimi të këshillit bashkiak;
- Institucioni ka hartuar dhe miratuar një plan trajnimesh për stafin e bashkisë, në varësi të nevojave të tyre specifike;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" dhe nuk ka ndonjë udhëzim specifik.
- Sistemi i komunikimit dhe informimit në Bashkinë Krujë vlerësohet pozitiv. Në të gjitha rastet, titullari informohet me memo ose nëpërmjet raporteve të ndryshme të prodhuara nga drejtoritë përkatëse. Ndërsa me institucionet e vartësisë informimi dhe komunikimi realizohet me anë të kanaleve elektronike të komunikimit (e-mail) dhe shkresave zyrtare.

Bashkia Pogradec

Gjatë monitorimit të realizuar në Bashkinë Pogradec konkludojmë se ky institucion duhet të rrisë shkallën e përgjegjshmërisë për implementimin e kërkesave të kontrollit të brendshëm duke marrë në konsideratë faktin e asistencës direkte të ofruar nga ekspertët e huaj të projektit të binjakëzimit. Gjatë monitorimit të kryer, rezultoi se:

- Institucioni ka një strategji të miratuar me objektivat kryesorë;
- Me urdhër të kryetarit është miratuar rregullorja e brendshme e bashkisë;
- Delegimi kryhet sipas legjislacionit në fuqi ku kryetari i bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues ka deleguar funksionet e tij tek nënkryetari;

- Ekzistojnë përshkrimet e punës dhe vlerësimet e punës për stafin e bashkisë;
- Është ngritur Grupi i menaxhimit Strategjik por gjatë takimeve nuk diskutohen çështje që lidhen me MFK;
- Regjistri i riskut është hartuar vetëm për Drejtorinë e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare ndërkohë që çdo drejtori duhet të hartojë regjistrin e riskut dhe duhet të konsolidohen në një dokument të vetëm i cili miratohet nga nëpunësi autorizues;
- Hartat e proceseve të punës janë ndërtuar vetëm për disa procese;
- Nuk ka manuale të proceseve të punës;
- Nuk janë ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës;
- Sistemi i komunikimit rezulton të jetë efektiv. Titullari informohet nëpërmjet raporteve të ndryshme mbi ecurinë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" dhe nuk ka ndonjë udhëzim specifik.

Bashkia Devoll

Gjatë monitorimit të kryer në Bashkinë Devoll, rezulton se ky institucion duhet të rrisë shkallën e përgjegjshmërisë ndaj implementimit të sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe ofrimin e asistencës për stafin e tij. Rezultatet e monitorimit janë si më poshtë vijon:

- Institucioni ka një rregullore të brendshme të miratuar me urdhër të titullarit;
- Janë evidentuar rreth 40 raste të shkeljes së etikës të cilat janë trajtuar në mënyrën e duhur;
- Institucioni nuk ka një plan vjetor pune të miratuar;
- Ekzistojnë përshkrimet e punës dhe vlerësimet e punës për stafin e bashkisë;
- Struktura organizative për vitin 2017 është e miratuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë;
- Është ngritur me urdhër të kryetarit, grupi i menaxhimit strategjik ku mbledhjet dokumentohen me minuta takimi;
- Delegimi i funksioneve realizohet në përputhje me ligjin e MFK ku Kryetari i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues ka deleguar funksionet e tij tek Nënkryetari;
- Është caktuar koordinatori i deleguar i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatori i riskut i cili është punonjës pjesë e strukturës së financës;
- Në vitin 2017, është miratuar një urdhër i veçantë për funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut në Bashkinë Devoll;
- Nuk ka një strategji risku ndërkohë që është hartuar dhe miratuar regjistri i rikut i konsoliduar;
- Nuk janë ndërtuar hartat e proceseve të punës;
- Nuk janë ndërtuar manualet e proceseve të punës sipas formatit të përcaktuar nga DH/MFK;
- Nuk janë ndërtuar gjurmët e auditimit;
- Është hartuar analiza vjetore e punës dhe janë përcaktuar objektivat për vitin 2018 vetëm për sektorin e menaxhimit financiar, ndërkohë që ky proces duhet të realizohet nga të gjitha strukturat brenda bashkisë.

Bashkia Shijak

Gjatë monitorimit të realizuar në Bashkinë Shijak u evidentua që ky institucion ka një ndërgjegjësim të lartë mbi kontrollin e brendshëm nga ana e menaxherëve të lartë të këtij institucioni dhe stafit të tij për implementimin e kërkesave të kontrollit, vetëm se implementimi

i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit është në nivelet fillestare. Rezultatet e monitorimit janë si më poshtë vijon:

- Bashkia Shijak mbështetet tek Srategjia e Zhvillimit të Territorit, në të cilën ka evidentuar objektivat dhe prioritetet e bashkisë;
- Ky institucion ka hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme, e cila përmban të gjitha procedurat dhe rregullat mbi funksionimin e institucionin, kodin e etikës, të komunikimin kompetencat dhe detyrat e administratës, por është e miratuar në 2016, si rrjedhojë kjo rregullore duhet të përshtatët me strukturën e re të këtij institucioni;
- Nuk ka të hartuar planin vjetor të punës për çdo drejtori;
- Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik nëpërmjet një Urdhri të kryetarit të bashkisë, por në të nuk evidentohet i dokumentuar trajtimi i çështjeve të lidhura me MFK;
- Delegimi i detyrave funksionon vetëm në mungesë bazuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe në detyrë, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.
- Koordinatori i Riskut është deleguar me urdhër të miratuar nga Nëpunësi Autorizues sipas kërkesave të ligjit të MFK;
- Nuk janë ndërtuar hartat e proceseve të punës;
- Nuk janë ndërtuar manuale të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;
- Nuk janë ndërtuar gjurmët e auditimit;
- Nuk është ndërtuar një regjistër riskut nga çdo drejtori;
- Nuk është ndërtuar një strategji për menaxhimin e risqeve;
- Koordinatoi i riskut ishte deleguar si funksion nga ana e kryetarit të bashkisë;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" dhe nuk ka ndonjë udhëzim specifik.

Bashkia Libohovë

Gjatë monitorimit të kryer në Bashkinë Libohovë, rezultoi se institucioni ka nevojë për rritje të nivelit të ndërgjegjësimit për menaxherët e nivelit të lartë mbi kontrollin e brendshëm si dhe ofrimin e asistencës për stafin e tij. Në varësi të kërkesave dhe instrumenteve bazë të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, përfundimet e arritura vijojnë si më poshtë:

- Prioritetet dhe aktivitetet e institucionit janë pasqyruar vetëm në dokumentin e PBA-së;
- Rregullorja e brendshme e këtij institucioni mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së bashkisë Libohovë është miratuar në vitin 2016 nga kryetari i bashkisë;
- Struktura organizative e institucionit është e miratuar për vitin 2017;
- Delegimi i detyrave funksionon në mungesë, bazuar në Kodin e Proçedurave Administrative;
- Plani vjetor i punës për vitin 2017 nuk është përgatitur dhe miratuar;
- Ekzistojnë përshkrimet e punës për çdo punonjës si edhe kryhen vlerësimet periodike;
- Eshtë ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të kryetarit të bashkisë;
- Nuk janë ndërtuar hartat e proceseve të punës;
- Nuk janë ndërtuar gjurmët e auditimit;
- Nuk kishte manual të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;
- Nuk është hartuar regjistri i riskut i konsoliduar i institucionit;
- Ky institucion nuk ka përgatitur strategjinë e menaxhimit të riskut të konsoliduar;
- Sistemi i komunikimit dhe informimit në Bashkinë Libohovë vlerësohet pozitiv. Në të gjitha rastet, titullari informohet me memo ose nëpërmjet raporteve të ndryshme të prodhuara nga drejtoritë përkatëse.

- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" dhe nuk ka ndonjë udhëzim specifik.

Bashkia Cërrik

Gjatë monitorimit në Bashkinë Cërrik rezultoi një ndërgjegjësim i lartë mbi kontrollin e brendshëm nga ana e menaxherëve të lartë të këtij institucioni dhe stafit të tij. Rezultatet e monitorimit në vend të këtij institucioni janë si më poshtë vijon:

- Plani vjetor i punës për vitin 2017 është miratuar.
- Rregullorja e brendshme e këtij institucioni mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së bashkisë dhe njësive administrative është miratuar në vitin 2017, nëpërmjet një vendimi të kryetarit të bashkisë.
- Struktura organizative e institucionit është e miratuar për vitin 2017 si dhe vitin 2018.
- Bashkia Cërrik ka përgatitur një strategji të zhvillimit të bashkisë, që përmban të gjitha prioritetet dhe aktivitetet e institucionit;
- Koordinatori i MFK-së është përcaktuar dhe deleguar tek drejtori i përgjithshëm i menaxhimit financiar, burimeve njerëzore dhe shërbimeve ligjore;
- Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik nëpërmjet një urdhri të brendshëm të kryetarit të bashkisë;
- Regjistri i riskut ishtë përgatitur nga çdo drejtori dhe ishte konsoliduar dhe miratuar nga kryetari në një dokument të vetëm.
- Ky institucion ka përgatitur dhe miratuar nga kryetari strategjinë e menaxhimit të riskut të konsoliduar.
- Janë hartuar dhe miratuar hartat e proceseve të punës për disa procese kryesore të drejtorisë së financës dhe drejtorisë së burimeve njerëzore;
- Nuk kishte manual të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;
- Nuk janë ndërtuar gjurmët e auditimit;
- Bashkia ka njësi auditimi, e cila ka ndërmarrë angazhim auditimi për vitin 2017;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" si dhe mbi një rregullore specifike të miratuar nga kryetari i bashkisë;

Bashkia Peqin

Gjatë monitorimit të kryer në Bashkinë Peqin, rezultoi se institucioni ka nevojë për rritje të nivelit të ndërgjegjësimit për menaxherët e nivelit të lartë mbi kontrollin e brendshëm si dhe ofrimin e asistencës për stafin e tij. Në varësi të kërkesave dhe instrumenteve bazë të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, përfundimet e arritura vijojnë si më poshtë:

- Plani vjetor i punës për vitin 2017 është miratuar dhe përfshin dhe njësitë e varësisë së bashkisë;
- Struktura organizative e institucionit është e miratuar për vitin 2017;
- Rregullorja e brendshme e këtij institucioni mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së bashkisë Peqin është miratuar për vitin 2017 nëpërmjet një vendimi të kryetarit të bashkisë;
- Delegimi i detyrave funksionon në mungesë, bazuar në Kodin e Proçedurave Administrative;
- Ekzistojnë përshkrimet e punës për çdo punonjës si edhe kryhen vlerësimet periodike;
- Nuk janë ndërtuar hartat e proceseve të punës;
- Nuk janë ndërtuar gjurmët e auditimit;
- Nuk kishte manual të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;
- Nuk është hartuar regjistri i riskut i konsoliduar i institucionit;
- Ky institucion nuk ka përgatitur strategjinë e menaxhimit të riskut të konsoliduar;

- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" dhe nuk ka ndonjë udhëzim specifik.

Bashkia Kamëz

Gjatë monitorimit në Bashkinë Kamëz rezultoi një ndërgjegjësim i lartë mbi kontrollin e brendshëm nga ana e menaxherëve të lartë të këtij institucioni dhe stafit të tij. Rezultatet e monitorimit në vend të këtij institucioni janë si më poshtë vijon:

- Vizioni i kësaj bashkie është paraqitur në Buletinin Vjetor 2017 të bashkisë;
- Prioritetet dhe aktivitetet e institucionit janë pasqyruar në Planin Operacional të Zhvillimit Vendor (POZHL), i cili është përgatitur në shkurt të vitit 2016
- Plani vjetor i punës për vitin 2017 është përgatitur dhe miratuar nga çdo drejtori e bashkisë Kamëz;
- Rregullorja e brendshme e këtij institucioni mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të bashkisë është miratuar në vitin 2016, nëpërmjet një vendimi të këshillit bashkiak, ndaj sugjerojmë përshtatjen e tij dhe me ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit 2017;
- Struktura organizative e institucionit është e miratuar për vitin 2017 si dhe vitin 2018;
- Në institucion nuk ka raste të delegimit sipas ligjit të MFK-së si dhe funksioni i koordinatorit të riskut dhe MFK-së nuk është deleguar;
- Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik nëpërmjet një urdhri të brendshëm të kryetarit të bashkisë si dhë është përgatitur një plan punë me aktivitetet që duhet të zhvillojë grupi;
- Regjistri i riskut ishtë përgatitur nga çdo drejtori dhe ishte konsoliduar dhe miratuar nga kryetari në një dokument të vetëm.
- Institucioni ka hartuar një strategji të menaxhimit të riskut;
- Janë hartuar dhe miratuar harta procese punë për disa procese kryesore të bashkisë Kamëz;
- Ekzistojnë përshkrimet e punës për çdo punonjës si edhe kryhen vlerësimet periodike
- Nuk kishte manual të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;
- Bashkia ka njësi auditimi, e cila ka ndërmarrë angazhim auditimi për vitin 2017;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" si dhe nuk ka rregullore specifike të miratuar nga kryetari i bashkisë;
- Në bashkinë Kamëz është ngritur një grup pune, nëpërmjet një urdhri të brendshëm të kryetarit të bashkisë, për hartimin e dokumentacionit në lidhje me elementët e MFK-së për vitin 2017.

✓ Institucionet e Pavarura

Kontrolli i Lartë i Shtetit

Nga monitorimi që u krye në ketë institucion u evidentua se niveli i lartë menaxherial dhe stafi I institucionit i ka vlerësuar maksimalisht kërkesat e ligjit të MFK. Rezultatet e monitorimit në vend të këtij institucioni janë si më poshtë vijon:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit e zhvillon aktivitetin e vet duke u mbështetur në strategjinë për menaxhim dhe zhvillim për 2013- 2017 në të cilin janë evidentuar objektivat strategjike të këtij institucioni. Objektivat vjetore dhe operacionale kanë qëne fokusi i punës së institucionit dhe monitorimit të tij në vazhdimësi e evidentuar dhe në raportet vjetore të monitorimit të Strategjisë.

- Përveç Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të KLSH, i cili për vitin 2018 sipas planit të zhvillimit të MFK do të rishikohet duke reflektuar ndryshimet strukturore të institucionit si dhe instalimin e një sistemi të ri informatik të proceseve të auditimit dhe atyre administrative, është miratuar dhe kuadri rregullor per etikën dhe integritetin si dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e kodit të etikës në institucion.
- Me Urdhërin në 219 datë 31.12.2017 eshtë miratuar rregullorja e brendshme e posaçme për procedurat e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit, mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes nga hakmarrja ne KLSH si dhe struktura përkatëse për ndjekjen e këtij procesi.
- Në KLSH është ngritur dhe funksionon sistemi i menaxhimit të riskut. Eshtë miratuar strategjia e Menaxhimit të Riskut me Vendim të Kryetarit nr, 42 datë 30.03.2015. Për vitin 2017 nga institucioni ishte përgatitur materiali i plotë që lidhet me menaxhimin e risqeve, që përfshin:
  - Urdhërin nr,11 datë 16.01.2017 mbi përgatitjen e regjistrit të risqeve për KLSH.
  - Vendimi për miratimin e regjistrit të risqeve nga GMS.
  - Raporti Monitorimit të Strategjisë për Menaxhimin e Riskut.

- Me Vendimin e kryetarit të KLSH-së nr 144 datë 13.12.2016 KLSH "Për miratimin e Gjurmëve të Auditimit në KLSH" në përputhje me zbatimin e kërkesave të kuadrit rregullator janë miratuar dokumenti i gjurmeve te auditimit dhe lista e proceseve te punes për proceset më kryesore të punës së institucionit (për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit, për prokurimet me vlerë të lartë dhe të vogël si dhe për menaxhimin e aktivete)
- Në KlSh është instaluar e një sistem informacioni për menaxhimin dhe mbështetjen e proceseve të auditimit dhe atyre mbështetëse administrative, nëpërmjet të cilit sigurohet ndër të tjera përmirësimi i performancës, produktivitetit dhe efiçencës operacionale të brendshme,përmirësimi dhe garantimi i transparencës dhe monitorimit të aktivitetit të KLSH-se në zbatim të objektivave.
- Vlen të theksohet se për çdo mbledhje të GMS është mbajtur protokolli i mbledhjeve dhe në këto mbledhje janë diskutuar dhe çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin. fokusi i mbledhjeve nuk janë vetëm

Avokati i Popullit

Gjatë monitorimit të institucionit të Avokatit të Popullit evidentohet fakti se ky institucion ka bërë progres përsa i përket implementimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Rezultatet e monitorimit janë si më poshtë vijon:

- Avokati i Popullit ka një plan strategjik, në të cilin përfshihen objektivat dhe prioritetet e tij, të cilat duhet të përshtaten dhe për vitin 2017;
- Institucioni ka një Kod të sjelljes së mirë administrative, të miratuar me urdhër të brendshëm nga titullari;
- Institucioni ka një Rregullore "Për parandalimin e konfliktit të interesave të punonjësve të institucionit të Avokatit të Popullit", të miratuar me urdhër të brendshëm;
- Struktura e institucionit është e miratuar për vitin 2017, nëpërmejt një urdhri të brendshëm;
- Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit është e miratuar;
- Koordinatori i Riskut është deleguar me urdhër të miratuar nga Nëpunësi Autorizues sipas kërkesave të ligjit të MFK;

- Delegimi i detyrave sipas ligjit të MFK-së funksionon;
- GMS funksionon dhe ka diskutuar në mbledhjet e veta çështje që lidhen me MFK.
- Institucioni ka një urhdër të brendshëm mbi rritjen e aftësive profesionale dhe trajnimin e punonjësve të institucionit të Avokatit të Popullit;
- Në institucion ekzistojnë përshkrimet e punës dhe vlerësimet e punës;
- Institucioni ka hartuar një format regjistri risku, i cili nuk është ai i rekomanduar nga Minsitria e Financave dhe Ekonomisë si dhe sugjerojmë konsolidimin e regjistrit të riskut për të gjitha drejtoritë e institucionit në një dokument të vetëm, të miratuar nga titualli;
- Është miratuar Strategjia e menaxhimit të riskut të institucionit, nëpërmjet një urdhri të brendshëm;
- Nuk janë ndërtuar hartat e proceseve të punës;
- Nuk janë ndërtuar gjurmët e auditimit;
- Nuk kishte manual të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në një regullore specifike "Për rregullat dhe procedurat për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të institucionit të Avokatit të Popullit";
- Ka një rregullore, të miratuar me urdhër të brendshëm të titullarit, lidhur me përdorimin e postës elektronike në institucionin e Avokatit të Popullit;
- Ka një urdhër të brendshëm të titullarit lidhur me vlerësimin e kërkesave/ankesave të paraqitura në institucionin e Avokatit të Popullit si dhe afatet për trajtimin e tyre.

Prokuroria e Përgjithshme

Gjatë monitorimit të institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme, evidentohet fakti se ky institucion ka bërë progres përsa i përket implementimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Rezultatet e monitorimit janë si më poshtë vijon:

- Deklarata e misionit është paraqitur në Programin Buxhetor Afatmesëm;
- Objektivat e institucionit janë të përcaktuara në raportin vjetor dhe në Strategjinë Afatmesme 2015-2017;

- Grupi i Menaxhimit Strategjik është ngritur me Urdhër të titullarit të institucionit dhe mbledhjet dokumentohen me minuta takimi;
- Rregullorja e brendshme është miratuar në vitin 2015 me urdhër të titullarit në përputhje me strukturën dhe organikën e institucionit;
- Ekziston nje rregullore e veçantë lidhur me etikën dhe sjelljen e prokurorëve;
- Delegimi i funksioneve kryhet sipas ligjit të MFK dhe Kodit të Procedurave Administrative (në rastin e delegimeve në mungesë);
- Ekzistojnë përshkrimet e punës dhe vlerësimet e punës për punonjësit;
- Është miratuar Strategjia e menaxhimit të riskut dhe regjistri i riskut i konsoliduar për këtë institucion;
- Nuk janë hartuar hartat e proceseve të punës dhe manualet e proceseve të punës sipas formateve të përcaktuara nga DH/MFK;
- Është ndërtuar dhe miratuar gjurmë auditimi për lëvizjen e aktiveve por vetëm në fomë narrative. Në vazhdimësi duhet të ndërtohen gjurmët e auditimit në formë skematike për proceset kryesore të punës;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" dhe nëpërmjet një rregullore specifike të miratuar nga titullari i institucionit;
- Sistemi i komunikimit vlerësohet pozitiv. Titullari informohet nëpërmjet raporteve të ndryshme të gjeneruara nga çdo drejtori;
- Njësia e auditimit të brendshëm jep rekomandime lidhur me përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Autoriteti i Konkurencës

Gjatë monitorimit të Autoriteti të Konkurencës evidentohet fakti se ky institucion ka nevojë për rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe shtrirjen e zbatimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në të gjithë sektorët e kësaj njësie publike, pasi vihet re që vetëm struktura e financës është munduar të zbatojë kërkesat ligjore të MFK. Rezultatet e monitorimit janë si më poshtë vijon:

- Struktura e institucionit është e miratuar për vitin 2017;
- Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Autoritetit të Konkurencës është e miratuar por po rishikohet që të jetë në përputhje me strukturën e re të institucionit;
- Gjithashtu ekzistojnë të miratuara edhe disa rregullore në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe buck up- it të sistemit të IT.
- Koordinatori i Riskut dhe Koordinatori i MFK nuk është deleguar me urdhër të miratuar nga Nëpunësi Autorizues sipas kërkesave të ligjit të MFK;
- Kryesisht realizohet delegim në mungesë dhe jo sipas kërkesave të ligjit të MFK-së;
- GMS është ngritur me urdhër të titullarit por nuk ka diskutuar në mbledhjet e veta çështje që lidhen me MFK;
- Në institucion ekzistojnë përshkrimet e punës dhe vlerësimet e punës;
- Institucioni ka hartuar një regjistri risku, të unifikuar në një dokument të vetëm, të miratuar nga titualli por ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm;
- Gjithashtu është hartuar edhe një strategji menaxhimi risku e cila duhet të përmirësohet dhe të marrë formën e duhur të një strategjie;
- Objektivat përcaktohen në bazë të dokumentit të Politikës Kombëtare të Konkurencës i cili është një dokument strategjik afatmesëm.
- Nuk kanë planet vjetore të mbështetura në objektiva si një dokument i unifikuar por kanë plane mujore pune të miratuara për çdo drejtori;
- Janë ndërtuar disa hartat e procesesh pune por jo të unifikuara për të gjithë institucionin por vetëm për disa procedura tek drejtoria e financës;
- Nuk janë ndërtuar gjurmët e auditimit sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;
- Nuk janë ndërtuar manuale të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK;
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" dhe nuk ka ndonjë udhëzim specifik.

Opinion i Përgjithshëm

Gjatë monitorimeve të realizuara në vend nga stafi i DH/MFK, u evidentua një rritje e ndërgjegjësimit të menaxherëve dhe stafit të njësive publike, mbi rëndësinë e konceptit dhe implementimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Kjo është reflektuar dukshëm në mënyrën e plotësimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit, ku vlerësimi dhe informacioni i përfshirë ishte më afër situatës reale të institucioneve.
Nga analizimi i gjetjeve të monitorimit, përmirësime ka pasur në komponentin e mjedisit të kontrollit, ku shumica e institucioneve kanë ngritur një mjedis kontrolli efektiv me të gjithë elementët përbërës të tij (struktura organizative të miratuara, rregullore të brendshme, sistem të politikave të burimeve njerëzore etj). Problematika janë evidentuar në implementimin e instrumentave specifikë të sistemit të MFK, të tillë si: harta e proceseve të punës, manualet e proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit për proceset kryesore të punës. Lidhur me ngritjen e një sistemi efektiv të menaxhimit të riskut, evidentohet që shumë institucione nuk kanë një regjistër risku të konsoliduar dhe miratuar si dhe ende janë në fazat fillestare të përgatitjes së një strategjie të menaxhimit të riskut.

KAPITULLI IV – VLERËSIMI I SISTEMIT TË MFK NË NJËSITË SHPENZUESE ME BUXHET TË MADH

Në kuadër të rekomandimeve të organizmave ndërkombëtare (SIGMA) si dhe gjithëpërfshirjes së njësive të sektorit publik në procesin e rëndëesishëm të implementimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, Ministria e Financave dhe Ekonomisë përzgjodhi për vlerësim një numër të caktuar njësish varësish, të cilat karakterizohen nga një buxhet i madh. Vlerësimi i sistemit të MFK-së në këto institucione varësie për vitin 2017 (gjithsej 11 institucione) u bazua në pyetësorët e vetëvlerësimit të MFK-së, treguesit e performancës së Drejtorisë së Thesarit (4 tregues) si dhe treguesit e performancës së Drejtorisë së Buxhetit (2 tregues). Gjatë kësaj analize u vlerësuan të pesë komponentët e MFK-së si: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi si dhe monitorimi si dhe gjashtë treguesit e tjerë të thesarit dhe buxhetit, duke rezultuar me 330 pikë maksimale potenciale të mundshme. Në bazë të pikëve të vlerësuara në total për të njëmbëdhjetë komponentët, u përfitua rankimi i mëposhtëm, i paraqitur nëpërmjet tabelës në vijim.

Tabela 9. Rankimi i njësive shpenzuese me buxhet të madh sipas indikatorëve të performancës për vitin 2017

Rankimi	***Institucioni***	***Vlerësimi në pikë për vitin 2017***
1	Shëërbimi Kombëtar i Punësimit	305
2	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural	275
3	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	265
4	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	260
4	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	260
5	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare	255
5	Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza	255
6	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	250
7	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	245
8	Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve	235
9	Autoriteti Rrugor Shqiptar	215

Siç vihet re, institucioni me pikët më të larta është Shërbimi Kombëtar i Punësimit me 305 pikë nga 330 pikë maksimale të mundshme, duke u renditur në këtë mënyrë në vendin e parë, me një realizim performance prej 92%. Më pas, me vlerësimin më të lartë renditet institucioni i Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, etj, të cilët kanë grumbulluar respektivisht 275, 265, 260 dhe 260 pikë. Bazuar në këtë vlerësim, performanca e këtyre institucioneve paraqitet e kënaqshme, pasi nga pikët e marra, rezulton një efektivitet minimal prej 65%, i cili i përket njësisë së varësisë të renditur në vend të fundit, me 215 pikë, Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Një vështrim i përgjithshëm për disa prej treguesve kryesorë të analizuar për këto njësi varësie paraqitet si vijon:

4.1 Analiza për njësitë shpenzuese me buxhet të madh

1. Treguesi i parë i analizuar nga Drejtoria e Thesarit është **"Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar"**, i cili për vitin 2017 është vlerësuar mesatarisht në nivelin 14 pikë nga 30 pikë të mundshme (ose 47%), duke reflektuar një performancë mesatare të tij. Evident është fakti që shumica e këtyre njësive të varësisë kanë një vlerësim mesatar ose

nënmesatar të këtij indikatori (vlerësuar me 15, 10 ose 5 pikë) dhe vetëm Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është vlerësuar me 25 pikë. Institucioni me vlerësimin më të ulët përsa i përkët këtij indikatori, për vitin 2017, është Autoriteti Rrugor Shqiptar, vlerësuar me 5 pikë.

2. Indikatori **"Anulimi i kontratave gjatë një viti"** është vlerësuar mesatarisht me 28 pikë (ose 94%)e nivelit referues. Nga analiza rezulton se shumica e njësive të varësisë janë vlerësuar me 30 pikë, duke reflektuar një performancë shumë të kënaqshme për këtë tregues. Institucioni me vlerësimin më të ulët për këtë indikator është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e vlerësuar me 15 pikë.
3. Për vitit 2017, indikatori **"Urdhër shpenzimet e refuzuara nga ana e Thesarit"** është vlerësuar maksimalisht me 30 pikë, duke evidentuar faktin që të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura.
4. **"Dorëzimi në kohë i kontratave në thesar"** është një tregues shumë i rëndësishëm. Për periudhën analizuese, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 8.2 pikë (ose 27%) të nivelit referues. Ky rezultat paraqitet në nivele shumë të ulëta, duke evidentuar faktin se pothuajse të gjitha njësitë e varësisë të marra në analizë kanë dorëzuar pjesën më të madhe të kontratave me vonesë në thesar, përveç institucionit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, i cili është vlerësuar maksimalisht me 30 pikë.
5. Treguesi **"Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente",** për vitin 2017 pasqyron një performancë shumë të mirë, duke qënë se është vlerësuar mesatarisht me 25 pikë nga 30 pikë të mundshme (ose 83%) të nivelit referues të vlerësimit. Kryesisht, mosrealizimi i shpenzimeve korrekte nga ardhur nga mosrealizimi i fondeve për paga, sigurime, shërbime dhe transferta, etj.
6. Treguesi **"Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale",** evidenton një performancë mesatare për vitin 2017, duke qënë se është vlerësuar mesatarisht me 18.7 pikë. Institucionet me realizimin më të ulët të shpenzimeve kapitale paraqiten: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (vlerësuar me 5 pikë), Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (vlerësuar me 10 pikë), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (vlerësuar me 10 pikë) dhe Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (vlerësuar me 10 pikë).
7. Komponenti i parë i vlerësuar për sistemin e MFK-së është **Mjedisi i Kontrollit**. Për vitin 2017, pikët mesatare të marra nga njësitë e varësisë janë 27.3 pikë nga 30 pikë maksimale të mundshme ose 91 % të nivelit referues të vlerësimit. Performanca e këtyre institucioneve, në lidhje me këtë komponent të sistemit të MFK-së, paraqitet në nivele shumë të kënaqshme, duke qënë se vlerësimi i marrë, sipas pyetësorëve të vetëvlerësimit të analizuara, është 3.5 pikë nga 4 pikë maksimale të mundshme. Pra, shumica e këtyre institucioneve implementojnë në mënyrë efektive elementët e mjedisit të kontrollit, si rregullore, kodin e etikës, politikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, etj.
8. Komponenti i dytë i vlerësuar për sistemin e MFK-së është **Menaxhimi i Riskut**. Për vitin 2017, pikët mesatare të marra nga njësitë e varësisë janë 23.6 pikë nga 30 pikë maksimale të mundshme ose 79 % të nivelit referues të vlerësimit. Performanca e këtyre institucioneve, në lidhje me këtë komponent të sistemit të MFK-së, paraqitet në nivele të kënaqshme, duke qënë se vlerësimi i marrë, sipas pyetësorëve të vetëvlerësimit të analizuara, është 3.2 pikë nga 4 pikë maksimale të mundshme. Pra, sipas analizës së mësipërme, shumica e këtyre institucioneve kanë filluar procesin e ngritjes së sistemit të menaxhimit të riskut në institucionet e tyre.
9. Komponenti i tretë i vlerësuar për sistemin e MFK-së është **Aktivitetet e kontrollit**. Për vitin 2017, pikët mesatare të marra nga njësitë e varësisë janë 25.5 pikë nga 30 pikë maksimale të mundshme ose 85 % të nivelit referues të vlerësimit. Performanca e këtyre institucioneve, në lidhje me këtë komponent të sistemit të MFK-së, paraqitet në nivele shumë të kënaqshme, duke qënë se vlerësimi i marrë, sipas pyetësorëve të vetëvlerësimit të analizuara, është 3.55 pikë nga 4 pikë maksimale të mundshme. Pra, sipas analizës së mësipërme, shumica e këtyre institucioneve implementojnë në mënyrë efektive elementë si: manualet e proceseve të punës, hartat e proceseve të punës, etj.

10. Komponenti i katërt i vlerësuar për sistemin e MFK-së është **Informimi dhe Komunikimi**. Për vitin 2017, pikët mesatare të marra nga njësitë e varësisë janë 28.2 pikë nga 30 pikë maksimale të mundshme ose 94 % të nivelit referues të vlerësimit. Performanca e këtyre institucioneve, në lidhje me këtë komponent të sistemit të MFK-së, paraqitet në nivele shumë të kënaqshme, duke qënë se vlerësimi i marrë, sipas pyetësorëve të vetëvlerësimit të analizuara, është 3.7 pikë nga 4 pikë maksimale të mundshme. Pra, sipas analizës së mësipërme, shumica e këtyre institucioneve implementojnë sisteme efektive komunikimi dhe informimi në institucionet e tyre.
11. Komponenti i fundit i vlerësuar për sistemin e MFK-së është **Monitorimi**. Për vitin 2017, pikët mesatare të marra nga njësitë e varësisë janë 28.2 pikë nga 30 pikë maksimale të mundshme ose 94 % të nivelit referues të vlerësimit. Performanca e këtyre institucioneve, në lidhje me këtë komponent të sistemit të MFK-së, paraqitet në nivele shumë të kënaqshme, duke qënë se vlerësimi i marrë, sipas pyetësorëve të vetëvlerësimit të analizuara, është 3.7 pikë nga 4 pikë maksimale të mundshme. Pra, sipas analizës së mësipërme, shumica e këtyre institucioneve implementojnë sisteme efektive të monitorimit dhe raportimit në institucionet e tyre.

Opinion i Përgjithshëm

Gjendja e sistemit të MFK-së në njësitë e varësisë me buxhet të madh paraqitet në nivele shumë të kënaqshme, ku sipas vetëvlerësimit të tyre, ky sistem vlerësohet me 3.54 pikë nga 4 pikë maksimale të mundshme. Por gjithashtu, theksojmë nevojën për marrjen e masave të mëtejshme në kuadër të përmirësimit të këtij sistemi, kryesisht në lidhje me komponentin e menaxhimit të riskut.

KAPITULLI V – VEPRIMTARIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Analiza e veprimtarisë së auditimit të brendshëm është kryer nga konsolidimi i të dhënave të raporteve vjetore të 115 njësive të auditimit të brendshëm (NJAB) nga 119 NJAB që funksionojnë në sektorin publik. Për vitin 2017, nuk kanë raportuar NJAB e ngritura në Qendrën Spitalore Elbasan, Qendrën Spitalore Korçë, Qendrën Spitalore Fier dhe Universitetin e Tiranës. Në këto raporte janë analizuar rezultatet e veprimtarisë të auditimit të brendshëm, kufizimet me të cilat janë përballur audituesit dhe prioritetet për të ardhmen, bazuar në mënyrën standarde të raportimit të përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik mbështetet në një kuadër ligjor, i cili është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuara. Bazë e këtij kuadri rregullator janë: Ligji nr 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kodi i Etikës për Audituesit e Brendshëm dhe aktet e tjera nënligjore. Kjo veprimtari realizohet nëpërmjet zbatimit të Planeve Strategjike dhe Vjetore, të miratuara nga Titullarët përkatës të njësive publike, ku përcaktohen prioritetet e menaxhimit, objektivat, risqet, treguesit e matjes së performancës, në përputhje me burimet në dispozicion.

Për mirëadministrimin e fondeve publike dhe arritjen e objektivave të vendosura, titullarët e njësive publike duhet të mbështeten tek një sistem i fortë i auditimit të brendshëm. Në kuadrin rregullator në fuqi të auditimit të brendshëm janë të përcaktuara qartë mënyrat e sigurimit të auditimit të brendshëm nga ana e të gjitha njësive publike.

Konkluzionet, arritjet dhe mangësitë do të jenë bazë e analizës së sistemit që kryhet nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), në mënyrë që të reflektohen prioritetet për të ardhmen.

5.1 Planifikimi dhe realizimi i veprimtarisë



MFE analizon dhe konsolidon planet strategjike dhe vjetore të njësive të auditimit të brendshëm që funksionojnë në sektorin publik. Nga kjo analizë identifikohen risqet kryesore në bazë të të cilave është planifikuar veprimtaria e auditimit të brendshëm në njësitë publike.

Njësitë e Auditimit të Brendshëm që në fazën e planifikimit të punës për programimin e subjekteve dhe përcaktimit të tematikave të auditimit për vitin 2017, janë mbështetur në disa kritere si:

- Vlerësimi sa më real i riskut dhe përfshirja në planin e subjekteve me risk të lartë;
- Sugjerimet e titullarëve të njësive publike;
- Gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga auditimet e mëparshme.

Gjatë këtij viti strukturat e auditimit të brendshëm kanë realizuar 1,360 angazhime auditimi kundrejt 1,358 angazhime auditimi të programuara (përfshi këtu ndryshimet e planeve gjatë vitit), që e shprehur në përqindje përbën 100,1% realizim të Planit Vjetor.

Nga analiza e kryer në lidhje me realizimin e planit, gjatë këtij viti ka një ndryshim të pranueshëm nga plani fillestar i miratuar, kjo tregon për planifikim më të mirë të burimeve të auditimit nga ana e drejtuesve të NJAB, si dhe duhet theksuar rritja gjithnjë e më shumë e cilësisë së auditimeve të kryera. Cilësia vihet re si në hapat e ndjekur nga NJAB që në planifikimin e subjekteve deri në ndjekjen e rekomandimeve të dhëna.

Grafiku 7. Realizimi i misioneve të auditimit të brendshëm 2014-2017



Në grafikun e mëposhtëm paraqitet realizimi i angazhimeve të auditimit për vitin 2017 të ndara sipas llojit. Nga të dhënat e pasqyruara vërehet se gjatë vitit ka një numër të madh auditimesh të kombinuara (579 auditime) dhe auditime përputhshmërie (403 auditime). Në realizimin e veprimtarisë audituese vihet re një numër i konsiderueshëm i auditimeve të pa planifikuara, 149 me kërkesë të titullarëve të njësive publike, ku vihet re se këto lloj auditimesh zëvendësojnë auditimet e planifikuara të performancës meqënëse stafet audituese nuk kanë eksperiencë praktike në realizimin e këtyre auditimeve.

Grafiku 8. Llojet e auditimit të brendshëm sipas realizimit



Nga analiza e detajuar e këtyre të dhënave rezulton se në ndryshimin e realizimit të llojeve të auditimit nga llojet e përcaktuara në Planin Vjetor të miratuar kanë ndikuar disa faktorë:

- Planifikim të pabazuar në burimet reale të NJAB të pushtetit vendor (planifikojnë numër të madh auditimesh dhe nuk arrijnë ti realizojnë), ku mund të përmendim: Shërbimin Kombëtar të Punësimit 20/15, ZQRPP 29/14, ALUIZNI 23/4, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës 17/5, Bashkinë Skrapar 8/5, Bashkinë Divjakë 10/5, Bashkinë Kukës 12/7.
- E anasjellta e këtij fenomeni vihet re në NJAB që planifikojnë numër të kufizuar auditimesh por në fakt realizojnë shumë më tepër, ku mund të përmendim: Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve 18/26, QSUT 21/28, Albpetrol 18/27, Bashkia Mat 7/12, Bashkia Elbasan 13/17, Bashkia Kolonjë 14/28, Bashkia Pogradec 7/10, Bashkia Devoll 5/10, etj.
- Ndërhyrja e titullarëve të njësive publike duke kërkuar auditime të rëndësisë së veçantë jashtë planeve (149 angazhime auditimi me kërkesë të titullarëve).
- Ndryshimi i prioriteteve në veprimtaritë e subjekteve të audituara, pra ndryshim i shkallës së vlerësimit të riskut (fushat e konsideruara me risk të ulët gjatë fazës së planifikimit kanë rezultuar me risk të një shkalle më lartë dhe anasjelltas).

- Performancë jo në kërkesat e standardit të audituesve në kryerjen e funksionit të tyre, e theksuar kjo sidomos në stafin e punësuar rishtazi, pa eksperiencë, të patrajnuar e të paçertifikuar për njohuritë që kërkon profesioni. Ky fenomen vihet re në bashkitë që kanë ngritur së fundmi NJAB si: Bashkia Kuçovë, Bashkia Klos, Bashkia Roskovec, Bashkinë Tropojë, Bashkia Prrenjas, etj.

Faktorët e trajtuar më sipër, që kanë ndikuar në ndryshimin e planit të auditimit, do t'i bëhet prezent drejtuesve të NJAB me synimin e minimizimit të impaktit që ato kanë në realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm.

Opinion i përgjithshëm:
Nga analiza e kryer në lidhje me realizimin e planit, gjatë këtij viti vihet re një planifikim më i mirë i burimeve të auditimit nga ana e drejtuesve të NJAB, por ky element i rëndësishëm i këtij procesi duhet përmirësuar më tej në NJAB e pushtetit vendor, në të cilat është evidentuar problematikë në hartimin e planeve (llogaritjen e burimeve).

5.2 Vlerësimi i riskut



Fushat prioritare, mbi të cilat bazohen drejtuesit e NJAB për të hartuar planet e auditimit, përcaktohen nga analiza e detajuar e risqeve dhe problematikave të evidentuara përgjatë angazhimeve të mëparshme, si dhe nga specifikat e aktivitetit të njësive që auditohen. Në subjekte në të cilat risku është vlerësur i një niveli të lartë, vëmendje e madhe i është kushtuar procesit të ndjekjes së rekomandimeve, duke synuar jo vetëm përcaktimin e dëmit të shkaktuar apo përgjegjësive, por mbi të gjitha përmirësimin dhe parandalimin në përsëritjen e fenomeneve të tilla në të ardhmen.

Veprimtaria e audituesve të brendshëm konsiderohet, nga titullarët e njësive publike, si ofrues këshillash dhe rekomandimesh objektive për mirëqeverisje. Për këtë qëllim veprimtaria e audituesve të brendshëm fokusohet tek vlerësimi i risqeve. Ky vlerësim është kryer mbi:

- analizën e sistemeve dhe fushave të llogarisë për nga rëndësia, materialiteti, ndryshimi, risku, pikëpamjet e menaxhimit dhe presionet nga jashtë. Pas analizës së të gjithë komponentëve është përcaktuar frekuenca me mbulim e sistemeve të identifikuara;
- analizën e faktorëve të cilët kanë mundësinë më të madhe për të shkaktuar një ngjarje të papritur që mund të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë publike dhe natyrisht duke i dhënë prioritet gjithashtu dhe fushave të cilat kanë mundësinë më të lartë për të patur një ndikim negativ nga ndodhja e kësaj ngjarjeje.

Për vitin 2017 nga analiza e kryer në raportimet e njësive të auditimit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ndër sistemet e evidentuara me mangësi dhe kontrolle të brendshme jo funksionale apo inekzistente janë:

- *Sistemi i pagave, shpërblime, trajnime dhe komisione,* vlerësohet të jetë në nivel të lartë risku, që lidhen me shmangiet në zbatimin korrekt të procedurave ligjore të kërkuara për këtë qëllim. Mungesa e rregulloreve të brendshme, mos përcaktimi i qartë i detyrave dhe përgjegjësive për çdo pozicion pune, mos vendosja e kontrolleve të mjaftueshme dhe jo efiçent kanë sjellë rritjen e rasteve të shkeljeve dhe pagesave të parregullta për personelin, pagesat për orët mbi kohën normale të punës, shpërblime e trajnime, udhëtime e dieta, etj.
- *Sistemi i menaxhimit të aktiveve,* konsiderohet me risk të lartë, për shkeljet e konstatuara në: asetet e dhuruara pa pagesë si dhe mosregjistrimin e tyre në rregjistrat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara sipas njësive të qeverisjes vendore, mos regjistrimin e

aktiveve pranë Zyrave Vendore të Regjistrimit Pasurive të Paluajtshme, mos hartimit të regjistrit të aseteve, të mos pajisjes me çertifikatën e pronësisë të aktiveve afatgjata materiale. Kjo problematikë është evidentuar në: Bashkinë Skrapar, Bashkinë Dibër, Bashkinë Elbasan, Bashkinë Vau Dejës dhe Bashkinë Tiranë, etj.

- *Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore,* konsiderohet me risk të lartë pasi faktorëve si: rekrutimi i punonjësve jo në përputhje me kërkesat, aftësitë dhe nivelin e kërkuar të kualifikimeve, iu shtohet si mangësi serioze edhe mungesa e rregulloreve të hartuara për proceset kryesore të punës (ndarjen e detyrave), që shoqërohet me mangësi serioze në funksionimin e kontrolleve të brendshme, duke i bërë ato të pa mjaftueshme dhe jo eficente. Problematikë e evidentuar pothuajse në të gjitha bashkitë e vendit.
- *Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar*, është vlerësuar me risk të mesëm. Gjetjet në këtë sistem lidhen me: regjistrimin e aseteve në emër të njësisë të pa mbështetura në dokumentin që jep të drejtën e pronësisë, mos pasje të një liste të debitorëve si dhe mos ndjekje dhe monitorim në kohën e duhur të procesit të shlyerjes së detyrimeve, mos zbatimi i akteve rregullatore të kontabilitetit në sektorin publik gjatë hartimit të pasqyrave financiare. Kjo problematikë është evidentuar në Bashkinë Elbasan, Bashkinë Gramsh, Bashkinë Dropull, etj.
- *Procesi i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.* Niveli i detyrimeve të prapambetura mbetet një problem shqetësues dhe analiza e këtij problemi është në fokus së veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Ky fenomen haset në një numër të konsiderueshëm të njësive publike ku mund të përmendim: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Drejtësisë dhe kryesisht në pushtetin vendor.
- *Sistemi i privatizimit, shitjes, qiradhënie*s, konsiderohet me risk, sepse nuk ka gjurmë të dokumentuara të procesit të qeradhënies të pronës publike, zbatueshmëri të procedurave ligjore të përcaktuara dhe zbatim të detyrimeve për pagesën dhe kamatvonesat e përcaktuara, administrim dhe shitje e pronës publike si dhe monitorim i të ardhurave nga përdorimi i pronës nga njësitë publike. Kjo problematikë është evidentuar në Bashkinë Vau Dejës, Bashkinë Tiranë, etj.
- *Sistemi i prokurimeve,* në të cilin disa faktorë si: përzgjedhja e ofertës më të mirë, anullimi i procedurave të prokurimit dhe copëtimi i fondeve deri në limit, për të shmangur tenderimin për mallra, shërbime, që përfshihen në një grup apo emërtim, janë konsideruar përcaktues në nivelin e lartë të riskut. Kjo është evidentuar në institucione të varësisë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Spitali i Traumës Tiranë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, etj.
- *Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit.* Ky sistem vlerësohet me risk të lartë, nga ndikimi i faktoreve të lidhura me mosshpërndarjen dhe mospërdorimin e fondeve publike për qëllimin e përcaktuar, pra me dobi, kursim dhe frytshmëri. Në fazën e programimit risku është identifikuar në programimin me rezervë të burimeve të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për subjektet tregtarë dhe familjarët. Evidentuar si problematikë në Bashkinë Dibër, Bashkinë Tepelenë, Bashkinë Memaliaj, Bashkinë Kolonjë dhe Bashkinë Selenicë.
- *Tek grupimi: Sisteme të tjera të lidhura me misionin dhe qëllimin e njësive të qeverisjes vendore,* prezenca e riskut lidhet me mos evidentimin, regjistrimin dhe rakordimin e të ardhurave të krijuara nga taksat dhe tarifat vendore dhe mosregjistrim i detyrimeve të prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore të subjekteve tregtare. Gjetje këto të evidentuara në Bashkinë Mallakastër, Bashkinë Gramsh, Bashkinë Memaliaj, Bashkinë Kukës, Bashkinë Kavajë, Bashkinë Sarandë dhe Bashkinë Tiranë.

Opinion i përgjithshëm:
Nga vlerësimi i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, duke u bazuar në fushat me risk të identifikuara më lart, konkludohet që duhet t'i kushtohet një vëmendje më e madhe nga menaxhimi i njësive publike të audituara përmirësimeve të nevojshme të sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke adresuar rekomandimet e audituesve.

5.3 Gjetjet e auditimit të brendshëm



Audituesit e brendshëm gjatë realizimit të veprimtarisë së tyre evidentojnë problematika të ndryshme në të gjitha sistemet e kontrollit të brendshëm dhe japin opinionin dhe rekomandimet përkatëse për një mirëmenaxhim të fondeve publike dhe të përdorimit të tyre me dobi, kursim dhe frytshmëri.

Gjatë kësaj periudhe gjetjet kryesore në numër dhe në vlerë monetare kanë të bëjnë kryesisht me mosfunksionimin siç duhet të sistemit të prokurimeve, blerjeve dhe investimeve, sistemit të administrimit të pronës dhe pasurisë, sistemi i tatimeve, taksa dhe dogana dhe sisteme të tjera sipas misionit dhe qëllimit të institucionit. etj. ku më kryesoret përmendim gjetjet:

- *Në* sistemin e prokurimeve, blerjeve dhe investimeve, kryesisht me nënshkrim të kontratave duke ndryshuar kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, mosndjekjen e hapave ligjorë për blerjet e vogla, blerjen e mjeteve të transportit në kundërshtim me specifikimet teknike, etj.
- *Në* sistemin e administrimit të pronës dhe pasurisë. Referuar raporteve të dërguara nga NJAB-të, rezulton se ka pasur probleme me procesin e vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, asgjësimit me tjetërsim të formës fillestare, marrjes së titujve të pronësisë së trojeve dhe ndërtesave, etj.
- *Në sistemin e kontabilitetit. Konsiston në parregullësi të fuksionimit të sistemit të kontabilitetit (dokumenta jo të besueshme), në inventarët e njësive mbahen aktive, të cilat nuk ekzistojnë dhe kanë të bëjnë me vlerën e objekteve ndërtimore të amortizuar dhe të dëmtuara plotësisht, etj.*

Nga analiza rezulton që gjetjet lidhen me fushat e vlerësuara me risk të lartë që në fazën e planifikimit të veprimtarisë audituese, ato do të trajtohen në mënyrë të vazhdueshme si nga audituesit e brendshëm, subjektet e audituara ashtu edhe nga titullarët e njësive publike.

Të dhënat numerike mbi rastet e konstatuara të dëmit ekonomik, si dhe ndikimi që ato kanë pasur në buxhetin e subjekteve të audituara në mënyrë të përmbledhur jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 10. Gjetjet me dëm ekonomik sipas sistemeve, viti 2017

Nr.	Gjetjet sipas sistemit	Dëmi ekonomik (000/lekë)
1	Prokurim, blerje dhe investime	7.276.824
2	Paga, shpërblime, trajtime, komisione	56.249,28
3	Fondet e sig. shoq dhe shëndetësore	8.017,74
4	Tatime, taksa dhe dogana	291.854,4
5	Admin. prone dhe pasurie	17.520,6
6	Privatizime, shitje dhe qeradhënie	21.546,2
7	Koncesione dhe ankande	11.303
8	Legalizime, urbanistikë dhe kthim pronash	2.405,7
9	Kreditim, subvencione	24.567,8
10	Të tjera	138.207
	TOTALI	**7.848.500,4**

Vërehet se nga auditimet e kryera janë konstatuar 6286 raste të shkeljeve, për të cilat gjetjet llogariten në 7.848,5 milionë lekë.

Në tabelën e mësipërme tregohet në mënyrë të qartë se gjatë vitit 2017, sistemi i prokurimeve, blerjeve dhe investimeve dhe tatim, taksa dhe dogana kanë pasur gjetjet me vlerë më të madhe të shkeljeve të konstatuara.

Grafiku 9. Niveli i gjetjeve për vitin 2014-2017



Siç shihet, sistemeve me risk më të lartë i përkasin dhe gjetjet dhe problematikat kryesore që kanë dalë si rezultat i auditimeve të kryera gjatë vitit.

Gjatë këtij viti janë evidentuar nga audituesit e brendshëm 18 raste për invesitigim të mëtejshëm nga njësi të specializuara. Këto janë trajtuar nga 12 NJAB kryesisht të: Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, AKU, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Posta Shqiptare sha, Albpetrol, Drejtoria e Përgjithshme e Tranportit Rrugor dhe Bashkia Kukës.
Pesë prej këtyre rasteve i janë drejtuar për investigim të mëtejshëm Drejtorisë së Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pesë raste prokurorive të rretheve përkatëse, rastet e tjera i janë drejtuar titullarëve të njësive publike, Agjensisë së Prokurimit dhe Drejtorive të Policisë së Qarqeve përkatëse.

Opinion i përgjithshëm:
Gjetjet me dëm ekonomik kanë një rritje të konsiderueshme krahasuar me gjetjet e vitit të mëparshëm. Kjo si pasojë e frymës Qeverisëse për të luftuar korrupsionin. Gjithashtu, ndikim ka patur dhe rritja e aftësisë profesionale të audituesve të brendshëm, thellimi i njohurive në fushat specifike, ashtu edhe në aksesin e pakufizuar në përdorimin e dokumentacioneve dhe informcaioneve në subjektet e audituara.

Vlerësohet një ndërgjegjësim në rritje e NJAB për të mos trajtuar vetë çështje që në vlerësimin e tyre përbëjnë vepër penale, por t'i dërgojnë ato për investigim të mëtejshëm tek njësi të specializuara sikurse është struktura e inspektimit financiar publik.

5.4 Vlerësimet e sistemeve të kontrollit të brendshëm

Njësitë e auditimit të brendshëm, në përmbushje të misionit të veprimtarisë së tyre, kanë vlerësuar si një nga detyrat kryesore, dhënien e opinionit mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e **sistemit të kontrollit të brendshëm, bazuar në vlerësim e këtyre sistemeve.**

Kontrolli i Brendshëm është vlerësuar si një nga elementët kryesor që përmbledh organizimin me detyrat funksionale, politikat dhe procedurat e përdorura në çdo subjekt, me qëllim që të ndihmojë dhe sigurojë menaxhimin se po arrihen rezultatet e synuara, se burimet po përdoren në përputhje me qëllimet dhe objektivat e subjektit, se programet janë të mbrojtura nga keqmenaxhimet dhe se informacioni i besueshëm dhe kohor është përfituar, ruajtur, raportuar dhe përdorur për vendimmarrjen.

Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm ka konsistuar jo vetëm thjesht në pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat por ka përfshirë si veprimet financiare dhe jo-financiare të

organizatës dhe vlerën e parasë së fondeve publike, vlerësimin nëse fondet publike janë shpërdarë dhe përdorur për qëllimin e dhënë dhe sipas parimeve të tre E-ve.

Nga rezultatet e vleresimeve, audituesit kanë dhënë opinione se pranë njësive publike, menaxhimi nuk ka vendosur kontrolle të brendshëm në çdo sistem apo në rastin e ngritjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm ato nuk funksionojnë.

Ndër mangësitë e konstatuara në funksionimin e kontrolleve të brendshme, veçojmë se:

- Njësitë publike nuk kanë hartuar e miratuar planet strategjike e vjetore, ku të jenë përcaktuar objektivat kryesore të institucionit të cilat duhet të jenë SMART (specifike, të matshme, të arritshme, të përshtatshme dhe në kohë) dhe prioritetet,
- Njësite publike nuk kanë hartuar Strategjinë e menaxhimit të riskut për të identifikuar dhe analizuar risqet e brendshme e të jashtme, vendosja e objektivave në nivel forme veprimi, operacional dhe strategjik nga menaxhimi, bazuar në aktivitetet e parashikuara, kundrejt objektivave dhe arritjes se tyre.
- Njësite publike nuk kanë hartuar dhe përditësuar rregjistrin e riskut ku të identifikojnë risqet dhe masat për minimizimin e tij.
- Rregulloret përkatëse nuk kanë të përcaktuar, detyrat dhe përgjegjësitë, linjat e komunimikit dhe raportimit brenda institucionit.

Mos funksionimi si duhet i sistemeve të kontrollit të brendshëm ka ardhur kryesisht nga:

- Mos njohja e kuadrit ligjor nga punonjësit e njësive të audituara.
- Mungesa e punonjësve të aftë profesionalisht.
- Ndarja e paqartë e detyrave të punonjësve, e cila sjell mbivendosje, mungesë në përcaktimin e përgjegjësive për dobësitë e sistemeve.

Gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit, vlerësimi i efektivitetit dhe efçencës në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm është përparësi, pasi mangësitë në këtë drejtim kanë ndikim të ndjeshëm në arritjen e objektivave strategjikë, operacional dhe financiar të njësive publike.
Për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm audituesit janë përqendruar kryesisht në masat e kontrollit, në planet e organizimit, në metodat dhe procedurat për administrimin e mjeteve monetare e materiale, në zbulimin pa vonesë të anomalive, gabimeve dhe parregullsive në informacionet kontabile dhe financiare, si dhe shpërdorimet dhe dëmtimet me qëllim parandalimin e tyre në të ardhmen.

Opinion i përgjithshëm:
Njësitë publike kanë ngritur sistemet e kontrollit të brendshëm por nga vlerësimi audituesve të brendshëm ka zhvillim të vazhdueshëm por gjithmonë ka vend për përmirësime të mëtejshme në menaxhimin dhe funksionimin e tyre.

5.5 Sigurimi i brendshëm i cilësisë së auditimit të brendshëm



Bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm sigurimi i cilësisë është një proces që duhet të kryhet në mënyrë të vazhdueshme nga drejtuesit e NJAB, si kërkesë e domosdoshme për të identifikuar objektivisht mangësitë, përmirësimet që duhen bërë dhe masat efektive që duhet të ndërmerren në të ardhmen, në mënyrë që të sigurohet një cilësi sa më e lartë e të gjithë punës audituese.

Ky proces synon të garantojë përmirësim të vazhdueshëm të punës audituese në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe ka qenë dhe mbetet në vazhdimësi si një ndër objektivat kryesore të kësaj veprimtarie.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një nga fazat më të rëndësishme të veprimtarisë audituese, i cili realizohet nga drejtuesi i njësisë dhe vlerëson performancën, si dhe përputhjen me standardet ndërkombëtare të këtij shërbimi.

Kjo fazë e auditimit të brendshëm nuk kryhet në përputhje me mënyrën dhe formatet e përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm ose nuk kryhet fare sepse 30% (40 njësi të auditimit të brendshëm) funksionojnë me 1 (18 njësi auditimi të brendshëm) ose 2 auditues (22 njësi të auditimit të brendshëm). Këto njësi e kanë të pamundur ta realizojnë vlerësimin e punës së tyre. Këto NJAB nuk mund të hartojnë programe që rishikojnë e vlerësojnë përputhshmërinë me standardet e auditimit të brendshëm të punës së tyre, për këtë arësye këto struktura nuk mund të realizojnë procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Nga analiza e bërë elementëve të sigurimit të brendshëm të cilësisë në pyetësorin e vetëvlerësimit, vihet re se strukturat e paplotësuara (me një, me dy auditues) nuk kryejnë këtë proces kaq të rëndësishëm të veprimtarisë audituese, në të njëjtën kohë dhe strukturat e tjera kanë mangësi të theksuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë. Problematika në realizimin e këtij elementi të veprimtarisë nuk garanton mbikëqyrjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm në të gjitha fazat, gjë që ka ndikuar në cilësinë e punës së auditimit të brendshëm.

Opinion i përgjithshëm:
Njësitë e auditimit të brendshëm kryejnë sigurimin e brendshëm të cilësisë të veprimtarisë audituese por nuk kanë përditësuar mënyrën e këtij vlerësimi me ndryshimet në aktet nënligjore.
Në njësitë e auditimit të brendshëm që funksionojnë jashtë kritereve ligjore nuk kryhet sigurimi i brendshëm i cilësisë.

5.6 Rekomandimet e Auditimit të Brendshëm

55% e rekomandimeve të dhëna nga audituesit e brendshëm janë zbatuar, krahasuar me 47% niveli i zbatimit të vitit të mëparshëm

Zbatimi i rekomandimeve është përgjegjësi e titullarit të njësisë publike të audituar, por roli i auditimit të brendshëm është monitorimi në vazhdimësi i progresit në zbatimin e tyre.

Rekomandimet e dhëna kanë synim përmirësimin e sistemeve përkatëse, uljen e nivelit të riskut dhe dhënien e këshillave për titullarët për parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen. Është e njohur që përgjegjësia e zbatimit të rekomandimeve rëndon mbi vetë drejtuesit e subjekteve të audituara, por nga ana tjetër përgjegjësia e auditimit të brendshëm nuk kufizohet vetëm në dhënien, por dhe në monitorimin e vazhdueshëm të rekomandimeve të lëna, pasi dhe rezultatet e punës audituese varen në një masë të madhe nga ky faktor.

Nga monitorimi i vazhdueshëm i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2016 është evidentuar një rritje e konsiderueshme nga 47% e nivelit të zbatimit e evidentuar në raportin vjetor 2016 në në 68% e nivelit të zbatimit gjatë analizës së këtij treguesi në vitin 2017.

Rekomandimet e lëna nga NJAB, janë rezultat i analizave dhe vlerësimeve të sistemeve dhe kontrolleve të brendshme të ngritura pranë njësive publike. Ato përcaktojnë dhe i japin prioritet veprimeve që duhet të ndermerren për një funksionim më të mirë të këtyre sistemeve, ndreqjen

e parregullsive, ruajtjen e aseteve dhe minimizimin e rasteve të mashtrimit duke ndikuar në miradministrimin e fondeve publike.

Përgjithësisht, rekomandimet e dhëna gjatë vitit 2017 nga NJAB që funksionojnë në njësitë publike kanë të bëjnë me:

1. Rekomandime për përmirësimin e sistemeve dhe rekomandime me karakter organizativ, të cilat janë adresuar për përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, përgatitjen e gjurmëve të auditimit, sistemin e prokurimeve publike dhe sistemin e raportimit financiar dhe kontabilitetit.
2. Rekomandime për përmirësimin e proceseve të vendimmarrjes të politikave, të procedurave dhe hartimit të strategjive, të cilat ndihmojnë njësitë publike për përcaktimin sa më real të prioriteteve dhe objektivave vjetore, afatmesëm dhe afatgjatë;
3. Rekomandime për përmirësimin e srukturave organizative, në funksion të rritjes së efektivitetit të punës;
4. Rekomandime për korrigjimin e parregullsive, parandalimin e shpërdorimeve, shkeljeve dhe ruajtjen e pronës publike, si dhe
5. Rekomandime që lidhen me zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve në njësitë publike dhe sidomos stafit që punon në strukturat e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Për rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve është e nevojshme ndërmarrja e veprimeve të duhura nga titullarët e njësive publike, të cilët në shumë raste nuk i shikojnë strukturat e auditimit të brendshëm si funksione që shtojnë vlerë për realizimin e objektivave të vendosura.

Gjatë analizës së rekomandimeve të dhëna janë evidentuar disa mangësi në lidhje me cilësinë e tyre, ku ndër më kryesoret mund të përmendim:

1. Në disa raste formulimi i rekomandimeve është parashkruar si zbatim i aktit ligjor në fuqi. Ky formulim nuk mund ti rekomandohet subjekteve të audituara por duhet të bëhet adresim konkret i rekomandimit, bazuar në mos respektimin e procedurave apo sistemeve përkatëse të ngritura nga njësia publike.
2. Rekomandime të vështira për t'u realizuar, pasi audituesit nuk arrijnë të bëjnë dallimin midis rekomandimeve me ndikim financiar dhe atyre pa ndikim financiar.
3. Rekomandime që nuk tregojnë se çfarë, si dhe kur duhet bërë, nuk propozojnë zgjidhje të qartë për problemin, apo të përmendin zgjidhje alternative të tij.
4. Rekomandime që nuk bazohen logjikisht tek gjetjet dhe pasojat përkatëse, ndërkohë që ato duhet të përqëndrohen në ndërmarrjen e veprimeve specifike konkrete që synojnë korrigjimin e çështjeve.

Megjithë problematikën e sipërcituar, nga analiza e veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm konstatohet se ka rritje në cilësinë e rekomandimeve të lëna për zbatim, kjo falë tematikave të trajtuara në trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga MFE. Të dhënat e mësipërme tregojnë se niveli i lartë i pranimit të rekomandimeve dhe niveli i zbatimit të tyre janë rezultat i përmirësimit të cilësisë së punës së vetë audituesve.

Tabela 11. Rekomandimet sipas llojit për vitin 2017

REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT				
Rekomandime për përmirësim sistemesh	Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor	Rekomandime të karakterit organizativ	Rekomandime për arkëtime	Rekomandime të tjera
2238	377	2975	953	1798

Tabela e mëposhtme jep informacion mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve sipas prioritetit të tyre. Konstatohet se treguesi për zbatimin e rekomandimeve është pozitiv, pasi ato janë pranuar 99,6% dhe zbatueshmëria e tyre është në masën 55%. Vlen të theksohet fakti që matja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm ka një shtrirje kohore minimalisht 2 vjecare për shkak të afateve të ndryshme kohore të zbatimit për secilin rekomandim, periudhën e realizimit të angazhimeve të auditimit, si dhe mënyrat e monitorimit të përcaktuara në MAB. Monitorimi i vazhdueshëm i këtij procesi siguron përcaktimin e afateve të sakta në planet e veprimit dhe dokumentimin e duhur të mënyrës së bashkëpunimit ndërmjet NJAB dhe subjekteve të audituara.

Tabela 12. Zbatimi i rekomandimeve për vitin 2017

STATUSI I REKOMANDIMEVE			
Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Rekomandime në proces zbatimi
8371	8341	4625	3918

Këto rekomandime i referohen gjetjeve të konstatuara dhe kanë synim përmirësimin e sistemeve përkatëse, uljen e nivelit të riskut në këto sisteme dhe dhënien e këshillave për zgjidhje që mundësojnë parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen.

Nga analiza e veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm konstatohet se vazhdojnë përpjekjet e audituesve për rritjen e cilësisë së rekomandimeve të lëna për zbatim. Të dhënat e mësipërme tregojnë se pranimi i rekomandimeve dhe niveli i zbatimit të tyre janë rezultat i përmirësimit të cilësisë së punës së vetë audituesve. Gjithashtu, kjo shoqërohet me një kuptim më të drejtë të menaxhimit të subjekteve të audituara mbi vlerën dhe përfitimet e auditimit të brendshëm.

Grafiku 10. Niveli i rekomandimeve 2014-2017 (në numër) dhe zbatimi i rekomandimeve (në %) për vitin 2017





Nëse auditimi i brendshëm do të luajë një rol pasiv, i cili do të konsistonte thjesht në dhënien e rekomandimeve të paqarta dhe të pa aplikueshme, atëherë nuk do të kishim përmbushje të misionit dhe objektivave të tij strategjikë, pra për vlerë të shtuar të subjektit të audituar apo përmirësim të veprimtarisë së tij. Për këtë arsye, vlerësimi i veprimtarisë së strukturave të auditimit nuk është kufizuar vetëm në dhënien e rekomandimeve të dhëna, por ka konsideruar si tregues të rëndësishëm edhe shkallën e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Opinion i përgjithshëm:
Nga analiza ka rezultuar se njësitë e qeverisjes së përgjithshme raportojnë se ka një progres të dukshëm në monitorimin e nivelit të zbatimin e rekomandimeve, por në njësi auditimi të caktuara shkalla e implementimit të rekomandimeve të dhëna lë vend për përmirësime në të ardhmen. Ky fenomen ka ndikuar që një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve të përsëriten edhe në auditimet e radhës.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se niveli i lartë i pranimit të rekomandimeve dhe niveli i zbatimit të tyre janë rezultat i përmirësimit të cilësisë së punës së vetë audituesve. Gjithashtu, kjo shoqërohet me ndërgjegjësimin gjithnjë e në rritje të titullarëve të njësive publike për rolin, vlerën dhe përfitimet nga shërbimi i auditimit të brendshëm.

Nga të dhënat e analizuara, deri në fund të vitit 2017 në sektorin publik funksionojnë 119 njësi të auditimit të brendshëm, të cilat kryejnë shërbimin e tyre në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ky shërbim përfshin vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, dhënien e sigurisë objektive dhe rekomandimeve të vlefshme për titullarët e njësive publike, për arritjen e objektivave të vendosura. Në këtë mënyrë audituesit e brendshëm në sektorin publik duhet të zotërojnë nivel të lartë profesional, për të dhënë ndihmën e tyre në mirë menaxhimin e fondeve publike.

Gjatë këtij viti vihet re një rritje e numrit të NJAB (7 më shumë se në vitin 2016). Në njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, sipas organikave të miratuara janë planifikuar 428 audituesë të brendshëm dhe aktualisht të punësuar janë 400 audituesë të brendshëm, nga të cilët 308 janë të çertifikuar si "Audituesë të brendshëm në sektorin publik", 36 punonjës janë në proces çertifikimi (procesi përfundon në Korrik 2018) dhe 56 punonjës të NJAB nuk e zotërojnë këtë çertifikatë, por duhet të ndjekin procesin e çertifikimit gjatë 2 viteve të para të punësimit.

Tabela e mëposhtme jep informacion të detajuar mbi ecurinë e procesit të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në njësitë publike për pesë vitet e fundit:

Tabela 13. Të dhëna për Audituesit e Brendshëm

Emërtimi	Struktura (numri)	Audituesë të brendshëm Plan/Fakt	Të çertifikuar	Në proces çertifikimi	Të pa çertifikuar
Ministritë e Linjës	11	71/65	64	0	1
Inst. Qendrore	32	97/91	80	3	8
Univ. & Shoq.Aksionere	20	88/84	61	12	11
Inst.të Pavarura	9	32/29	27	0	2
Bashki (46+1)	47	140/131	76	21	34
Shuma	**119**	**428/400**	**308**	**36**	**56**

Nga analiza e përbërjes profesionale të stafit audituesë të punësuar gjatë vitit 2017 vihet re që numrin më të madh e zënë specialistë të fushave ekonomike, ku 347 audituesë janë ekonomistë, 40 juristë dhe vetëm 13 i përkasin disiplinave të tjera. Fusha të ndryshme të sektorit publik janë objekt i auditimit të brendshëm, për këtë është e nevojshme që në raste specifike audituesit e brendshëm të jenë të profilizuar sipas këtyre fushave. Aktualisht në 119 NJAB në sektorin publik vihet re se: NJAB e Ministrisë së Mbrojtjes ka në përbërjen e saj oficer logjistike, NJAB e Ministrisë së Mjedisit ka në përbërjen e saj inxhinier Pyjesh, NJAB e Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor ka në përbërjen e saj mjek dhe farmacist, NJAB në Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike kanë në përbërje inxhinier elektrik, etj.

Nga viti në vit, vihet re një trend në rritje e audituesve të brendshëm me profesion bazë në shkencat ekonomike, nga 337 ekonomistë të punësuar në vitin 2016 në 347 ekonomistë për vitin 2017.

Grafiku 11. Vjetërsia e AB gjatë 4 viteve dhe ndarja profesionale e AB e shprehur në %





Në kuadrin ligjor në fuqi, një nga kushtet e punësimit si auditues i brendshëm është dhe eksperienca në profesionin bazë, e diferencuar për drejtues të NJAB, auditues të brendshëm dhe punonjës të NJAB. Nga analiza e të dhënave të raportuara nga strukturat audituese, rezulton se 162 punonjës kanë eksperiencë pune në auditim deri në 5 vjet dhe 238 mbi 5 vjet punë si auditues.

Aktualisht në pushtetin vendor janë krijuar në 49 Bashki njësi të auditimit të brendshëm, nga të cilat në 46 prej tyre kjo veprimtari funksionon normalisht. Në 3 bashki (Bashkitë: Cërrik, Belsh dhe Kurbin) kanë miratuar strukturën e auditimit, por kanë një mungesë të theksuar të kapaciteteve të stafit auditues. Ndërkohë 5 bashki relativisht të vogla (Pustec, Përmet, Këlcyrë, Finiq dhe Libohovë) kanë realizuar shërbimin e auditimit me akt-marrëveshje me njësi auditimi të njësive të tjera publike. Në 7 bashkitë e tjera (Bashkitë: Klos, Poliçan, Has, Pukë, Konispol, Rrogozhinë dhe Delvinë) janë duke bërë përpjekje për realizmin e këtij shërbimi sipas mënyrave të përcaktuara në kuadrin rregullator.

Gjatë këtij viti vërehet një numër relativisht i konsiderueshëm i njësive të auditimit të brendshëm që funksionojnë në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi, ose me më pak se tre auditues ose me staf të pa kualifikuar (40 njësi me mungesë stafi, 10 njësi me drejtues të NJAB të paçertifikuar, 4 njësi me më shumë se 1/3 të punonjësve të paçertifikuar), gjë e cila ndikon në realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm sipas përcaktimeve ligjore.

Shërbimi i auditimit të brendshëm nuk shtrihet në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme konkretisht nga 26 institucione të pavarura vetëm 11 prej tyre janë të mbuluar me shërbimin e auditimit të brendshëm me njërën nga format e përcaktuara në ligj, si dhe 17 njësi publike në varësi të Kryeministrisë vetëm 4 prej tyre janë të mbuluar me shërbimin e auditimit të brendshëm.

Opinion i përgjithshëm:
Shërbimi i auditimit të brebndshëm nuk shtrihet në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, aktualisht kjo porblematikë vërehet në institucionet e pavaruara, njësi publike në varësi të Kryeministrisë dhe në disa bashki.

Vihet re interesi në rritje i punonjësve të rinj për tu punësuar në strukturat audituese. Kjo shihet si një frymë e re, e përshtatur me zhvillimet teknologjike dhe energjinë që karakterizon brezat e rinj. Ata janë një gjeneratë e re që në bashkëpunim me audituesit me përvojë do të realizojnë në të ardhmen nivel gjithnjë e në rritje të cilësisë së punës audituesve

5.7 Funksionimi i Komiteteve të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në germën b të nenit 12 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", titullarët e njësive publike kanë të drejtën e vendimmarrjes për krijimin e komiteteve të auditimit të brendshëm. Mënyra e funksionimit të këtyre komiteteve rregullohet

me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.160, datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike".

Gjatë vitit 2017 janë krijuar tetë komitete përkatësisht në: Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Institutin e Statistikave.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si përgjegjëse për bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, për analizimin e funksionimit të komiteteve me shkresë nr.2944, datë 13.02.2018 ka kërkuar vënien në dispozicion të raportit vjetor të veprimtarisë të Komiteteve të Auditimit të Brendshëm (KAB).

Kjo analizë bazohet në raportimin vjetor të pesë prej KAB, të dërguar zyrtarisht në MFE. Bazuar në këto raporte evidentohet se, gjatë kësaj periudhe këto komitete kanë funksionuar bazuar në përcaktimet e akteve ligjore të sipërcituara, duke zgjedhur drejtuesin e komitetit dhe përgatitur rregulloren e brendshme për një mirëfunksionim të tyre. Këto organe janë asistuar në veprimtarinë e tyre nga një punonjës i njësisë së auditimit të brendshëm, i caktuar zyrtarisht nga drejtuesi i NJAB.

Këto KAB kanë shqyrtuar dhe dhënë rekomandime për përmirësimin e kartës së auditimit, planit strategjik dhe vjetor, si dhe për raportin vjetor të veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm.

Nëpërmjet raporteve të auditimit kanë monitoruar funksionimin apo jo të sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë publike përkatëse, si dhe përputhshmërinë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm me standardet ndërkombëtare të auditimit. Për të gjitha vlerësimet dhe konstatimet, këto komitete kanë dhënë këshilla për titullarin e njësisë publike për mjaftueshmërinë ose jo të burimeve të njësisë së auditimit të brendshëm.

Nga kjo analizë rezulton që për arsye objektive nuk funksionon Komiteti i Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Në fillim të vitit 2018 është krijuar dhe ka filluar funksionimin Komiteti i Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Kulturës, ndërsa në Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk janë krijuar KAB.

Opinion i përgjithshëm:
Komitetet e Auditimit të Brendshëm vlerësojnë se në vija të përgjithshme veprimtaria audituese është në përputhje me standardet, por për fusha specifike kërkohet përmirësim i vazhdueshëm në vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

KAPITULLI VI- AKTIVITETET E DH/KBFP PËR VITIN 2017 DHE PLANI NË VIJIM

Gjatë vitit 2017, veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (DPH/KBFP) u fokusua në arritjen e objektivave të parashikuara për fushën e kontrollit të brendshëm (shtylla 5) dhe aktivitetet e parashikuara për fushën e kontabilitetit publik (shtylla 4) të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020.

6.1 Aktivitetet e DH/MFK gjatë vitit 2017

Bazuar në këtë dokument kyç, u arritën objektivat e drejtorisë për vitin 2017, duke u fokusuar në mënyrë të përmbledhur në këto drejtime:

1. **Hartimi dhe përmirësimi i bazës ligjore/nënligjore të fushës së kontrollit të brendshëm**

a) Në fushën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", DH/MFK gjatë vitit 2017 është angazhuar me përmirësimin e dy akteve nënligjore si më poshtë:

- Draft-Udhëzimi "Për Evidencimin, Rregjistrimin, Përdorimin dhe Raportimin e Financimeve të Huaja në Kuadrin e Projekteve dhe Marrëveshjeve me Donatorët e Huaj;
- Draft-Udhëzimi "Mbi Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit".

b) Në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar

Në kuadër të përmirësimeve në fushën e kontabilitetit publik, DH/MFK është angazhuar në hartimin e Udhëzimit të mbylljes së llogarive vjetore, si një detyrim ligjor i përvitshëm, në të cilën përcaktohen afatet dhe procedurat e nevojshme për mbylljen e llogarive vjetore nga njësitë publike dhe konsolidimi i tyre nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
DH/MFK, në zbatim të projektit "Për përmirësimin e kontabilitetit në sektorin publik" do të përfshihet në aktivitetet e këtij projekti, i cili synon hartimin e një plani veprimi për ndërtimin e një sistemi kontabël në sektorin publik të besueshëm, si dhe fillimin e zbatimit gradual të hapave të mëtejshëm. Gjatë vitit 2017, DH/MFK është angazhuar në hartimin e Udhëzimit "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i cili do të shërbejë si një bazë rregullatore tranzitore për kontabilitetin në sektorin publik, deri në implementimin e plotë të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS).

2. **Vlerësimi i progresit të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme**

a) Finalizimi i Raportit Vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2016.

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2017, drejtoria ka finalizuar Raportin Vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme duke

ofruar një përmbledhje vjetore të aktiviteteve të njësive të qeverisjes së përgjithshme në fushën e KBFP, arritjet dhe mangësitë e evidentuara në vitin e mëparshëm si dhe duke sugjeruar rekomandime për njësitë publike për përmirësime të mëtejshme.

b) Monitorimi në vend i zhvillimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm

Me synimin kryesor inkurajimin e njësive publike për të kryer një vetëvlerësim të hollësishëm dhe të besueshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe për të siguruar një lidhje të qartë ndërmjet çështjeve të përgjithshme të MFK dhe dokumenteve konkrete ose aktiviteteve që duhet të ekzistojnë apo të ndërmerren, DH/MFK realizoi monitorimin në vend për zhvillimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në 16 institucione publike.
Pas përfundimit të gjithë procesit të monitorimit, institucioneve iu është dërguar një shkresë zyrtare ku krahas evidentimit të gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm, janë lënë dhe rekomandimet e nevojshme për marrjen e masave për përmirësimin e këtij sistemi.

3. Implementimi i sistemit të MFK në 4 institucione publike pilot të përzgjedhura

DH/MFK, në kuadër të implementimit të një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit, bazuar në eksperiencën e fituar nga projekti i binjakëzimit, parashikoi për vitin 2017 implementimin e këtij sistemi në 4 institucione pilot të përzgjedhur (Ministria e Brendshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar). Për këtë proces, është përgatitur një plan i detajuar aktivitetesh lidhur me instrumentet kryesorë që do të implementohen, personat përgjegjës për zhvillimin e e tyre dhe afatet kohore të nevojshme për realizim.
Bazuar në planin e miratuar të aktiviteteve, gjatë muajit dhjetor, u zhvilluan takimet me Autoritetin Rrugor Shqiptar, ku ekspertët e DH/MFK vlerësuan në vend, bazuar tek pyetësori i vetëvlerësimit, funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të institucionit. Në vazhdimësi, do të realizohen të gjitha misionet për këto institucione dhe pritet që ky proces të përfundojë brenda vitit 2018.

4. Trajnime/workshop-e/seminare në kuadër të ndërgjegjësimit të administratës publike, mbi rolin dhe rëndësinë e zbatimit të MFK

a) Trajnime mbi informimin e njësive të qeverisjes vendore me kërkesat e ligjit të MFK

Ndër funksionet kryesore të DH/MFK është ofrimi i trajnimeve në vijueshmëri në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të përgjegjshmërisë menaxheriale në institucionet e sektorit publik. Në këtë kontekst, u parashikua realizimi i trajnimeve mbi informimin e njësive të qeverisjes vendore me kërkesat e ligjit të MFK.
Nëpërmjet këtyre trajnimeve, synohet informimi dhe ndërgjegjësimi i menaxherëve të niveleve të ndryshëm dhe stafit të njësive të qeverisjes vendore mbi rëndësinë e implementimit të një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe zbatimin në praktikë të instrumentave të MFK-së.
Gjatë vitit 2017, u zhvilluan 5 cikle trajnimi 3-ditore (respektivisht janë realizuar trajnimet në Qarkun e Vlorës, Korçës, Tiranës, Gjirokastrës dhe Kukësit) ku morën pjesë rreth 131 pjesëmarrës. Ndërkohë, trajnimet në qarkun e Shkodrës dhe Elbasanit u realizuan në fillim të vitit 2018.

b) Trajnime të organizuara në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA)

Në kuadër të realizimit me sukses të objektivave të përcaktuar në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike si dhe rekomandimeve të përfshira në raportet e monitorimit të organizmave ndërkombëtarë (SIGMA, PEFA) mbi rëndësinë e zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe konceptit të përgjegjshmërisë menaxheriale, DH/MFK në bashkëpunim me ASPA-n, realizoi tre cikle trajnimesh 5-ditore, për nivele të ndryshme manaxheriale (gjithsej 63 pjesëmarrës).

c) Takime me titullarët e institucioneve publike përgjatë trajnimeve dhe monitorimeve mbi vlerësimin e performancës

Gjatë vitit 2017, drejtuesit e DPH/KBFP realizuan takime ndërgjegjësuese me menaxherët e nivelit të lartë të çdo ministrie linje, mbi vlerësimin e performancës së këtyre institucioneve për vitin 2016, ku morën pjesë rreth 52 menaxherë. Kjo praktikë, e ndjekur dhe gjatë vitit 2016, ka si synim evidentimin e gjetjeve kryesore lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm, bazuar në 20 indikatorë të matshëm të performancës së DH/MFK, DH/AB, Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme e Thesarit, të vlerësuar sipas metodologjisë së monitorimit.
Nëpërmjet këtyre takimeve ndërgjegjësuese, sugjerohen dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

d) Trajnime në disa institucone të qeverisjes së përgjithshme lidhur me implementimin e instrumentave të MFK-së, bazuar në kërkesat e tyre për asistencë

Gjatë vitit 2017, është vënë re një rritje e dukshme e institucioneve të cilat kërkojnë asistencë direkte për informimin dhe zbatimin në praktikë të instrumentave të MFK-së. DH/MFK, realizoi trajnimet në ish-Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Qëndrën për Trajnimin e Administratës Tatimore dhe Doganore, ku morën pjesë rreth 80 pjesëmarrës.

5. Detyra të tjera funksionale të DH/MFK

a) Shqyrtimi në vazhdimësi gjatë 2017, i kërkesave të ardhura nga njësitë publike për konfirmimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues

Edhe për vitin 2017 vazhdoi shqyrtimi i kërkesave të ardhura nga njësitë publike për konfirmimin e NA dhe NZ, ku mesatarisht shqyrtohen rreth 70 kërkesa në muaj.
Në nëntor të vitit 2017, në zbatim të nenit 32 të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, përfundoi periudha kalimtare mbi përmbushjen e kritereve për nëpunësit zbatues të përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr. 10296/2010 të MFK. Për këtë arsye, DH/MFK iu ka dërguar shkresë zyrtare të gjitha institucioneve publike, si dhe për dijeni Departamentit të Adminitratës Publike, për verifikimin e zbatimit të kritereve të nëpunësit zbatues . Për të gjithë nëpunësit zbatues ekzistues të cilët nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në ligj, është kërkuar marrja e masave të menjëhershme për plotësimin e këtij pozicioni me nëpunës të cilët plotësojnë kriteret dhe njoftimin e DH/MFK-së.

b) Informimi i BE për aktivitetet e realizuara nga DH/MFK

Në kuadër të procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, vendi ynë vlerësohet çdo vit për progresin e arritur në implementimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Informimi i BE për aktivitetet e zhvilluara nga DH/MFK për implementimin e kërkesave të MFK realizohet nëpërmjet përgatitjes së raporteve dhe materialeve të ndryshme të kërkuar në kuadër të PKIE dhe të raportimeve për Kapitullin 6, 22 dhe 32 të raport progresit.

6.2 Aktivitetet e DH/AB gjatë vitit 2017

Ministria e Financave dhe Ekonomisë monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike veprimtarinë e auditimit të brendshëm në të gjithë sektorin publik për përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara dhe praktikat më të mira Evropiane.

Kjo strukturë ka një komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me NJAB e ministrive të linjës, institucioneve të vartësisë, institucioneve të pavarura dhe të pushtetit vendor nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, dhënies së mendimeve për ndryshimet e akteve ligjore, zgjidhjen e problematikave të ndryshme, si dhe në analizën dhe vlerësimin e veprimtarisë së strukturave audituese në sektorin publik.

Bazuar në këtë dokument kyç, u arritën objektivat e drejtorisë për vitin 2017, duke u fokusuar në mënyrë të përmbledhur në këto drejtime:

1. **Hartimi dhe përmirësimi i bazës ligjore/nënligjore të fushës së auditimit të brendshëm**

Me synim arritjen e objektivave, gjatë kësaj periudhe, veprimtaria e DH/AB është përqëndruar në zbatimin e kuadrit rregullator dhe monitorimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Gjatë vitit janë miratuar dhe publikuar dy akteve me përmbajtje metodologjie:

Urdhri nr. 22, datë 06.03.2017 "Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik". Miratimi i kësaj metodologjie, ka si qëllim kryesor përcaktimin e procedurës që duhet të ndiqet për kryerjen e vlerësimit të jashtëm të cilësisë së veprimtarisë së NjAB-ve, për sigurimin e respektimit dhe zbatimit të standarteve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm në një nivel të lartë, si dhe identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim në këtë veprimtari.

Urdhëri nr. 40, datë 08.05.2017 "Për publikimin e standarteve ndërkombëtare për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm në sektorin publik të pranuara për zbatim në Republikën e Shqipërisë". Miratimi i këtij urdhëri, kishte si qëllim të garantonte funksionimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm mbi baza të një sistemi të integruar me Standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të publikuara nga Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA), të cilat ishin rishikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm (BSNAB) gjatë vitit 2016, por ndryshimet e tyre do të hynin në fuqi në fillim të vitit 2017.

2. **Monitorim i vazhdueshëm i funksionimit të njësive të auditimit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme**

a) Konsolidimi i Planit Strategjik dhe Vjetor 2018-2020 për veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik

Gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2017, drejtoria ka konsoliduar Planin Strategjik dhe Vjetor 2018-2020 për veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, duke ofruar një përmbledhje dhe analizë të dhënash strategjike dhe vjetore të planifikuara nga ana e drejtuesit e NJAB për veprimtarinë audituese në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Vlerësohen nëse janë reflektuar problematikat dhe mangësitë e evidentuara në vitin e mëparshëm si dhe përcaktohen prioritetet e këtij shërbimi në nivel strategjik. Ky dokument, pas konsolidimit i dërgohet për

informacion Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit sipas përcaktime ligjore.

b) *Roli i DH/AB në vlerësimi i detyrimeve të prapambetura*

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në fazën e hartimit të planeve strategjike dhe vjetore të veprimtarisë audituese për periudhën 2018-2020, i ka rekomanduar njësive të auditimit të brendshëm të përfshijnë angazhime auditimi për vlerësimin e situatës në njësitë publike përkatëse, në lidhje me detyrimet e prapambetura. Nga analiza e planit të konsoliduar të veprimatrisë së auditimit të brendshëm është evidentuar njësitë e auditimit të brendshëm kanë planifikuar dhe do të kenë në fokus të veprimatrisë situatën në lidhje me detyrimet e prapambetura.

Mirëmenaxhimi i fondeve publike është gjithmonë në fokus të audituesve të brendshëm, për këtë fakt detyrimet e prapambetura si problematikë evidente janë duke u trajtuar nga ekspertë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si temë specifike: "Roli i auditimit të brendshëm për parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura", në programin e trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm gjatë gjithë vitit.

c) Vlerësimi i jashtëm i cilësisë së auditimit të brendshëm

Që nga krijimi i strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik ka qenë detyrë funksionale e kësaj strukture mbikqyrja, vlerësimi ose monitorimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik. Gjatë gjithë këtyre viteve kjo veprimtari është realizuar pa pasur një metodologji specifike të miratuar, por është bazuar në vlerësimin e procedurave të Manualit të Auditimit të Brendshëm të ndjekura nga NJAB.

Metodologjia për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, u miratua me urdhër të Ministrit të Financave nr. 22, datë 06.03.2017. Implementimi i kësaj metodologjie u realizua nga DH/AB me bashkëpunimin dhe mbështetjen e ekspertëve të SIGMA.

***Qëllimi**: "Monitorimi dhe vlerësimi në mënyrë periodike i veprimtarisë së njësisë së auditimit të brendshëm, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara të auditimit".*

Baza ligjore e kësaj mëtodologjie:

- **Standardi 1312: Vlerësimet e Jashtme**
  *"Vlerësimet e jashtme duhet të kryhen të paktën **një herë në 5 vjet** nga një vlerësues i kualifikuar dhe*
  i pavarur, ose nga një skuadër vlerësuesish nga jashtë organizatës".
- **Neni 24 i Ligjit nr.114/2015**

DH/AB duhet të vlerësojë NJAB:

- Të paktëm një herë në 5 vjet;
- Në bazë të një procesi të përzgjedhjes nga vlerësimi i riskut;
- Në bazë të ankesave të pranuara;
- Në bazë të çështjeve të ngritura në media;
- Në bazë të kërkesës së vetë NJAB.

Aktualisht në sektorin publik funksionojnë 119 NJAB, të cilat kryejnë shërbimin e auditimit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. DH/AB në hartimin e planit të veprimtarisë çdo vit duhet të parashikojë të paktëm 24 vlerësime të jashtme të cilësisë së veprimtarisë audituese (Të paktëm një herë në 5 vjet). Pa marrë në konsideratë rastet e tjera të përcaktimit të vlerësimit të parashikuara më lart.

Struktura e miratuar aktualisht e DH/AB përbëhet nga 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë). Vlerësojmë se me kapacitetet në dispozicion kjo strukturë nuk mund të përmbushë detyrimin e përcaktuar në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranuara. Kufizimi i

kapaciteteve të kësaj strukture është evidentuar në disa nga raportet më të rëndësishme të organizmave ndërkombëtarë, si: Banka Botërore, SIGMA, etj.

Kjo metodologji ka të përcaktuar dy kritere vlerësimi: kriteret kryesore dhe kriteret dytësore. Kriteret e vlerësimit bazohen në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm (standardet e performancës dhe standardet atributive). Secili kriter shoqërohet me hapat të detajuar vlerësimi, të cilët përfshijnë hap pas hapi gjithë veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

Gjatë vitit u realizuan pesë vlerësime të jashtme të cilësisë. Vlerësimet e veprimtarisë së njësisë së auditimit të brendshëm në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Autoritetin Rrugor Shqiptar u zhvilluan nga stafi i DH/AB në suportin e ekspertëve të SIGMA. DH/AB vazhdoi vlerësimet e veprimtarisë audituese në njësinë e auditimit të brendshëm në Bashkinë Berat dhe në Bashkinë Fier. Menaxhimi i veprimtarisë së njësisë së auditimit, për sigurimin e një niveli të lartë të zbatimit të bazës ligjore në fushën e auditimit të brendshëm dhe standardeve ndërkombëtare të pranuara, monitorohet në mënyrë periodike nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

HAPAT E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM



Në objektivat e përcaktuara lidhur me vlerësimet e jashtme të cilësisë përfshihet, jo vetëm përputhshmëria e veprimtarisë audituese me kuadrin ligjor rregullator, por edhe efektiviteti dhe eficensa e këshillave dhe rekomandimeve të adresuara për subjektet e audituara.

Gjetjet dhe konkluzionet e vlerësimeve

Gjatë monitorimeve u përcaktuan fushat që kishin nevojë për përmirësim dhe u dhanë rekomandimet përkatëse për përafrim të veprimtarisë me standardet ndërkombëtare. Ndër gjetjet më të rëndësishme në këtë proces vlerësimi u evidentuan:

Shmangia në planifikim dhe realizim e angazhimeve të auditimit në fushat/sistemet e njësisë publike, pjesë e organigramës dhe fokusimi tek angazhimet e auditimit të subjekteve të varësisë. Karta e auditimit, si akt administrativ që përcakton statusin organizativ, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit nuk ishte në përputhje me strukturën e parashikuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm (MAB).

Implementimi i ngadaltë i procedurave të përcaktuara në MAB (e rishikuar), lidhur me planifikimin, raportimet periodike, sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe monitorimin e progresit të rekomandimeve të adresuara.
Përfshirja e audituesve të brendshëm në disa raste në veprimtari operacionale të ndryshme nga veprimtaria e auditimit të brendshëm, gjë që bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të auditimit të brendshëm.
Përfshirja në grupe auditimi i ekspertëve të jashtëm jo audituesi, financierë të subjekteve të varësisë, duke krijuar mundësi për konflikte të mundshme interesi. Në këtë vlerësim është patur parasysh që këta ekspertë janë subjekt auditimi.

Rekomandimet vlerësimeve

Bazuar në gjetjet konstatuara grupet e vlerësimit kanë dalë në konkluzione, të cilat janë trajtuar si gjatë vlerësimit dhe në raporte finale dhe për përmirësimin e veprimtarisë së auditimit në të ardhmen janë ardesuar rekomandimet përkatëse.
Në rekomandimet që lidhen me **kriteret kryesore** të vlerësimit mund të përmendim:

- Drejtuesit e Njësive të Auditimit të Brendshëm duhet t'i drejtohen titullarit të njësisë publike dhe strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, për të ndjekur një procedurë të përshkallëzuar kundërshtimi lidhur me përfshirjen e audituesve të brendshëm në veprimtari operacionale në njësinë publike me qëllim minimizimin e kërcënimeve të pavarësisë dhe objektivitetit të veprimtarisë audituese**. Standardi 1100: Pavarësia dhe Objektiviteti.**
- Drejtoria e Auditimit të Brendshëm me mbështetjen e menaxhimit të njësisë publike, në bashkëpunim me institucione që ofrojnë trajnime të specializuara, të nxisë ngritjen e nivelit të aftësive profesionale të audituesve të brendshëm në fushën e Teknologjisë së Informacionit. **Standardi 1200: Aftësia dhe Kujdesi i Duhur Profesional.**
- Njësitë e Auditimit të Brendshëm duhet jo vetëm të përfshijnë në planet strategjike dhe vjetore por dhe të realizojnë angazhime auditimi në të gjitha drejtoritë e njësisë publike, pjesë e organigramës së saj. **Standardi 2000: Menaxhimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm**.
- Implementim më i shpejtë i procedurave të përcaktuara në MAB e rishikuar, lidhur me planifikimin, raportimet periodike, sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe monitorimin e progresit të rekomandimeve të adresuara. **Standardi 2000: Menaxhimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm**.
- Shmangia e përfshirjes në grupe auditimi të ekspertëve jo audituesi, punonjës aktualë të drejtorive të financës në subjektet e varësisë, me qëllim mënjanimin e konflikteve të mundshme të interesit. **Standardi 2200: Planifikimi i angazhimit.**

Në rekomandimet që lidhen me **kriteret dytësore** të vlerësimit mund të përmendim:

- Përditësimi i Kartave të Auditimit të Brendshëm dhe plotësimi i strukturës sipas përcaktimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm në fuqi. **Standardi 1000: Qëllimi, Autoriteti dhe Përgjegjësitë.**
- Përcaktimi i indikatorëve të matjes së cilësisë së perfomancës së veprimtarisë audituese, me synim vlerësimin e përputhshmërisë së saj me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuara. **Standardi 1300: Sigurimi i Cilësisë dhe Programi i Përmirësimit.**
- Hartimi dhe miratimi i Programit të Siguridhënies dhe Përmirësimit të Cilësisë, për vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit me qëllim krijimin e këtij shërbimi. **Standardi 1300: Sigurimi i Cilësisë dhe Programi i Përmirësimit.**
- Në raportet e hartuara në përfundim të çdo angazhimi, grupi i auditimit duhet të shpreh një opinion të përgjithshëm lidhur me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në subjektet e audituara, bazuar në analizimet e kryera për realizimin e objektivave, zbatimin e prioriteteve, strategjive, si dhe për administrimin e fondeve, aktiveve. **Standardi 2100: Natyra e Punës**
- Kryerja e një monitorimi më efektiv në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të adresuara në subjektet e audituara, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë për ndikimin e mos

zbatimit të tyre në arritjen e objektivave të përcaktuara. **Standardi 2500: Monitorimi i Progresit.**

Opinion i përgjithshëm:
Njësitë e auditimit të brendshëm duhet të tregojnë kujdesin e duhur professional, për të zhvilluar dhe përcaktuar indikatorët e performancës, si dhe programin për përmirësimin e cilësisë, i cili duhet të mbulojë të gjithë aspektet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Të gjitha në kuadër të të realizimit të objektivit kryesor që veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor në fuqi.

3. Analiza e Pyetësorëve të vetëvlerësimit të njësive të auditimit të brendshëm

Njësitë e auditimit të brendshëm për vitin 2017, kanë plotësuar Pyetësorin e vetëvlerësimit të NJAB, bazuar në Udhëzimin nr.89, datë 28.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike". Nga 115 NJAB të cilat kanë raportuar, këtë pyetësor e kanë plotësuar 110 NJAB.

Analiza e Pyetësorit të vetëvlerësimit fokusuar në katër grupime pyetjesh, përkatësisht mbi:

- Funksionimin e NJAB sipas akteve ligjore;
- Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve nga NJAB;
- Planin e veprimit dhe monitorimin e rekomandimeve;
- Raportimin e veprimtarisë audituese.

Grafiku 12. Funksionimi i NJAB sipas akteve ligjore



NJAB në sektorin publik duhet të funksionojnë në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi, e cila është e bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe duhet të përbëhen minimalisht nga tre audituesë. Ky kriter nuk është i plotësuar nga një pjesë e NJAB dhe kjo sjell si pasojë edhe mosfunksionimin si duhet të tyre. Nga analiza e të dhënave 68% e NJAB janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, pra e përmbushin këtë kriter.

Çdo NJAB ka detyrimin ligjor të hartojë dhe përmirësojë herë pas here Kartën e Auditimit të Brendshëm (KAB). KAB përcakton statusin organizativ të NJAB, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e NJAB. Nga të dhënat e konsoliduara shihet se 72% e NJAB i kanë KAB të miratuara, të rishikuara dhe që i përmbushin kriteret.

NJAB duhet të përfshijnë në aktivitetin e tyre të gjithë fushat e përgjegjësisë shtetërore të njësisë publike që përfaqësojnë. Nga analiza e të dhënave ka rezultuar që 71% e NJAB përfshijnë në veprimtarinë e tyre gjithë aktivitetin e njësisë publike. Problematika më e madhe në këtë fushë janë veprimtaria audituese e disa NJAB në ministritë e linjës, të cilat nuk programojnë auditimin

e aparateve të ministrive si subjekte me risk të lartë, dhe si shpenzuese të vlerave të konsiderueshme monetare.

Roli i auditimit të brendshëm është të ndihmojë njësinë publike në arritjen e objektivave. Objektivat e NJAB gjithnjë duhet të jenë në përputhje me objektivat e njësisë publike. Nga analiza e të dhënave, vihet re se 88% e NJAB i kanë objektivat e tyre në përputhje me objektivat e njësive publike në të cilat ato operojnë.

Është detyrë e NJAB që në procesin e planifikimit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e njësive publike. Në bazë të këtij identifikimi dhe vlerësimi organizohet puna që njësitë e identifikuara me risk të lartë të përfshihen në planin vjetor të auditimit. Nga analiza e përgjigjeve të NJAB, rezulton që 55% e tyre e bazojnë planin e auditimit plotësisht në vlerësimin e riskut të veprimtarisë së njësisë publike dhe 42 % e tyre bazohen pjesërisht. Vihet re se ne këtë fushë ka vend për përmirësime në të ardhmen.

Grafiku 13. Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i risqeve



Në lidhje me identifikimin dhe vlerësimin e drejtë nga NJAB të risqeve që lidhen me objektivat, në 46% të NJAB procesi i identifikimit dhe vlerësimit të riskut mbulon të gjitha fushat e auditimit, në 41% të njësive vlerësojnë këto risqe por duhet një punohet më shumë për vlerësim real të tyre.

Plani i veprimit është një dokument i rëndësishëm i një angazhimi auditimi, i cili hartohet nga pala e audituar dhe miratohet nga titullari i njësisë publike të audituar. Afatet e zbatimit të rekomandimeve diskutohen paraprakisht për të qenë sa më konciz dhe të saktë, që parregullsitë e vërejtura të mos përsëriten. Nga të dhënat e analizuar 60% e NJAB përmbushin këtë kriter, pra hartimi i planit të veprimit kryhet nga pala e audituar, diskutohet dhe miratohet nga titullari i njësisë dhe i dërgohet zyrtarisht NJAB.

Grafiku 14. Plani i Veprimit dhe monitorimi i rekomandimeve



Vihet re se, përgjigjet në lidhje me përputhshmërinë e rekomandimeve me gjetjet përkatëse dhe monitorimin e tyre rezultatet janë pozitive, 83% të NJAB rekomandimet i kanë të lidhura plotësisht me gjetjet dhe vetëm 65% e NJAB i monitorojnë ato vazhdimisht.

Grafiku 15. Raportimi i veprimtarisë audituese



Manuali i auditimit të brendshëm ka një procedurë të qartë në lidhje me raportimin e angazhimit të auditimit. Vihet re se 76% e NJAB përgatisin dhe dërgojnë raportin e auditimit në përputhje me kërkesat e Manualit të auditimit të brendshëm, 23% e NJAB janë në përpthje të pjesshme me kërkesat e MAB.

Dosja e një angazhimi auditimi duhet të plotësohet me përpikmëri me të gjitha letrat e punës si: programi i angazhimit, dokumentet justifikues të gjetjeve, projekt-raporti, vërejtjet e palës së audituar, raporti final, etj. Nga të dhënat e konsoliduara vihet re se 79% e NJAB i bashkëngjisin në dosje vërejtjet e subjektit të audituar.

Pas plotësimit të dosjeve të auditimit sipas përcaktimeve të Manualit të Auditimit të Brendshëm, ato arkivohen sipas kuadrit rregullator në fuqi. Nga analiza e përgjigjeve vihet re se 58% e NJAB kryejnë arkivimin e dosjeve të përhershme sipas përcaktimeve ligjore. Vihet re se një pjesë e konsiderueshme e NJAB nuk kanë dosje të përhershme dhe drejtuesit e NJAB duhet të marrin masa për përmbushjen e këtij kriteri.

Nga analiza në tërësi e "Pyetësorit të vetëvlerësimit", vihet re që në masë të konsiderueshme NJAB kanë qenë të qarta dhe koncize në përgjigjet e tyre. Të dhënat tregojnë që përgjigjet e dhëna janë shumë afër të dhënave reale, të cilat janë analizuar nga raportet vjetore të veprimtarisë së NJAB.

Në lidhje me problematikat e konstatuara në këtë analizë, DH/AB do të ketë një nga prioritetet e saj ndërgjegjësimin dhe koordinimin më të madh të informacionit me NJAB për mirëfunksionimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në përafrim të plotë me standardet ndërkombëtare.

4. Trajnimi i vijueshëm profesional dhe certifikimi i audituesve të brendshëm

a) Trajnimi i Vijueshëm Profesional i organizuara në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA)



Bazuar në "Programin e trajnimit të vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik për vitin 2017", i miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.136, datë 30.12.2016, është zhvilluar trajnimi i vijueshëm profesional i 313 audituesve të brendshëm në detyrë. Ky proces është organizuar nga DH/AB në bashkëpunim dhe me ASPA në kuadër të përditësimit të njohurive të audituesve të brendshëm të çertifikuar në detyrë.

Objektivi strategjik i zhvillimit profesional të audituesve të brendshëm është krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për zbatimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe modern të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

Sistemet e kontrollit duhet të vlerësohen nga një staf i mirë trajnuar, për të siguruar se fondet publike përdoren me efektivitet, eficiensë dhe ekonomi, duke ju përmbajtur standardeve profesionale ndërkombëtare (IIA), Standardi 1230, sipas të cilit audituesit e brendshëm duhet të përforcojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e tyre përmes zhvillimit të vijueshëm profesional.

Trajnimi i vijueshëm profesional për vitin 2017 u organizua bazuar në urdhërin e Ministrit të Financave nr.136, datë 30.12.2016 "Për miratimin e programit të trajnimit të vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik për vitin 2017", i cili në të cilin u programuan të gjithë auditues të brendshëm në detyrë.

Në përgatitjen e programit të trajnimit u analizuan kërkesat individuale të identifikuara në formularët e vlerësimit të trajnimeve të mëparshme, kërkesat e paraqitura nga intervistat sporadike me audituesit, gjatë zhvillimit të fazave të trajnimit dhe analizën e nevojave për trajnim të identifikuara nga drejtuesit e NJAB dhe audituesit e brendshëm. Trajnimi për vitin 2017 u konceptua në 4 module, sipas grupeve të synuara (periudha Mars-Tetor), konkretisht:

- Në modulin e I-rë, u përfshinë drejtuesit e NJAB të ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore;
- Në modulin e II-të, u përfshinë audituesit e brendshëm të ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore;
- Në modulin e III-të, u përfshinë drejtuesit dhe audituesit e NJAB të punësuar në qeverisjen vendore;
- Në modulin e IV, u përfshinë audituesit institucioneve qendrore të përcaktuar për auditimin e fondeve IPA.

Përgatitja e moduleve dhe zhvillimi i trajnimit, u krye në 13 javë nga trajnërë të përzgjedhur sipas përcaktimeve ligjore, por duhet të theksojmë që pjesa më e madhe e tyre ishin pjesë e Trajnimit të Trajnerëve të organizuar me ekspertë të Projektit të binjakëzimit Austriako-Francez "Implementimi i një sistemi modern të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Inspektimi Financiar në Shqipëri", i financuar nga fondet IPA 2012.

Për të siguruar që trajnimi të jetë sa më i dobishëm dhe frytdhënës, metodologjia e trajnimit u orientua si drejt teorisë, po ashtu dhe praktikës, duke marrë në konsideratë mjedisin aktual me të cilin përballet stafi i njësive publike, në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe fushën e auditimit të brendshëm. Trajnimi përveç pjesës teorike përmban rastet studimore, puna në grupe, si dhe shkëmbimin e eksperiencat profesionale të audituesve ndërmjet njëri tjetrit.

Nga analiza e veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm konstatohet se ka rritje në cilësinë e rekomandimeve të lëna për zbatim, kjo falë programeve të trajnimit të vijueshëm profesionale të organizuara nga DH/AB.

Programi i trajnimit ishte një ndërveprim ndërmjet teorisë, praktikës dhe pjesëmarrësve me qëlllim përshtatjen e kërkesave të audituesve me objektivat e zhvillimit të njësive publike dhe qeverisjes në përgjithësi.

Tabela 14. Të dhënat e audituesve të trajnuar

Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Plan/Fakt	Plan/Fakt	Plan/Fakt	Plan/Fakt	Plan/Fakt	Plan/Fakt
0/0	328/80	388/280	360/349	302/302	313/313

Këto trajnime vlerësohen që kanë patur një efekt pozitiv në procesin e përditësimit të njohurive të audituesve. Efektet pozitive të njohurive të përfituara gjatë këtyre trajnimeve kanë dhënë frytet e tyre në mënyrën e konceptimit të angazhimeve të auditimit, mënyrën e planifikimit dhe raportimit të rezultateve.

b) Çertifikimi i punonjësve të njësive të auditimit të brendshëm

Në muajin Qershor 2017, DH/AB në bashkëpunim me Komisionin e Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm (KKAB) përfundoi me sukses procesin e çertifikimit të audituesve të brendshëm për sezonin 2016-2017, të cilin cilin e ndoqën 42 pjesëmarrës dhe në fund të procesit u çertifikuan si "Auditues të brendshëm në sektorin publik" 37 pjesëmarrës.

Fillimi i procesit të certifkimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik për sezonin 2017-2018 u miratua me urdhër të Ministrit të Financave nr.34, datë 14.04.2017. Bazuar në kuadrin rregullator organizimin e këtij procesi e realizoi DH/AB në bashkëpunim me KKAB. Në këtë proces aplikuan për regjistrim 74 kandidatë për auditues të brendshëm dhe vetëm 51 prej tyre plotësuan kriteret sipas përcaktimeve ligjore për të ndjekur këtë proces. Programi çertifikimit është në vitin e dytë të aplikimit dhe ka marrë vlerësime pozitive si nga trajnerët e përfshirë në proces ashtu dhe nga kandidatët për auditues të brendshëm.

Gjatë vitit 2017 u zhvilluan trajnimet në Modulin Bazë 1 "Mjedisi i auditimit të brendshëm", Modulin Bazë 2 "Standardet profesionale për auditimin e brendshëm", Modulin bazë 3 "Planifikimi i auditimit të brendshëm", dhe organizuan provimet për testet paraprake në të tre modulet.

Aktualisht, janë zhvilluar trajnimet në Modulin Bazë 4 "Kryerja e auditimit të brendshëm", Modulin Bazë 5 "Raportimi i auditimit të brendshëm", Modulin bazë 6 "Aftësitë dhe teknikat e auditimit të brendshëm", dhe organizuar provimet për testet paraprake në të tre modulet.

Në muajin Maj 2018, u zhvillua provimi me shkrim për tesitimin e njohurive të kandidatëve për të fituar titullin "Auditues i brendshëm në sektorin publik". Në këtë provim plotësuan kriteret e përcaktuara vetëm 48 kandidatë nga 51 kandidatë të regjistruar. Ky proces çertifkimi finalizohet në muajin Korrik 2018.

Opinion i përgjithshëm:
Trajnimi i vijueshëm profesional, i mbështetur në metodologji dhe teknika bashkëkohore të përshtatshme për kushtet e zhvillimit të auditimit të brendshëm në sektorin publik, do të ketë impakt pozitiv në rritjen e cilësisë së veprimtarisë audituese.
Profesionistët e rinj në fushën e auditimit do të japin kontributin e tyre në njësitë e auditimit të brendshëm me njohuritë e bashkëkohore të fituara në fushën e auditimit të brendshëm.
Nëpërmjet këtyre programeve synohet zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe efektiv trajnimi me qëllim nxitjen dhe motivimin e çdo audituesi për t'u zhvilluar profesionalisht.

5. Detyra të tjera funksionale të DH/AB

a) Shqyrtimi në vazhdimësi gjatë 2017, i problematikave të njësive të auditimit të brendshëm sipas kërkesave të ardhura nga njësitë publike

Gjatë vitit 2017 janë shqyrtuar një sërë kërkesash të ardhura nga njësitë publike mbi problematikat e funksionimit të auditimit të brendshëm.

Këto problematika kanë konsistuar në krijimin dhe funskionimin e Komiteteve të Auditimit në ministritë e Linjës, zbatimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, konflikte ndërmjet NJAB dhe subjekteve të audituara, konfirmime mbi kryerjen e procesit të çertifikimit dhe trajnimit të vijueshëm profesional, etj.

Një komunikim i rëndësishëm ka qenë ndërmjet DH/AB dhe Kontrollit të lartë të Shtetit, në vazhdim të implementimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për fushat e auditimit të jashtëm, auditimit të brendshëm, menaxhimit financiar dhe inspektimit financiar.

b) Informimi i BE për aktivitetet e realizuara nga DH/AB

Në kuadër të procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, vendi ynë vlerësohet çdo vit për progresin e arritur në implementimin e auditimit të brendshëm.

Informimi i BE për aktivitetet e zhvilluara nga DH/AB implementimin e kërkesave të auditimit të brendshëm realizohet nëpërmjet përgatitjes së raporteve dhe materialeve të ndryshme të kërkuar në kuadër të PKIE dhe të raportimeve për Kapitullin 6, 22 dhe 32 të raport progresit.

Konkluzione mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm gjatë vitit 2017

Në vlerësimin e DH/AB, përmirësimet e vërejtura në veprimtarinë e auditimit të brendshëm, gjatë vitit të kaluar janë në drejtim të:

Finalizimit të hartimit dhe miratimit të një kuadri të plotë ligjor dhe nënligjor në fushën e auditimit të brendshëm, i cili do t'i vijë në ndihmë njësive të auditimit të brendshëm për të realizuar një shërbim sa më cilësor, bashkëkohor dhe në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit, të pranuara.

Përditësimit të njohurive të audituesve të brendshëm nëpërmjet programeve bashkëkohore të trajnimit të vijueshëm professional, të cilat përveç pjesës teorike kanë trajtuar raste studimore, punë në grupe, si dhe shkëmbimin e eksperiencat profesionale të audituesve ndërmjet njëri tjetrit.

Organizimit i një procesi kombëtar çertifikimi, që i ofron kandidatëve njohuritë bazë për profesionin e audituesit të brendshëm. Në risitë e procesit përmendim materialet e trajnimit të fokusuara tërësisht në fushën e auditimit të brendshëm, numrin e kufizuar të pjesëmarrësve, lektorët e mirëtrajnuar, mënyra e organizimit të testeve paraprake, provim me shkrim dhe prezantimi i rastit studimor.

Implementimit të metodologjisë së vlerësimit të jashtëm të cilësisë mbi veprimtarinë e njësive të auditimit të brendshëm, me anë të së cilës u monitorua përshtatshmëria me kuadrin rregullator e veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm, u përcaktuan gjetjet dhe u adresuan rekomandimet për fushat që kërkonin përmirësim në të ardhmen.

Fokusi i auditimit të brendshëm gjatë vitit 2018

Bazuar në risqet dhe problematikat e konstatuara, gjatë vitit 2018 veprimtaria e auditimit të brendshëm do të fokusohet tek çështje të tilla si:

- Monitorimi i vazhdueshëm i organizimit, funksionimit dhe shtrirjes së shërbimit të auditimit të brendshëm në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, si dhe nivelin e përputhjes me standardet ndërkombëtare, të pranuara. Për rritje të trasparencës dhe përgjegjëshmërisë më të lartë mbi përdorimin e fondeve publike, kërkohet nga titullarët që shërbimi i auditimit të brendshëm të ushtrohet me kompetencë, kujdes profesional, aftësi e trasparencë.

- Organizimi dhe zhvillimi i trajnimeve të vijueshme profesionale për zhvillimin profesional dhe përditësim të njohurive të të gjithë audituesve të brendshëm të çertifikuar në detyrë dhe trajtimi në to i temave sa më efektive mbi fushat dhe përgjegjësitë e njësive publike, si dhe përditësimi me të rejat e vendeve të rajonit e më gjerë.
- Organizimi dhe menaxhimi i procesit të çertifikimit për sezonin 2018-2019, për t'i ofruar punonjësve të rinj të njësive të auditimit të brendshëm ndihmë profesionale dhe një kualifikim cilësor për marrjen e njohurive bazë në këtë fushë.
- Roli që auditimi i brendshëm ka në zhvillimet e reformave të financave publike kërkon kuptimin e drejtë dhe mbështetjen e duhur nga menaxhimi i lartë, për këtë duhet ndërgjegjësim i vazhdueshëm i tyre për rolin dhe përgjegjsitë e auditimit të brendshëm.
- Monitorimi në vazhdimësi i nivelit të zbatimit dhe cilësisë së rekomandimeve të dhëna gjatë realizimit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me qëllim që auditimi të shihet si vlerë e shtuar nga titullarët e njësive publike dhe të gjithë grupet e interesit.
- Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së auditimit të brendshëm, nëpërmjet kryerjes së vlerësimeve të jashtme të cilësisë, për përputhje të kësaj veprimtarise me standardet ndërkombëtare, të pranuara.
- Në kuadër të propozimit të projektit "EU Technical assistance to support the strengthening of the capacities for the implementation of Public Financial Management Strategy", i cili është duke u implementuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, do të diskutohet në takimet e sekretariatit të përbashkët me Kontrollin e Lartë të Shtetit nevoja e hartimit të një metodologjie të përbashkët për auditimin e detyrimeve të prapambetura.

Tabela 15. Lidhja e Strategjisë së MFP 2014-2020 me Planin e Aktiviteteve të MFK

Produkti	Veprimet që do të ndërmeren	Statusi i realizimit	Kur? Afati për realizimin e aktivitetit
REFERENCA PËR AKTIVITETET STRATEGJIKE:			
	AKTIVITETI 1 – Akte ligjore/nënligjore në fushën e MFK-së		
Hartimi dhe përmirësimi i bazës ligjore/nënligjore të fushës së kontrollit të brendshëm	– Draftimi i udhëzimit për për delegimin e detyrave të punonjësve në institucionet e sektorit publik	30%	Tetor 2018
	– Finalizimi i Udhëzimit "Për Evidencimin, Rregjistrimin, Përdorimin dhe Raportimin e Financimeve të Huaja në Kuadrin e Projekteve dhe Marrëveshjeve me Donatorët e Huaj"	70%	Qershor 2018
	– Finalizimi i Udhëzimit "Mbi Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit".	100%	Shkurt 2018
	– Rishikimi i Urdhrit nr. 89, datë 28.12.2015 "Për miratimin e Metodologjisë së Monitorimit të Performancës së Njesive Publike	0%	Dhjetor 2018
	AKTIVITETI 2 – Implementimi i një sistemi modern të MFK në 4 institucione pilot		
Sistemet e MFK të përmirësuara në 4 njësi publike	– Organizimi i punës për përgatitjen e regjistrit të riskut dhe planit të veprimit për minimizimin e risqeve	0%	Qershor 2018
	– Organizimi i punës për përgatitjen e manualeve të proceseve të punës	20%	Korrik 2018
	– Organizimi i punës për përgatitjen hartimin e gjurmëve të auditimit	0%	Shtator 2018
	– Organizimi i punës për përgatitjen e Planit të Kontrollit të Brendshëm	0%	Tetor 2018
AKTIVITETI 3 – Rritja e ndërgjegjësimit të njësive publike mbi përfitimet e implementimit të konceptit të përgjegjshmërisë menaxheriale			
Ndërgjegjësimi i njësive publike mbi rolin dhe rëndësinë e zbatimit të sistemit të MFK-së dhe konceptit të përgjegjshmërisë	– Monitorimi i zbatimit të MFK me qëllim vlerësimin e nivelit të zbatueshmërisë së kërkesave të ligjit të MFK-së dhe akteve nënligjore në zbatim të tij	100%	Mars-Prill 2018

menaxheriale	– Organizimi i trajnimeve dhe seminareve të ndërgjegjësimit, për nivele të ndryshme të menaxhimit në bashkëpunim me ASPA	20%	Gjatë gjithë vitit
	– Trajnime Specifike në varësi të kërkesave të institucioneve për asistencë lidhur me implementimin e sistemit të MFK	0%	Gjatë gjithë vitit
	– Vlerësimi i performancës bazuar në raportin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në 11 ministri linje	100%	Maj 2018
	– Seminare ndërgjegjësimi me drejtuesit e lartë të NJQP (Sekretarë të Përgjithshëm dhe menaxherë të tjerë) rreth përfitimeve të konceptit të përgjegjshmërisë manaxheriale	0%	Shtator 2018
AKTIVITETI 4- Përmirësimi në fushën e Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Privat në Shqipëri			
Përmirësimi në fushën e Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Privat në Shqipëri	– Miratimi i Udhëzimit të përkohshëm nr. 8, datë. 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"	100%	Mars 2018
	– Miratimi i Ligjit të Ri për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare brenda vitit 2018	100%	Maj 2018
	– Përditësimi i bazës aktuale rregullatore të kontabilitetit në sektorin publik	0%	Gjatë gjithë vitit
	– Vlerësimi i hendekut midis bazës aktuale rregullatore në vend dhe standardeve ndërkombëtare	100%	Janar 2018
	– Përgatitja e planit të veprimt për zbatimin e standardeve ndërkombëtare, me mbështetjen e projektit të Bankës Botërore "Për zbatimin e IPSAS".	0%	Gjatë gjithë vitit

Tabela 16. Lidhja e Strategjisë së MFP 2014-2020 me Planin e Aktiviteteve të AB

Produkti	Veprimet që do të ndërmeren	Statusi i realizimit	Kur? Afati për realizimin e aktivitetit
REFERENCA PËR AKTIVITETET STRATEGJIKE:			
	AKTIVITETI 1 – Akte ligjore/nënligjore në fushën e AB -së		
Hartimi dhe përmirësimi i bazës ligjore/nënligjore të fushës së auditimit të brendshëm	– Miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, miratuar me urdhër nr.100, datë 25.10.2016.	0%	Shtator 2018
	AKTIVITETI 2 – Zhvillimi Profesional i audituesve të bredshëm në sektorin publik		
Zhvillimi profesional i audituesve të brendshëm	– Organizimi dhe zhvillimi i trajnimit të vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm në detyrë.	55%	Nëntor 2018
	– Përfundimi i procesit të çertifikimit të kandidatëve për audites të brendshëm për sezonin 2017 -2018	90%	Korrik 2018
	– Organizimi i procesit të çertifikimit të kandidatëve për audites të brendshëm për sezonin 2018 -2019	10%	Qershor 2019
	AKTIVITETI 3 – Kryerja e vlerësimeve të jashtme të cilësisë së veprimtarisë audituese		
Zbatimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm nga NJAB	– Vlerësimi i jashtëm i cilësë së veprimtarisë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit	100%	Mars 2018
	– Vlerësimi i jashtëm i cilësë së veprimtarisë në Ministrinë e Mbrojtjes	100%	Mars 2018
	– Vlerësimi i jashtëm i cilësë së veprimtarisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	100%	Maj 2018
	– Vlerësimi i jashtëm i cilësë së veprimtarisë në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme	100%	Maj 2018
	– Vlerësimi i jashtëm i cilësë së veprimtarisë në Ministrinë e Brendshme	20%	Qershor 2018
	– Vlerësimi i jashtëm i cilësë së veprimtarisë në Ministrinë e Drejtësisë	0%	Korrik 2018

	– Vlerësimi i jashtëm i cilësë së veprimtarisë në Ministrinë e Bujqësisë	0%	Korrik 2018
	– Vlerësimi i jashtëm i cilësë së veprimtarisë në Bashkinë Gjirokastër	0%	Shtator 2018
	– Vlerësimi i jashtëm i cilësë së veprimtarisë në bashkinë Bulqizë	0%	Tetor 2018
	– Vlerësimi i jashtëm i cilësë së veprimtarisë në Ministrinë e Kulturës	0%	Nëntor 2018
	AKTIVITETI 4- Analiza e funksionimit të njësive të auditimit të brendshëm		
Analiza e indikatorëve të performancës së NJAB	– Hartimi i Raportit të konsoliduar mbi veprimtarinë e njësive të auditimit të brendshëm për vitin 2017, pjesë e raportit të konsoliduar për kontrollin e brendshëm në sektorin publik	100%	Maj 2018
	– Analiza dhe konsolidimi i planeve strategjike dhe vjetore te njësive të auditimit të brendshmë në sektorin publik 2019-2021	0%	Dhjetor 2018
	– Raportimi periodik në Sektorin e Integrimit Europian në kuadër të Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit	0%	Gjatë gjithë vitit

ANALIZA E DETAJUAR E MINISTRIVE, BASHKIVE, INSTITUCIONEVE TË PAVARURA DHE INSTITUCIONEVE TË GRUPIT 87, NË VARËSI TË KRYEMINISTRISË PËR VITIN 2017

Ky raport është përgatitur nga: Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

LISTA E SHKURTIMEVE

AB	Auditimi i Brendshëm
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Europian
KBFP	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
KB	Kontrolli i Brendshëm
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NPA	Nëpunës i Parë Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
DH/AB	Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm
DH/MFK	Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin
NJQP	Njësi e Qeverisjes së Përgjithshme
NJQQ	Njësi e Qeverisjes Qendrore
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
GMS	Grupi për Menaxhimin Strategjik
RSH	Republika e Shqipërisë

ANEKS 1. ANALIZA E DETAJUAR E MINISTRIVE, BASHKIVE, INSTITUCINEVE TË PAVARURA DHE GRUPI 87, NË VARËSI TË KRYEMINSTRISË

✓ Monitorimi i Performancës për ministritë e linjës

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) të Ministrive të Linjës për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e dhjetë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është vlerësuar me 530 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, e renditur në vendin e parë në rankimin e ministrive. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1. Vlerësimi i Indikatorëve për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	25	4%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	2%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	10	43.84%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	30	1.4%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	17.3%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	0.66%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	30	0%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	20	3
14.Informimi dhe komunikimi	30	4
15.Monitorimi	30	4
16.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
20. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	25	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë ministri gjatë vitit 2017 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 4% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë ministri, është 25 pikë, duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket intervalit të dytë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 2%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, të gjitha urdhër-shpenzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2017, për këtë institucion, raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 43.84%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e katërt të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 10 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që një asnjë urdhër-prokurim nuk ka qënë i paautorizuara kur është paraqitur në APP. Në këtë aspekt bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është maksimal 30 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik

1. Duke u bazuar në raportet e monitorimit që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka dorëzuar raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.

2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit buxhetor. Gjatë vitit 2017, ky institucion ka realizuar 98.6% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 1.4%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë është 30 pikë, çka flet për një performancë shumë të mirë të këtij institucioni.
3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale** është një indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Buxhetit, i cili evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka realizuar rreth 82.67% të shpenzimeve kapitale të planifikuara, duke evidentuar në këtë mënyrë një nivel mosrealizimi të shpenzimeve kapitale prej 17.3% që është shumë më i lartë se ato korrente (1.4%). Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 15 pikë, duke qënë se përqindja e mësipërme i përket intervalit të tretë të këtij sistemi vlerësimi.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2017 ka qenë 11 dhe shuma në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 382,754. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në %) është 0.66%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, pikët për këtë institucion, përsa i përket këtij indikatori, janë 30 pikë. Këto rialokime janë bërë në kuadër të shpenzimeve për paga dhe sigurime, për shpenzime operative, për ekzekutim vendimesh gjyqësore si dhe për kuota ndërkombëtare. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka një performancë shumë të kënaqshme për këtë indikator.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikatori i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, gjatë vitit 2017 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare, të cilat i përkasin segmentit 0-4 pikë. Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.7 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Menaxhimi i riskut dhe aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar respektivisht me 3.3 pikë dhe 3.43 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi kanë marrë mesatarisht 4 pikë secili, duke u vlerësuar maksimalisht me 30 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të mira.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë**, paraqet indikatorët e mëposhtëm.

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesit e brendshëm janë të certifikuar kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, kurse një audites duhet të ndjekë procesin e certifikimit në dy vitet e para të punësimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB prej vitesh ka një përpikmëri në lidhje me afatet e raportimit dhe ka marrë vlerësimet maksimale. (30 pikë)

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 22 dhe ka realizuar 27 angazhime auditimi (1 a.performance dhe 26 a. të kombinuara).

Gjatë këtij viti vlerësojmë që është e vetmja NJAB që ka përcaktuar saktë indikatorët e performancës, ka miratuar programin për përmirësimin e cilësisë, si dhe ka kryer angazhime auditimi të performancës. Kjo NJAB në të gjitha raportet e auditimit jep opinion të përgjithshëm për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 10 punonjës (1 drejtues dhe 9 specialistë), dhe aktualisht kjo NJAB ka vend vakant të një audituesi të brendshëm. (25 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për vitin 2017

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë është vlerësuar me 510 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, e renditur në vendin e dytë në rankimin e ministrive. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 2. Vlerësimi i Indikatorëve për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	10%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	1%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	10	47.65%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	30	2%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	12.45%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	0.41%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	10	45.6%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	30	4
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14.Informimi dhe komunikimi	30	4

15.Monitorimi	30	4
16.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
20. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	25	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë ministri, gjatë vitit 2017 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 10% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket intervalit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 1%, çka flet për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, duke u vlerësuar me 30 pikë maksimale.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër-Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, 99% e urdhër-shpenzimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një performancë jo e kënaqshme, pasi 47.65% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor, ndaj dhe është vlerësuar me 10 pikë, duke qënë se ndodhet ne intervalin e katërt të vlerësimit.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%., duke treguar një një performancë shumë të kënaqshme të këtij institucioni lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik

1. Duke u bazuar në raportet e monitorimit që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë, që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie kanë përmbushur kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin buxhetor. Gjatë vitit 2017, ky institucion ka realizuar 98% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është 2%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë është 30 pikë maksimale, çka flet për një performancë shumë të mirë të këtij indikatori.
3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale,** është indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Buxhetit. Ky indikator evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka realizuar këto shpenzime ne masën 87.55% dhe ka një mosrealizim të këtyre shpenzimeve me 12.45%. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 15 pikë çka flet për një nivel mesatar të këtij indikatori.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2017 ka qënë 6 dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 133,346. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në %) është 0.41%. Kryesisht, këto rialokime janë bërë për shpenzime për kuota ndërkombëtare, për bursa, për likuidim detyrimesh të prapambetur si dhe për financim federatash. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion, përsa i përket këtij indikatori, është maksimal me 30 pikë.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikatori i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, përqindja e detyrimeve të prapambetura të krijuara gjatë vitit 2017 është 45.6%. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 10 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare, të cilat i përkasin segmentit 0-4 pikë. Për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.8 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti "Menaxhimi i riskut" arrin në të njëjtin nivel vlerësim me 3.5 pikë, duke i korresponduar kështu të njëjtit niveli vlerësimi me 30 pikë, sipas metodologjisë së monitorimit. Gjithashtu, komponenti i aktiviteteve të kontrollit, Informimi dhe komunikimi si dhe monitorimi janë vlerësuar mesatarisht me 4 pikë, 3.8 pikë dhe 3.75 pikë, duke marrë secili nga 30 pikë maksimale. Pra,

sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të mira. Kjo vjen edhe si rezultat pasi kjo ministri ka qënë institucion pilot në projektin e binjakëzimit të Ministrisë së Financave (2014-2016), gjë që ka ndikuar në një vlerësim më realist të komponentëve të MFK-së.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. Kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me (30 pikë).

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 19 angazhime auditimi dhe ka realizuar 22 angazhime auditimi (19 a. të kombinuara dhe 3 a. me kërkesë të titullarit, të paplanifikuara). NJAB nuk ka vlerësuar funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në aparatin e ministrisë duke dobësuar në këtë mënyrë rolin dhe misionin e auditimit të brendshëm dhe duke ulur efektivitetin e punës së auditimit.

NJAB duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës dhe të kryejë sigurimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet përcaktimit të indikatorëve të performancës dhe hartimit të programit të përmirësimit të cilësisë.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), dhe aktualisht ka një vend vakant të specialistit në NJAB. Audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar. (25 pikë).

<u>Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Brendshme për vitin 2017</u>

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Brendshme është vlerësuar me 495 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, e renditur në vendin e katërt në rankimin e ministrive. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 3. Vlerësimi i Indikatorëve për Ministrinë e Brendshme

Ministria e Brendshme	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	9%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	25	5%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	5	55.2%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	1%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%

7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	30	1.69%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	23.75%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	1.15%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	15	16.9%
11. Mjedisi i kontrollit	20	3
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14.Informimi dhe komunikimi	30	4
15.Monitorimi	30	4
16.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
20. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	25	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë ministri, gjatë vitit 2017 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 9% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë ministri është 15 pikë, duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket intervalit të tretë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për ministrinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 5%, çka flet për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 25 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i konsiderueshëm i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 55.2%. Kjo përqindje e kontratave që

nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e pestë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 5 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë të dobët si dhe theksojnë nevojën për marrjen e masave të menjëhershme në këtë drejtim.

5. **Urdhër-prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 1%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik

1. Duke u bazuar në raportet e monitorimit që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Brendshme i ka dorëzuar raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë, që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit buxhetor. Gjatë vitit 2017, ky institucion ka realizuar 98.31% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është 1.69%. Bazuar në këtë performancë të ministrisë përkatëse, vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë është 30 pikë, pra vlerësim me pikët maksimale.
3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale,** është indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Buxhetit. Indikatori na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Brendshme ka realizuar rreth 76.25% të shpenzimeve kapitale të planifikuara, duke evidentuar në këtë mënyrë një nivel më të lartë mosrealizimi të shpenzimeve kapitale (23.75%) krahasuar edhe me ato korrente (1.69%). Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është 15 pikë, duke qënë se përqindja e mësipërme i përket intervalit të tretë të këtij sistemi vlerësimi.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2017 ka qënë 7 dhe shuma në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 203,227. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në %) është 1.15%. Këto rialokime janë bërë kryesisht për shpenzime për dëmtime banesash apo emergjenca civile. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, pikët për këtë institucion përsa i përket këtij indikatori janë 30 pikë maksimale.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikatori i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Brendshme, përqindja e detyrimeve të prapambetura të krijuaragjatë vitit 2017 është 16.9%. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 15 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare, të cilat i përkasin segmentit 0-4 pikë. Për Ministrinë e Brendshme, mjedisi i kontrollit dhe menaxhimi i riskut janë vlerësuar mesatarisht me 3.4 pikë dhe 3 pikë, duke marrë respektivisht nga 20 pikë. Komponentët e aktiviteteve të kontrollit, informimi dhe komunikimi si dhe monitorimi janë vlerësuar mesatarisht me 3.6 pikë, 4 pikë dhe 4 pikë, duke marrë secili nga 30 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Brendshme** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor duhej dhënë arsyetim më i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 23 angazhime auditimi, në fakt ka kryer 29 angazhime auditimi, 12 auditime përputhshmërie dhe 17 auditime të kombinuara, kjo tregon për një llogaritje jo të saktë të burimeve të auditimit. NJAB duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës.

Nga monitorimi i raportit konstatohet që struktura dhe formatet plotësojnë të gjitha kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, por duhet fokusuar më shumë në vlerësimin e riskut për subjekte të cilat përdorin fonde të konsiderueshme publike.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 8 punonjës (1 drejtues dhe 7 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar. Kjo NJAB ka një pozicion të paplotësuar. (25 pikë)

<u>Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2017</u>

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është vlerësuar me 500 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, e cila është e renditur në vendin e tretë në rankimin e ministrive. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si më poshtë.

Tabela 4. Vlerësimi i Indikatorëve për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	12%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	2%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	2%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	10	49.13%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	1%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	25	4.8%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	13.03%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	0.08%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	10	27.5%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14.Informimi dhe komunikimi	30	4
15.Monitorimi	30	4
16.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
20. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për vitin 2017, ky indikator ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 12% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është 15 pikë, duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket intervalit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 2%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më

vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, 98% e urdhër-shpenzimeve të Ministrisë së Shëndetësisëdhe Mbrojtjes Sociale janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur dhe me dokumentacionin përkatës. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.

4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një performancë jo e kënaqshme pasi 49.13% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 10 pikë pasi ndodhet ne nivelin e katërt të vlerësimit. Kjo përqindje vjen për shkak të volumit të lartë të kontratave dhe mënyrës së funksionimit të tyre, kryesisht me njësitë e vartësisë së kësaj ministrie.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 1%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë shumë të kënaqshme lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik

1. Duke u bazuar në raportet e monitorimit që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i ka dorëzuar raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin buxhetor. Gjatë vitit 2017, ky institucion ka realizuar 95.2% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 4.8%. Ky mosrealizim i këtyre shpenzimeve ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i fondeve për mallra dhe shërbime për shkak të ndryshimit të përgjegjësisë dhe kalimit të fondeve nga MMSR. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë, çka flet për një performancë shumë të kënaqshme.
3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale,** është indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Buxhetit. Ky indikator evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka realizuar këto shpenzime ne masën 86.97% dhe ka një mosrealizim të këtyre shpenzimeve me 13.03%. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 15 pikë, çka flet për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, **numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2017 ka qënë 3 dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qenë 45,504 lekë**. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 0.08%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në

përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion përsa i përket këtij indikatori është maksimal me 30 pikë. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka një performancë shumë të mirë për këtë indikator.

5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikatori i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, gjatë vitit 2017, janë krijuar 27.5% detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 10 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare, të cilat i përkasin segmentit 0-4 pikë. Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.9 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti "Menaxhimi i riskut" arrin në një nivel vlerësimi me 3.3 pikë, duke i korresponduar kështu nivelit të dytë të vlerësimit prej 20 pikësh, sipas metodologjisë së monitorimit. Ndërsa edhe aktivitetet e kontrollit dhe Informimi dhe komunikimi dhe monitorimi kanë marrë nga 30 pikë pasi janë vlerësuar respektivisht me nga 4 pikë secili. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të kënaqshme.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 20 angazhime auditimi, në fakt ka kryer 22 angazhime auditimi (7 a. përputhshmërie, 6 a.financiare, 9 a. të kombinuara). NJAB nuk ka vlerësuar funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në aparatin e ministrisë duke dobësuar në këtë mënyrë rolin dhe misionin e auditimit të brendshëm dhe duke ulur efektivitetin e punës së auditimit.

NJAB duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës dhe të kryejë sigurimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet përcaktimit të indikatorëve të performancës dhe hartimit të programit të përmirësimit të cilësisë.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 7 punonjës (1 drejtues dhe 6 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vitin 2017

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është vlerësuar me 480 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke e renditur në vendin e gjashtë në rankimin e ministrive. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si në tabelën në vijim.

Tabela 5. Vlerësimi i Indikatorëve për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	25%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	1%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	5	68%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	15	7.71%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	30	0%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	0.63%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	05	61.5%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	20	3
14.Informimi dhe komunikimi	20	3
15.Monitorimi	30	4
16.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
20. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	25	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në Thesar**. Gjatë vitit 2017, kjo ministri ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 25% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është 15 pikë, duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i

kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 1%, çka flet për një nivel të shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, pothuajse të gjitha urdhër-shpenzimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë paraqitur në Thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin **kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre**. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një performancë e dobët pasi 68% e kontratave të dorëzuara në Thesar kanë qënë jashtë afatit ligjor, ndaj dhe është vlerësuar me 5 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që nuk ka asnjë urdhër-prokurim te paautorizuar nga Thesari, ndaj vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik

1. Duke u bazuar në raportet e monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i ka dorëzuar të gjitha raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit buxhetor. Gjatë vitit 2017, ky institucion ka realizuar 92,29% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 7,71%. Ky mosrealizim i këtyre shpenzimeve ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i fondeve për mallra dhe shërbime dhe nga shpenzimet për paga e sigurime shoqërore. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është 15 pikë, çka flet për një performancë mesatare të kësaj ministrie në lidhje me këtë indikator.
3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale,** është një indikator i cili gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Buxhetit. Ky indikator evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka realizuar 100% të shpenzimeve kapitale të planifikuara. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 30 pikë maksimale.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra

gjatë vitit 2017 **ka qënë 4 dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qenë 32,213**. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në %) është 0.63%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, pikët për këtë institucion përsa i përket këtij indikatori janë 30 pikë, duke treguar për një performancë shumë të kënaqshme të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikatori i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, gjatë vitit 2017 janë krijuar 61.5% detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 5 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare, të cilat i përkasin segmentit 0-4 pikë. Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.5 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit, e barabartë me 30 pikë. Komponenti menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit dhe informimi dhe komunikimi janë vlerësuar mesatarisht respektivisht me 3 pikë, 3,1 pikë dhe 3,3 pikë, duke marrë nga 20 pikë secili, sipas metodologjisë së monitorimit. Ndërkohë komponenti i monitorimit është vlerësuar mesatarisht me 3,75 pikë, duke marrë respektivisht 30 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të menaxhimit të riskut.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. Kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit janë realizuar 38 angazhime auditimi (1 a. përputhshmërie, 32 a. të kombinuara, dhe 5 a. me kërkesë të titullarit). NJAB duhet të kryejë një vlerësim më të thelluar të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 9 punonjës (1 drejtues dhe 8 specialistë), aktualisht mungon drejtuesi i NJAB, pra ka një pozicion të pa plotësuar.(25 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2017

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është vlerësuar me 465 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke u renditur në vendin e tetë në rankimin e ministrive. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 6. Vlerësimi i Indikatorëve për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	9%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	25	4%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	10	33.05%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	25	5%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	15	9.95%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	14.69%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	15	14.22%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	0	96.7%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	30	4
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14.Informimi dhe komunikimi	20	3
15.Monitorimi	30	4
16.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
20. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë indikator, kjo ministri gjatë vitit 2017 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 9% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të mirë të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi, sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është 15 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.

2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 4%, çka flet për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 25 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, të gjitha urdhër-shpenzimet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një performancë jo shumë e kënaqshme, pasi 33.05% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor, ndaj dhe është vlerësuar me 10 pikë pasi ndodhet ne nivelin e katërt të vlerësimit.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë shumë të mirë lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik

1. Duke u bazuar në raportet e monitorimit që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i ka dorëzuar 95 % të raporteve në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 25 pikë, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin buxhetor. Gjatë vitit 2017, ky institucion ka realizuar 90.05% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 9.95%. Ky mosrealizim i këtyre shpenzimeve ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore, shërbime dhe tranferta. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është 15 pikë, çka flet për një performancë mesatare të kësaj ministrie në lidhje me këtë indikator.
3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale,** është indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Buxhetit. Ky indikator evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i ka realizuar këto shpenzime ne masën 85.31% dhe ka një mosrealizim

të këtyre shpenzimeve me 14.69%. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 15 pikë, çka flet për një nivel mesatar të këtij indikatori.

4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, **numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2017 ka qënë 6 dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 574.797 lekë**. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në %) është 14.22%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion përsa i përket këtij indikatori është 15 pikë. Kryesisht këto rialokime janë bërë për mbulimin e shpënzimeve gjyqësore, shërbime për kulturat bujqësore, nxitje ndaj prodhimit nujqësor dhe blegtoral, etj. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka një performancë mesatare për këtë indikator.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikatori i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural gjatë vitit 2017 janë krijuar detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar në masën 96.7%. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 0 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare, të cilat i përkasin segmentit nga 0-4 pikë. Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit dhe monitorimi janë vlerësuar mësatarisht me nga 3.88 pikë, 3.7 pikë, 3.7 pikë dhe 3.5 pikë, duke marrrë secili nga 30 pikë, sipas metodologjisë së monitorimit të performancës. Informimi dhe komunikimi është i vetmi indikator i vlerësuar mesatarisht me 3.3 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të kënaqshme. Në këtë drejtim ka ndikuar edhe përfshirja e këtij institucioni si pjesë e projektit të binjakëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me Ministrinë e Financave të Austrisë dhe Francës me statusin e "institucionit pilot".

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. Kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 pikë të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 23 angazhime auditimi, në fakt ka kryer 23 angazhime auditimi (16 a. të kombinuara, 4 shërbime këshillimi dhe 3 a. me kërkesë të titullarit). NJAB duhet të realizojë anagazhime auditimi për vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në të gjitha drejtoritë e aparatit të ministrisë, mos realizimi i tyre dobëson rolin dhe misionin e auditimit të brendshëm. NJAB duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë). Aktualisht kjo NJAB nuk ka vende vakante. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2017

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Drejtësisë është vlerësuar me 485 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme. Kjo ministri është renditur në vendin e pestë në rankimin e ministrive. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 7. Vlerësimi i Indikatorëve për Minstrinë e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	10%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	5	54%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	25	3%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	25	5%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	10	37.59%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	21.44%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	25	3.05%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	15	7.1%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	30	4
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14.Informimi dhe komunikimi	30	4
15.Monitorimi	30	4
16.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
20. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	25	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për vitin 2017, kjo ministri ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 10% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për Ministrinë e Drejtësisë, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, duke u vlerësuar me 30 pikë maksimale.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, pothuajse të gjitha urdhër-shpenzimet e Ministrisë së Drejtësisë janë paraqitur në Thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2017, 54% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 5 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 3%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë të kënaqshme lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 25 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik

1. Duke u bazuar në raportet e monitorimit që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Drejtësisë i ka dorëzuar pothuajse të gjithë raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Vlerësimi i marrë për këtë indikator është 25 pikë, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin buxhetor. Gjatë vitit 2017, ky institucion ka realizuar 62.41% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 37.59%. Ky mosrealizim i këtyre shpenzimeve ka ardhur kryesisht nga ekzistenca e strukturave

organike të paplotësuara të këtij institucioni. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është 10 pikë, çka flet për një performancë jo shumë të kënaqshme të kësaj ministrie në lidhje me këtë indikator.

3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale,** është indikator i cili gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Buxhetit. Ky indikator evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Drejtësisë ka një realizim të këtyre shpenzimeve kapitale me 78.56%. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 15 pikë pasi mosrealizimi për këtë indikator ndodhet në intervalin e tretë të vlerësimit.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, **numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2017 ka qënë 1 dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 247.410.** Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 3.05%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion përsa i përket këtij indikatori janë 25 pikë. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Drejtësisë ka një performancë shumë të mirë për këtë indikator. Kryesisht këto rialokime janë bërë për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe sigurime. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Drejtësisë ka një performancë shumë të mirë për këtë indikator.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikatori i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Drejtësisë, gjatë vitit 2017 janë krijuar 7.1% detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 15 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare, të cilat i përkasin segmentit nga 0-4 pikë. Për Ministrinë e Drejtësisë, të gjithë komponentët janë vlerësuar maskimalisht me nga 30 pikë, duke marrë respektivisht nga 4 pikë komponenti i mjedisit të kontrollit, 4 pikë komponenti i menaxhimit të riskut, 3.86 pikë komponenti i aktiviteteve të kotnrollit, 3.83 pikë komponenti i informimit dhe komunikimit dhe 4 pikë komponenti i monitorimit. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të kënaqshme.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Drejtësisë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me (30 pikë).

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 25 angazhime auditimi dhe ka realizuar 41 angazhime (23 a.përputhshëmrie, 12 a. të kombinuara, 6 a. me kërkesë të titullarit).

NJAB ka vlerësuar funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në sektorin e menaxhimit të fondeve IPA, por në të ardhmen duhet të realizojë angazhime auditimi në të gjitha fushat e përgjegjësisë së ministrisë (aparati) sepse mosrealizimi i tyre dobëson rolin dhe misionin e auditimit të brendshëm. Kjo njësi duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të performancës.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar, por aktualisht pozicioni i drejtuesit të NJAB është vakant. (25 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2017

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është vlerësuar me 500 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, e cila është renditur në vendin e tretë nga rankimi i ministrive. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017, sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna, janë si më poshtë vijon.

Tabela 8. Vlerësimi i Indikatorëve për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	15%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	0	100%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	25	4.36%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	5	75.33%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	0%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	30	0%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	20	3
14.Informimi dhe komunikimi	30	4
15.Monitorimi	30	4
16.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
20. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë ministri, gjatë vitit 2017 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 15% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë ministri, është 15 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket intervalit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për ministrinë në fjalë nuk kemi asnjë kontratë të anuluar, pra raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në Thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2017, raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 100%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e gjashtë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 0 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të paautorizuara të dorëzuar në APP me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që të gjitha urdhër-prokurimet kanë qënë të autorizuara kur janë paraqitur në APP. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik

1. Duke u bazuar në raportet e monitorimit që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme i ka dorëzuar raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë, që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në

të njëjtën mënyrë që parashikohet edhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.

2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit buxhetor. Gjatë vitit 2017, ky institucion ka realizuar 95.64% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është 4.36%. Ky mosrealizim i këtyre shpenzimeve ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i shpenzimeve për zëra si paga, sigurime, shërbime dhe transferta. Bazuar në këtë performancë, vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë është 25 pikë.
3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapital është një** indikator i cili gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Buxhetit. Indikatori na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka realizuar rreth 24.67% të shpenzimeve kapitale të planifikuara, duke evidentuar në këtë mënyrë në një nivel më të lartë mosrealizimi të shpenzimeve kapitale (75.33%) krahasuar edhe me ato korrente (4.36%), për shkak të mosrealizimit të financimit të huaj. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është 5 pikë, duke qënë se përqindja e mësipërme i përket intervalit të pestë të këtij sistemi vlerësimi.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2017 ka qënë 0. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës për këtë institucion është 30 pikë maksimale. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka një performancë shume të mirë për këtë indikator.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikatori i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, gjatë vitit 2017, nuk janë krijuar detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare, të cilat i përkasin segmentit nga 0-4 pikë. Për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.94 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Komponenti i menaxhimit të riskut dhe aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me nga 3.3 pikë secili, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Ndërsa, komponenti i informimit dhe komunikimit si dhe monitorimit janë vlerësuar mesatarisht, respektivisht, me nga 3.8 pikë dhe 4 pikë, duke marrë nga 30 pikë secili. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të mira, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut dhe Aktiviteteve të kontrollit, të cilët mesatarisht janë vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 15 angazhime auditimi, në fakt ka kryer 11 angazhime auditimi (1 a.përputhshmërie dhe 10 a. të kombinuara), ky mosrealizim ka ndodhur për shkak të ristrukturimit të kësaj njësie publike.

NJAB ka një vlerësim të thelluar të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet e varësisë, por gjatë kësaj periudhe nuk ka kryer asnjë angazhim auditimi në aparatin e ministrisë. Nga analiza e realizuar, kjo NJAB ka kryer sigurimin e brendshëm të cilësisë por jo sipas formateve të përcaktuara në Manual (indikatorët e performancës dhe programin e përmirësimit të cilësisë). Në lidhje me raportimin vjetor i është përmbajtur strukturës së kërkuar dhe ka bërë identifikimin e risqeve.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2017

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Mbrojtjes është vlerësuar me 495 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, e renditur në vendin e katërt në rankimin e ministrive. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 9. Vlerësimi i Indikatorëve për Ministrinë e Mbrojtjes

Ministria e Mbrojtjes	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	11%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	0	80%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	30	1.2%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	11.93%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	1.45%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	10	45.9%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4

14.Informimi dhe komunikimi	30	4
15.Monitorimi	30	4
16.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
20. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë ministri, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 11% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mestar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë ministri, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket intervalit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, të gjitha urdhër-shpenzimet e Ministrisë së Mbrojtjes janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër shumë i konsiderueshëm i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 80%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e gjashtë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 0 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP),

me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që një asnjë nga urdhër-prokurimeve nuk kanë qënë të paautorizuara kur janë paraqitur në APP. Në këtë aspekt bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik

1. Duke u bazuar në raportet e monitorimit që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Mbrojtjes i ka dorëzuar raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit buxhetor. Gjatë vitit 2017, ky institucion ka realizuar 98.8% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 1.2%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë është 30 pikë, çka flet për një performancë shumë të mirë të këtij institucioni.
3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale,** ky indikator gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Buxhetit. Ky indikator na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Mbrojtjes ka realizuar rreth 88.07% të shpenzimeve kapitale të planifikuara, duke evidentuar në këtë mënyrë një nivel mosrealizimi të shpenzimeve kapitale prej 11.93%. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 15 pikë, duke qënë se përqindja e mësipërme i përket intervalit të tretë të këtij sistemi vlerësimi.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2017 ka qënë 2 dhe shuma në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 171,178. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në %) është 1.45%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, pikët për këtë institucion, përsa i përket këtij indikatori, janë 30 pikë maksimale. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Mbrojtjes ka një performancë shumë të mirë për këtë indikator.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikatori i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Mbrojtjes, gjatë vitit 2017 janë krijuar rreth 45.9 % detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 10 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare, të cilat i përkasin segmentit nga 0-4 pikë. Për Ministrinë e Mbrojtjes, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.75 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë maksimale. Komponenti i menaxhimit të riskut është vlerësuar mesatarisht 3 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Ndërsa aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi dhe monitorimi janë vlerësuar mesatarisht me nga 3.71 pikë, 4 pikë dhe 3.5 pikë, duke marrë nga 30 pikë secila. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të mira, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut, i cili mesatarisht është vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Mbrojtjes** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin dhe planifikimin vjetor dhe është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 35 angazhime auditimi, në fakt ka kryer 46 angazhime auditimi (13 a.përputhshmërie, 15 a.financiare dhe 18 a. të kombinuara). Kjo tregon për një mosllogaritje të mirë të burimeve në dispozicion.

NJAB duhet të kryejë auditime të performancës së subjekteve (drejtoritë e aparatit të ministrisë), përfshirë programimin, realizimin e objektivave, matjen e rezultateve për të identifikuar mangësitë në politikat e hartuara, duke synuar përdorimin sa më me efektivitet të mjeteve dhe burimeve.

Kjo njësi duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës dhe për çdo angazhim të realizuar të japë një opinin mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Nga analiza e realizuar, kjo NJAB nuk ka kryer sigurimin e brendshëm të cilësisë, pra nuk ka përcaktuar indikatorët e performancës dhe nuk ka hartuar programin e përmirësimit të cilësisë, sipas kuadrit rregullator.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 9 punonjës (1 drejtues dhe 8 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2017

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është vlerësuar me 500 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, e renditur në vendin e tretë në rankimin e ministrive. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 10. Vlerësimi i indikatorëve për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	12%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	25	4%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	10	34.3%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	15	9.1%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	30	0%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	0%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	10	30.7%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14.Informimi dhe komunikimi	30	4
15.Monitorimi	30	4
16.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
20. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për vitin 2017, kjo ministri ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 12% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është 15 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin

2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 4%, çka flet për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 25 pikë.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, të gjitha urdhër-shpenzimet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë të mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një performancë mesatare, pasi 34.3% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 10 pikë pasi ndodhet ne nivelin e katërt të vlerësimit.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë shumë të mirë lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është maksimal prej 30 pikësh.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik

1. Duke u bazuar në raportet e monitorimit që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Turzimit dhe Mjedisit i ka dorëzuar raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin buxhetor. Gjatë vitit 2017, ky institucion ka realizuar 90.9% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 9.1%. Ky mosrealizim i këtyre shpenzimeve ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i shpenzimeve për zëra si paga, sigurime, për shkak të ristrukturimit. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë është 15 pikë, çka flet për një performancë mesatare të këtij indikatori.
3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale,** është indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Buxhetit. Ky indikator evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka realizuar këto shpenzime ne masën 100% dhe ka një mosrealizim të këtyre shpenzimeve me 0%. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 30 pikë maksimale, çka flet për një nivel shumë të mirë të këtij indikatori.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, **numri i rialokimeve të**

bëra gjatë vitit 2017 ka qënë 0 dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 0 lekë. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 0%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion përsa i përket këtij indikatori është 30 pikë. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka një performancë shumë të mirë për këtë indikator.

5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikatori i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, gjatë vitit 2017 janë krijuar detyrime të prapambetura në masën 30.7%, ndaj vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 10 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare, të cilat i përkasin segmentit nga 0-4 pikë. Për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, komponenti i mjedisit të kontrollit, aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi dhe monitorimi janë vlerësuar mesatarisht me 4 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti i menaxhimit të riskut arrin në një nivel vlerësimi me 3 pikë, duke i korresponduar kështu nivelit të dytë të vlerësimit me 20 pikë, sipas metodologjisë së monitorimit. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të mira.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. Kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 12 angazhime auditimi, në fakt ka kryer 10 angazhime auditimi (7 a. të kombinuara dhe 3 a. me kërkesë të titullarit), duhet të theksojmë se kjo NJAB ka lënë jashtë programimit të gjitha drejtoritë e aparatit të ministrisë duke audituar vetëm njësitë e varësisë.

Kjo njësi duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës dhe për çdo angazhim të realizuar të japë një opinin mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Nga analiza e realizuar, kjo NJAB nuk ka kryer sigurimin e brendshëm të cilësisë, pra nuk ka përcaktuar indikatorët e performancës dhe nuk ka hartuar

programin e përmirësimit të cilësisë, sipas kuadrit rregullator. Në lidhje me raportimin vjetor megjithëse i është përmbajtur strukturës së kërkuar dhe ka bërë identifikimin e risqeve.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), nuk ka një vend të paplotësuar në NJAB. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Kulturës për vitin 2017

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Kulturës është vlerësuar me 470 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, e renditur në vendin e shtatë në rankimin e ministrive. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017, sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna, janë:

Tabela 11. Vlerësimi i Indikatorëve për Ministrinë e Kulturës

Ministria e Kulturës	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	11%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	5	56.7%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	2%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	30	1.55%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	10	42.53%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	15	5.63%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	0	100%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	30	4
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14.Informimi dhe komunikimi	30	4
15.Monitorimi	30	4
16.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
20. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	20	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për vitin 2017, kjo ministri ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 11% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive

publike për Ministrinë e Kulturës, është 15 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket intervalit të tretë të vlerësimit.

2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, 1% e urdhër-shpenzimeve të Ministrisë së Kulturës janë paraqitur në thesar në mënyrën jo të duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një performancë jo të kënaqshme në lidhje me këtë indikator, pasi 56,7% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me vetëm 5 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 2%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë shumë të mirë lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik

1. Duke u bazuar në raportet e monitorimit që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Kulturës i ka dorëzuar raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin buxhetor. Gjatë vitit 2017, ky institucion ka realizuar 98.45% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 1.55%. Ky mosrealizim i këtyre shpenzimeve ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i shpenzimeve për zëra si paga, për shkak të ekzistencës së vendeve vakante. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë është 30 pikë, çka flet për një performancë shumë të kënaqshme të këtij indikatori.
3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale,** është indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Buxhetit. Ky indikator evidenton masën në të cilën janë realizuar

shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Kulturës ka realizuar këto shpenzime në masën 57.47% dhe ka një mosrealizim të këtyre shpenzimeve me 42.53%. Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 10 pikë, çka flet për një nivel jo shumë të kënaqshme të këtij indikatori.

4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, **numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2017 ka qenë i lartë me 13 rialokime dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qenë 73,583**. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 5.63%. Kryesisht, ky rialokim është bërë për përballimin e nevojave për fonde shtesë të institucioneve, kryesisht, për shpenzime për mallra dhe shërbime. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion është 15 pikë, çka flet për një performancë mesatare të këtij indikatori.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikatori i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Kulturës, gjatë vitit 2017 nuk ka shlyer asnjë nga krijimi i detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar (100%). Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 0 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare, të cilat i përkasin segmentit nga 0-4 pikë. Për Ministrinë e Kulturës, të gjithë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit janë vlerësuar respektivisht me nga 3.88 pikë, 3.5 pikë, 3.86 pikë, 3.7 pikë dhe 3.75 pikë, duke marrë secili nga 30 pikë. Sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të kënqashme.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Kulturës** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar dhe realizuar 14 angazhime auditimi (1 a. përputhshmërie, 12 a. të kombinuara dhe 1 a. me kërkesë të titullarit). Nga kjo njësi është shmangur auditimi i vetë institucionit, si njësi të rëndësishme shpenzuese të fondeve buxhetore, duke dobësuar rolin dhe misionin që i ngarkon ligji i

auditimit. Kjo njësi duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës.

Në lidhje me raportimin vjetor megjithëse i është përmbajtur strukturës së kërkuar dhe ka bërë identifikimin e risqeve, kërkohet një vlerësim më i thelluar i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm në detyrë janë janë të certifikuar dhe të trajnuar. Aktualisht ka një vend të pa plotësuar të drejtuesit të NJAB. (20 pikë)

- ✓ **Monitorimi i Performancës së <u>bashkive qendër-qarku</u> që kanë njësi auditimi**

<u>Monitorimi i Performancës për Bashkinë Tiranë për vitin 2017</u>

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017 është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Tiranë është vlerësuar me 350 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke u renditur në vendin e shtatë në vitin 2017 nga vendi i katërt që ishte në vitin 2016 me një rënie në pikëzim për 36 pikë, ky rezultat është kryesisht në treguesit që lidhet me veprimet në thesar.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më sipër.

Tabela 12. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Tiranë

Bashkia Tiranë	Pikët Viti 2016	Vlerësimi Në %	Pikët Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	25	2.74%	10	46.7%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0.74%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	25	3%	0	83.24%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	30	4
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	26		25	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		15	

13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25		25
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	20		25

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar brenda afatit 30 ditësh**. Ky indikator për vitit 2017 është vlerësuar me 10 pikë që përfaqëson 46.7% të totalit të faturave që nuk kanë respektuar afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar. Në krahasim me vitin 2016, i cili ishte 25 pikë ka një rënie prej **15 pikësh** që ndikon në rënien e performancës së institucionit. Përformanca e këtij treguesi nuk eshtë e kënaqëshme si në institucionin e bashkisë ashtu dhe në institucionet e varësisë,
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0% çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017 ka një numër të lartë të kontratave të paraqitura me vonesë në thesar që arrijnë në 83.24% kundrejt numrit të përgjithshëm të kontratave të nënshkruara, i cili është vlerësuar me 0 pikë. Në krahasim me vitin 2016 që ishtë 3%, (25 pikë) në vitin 2017 ka një përkeqësim të performancës së këtij treguesi prej **25** pikësh. Ky tregues duhet të vlerësohet dhe analizohet nga strukturat përkatëse të institucionit.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Tiranë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.81 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 2.33 pikë, duke marrë 10 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 3.71 pikë, duke marrë 30 pikë sipas metodologjisë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi janë vlerësuar me 4 pikë dhe 4 pikë, duke grumbulluar respektivisht nga 30 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut, i cili ka marrë vlerësim më të ulët në krahasim me komponentët e tjerët. Ky komponent paraqitet me të njëjtën situatë si në vitin 2016, që tregon se nga Bashkia Tiranë nuk ka ndërmarrë aktivitete për krijimin dhe funksionimim e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e riskut në këtë bashki. Në planin për zhvillimin e MFK për vitin 2018, bashkëlidhur raportit për funksionimin e kontrollit të brendshëm në bashki, janë përcaktuar detyra dhe afatet konkrete për miratimin e një strategjie të menaxhimit të riskut si dhe për hartimin e manualeve të proceseve të punës si dhe të gjurmëve të auditit për këto procese.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Tiranë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, një auditues duhet të certifikohet brenda 2 viteve të para të punësimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 15 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 21 angazhime auditimi dhe ka realizuar 22 (5 a.përputhshmërie, 4 a.performance, 9 a. të kombinuara dhe 4 a. me kërkesë të titullarit). Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka bërë identifikimin e listimin e fushave me risk të lartë si dhe vlerësimet konkrete mbi mosfunksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në të ardhmen duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. Aktualisht NJAB në këtë institucion është në nivel drejtorie, e përbërë nga 10 punonjës (1 drejtues dhe 9 specialistë), ku pozicioni i drejtuesit të NJAB dhe një audituesi të brendshëm janë të paplotësuara (25 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Shkodër për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Shkodër është vlerësuar me 415 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë shumë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e dytë.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 13. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Shkodër

Bashkia Shkodër	Pikët Viti 2016	Vlerësimi Në %	Pikët Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	0.77%	25	3.28%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0.16%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	25	4.7%	25	4%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25		25	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 3.28% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Vlerësuar sipas metodologjisë së monitorimit të performancë është 25 pikë. Krahasuar me vitin 2016 ka një përkeqësim për 5 pikë në këtë indikator. Por, në përgjithësi ka një performancë të kënaqshme lidhur me këtë tregues.

2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Për vitin 2017, për këtë bashki, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i ulët i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 4% duke u vlerësuar me 25 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë të kënaqshme të bashkisë Shkodër në këtë drejtim.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Shkodër, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.56 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Menaxhimi i riskut dhe aktivitete e kontrollit janë vlerësuar përkatësisht 3.17 pikë dhe 3.43 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi janë vlerësuar me 3.83 pikë dhe 3.75 pikë, duke grumbulluar nga 30 pikë secili komponent.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumëtë kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut dhe aktiviteteve të kontrollit të cilët mesatarisht janë vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët me 20 pikë. Një element shumë i rëndësishëm në kuadër të aktiviteteve të kontrollit dhe menaxhimit të riskut janë hartimi dhe përditsimi në vazhdimësi i manualeve të proceseve të punës.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Shkodër** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 12 angazhime auditimi dhe ka realizuar 10 angazhime auditimi (6 a. të kombinuara dhe 4 a. me kërkesë të titullarit). Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, në këtë material janë bërë përshkrime të gjata dhe të hollësishme mbi gjetjet në çdo angazhim auditimi, duke mos bërë një përmbledhje dhe vlerësim të përgjithshëm mbi fushat me risk të lartë. Kjo NJAB ka dhënë vlerësime mbi pikat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit të kontrollit të brendshëm. Në të ardhmen duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektor, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Durrës për vitin 2017

Vlerësimi i performancës së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) të Bashkive për vitin 2017 është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore mbështetet në analizën e pesë treguesve (indikatorëve) të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Durrës është vlerësuar me 405 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, e cila është e renditur në vendin e tretë. Vlerësojmë që në krahasim më vitin e kaluar, duke treguar një performancë të kënaqshme në realizimin e treguesve sipas tabelës më poshtë.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017, sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si në tabelën më poshtë.

Tabela 14. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Durrës

Bashkia Durrës	Pikët Viti 2016	Vlerësimi Në %	Pikët Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	1.92%	15	6.8%

2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	15	10.96%	30	2%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.9%	30	1.46%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	**25**	**5.1%**	**5**	**67.63%**
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	30	4	30	4
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4	30	4
9.Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10.Monitorimi	30	4	30	4
11.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	25		30	
13. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		25	
15. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	25		30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë, kjo bashki gjatë vitit 2017 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 6.8% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Bazuar në vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për Bashkinë Durrës, është 15 pikë. Sipas tabelës së mësipërme, ky indikator paraqitet me një performancë më të ulët kundrejt vitit 2016, i cili ishte 30 pikë. Përformanca e këtij treguesi është po thuajse e njëjtë si në Bashki ashtu dhe ne njësitë vartëse të bashkisë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 2%, çka flet për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, duke u vlerësuar me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, Bashkisë Durrës i janë refuzuar nga thesari 1.46% e urdhër-shpenzimet të paraqitura jo në përputhje me kërkesat e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, numri i kontratave që nuk janë paraqitur brenda afateve kohore të përcaktuara është shumë i lartë dhe përfaqëson 67.63% të numrit të tyre kundrejt totalit të kontratave të

institucionit. Ky indikator tregon një performancë jo të kënaqëshme të institucionit duke u vlerësuar me 5 pikë. Në krahasim me vitin 2016 që ishtë 5.1%, (25 pikë) në vitin 2017 ka një përkeqësim të performancës së këtij treguesi. Ky tregues duhet të vlerësohet dhe analizohet nga strukturat përkatëse të institucionit.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë të shkëlqyer lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi i performacës nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Për çdo komponent janë llogaritur pikët mesatare të tij, të cilat përcaktohen duke konsideruar raportin e shumës së pikëve me të cilat institucioni ka vlerësuar çdo pyetje në përbërje të secilit komponent me numrin e pyetjeve respektive. Për Bashkinë Durrës, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.94 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti Menaxhimi i riskut dhe Aktivitetet e Kontrollit arrijnë në të njëjtin nivel vlerësim me 3.83 dhe 3.57 pikë secila, duke i korresponduar kështu të njëjtit nivel vlerësimi me 30 pikë, sipas metodologjisë së monitorimit. Gjithashtu, edhe Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi kanë marrë 30 pikë, pasi janë vlerësuar respektivisht me 3.83 pikë dhe 4 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të mira.

Nga vlerësimi i pyetësorit të vëtëvlerësimit, në kuadër të monitorimit të realizuar në Bashkinë e Durrësit u konstatua që, nëse për komponentin e mjedisit të kontrollit, informim komunikimit dhe monitorimit nga institucioni, situata vlerësohet e kënaqshme, përsa i përket menaxhimit të riskut në institucion nuk ishte ngritur dhe funksiononte sistemi i menaxhimit të riskut. Për komponentin e aktiviteteve të kontrollit mund të themi se duheshin fokusuar më shumë tek përgatitja e manualeve të proceseve të punës si një element i rëndësishëm kontrolli dhe monitorimi të punës së çdo strukture të institucionit.
Bazuar sa më sipër, ka një vlerësim të përformacës përsa i përket komponentëve të kontrollit të brendshëm së institucionit më të ulët veçanërisht për komponentin e menaxhimit të riskut sa është raportuar.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Durrës** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar dhe realizuar 10 angazhime auditimi (2 a.përputhsmërie, 1 a.financiar dhe 7 a. të kombinuara). Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka bërë identifikimin dhe listimin e fushave me risk të lartë si dhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. NJAB duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 3 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar. Aktualisht nuk ka vend të paplotësuar në njësinë e auditimit të brendshëm. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Korçë për vitin 2017

Vlerësimi i performancës së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) të Bashkive për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore mbështetet në analizën e pesë treguesve (indikatorëve) të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Korçë është vlerësuar me 430 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, e cila është e renditur në vendin e parë kundrejt vendit të dytë në vitin 2016 me rritje në performancë për 25 pikë. Vlerësojmë se Bashkia Korçë paraqitet me një performancë shumë të mirë pothuajse në të gjithë indikatorët për vlerësimin e performancës sipas metodologjisë së miratuar.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si më poshtë.

Tabela 15. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Korçë

Bashkia Korçë	Pikët Viti 2016	Vlerësimi Në %	Pikët Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	25	3.42%	15	6.4%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0.7%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	2.1%	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	30	1%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	30	4	30	4
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	30	4
9.Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10.Monitorimi	30	4	30	4

11.Përgatitja e audituesve të brendshëm	20		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15		30	
13. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25		25	
15. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë kjo bashki gjatë vitit 2017 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 6.4% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar si mesatare për insitucion, pasi në nivelin e parë ky tregues është 12%. Pra institucionet e nivelit të dytë kanë performancë më të mirë se bashkia. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për Bashkinë Korçë është 15 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë maksimale.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, vetëm 1% e urdhër-shpenzimet të Bashkisë Korçë janë paraqitur në thesar në mënyrën jo të duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e kënaqshme në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një performancë shumë e kënaqshme pasi 1% e kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 30 pikë.

1. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0 %. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë shumë të kënaqshme lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi i performacës nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Për çdo komponent janë llogaritur pikët mesatare të tij, të cilat përcaktohen duke konsideruar raportin e shumës së pikëve me të cilat institucioni ka vlerësuar çdo pyetje në përbërje të secilit komponent me numrin e pyetjeve respektive. Për Bashkinë Korçë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.88 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e Kontrollit janë vlerësuar mesatarisht përkatësisht 3.67 pikë dhe 3.71 pikë duke u vlerësuar me 30 pikë. Gjithashtu, edhe Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi kanë marrë 30 pikë pasi janë vlerësuar respektivisht me 3.83 dhe 4 pikë.

Pra, bazuar në pyetësorin e vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm të Bashkisë Korçë paraqitet në nivele të kënaqshme. Theksojmë se kjo bashki ka qënë institucion pilot për implementimin e mjeteve të MFK e cila reflektohet dhe në rezultatet e dhëna në pyetësor.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Korçë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, një audituesi është në proces certifikimi.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar dhe ka realizuar 6 angazhime auditimi (1 a.përputhsmërie, 2 a.performance, 2 a. të kombinuara dhe 1 a. me kërkesë të titullarit).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka bërë identifikimin e fushave me risk të lartë si dhe ka dhënë opinionet përkatëse mbi vlerësimet e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në të ardhmen duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë). NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë).

<u>Monitorimi i Performancës për Bashkinë Elbasan për vitin 2017</u>

Vlerësimi i performancës së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) të Bashkive për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore mbështetet në analizën e pesë treguesve (indikatorëve) të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Elbasan është vlerësuar me 380 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të mirë të kësaj bashkie e cila është e renditur në vendin e pestë nga vendi i tretë që ishte në vitin 2016, duke arritur një performancë më të ulët për 15 pikë, konkretisht është në treguesit që lidhen me veprimet në thesar.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si më poshtë.

Tabela 16. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Elbasan

Bashkia Elbasan	Pikët Viti 2016	Vlerësimi Në %	Pikët Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	8.85%	10	28.8%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0.3%	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	19.7%	5	59%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	25	4.6%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	30	4	30	4
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4	30	4
9.Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10.Monitorimi	30	4	30	4
11.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	30		25	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë kjo bashki gjatë vitit 2017 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar mesatarisht në masën 28.8% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar, duke u vlerësuar mr 10 pikë sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike. Kjo tregon për një nivel jo të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, kryesisht në bashki por e njëjta performancë është dhe në pjesën më të madhe të njësive të varësisë. Duke patur dhe përkeqësim të performancës së këtij treguesi në krahasim më vitin 2016 (tabela si më sipër).
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se

ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë maksimale.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, vetëm 1% e urdhër-shpenzimeve të Bashkisë Elbasan janë paraqitur në thesar në mënyrën jo të duhur. Kjo tregon se pothuajse të gjitha urdhë-shpenzimet janë paraqitur në thesar siç duhet. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, numri i kontratave që nuk janë paraqitur brenda afateve kohore të përcaktuara është shumë i lartë dhe përfaqëson 58% të numrit të tyre kundrejt totalit të kontratave të institucionit. Ky indikator tregon një performancë jo të kënaqëshme të institucionit duke u vlerësuar me 5 pikë. Në krahasim me vitin 2016 që ishtë 19.7%, (15 pikë) në vitin 2017, ka një përkeqësim të performancës së këtij treguesi. Ky tregues duhet të vlerësohet dhe analizohet nga strukturat përkatëse të institucionit.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë të kënaqshme lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi i performacës nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Për çdo komponent janë llogaritur pikët mesatare të tij, të cilat përcaktohen duke konsideruar raportin e shumës së pikëve me të cilat institucioni ka vlerësuar çdo pyetje në përbërje të secilit komponent me numrin e pyetjeve respektive. Për Bashkinë Elbasan, Mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.94 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit të barabartë me 30 pikë. Komponenti Menaxhimi i riskut dhe Aktivitetet e Kontrollit arrijnë në të njëjtin nivel vlerësim me 3.67 dhe 4 pikë secila, duke i korresponduar kështu të njëjtit niveli vlerësimi me 30 pikë, sipas metodologjisë së monitorimit. Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi janë vlerësuar me 30 pikë, pasi secila është vlerësuar përkatësisht me 3.83 pikë dhe 3.75 pikë mestarisht.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të kënaqshme. Nga monitorimi i realizuar në këtë bashki vlerësohet që ka një funksionim shumë të mirë të kontrollit të brendshëm, por puna duhet të fokusohet më shumë në drejtim të

përgatitjes së manualeve të proceseve të punës, si një element shumë i rëndësishëm i aktiviteteve të kontrollit dhe menaxhimit të riskut.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Elbasan** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesit e brendshëm janë të çertifikuar ose në proces çertifikimi dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 13 dhe ka realizuar 17 angazhime auditimi (11 a.përputhsmërie, 1 a.performance, 2 a.financiarë dhe 3 a.me kërkesë të titullarit), gjë që tregon për një planifikim jo të saktë të burimeve në dispozicion.

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit vjetor dhe formatit të miratuar të evidencave, ka bërë identifikimin e fushave me risk të lartë, por nuk ka dhënë asnjë vlerësim apo opinion mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si hapi i parë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 7 punonjës (1 drejtues dhe 6 specialistë). NJAB ka një pozicion të pa plotësuar. (25 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Vlorë për vitin 2017

Vlerësimi i performancës së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) të Bashkive për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore mbështetet në analizën e pesë treguesve (indikatorëve) të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Vlorë është vlerësuar me 340 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë relativisht të mirë të kësaj bashkie, e cila është e renditur në vendin e nëntë për vitin 2017, kundrejt vendit të shtatë për vitin 2016, me nivel më të ulët prej 35 pikë.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si më poshtë.

Tabela 17. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Vlorë

Bashkia Vlorë	Pikët Viti 2016	Vlerësimi Në %	Pikët Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017

1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	10.55%	15	15%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0.55%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	2.13%	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	0	86.2%	0	92%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	25	4.3%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4	20	3
9.Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10.Monitorimi	30	4	20	3
11.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	20	
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		25	
15. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 15 % të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit. Performanca e këtij indikatori është me të njëjtin nivel si dhe në vitin 2016.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, vetëm 1% e urdhër-shpenzimeve të Bashkisë Vlorë janë paraqitur në thesar në mënyrën jo të duhur. Kjo tregon se pothuajse të gjitha urdhë-shpenzimet janë paraqitur në thesar siç duhet. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është

analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një performancë e dobët pasi 92% e kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 0 pikë. Ky indikator ka të njëjtën performancë si dhe në vitin 2016, prandaj duhet të analizohen dhe te vlerësohet nga strukturat përkatëse për përmirësimin e tij.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë shumë të mirë lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi i performacës nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Për çdo komponent janë llogaritur pikët mesatare të tij, të cilat përcaktohen duke konsideruar raportin e shumës së pikëve me të cilat institucioni ka vlerësuar çdo pyetje në përbërje të secilit komponent me numrin e pyetjeve respektive. Për Bashkinë Vlorë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.56 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti Menaxhimi i riskut ka marrë 20 pikë, duke u vetvlerësuar mesatarisht me 2.83 pikë. Aktivitetet e Kontrollit dhe Informimi dhe komunikimi arrijnë në të njëjtin nivel vlerësim me 3.57 dhe 3.67 pikë secila, duke i korresponduar kështu të njëjtit niveli vlerësimi me 30 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Monitorimi, bazuar në metodologjinë e monitorimit, është vlerësuar me 30 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare. Në nivel të ulët paraqitet komponenti i menaxhimit të riskut për të cilin vlerësojmë se në institucion deri në vitin 2017 nuk është ngritur dhe funksionon sistemi i menaxhimit të riskut. Bashkëgjitur me raportin e funksionimit të kontrollit të brendshëm për vitin 2017, është përgatur dhe plani i punës i për zhvillimin e MFK për vitin 2018, duke u fokusuar ndër të tjera dhe në menaxhimin e riskut.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Vlorë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me (30 pikë).

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (20 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 10 angazhime auditimi dhe ka realizuar 11 angazhime auditimi (3 a.përputhshmërie, 7 a. të kombinuara dhe 1 a. me kërkesë të titullarit). Në të ardhmen duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës.

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka bërë identifikimin e fushave me risk të lartë si dhe vlerësimet përkatëse për mos ngritjen apo mos funksionimin efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm konform standarteve të kërkuara.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Berat për vitin 2017

Vlerësimi i performancës së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) të Bashkive për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore mbështetet në analizën e pesë treguesve (indikatorëve) të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Berat është vlerësuar me 385 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të relativisht të mirë të kësaj bashkie, e cila është e renditur në vendin e katërt për vitin 2017, me 10 pikë më shumë nga viti 2016.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si më poshtë.

Tabela 18. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Berat

Bashkia Berat	Pikët Viti 2016	Vlerësimi Në %	Pikët Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	2.14%	15	12.7%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0.86%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.75%	30	1.9%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	2.08%	25	5%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	1.6%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	30	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	30	4
10. Monitorimi	20	3	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	

12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 12.7% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Duke u vlerësuar me 15 pikë, sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki. Vlerësohet që ka një përkeqësim në këtë tregues për 15 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1.9%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 5%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e dytë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 25 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë të kënaqshme të bashkisë Berat në këtë drejtim.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Berat, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.19 pikë, ndaj dhe ka marrë 20 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar 3.17 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 3.43 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi janë vlerësuar me 4 pikë duke u vlerësuar me 30 pikë secila.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqëshme për 2017, duke u përmirësuar disa komponentë në krahasim me 2016. Për komponentët e Menaxhimit të riskut si dhe aktivitetet e kontrollit në bashki ka një ecuri të kënaqëshme, dhe vlerësojmë që institucioni është realist në vetëvlerësimin e tij, duke synuar përmirësimin e procesit si në menaxhimin e riskut nëpërmjet përgatitjes së regjistrit të risqeve dhe përfshirjes së të gjithë niveleve menaxheriale në këtë proces si dhe në përgatitjen e manualeve të proceseve të punës si element i rëndësishëm kontrolli.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Berat** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, një nga audituesit e brendshëm është në proces çertifikimi.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 12 dhe realizuar 11 angazhime auditimi (6 a. përputhshmërie, 3 a. të kombinuara dhe 2 a. me kërkesë të titullarit) , gjë që tregon për një planifikim jo të saktë të burimeve në dispozicion. Në të ardhmen duhet të përqëndrohet në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës dhe të shtrirjes së veprimtarisë në të gjitha drejtoritë e njësisë publike (aparati i Bashkisë).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka bërë identifikimi i fushave me risk si dhe janë dhënë opinionet përkatëse ku sistemet e kontrollit të brendshëm nuk janë funksionale.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Fier për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Fier është vlerësuar me 345 pikë nga 450 duke u renditur në vendin e nëntë për vitin 2017, nga vendi i gjashtë që ishte në vitin 2016, me përkëqësim në pikëzim prej 35 pikësh.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si në tabelën më poshtë.

Tabela 19. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Fier

Bashkia Fier	Pikët Viti 2016	Vlerësimi Në %	Pikët Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	0.63%	15	16.26%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.87%	30	1.9%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	15.7%	5	56.33%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		15	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 16.26% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar në realizimin e këtij indikatori. Bazuar në vlerësimin sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike bashkia është vlerësuar me 15 pikë. Vlerësojmë që ka përkeqësim në performancën e këtij treguesi në vitin 2017 kundrejt vitit 2016, me 15 pikë duke ndikuar ndjeshëm dhe në rankimin e institucionit.

2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për Bashkinë e Fierit, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1.9%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
6. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 56.33%, duke u vlerësuar me 5 pikë sipas metodologjisë së monitorimit të performancës. Ky indikator tregon për një përformancë jo të mirë të institucionit, që duke u krahasuar me vitin 2016 është përkëqësuar me 10 pikë (tabela më sipër). Prandaj ky indikator duhet të analizohen dhe të vlerësohet nga strukturat përkatëse për përmirësimin e tij.
4. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën epikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Fier, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi janë vlerësuar me 20 pikë duke marrë mesatarisht për secilin nga komponentët 3 pikë, 3 pikë, 3 pikë, 3.17 pikë dhe 2.75 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqëshme. Por konstatohet që ka të njëjtën performancë në treguesit e MFK me vitin 2016. Në përgjithësi vlerësohet që ka ecuri pozitive në komponentin e menaxhimit të riskut, lidhur me hartimin e regjistrit të risqeve, por është një proces që duhet të përfshijë të gjithë strukturat e institucionit dhe jo vetëm në qëndër.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Fier** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 8 dhe ka realizuar 12 angazhime auditimi (5 a. të kombinuara dhe 7 a. me kërkesë të titullarit), gjë që tregon për një planifikim jo të saktë të burimeve në dispozicion. Në të ardhmen duhet të përqëndrohet në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës dhe të shtrirjes së veprimtarisë në të gjitha drejtoritë e njësisë publike (aparati i Bashkisë).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, në raport ka përshkrime mbi gjetjet kryesore sipas sistemeve, por nuk janë evidentuar e përcaktuar fushat me risk të lartë, si dhe nuk është dhënë asnjë opinion mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si hapi i parë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Gjirokastër për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Gjirokastër është vlerësuar me 355 pikë nga 450 duke u renditur në vendin e tetë për vitin 2017, nga vendi i shtatë në vitin 2016, me 20 pikë më pak.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017, sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna, janë si më poshtë.

Tabela 20. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Gjirokastër

Bashkia Gjirokastër	Pikët Viti 2016	Vlerësimi Në %	Pikët Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	25	4.51%	15	11.8%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	15	11.9%	25	4%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	10	36.4%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	20	3	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		20	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 11.8% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë. Ky indikator në vitin 2017 kundrejt vitit 2016, është përkeqësuar për 10 pikë duke ndikuar në rankimin e institucionit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për Bashkinë e Gjirokastrës, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 4%, i cili është vlerësuar me 25 pikë. Në lidhje me këtë indikator, bashkia ka performuar më mirë duke rritur vlerësimin me 10 pikë kundrejt vitit 2016.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra të gjitha urdhër

shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.

4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2016, raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 36.4%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e katërt të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë maksimale 10 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë jo të mirë të bashkisë Gjirokastër në këtë drejtim. Ky tregues është përkeqësuar në vitin 2017 kundrejt vitit 2016 me 20 pikë, duke ndikuar ndjeshëm në rankimin e institucionit.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Gjirokastër, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.5 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 1.83 pikë, duke marrë 10 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 3.14 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi janë vlerësuar me 3.83 pikë dhe 3.5 pikë, duke grumbulluar respektivisht 30 pikë secili.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut dhe aktivitetet e kontrollit, të cilat janë vetëvlerësuar më pak në krahasim me komponentët e tjerë. Bazuar në pyetësorët e vetëvlerësimit, për vitet 2016 dhe 2017 paraqitet me të njëjtëm performancë, persa i përket komponentit të Menaxhimit të Riskut, duke mos ndërmarrë asnjë aktivitet për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Gjirokastër** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesi i brendshëm është në proces çertifikimi dhe drejtuesi i NJAB është i çertifikuar

dhe ka ndjekur trajnimin e vijueshëm profesional të organizuar nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Adituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Adituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Adituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar dhe ka realizuar 7 angazhime auditimi. Në të ardhmen duhet të përqëndrohet në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka bërë identifikimin e fushave dhe subjekteve me risk të lartë dhe dhënë opinionin mbi rezultatet e vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm të cilat funksionojnë në nivelin e duhur profesional dhe menaxhohen nga drejtuesit e institucioneve.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel zyre, e përbërë me 2 punonjës (1 drejtues dhe 1 specialist), ku drejtuesi i NJAB është i çertifikuar dhe i trajnuar kurse punonjësi i NJAB është në proces çertifikimi. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon me dy punonjës në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (20 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Lezhë për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Lezhë është vlerësuar me 330 pikë nga 450 duke u renditur në vendin e njëmbëdhjetë për vitin 2017 nga vendi i nëntë në vitin 2016, me 20 pikë më pak, duke rezultuar me një performancë jo të kënaqshme.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si më poshtë.

Tabela 21. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Lezhë

Bashkia Lezhë	Pikët Viti 2016	Vlerësimi Në %	Pikët Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	25	2.54%	10	33.6%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0.01%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	22.7%	10	48.14%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	10	45%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3

9. Informimi dhe komunikimi	30	4	20	3
10. Monitorimi	30	4	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	25		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	20	3	20	3
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		10	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 33.6% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel jo të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 10 pikë. Ky indikator paraqitet në nivel shumë më të ulët të realizimit për vitin 2017 kundrejt 2016 me 15 pikë më pak, duke ndikuar në nivelin e ulët të rankimit të institucionit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0.%, pra të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2016, ky institucion karakterizohet nga një numër mesatar i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 48.14%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e katërt të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 10 pikë. Sipas pasqyrës së mësipërme vlerësohet se ka përkeqësim të këtij indikatori me 5 pikë.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë. Ky indikator paraqitet me përmirësim kundrejt vitit 2016.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Lezhë, komponenti i mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut dhe aktiviteteve të kontrollit janë vlerësuar me nga 20 pikë secili, duke marrë mesatarisht 2.56 pikë, 3.17 pikë dhe 3.29 pikë. Gjithashtu dhe komponentët e Informimit dhe Komunikimit si dhe Monitorimit janë vlerësuar me 30 pikë, duke qënë se janë vetëvlerësuar mesatarisht me 2.83 pikë dhe 3.25 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme për komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Vlerësojmë që Bashkia Lezhë e ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit si një element të rëndësishëm për gjetjen e mangësive dhe si një mjet përmirësimi të komponentëve të MFK-së. Konkretisht, sipas informacionit të dërguar në raport, rezulton se në institucion është punuar për përgatitjen e regjistrit të risqeve dhe evidentimin e risqeve strategjike, por duhet të punohet që procesi i menaxhimit të risqeve të jetë praktikë pune e gjithe nivelit menaxherial.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Lezhë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB dhe audituesit të brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar, kurse punonjësi i NJAB është i paçertifikuar.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (20 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 10 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Kjo NJAB për vitin 2017 ka programuar 24 angazhime auditimi dhe ka realizuar 20 angazhime auditimi (2 a.përputhshëmrie, 5 a.performance, 5 a.financiarë 6 . të kombinuara dhe 2 a. me kërkesë të titullarit), gjë që tregon për planifikim jo të drejtë të burimeve në dispozicion.

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, nuk janë përshkruar gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm për vitin e raportimit, fushat me riskt të lartë, vlerësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm si hapi i parë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe rekomandimet e propozuara për përmirësimin e

sistemit të kontrollit të brendshëm, sikundër kërkohet në ligj NJAB nuk funksion në bazë të standardeve të auditimit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), ku drejtuesi i NJAB dhe audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar, kurse punonjësi i NJAB është i paçertifkuar. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Dibër për vitin 2017

Vlerësimi i performancës së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) të Bashkive për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore mbështetet në analizën e pesë treguesve (indikatorëve) të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Dibër është vlerësuar me 375 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e gjashtë, duke përmirësuar përformancën e saj me 25 pikë në krahasim me vitin 2016 që ishtë në vendin e nëntë.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 22. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Dibër

Bashkia Dibër	Pikët Viti 2016	Vlerësimi Në %	Pikët Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	0%	15	24.2%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	25	5%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	30	4
9.Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10.Monitorimi	20	3	20	3
11.Përgatitja e audituesve të brendshëm	10		20	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15		30	
13. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	20	3	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 24.2% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar, duke u vlerësuar me 15 sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike. Ky tregues rezulton me një performance jo të kënaqshme dhe në krahasim me 2016, është me 15 pikë më pak.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë maksimale.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një performancë shumë e mirë, pasi 5% e kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 25 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë të shkëlqyer lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi i performacës nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Për çdo komponent janë llogaritur pikët mesatare të tij, të cilat përcaktohen duke konsideruar raportin e shumës së pikëve me të cilat institucioni ka vlerësuar çdo pyetje në përbërje të secilit komponent me numrin e pyetjeve respektive. Për Bashkinë Dibër, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, monitorimi janë vlerësuar mesatarisht me 3.38 pikë, 2.83 pikë dhe 3.25 pikë duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi kanë marrë respektivisht 30 pikë, pasi janë vlerësuar respektivisht me 3.57pikë dhe 3.67 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme. Bazuar në raportin e paraqitur nga Bashkia Dibër për funksionimin e kontrollit të

brendshëm në këtë institucion vlerësojmë se nuk ka një sistem të ngritur dhe funksional për menaxhimin e riskut ,si një element shumë i rëndësishëm në arritjen e obkjektivave.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Dibër** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 20 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB dhe një auditues i brendshëm janë të paçertifikuar kurse një auditues i brendshëm është i çertifikuar dhe ka ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Kjo NJAB ka planifikuar dhe realizuar 8 angazhime auditimi (4 a. përputshmërie dhe 4 a. të kombinuar).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka përcaktuar fushat me risk të lartë dhe ka bërë vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Raporti ka përshkrime të gjata, të detajuara dhe të panevojshme mbi gjetjet për çdo angazhim auditimi, kurse rezultatet e vlerësimeve nga këto angazhime auditimi janë paraqitur tek përmbledhja e veprimtarisë së njësisë.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku drejtuesi i NJAB dhe një auditues i brendshëm është i paçertifikuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Kukës për vitin 2017

Vlerësimi i performancës së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) të Bashkive për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore mbështetet në analizën e pesë treguesve (indikatorëve) të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Kukës është vlerësuar me 365 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme dhe e renditur në vendin e shtatë me një performancë të kënaqshme në krahasim me vitin 2016.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 23. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Kukës

Bashkia Kukës	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi Në %	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	6.62%	10	38.14
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	0
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	14.7%	0	85
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	30	4
9.Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10.Monitorimi	30	4	30	4
11.Përgatitja e audituesve të brendshëm	20		20	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	20	3	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 38.14% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për performancë jo të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 10 pikë, duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë maksimale.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, të gjitha urdhër-shpenzimet të Bashkisë Kukës

janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë maksimale.

4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një performancë jo e kënaqshme pasi 85% e kontratave të dorëzuara nuk kanë kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 0 pikë. Ky tregues i përformancës ndikon ndjeshëm në uljen e rankimit të institucionit, pasi në krahasin me vitin 2016 është vlerësuar 15 pikë më pak.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë të shkëlqyer lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi i performacës nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Për çdo komponent janë llogaritur pikët mesatare të tij, të cilat përcaktohen duke konsideruar raportin e shumës së pikëve me të cilat institucioni ka vlerësuar çdo pyetje në përbërje të secilit komponent me numrin e pyetjeve respektive. Për Bashkinë Kukës, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.69 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti Menaxhimi i riskut eshtë vlerësuar me 20 pikë me një vlerësim mesatar për 3.33 pikë. Aktivitetet e kontrollit, Informimi dhe Komunikimi si dhe Monitorimi janë vlerësuar me 30 pikë sipas metodologjisë së monitorimit, që i korrespondojnë përkatësisht vlerësimit mesatar 3.57 pike dhe 4 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme. Bazuar në raportin mbi cilësinë e funksionimit të kontrollit të brendshëm të paraqitur nga Bashkia Kukës, vlerësojmë se megjithëse ka progres në këtë fushë, nga ana e bashkisë është paraqitur dhe plani i zhvillimit të MFK për vitin 2018 duke pasur në fokus, përmirësimet që lidhen me manualet e proceseve të punës si dhe elementë të tjerë të rëndësishëm të mirë menaxhimit të institucionit.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Kukës** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 20 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB dhe një nga audituesit e brendshëm janë paçertifikuar dhe nuk ka ndjekur trajnimin e vijueshëm profesional të organizuar nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me (30 pikë).

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 12 angazhime auditimi dhe ka realizuar 7 angazhime auditimi (5 a.përputhsmërie dhe 2 a. të kombinuara), gjë që tregon për një planifikim jo të saktë të burimeve në dispozicion. Në të ardhmen duhet të përqëndrohet më shumë në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës.

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit vjetor dhe formatit të miratuar të evidencave, ka bërë identifikimin e fushave me risk të lartë si dhe ka dhënë vlerësimet përkatëse mbi mosfunksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku drejtuesi i NJAB është i pa certifikuar, pra kjo njësi funksionon në kundërshtim me aktet nënligjore. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë).

✓ Monitorimi i Performancës së <u>bashkive të tjera</u> që kanë njësi auditimi

<u>Monitorimi i Performancës për Bashkinë Devoll për vitin 2017</u>

Vlerësimi i performancës së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) të Bashkive për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore mbështetet në analizën e pesë treguesve (indikatorëve) të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Devoll është vlerësuar me 325 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme dhe e renditur në vendin gjashtëmbëdhjetë nga vendi i njëzetë në vitin 2016.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me vitin 2016 është:

Tabela 24. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Devoll

Bashkia Devoll	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	6.37%	15	12.4%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	10	43%	25	4%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	15	6.9%	15	12.6%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	5	68%	15	10.71%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%

6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	10	2	10	2
9.Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10.Monitorimi	20	3	20	3
11.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	20		30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 12.4 % duke evidentuar një përkeqësim të situatës krahasuar me vitin 2016, ku vlerësimi për këtë indikator ishte 6.37% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Pavarësisht mosrealizimit të këtij indikatori, vlerësimi mbetet i njëjtë prej 15 pikësh duke qënë se këto vlera i përkasin nivelit të tretë të vlerësimit. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 4%, çka flet për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori, duke u vlerësuar me 25 pikë. Vlen të theksohet përmirësimi i dukshëm krahasuar me vitin 2016, ku ky indikator vlerësohej me 10 pikë, ku masa e mosrealizimit të tij ishte 43%.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 12.6% krahasuar me 6.9% në vitin 2016. Kjo tregon për një rritje të nivelit të mosrespektimit të përcaktimeve në Udhëzimin për Zbatimin e Buxhetit pavarësisht se vlerësimi për këtë indikator është 15 pikë, i njëjtë më vitin e kaluar.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, vihet re një përmirësim i dukshëm i performancës së institucionit, ku përqindja e mosrealizimit të këtij indikatori është ulur nga 68% në 10.71%. Vlerësimi për këtë indikator është 15 pikë, çka tregon një performancë mesatare në këtë drejtim.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë

detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, ashtu si vitin e kaluar, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë të shkëlqyer lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi i performacës nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Për çdo komponent janë llogaritur pikët mesatare të tij, të cilat përcaktohen duke konsideruar raportin e shumës së pikëve me të cilat institucioni ka vlerësuar çdo pyetje në përbërje të secilit komponent me numrin e pyetjeve respektive. Për Bashkinë Devoll, gjendja e sistemit të MFK-së paraqitet e njëjtë me vitin 2016, ku mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 2.81 pikë, gjë që i referohet nivelit të dytë të vlerësimit e barabartë me 20 pikë. Komponenti Menaxhimi i riskut dhe Aktivitetet e kontrollit arrijnë në një nivel vlerësim me 1.83 pikë dhe 1.57 pikë, duke i korresponduar kështu nivelit të tretë të vlerësimit me 10 pikë, sipas metodologjisë së monitorimit. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi kanë marrë respektivisht 30 pikë dhe 20 pikë, pasi janë vlerësuar respektivisht me 3.83 dhe 3 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar nevojën për marrjen e masave në fushën e menaxhimit të riskut dhe aktiviteteve të kontrollit.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Devoll** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB është i çertifikuar dhe audituesi i brendshëm është në proces çertifikimi.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 5 angazhime dhe ka realizuar 10 angazhime auditimi (8 a.përputhshmërie, 1 a.financiarë, 1 a. të kombinuara).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, nuk janë përshkruar gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm për vitin e raportimit, fushat me riskt të lartë, vlerësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm si hapi i parë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe rekomandimet për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, sikundër kërkohet në ligj. NJAB nuk funksion në bazë të standardeve të auditimit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku drejtuesi i NJAB është i çertifikuar dhe audituesi i brendshëm është në proces çertifikimi. Kjo

njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Divjakë për vitin 2017

Vlerësimi i performancës së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) të Bashkive për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore mbështetet në analizën e pesë treguesve (indikatorëve) të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Divjakë është vlerësuar me 375 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme dhe e renditur në vendin e gjashtë në grupin e bashkive të tjera që kanë njësi auditimi, duke fituar kështu një pozicion në rankim krahasuar me vitin 2016.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me vitin 2016 është:

Tabela 25. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Divjakë

Bashkia Divjakë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	8.89%	10	44.5%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	2%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	2.27%	30	2%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	22.5%	10	45.8%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	25	3.3%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	30	4	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4	20	3
9.Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10.Monitorimi	30	4	30	4
11.Përgatitja e audituesve të brendshëm	0		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 44.5% të totalit të faturave të regjistruara në

Thesar. Krahasuar me vitin 2016, ku përqindja e mosrealizimit të këtij indikatori ishte 8.89%, evidentohet një përkeqësim i performancës së institucionit për sa i përket këtij indikatori. Kjo reflektohet edhe në vlerësimin prej 10 pikësh, më i ulët se në vitin 2016.

2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 2%, çka flet për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë maksimale. Krahasuar me vitin 2016, ku masa e realizimit të këtij indikatori ishte 100%, institucioni duhet të tregojë kujdes për sa i përket anulimit të kontratave kur ato janë në proces.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 2% krahasuar me 2.27% në vitin 2016, ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e kënaqshme në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një performancë mesatare, pasi 45.8% 22.5% e kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 10 pikë. Krahasuar me vitin 2016, ku 22.5% e kontratave nuk kanë respektuar afatin 3-ditor të dorëzimit në degën e thesarit, vihet re një përkeqësim i situatës në masën 23.3%, çka tregon nevojën për marrjen e masave për respektimin e afateve kohore nga ana e institucionit.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë të shkëlqyer lidhur me këtë indikator, duke marrë parasysh dhe përmirësimin e dukshëm krahasuar me vitin 2016 ku ky indikator vlerësohej në masën 3.3%. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi i performacës nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Për çdo komponent janë llogaritur pikët mesatare të tij, të cilat përcaktohen duke konsideruar raportin e shumës së pikëve me të cilat institucioni ka vlerësuar çdo pyetje në përbërje të secilit komponent me numrin e pyetjeve respektive. Për Bashkinë Divjakë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.81 pikë, gjë që i referohet

nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Gjithashtu, komponenti i informimit dhe komunikimit dhe monitorim është vlerësuar me 30 pikë, duke qënë se vetëvlerësimi i tyre korrespondon respektivisht 3.5 dhe 4 pikë. Për këto tre komponentë, vlerësimi është i njëjtë me vitin 2016 çka tregon se institucioni ka implementuar elementët e nevojshëm për zhvillimin efektiv të tyre. Për sa i përket komponentit të menaxhimit të riskut dhe aktivitetet e kontrollit, vihet re një ulje në vlerësimin e tyre krahasuar me vitin 2016. Këta indikatorë janë vlerësuar me 20 pikë (përkatësisht 3.17 dhe 3.29 pikë). Në përgjithësi, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme për të gjithë komponentët e saj.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Divjakë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesi i brendshëm është në proces çertifikimi dhe punonjësi i NJAB duhet të çertifikohet brenda dy viteve të para të punësimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 10 dhe ka realizuar 5 angazhime auditimi (3 a.përputhshmërie dhe 2 a.financiare).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur plotësisht strukturës së kërkuar të raportit, është raportuar për gjetjet kryesore sipas sistemeve por në raport nuk ka përshkrime për fushat me risk të lartë, vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe rekomandimet si tregues kryesore të veprimtarisë së NJAB.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 2 punonjës (1 drejtues dhe 1 specialist), ku audituesi i brendshëm është në proces certifikimi dhe punonjësi i NJAB i pa certifikuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Dropull për vitin 2017

Tabela 26. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Dropull

Bashkia Dropull	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	1.19%	15	14%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	10	30%	25	5%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	10	32%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%

6. Mjedisi i kontrollit	20	3	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4	30	4
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		25	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Dropull është vlerësuar me 395 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë shumë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e dytë, katër pozicione më lart se në vitin 2016. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2016 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit për vitin 2017 sipas drejtorive përkatëse dhe krahasimin me vitin 2016:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 14% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Vlen të theksohet fakti se ky indikator ka pasur një ulje të masës së realizimit të tij krahasuar me vitin e kaluar, ku vetëm 1.19% e faturave nuk respektoni afatin 30 ditor të depozitimit në thesar. Kjo reflektohet edhe në vlerësimin prej 15 pikësh për këtë vit, bazuar në metodologjinë e monitorimit të performancës së njësive publike.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 5%, çka flet për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 25 pikë. Vërehet një përmirësim i dukshëm i performancës së institucionit lidhur me realizimin e këtij indikatori, pasi në vitin 2016 përqindja e mosrealizimit ishtë në masën 30% duke u vlerësuar me 10 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato

refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, situata paraqitet e njëjtë me atë të vitit 2016, ku raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.

4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 32%, situatë e cila nuk ngjason me atë të vitit 2016, ku performanca e kësaj bashkie ishte e shkëlqyer. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e katërt të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 10 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë mesatare të bashkisë Dropull në këtë drejtim.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë çka tregon në vazhdimësi për një performancë shumë të mirë të institucionit .

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Dropull, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.5 pikë, dhe vlerësohet me 30 pikë dhe tregon një përmirësim të këtij komponenti krahasuar me vitin 2016, ku ishte vlerësuar me 20 pikë. Rezultate të kënaqshme janë arritur edhe në komponentët e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe komunikimit dhe monitorimit të cilët kanë marrë respektivisht 3.57, 3.67 dhe 3.5 pikë duke u vlerësuar maksimalisht me 30 pikë. Komponenti i cili është vlerësuar më pak është menaxhimi i riskut me 2.83 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit, Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, ashtu si vitin e kaluar, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut, i cili mesatarisht është vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Dropull** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB dhe audituesi i brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, kurse një punonjës është në proces dhe punonjësi tjetër i NJAB duhet të çertifikohet brenda dy viteve të para të punësimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar angazhime dhe ka realizuar 21 angazhime auditimi (14 a.përputhshmërie, 1 a.financiar, 3 a. të kombinuara dhe 3 shërbime këshillimi). Kjo NJAB ka aktmarrëveshje me Bashkinë Libohovë dhe Bashkinë Finiq për realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm.

Në të ardhmen duhet të përqëndrohet në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës dhe realizimin më të mirë të vlerësimit të brendshëm të cilësisë për angazhimet e auditimit. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka pasqyruar gjetjet kryesore sipas sistemeve, ka përcaktuar fushat me risk të lartë dhe ka dhënë vlerësimet mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 4 punonjës (1 drejtues dhe 3 specialistë), ku drejtuesi i NJAB dhe audituesi i brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale, punonjësi i NJAB është në përfundim të procesit të certifkimit punonjësi tjetër duhet të certifikohet brenda dy viteve të para të punësimit. NJAB nuk ka pozicion të pa plotësuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Finiq për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Finiq është vlerësuar me 350 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e njëmbëdhjetë krahasuar me vendin e pesëmbëdhjetë në vitin 2016.

Tabela 27. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Finiq

Bashkia Finiq	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/viti 2016
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	7.46%	10	30%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	15	8%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	25	5%

5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	5	71.4%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	10	2
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	20	3
10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		25	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me vitin 2016 janë paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 30% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar, duke evidentuar një ulje të përformancës krahasuar me vitin 2016 për sa i përket këtij indikatori (masa e mosrealzimit në vitin 2016 ishte 7.46% dhe vlerësimi 15 pikë). Ky vlerësim tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 10 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të katërt.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, ashtu si në vitin 2016,për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, ndaj vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë maksimale, duke u karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer në këtë drejtim dhe duke evidentuar një përmirësim të dukshëm të situatës krahasuar me vitin 2016.

4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i ulët i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 5%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e dytë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 25 pikë. Në krahasim me vitin e kaluar ku realizimi i këtij indikatori ishtë në masën 100%, vihet re një ulje e përformancës së këtij institucioni për sa i përket respektimit të afateve kokore për dorëzimin e kontratave ne thesar. Megjithatë, vlerësimi prej 25 pikësh tregon për një performancë të kënaqshme të bashkisë Finiq në këtë drejtim.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Vlen të theksohet fakti se bashkia Finiq ka bërë përmirësime të dukshme për sa i përket realizimit të këtij indikatori pasi në vitin 2016 masa e mosrealizimit të tij ishte 71.4%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit për vitin 2017, është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Finiq, mjedisi i kontrollit, informimi dhe komunikimi dhe monitorimi janë vlerësuar mesatarisht me 2.75 pikë,2.67 pikë dhe 3 pikë ndaj dhe kanë marrë nga 20 pikë. Ndërsa, komponenti i menaxhimit të riskut dhe aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 2.33 pikë dhe 2.14 pikë duke marrë 10 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Krahasuar me vitin 2016, bazuar në vetëvlerësim, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele më të ulta, duke theksuar nevojën për marrjen e masave të menjëhershme, në kuadër të përmirësimit të të gjithë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bashkia Finiq ka aktmarrëveshje me Bashkinë Dropull për realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Fushë-Arrëz për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Fushë-Arrëz është vlerësuar me 370 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e shtatë, tre pozicione më lart në rankim, krahasuar me vitin 2016.

Tabela 28. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Fushë-Arrëz

Bashkia Fushë-Arrëz	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	0%	30	1%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	8.3%	25	5%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	20		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	20	3	20	3
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me vitin 2016, janë paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 1% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Ashtu si vitin e kaluar ku realizimi i këtij indikatori ishte në maën 100%, evidentohet një nivel shumë i kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, për vitin 2017, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki është 30 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të parë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në

vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, situata paraqitet e njëjtë për bashkinë në fjalë, ku raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Edhe gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i ulët i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 5%, çka tregon një përmirësim të masës së realizimit të këtij indikatori në krahasim me vitin 2016 (8.3%). Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e dytë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 25 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë mesatare të bashkisë Fushë-Arrëz në këtë drejtim.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, ashtu si për viitn 2016, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Fushë-Arrëz, të gjithë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit janë vlerësuar me 20 pikë, ku respektivisht pikët mesatare për çdo komponent janë 3.13, 2.83, 2.86,3.33 dhe 2.75 pikë. Në krahasim me vitin e kaluar, vihet re një përmirësim i komponentit të menaxhimit të riskut ku vlerësimi mesatar është rritur nga 2.33 pikë në 2.83 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të mesatare, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, në kuadër të përmirësimit të të gjithë komponentëve të MFK-së si dhe rritjes së ndërgjegjësimit të menaxherëve mbi rëndësinë e implementimit të praktikave më të mira të MFK-së.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Fushë Arrëz** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB dhe audituesi i brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar, kurse punonjësi i NJAB duhet të ndjekë brenda dy viteve procesin e çertifikimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 8 angazhime dhe ka realizuar 7 angazhime auditimi (5 a.përputhshmërie, 1 a.performance dhe 1 a.financiar).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, por raporti nuk përshkruan gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm për vitin e raportimit, fushat me riskt të lartë, vlerësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm si hapi i parë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe rekomandimet e propozuara për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, sikundër kërkohet në ligj NJAB nuk funksion në bazë të standardeve të auditimit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku drejtuesi i NJAB dhe audituesi i brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar, punonjësi i NJAB duhet të ndjekë brenda dy viteve procesin e certifikimit. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Gramsh për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Gramsh është vlerësuar me 385 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e katërt, tre pozicione më lart se në vitin 2016.

Tabela 29. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Gramsh

Bashkia Gramsh	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	10	26%	15	18.6%

2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	1%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.26%	30	1.2%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	5	55.6%	15	27.2%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	30	4	30	4
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	20	3	20	3
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016, janë paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 18.6% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Edhe pse ka një përmirësim krahasuar me vitin 2016, ku indikatori vlerësohej me një mosrealizim prej 26%, përsëri këto shifra tregojnë për një nivel jo të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 1%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë. Në krahasim me vitin 2016, ku realizimi i këtij indikatori ishte në masën 100%, vërehet një ulje e lehtë e performancës së bashkisë Gramsh, pavarësisht se vlerësimi sipas metodologjisë mbetet i njëjtë në të dy vitet.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më

vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1.2%, afërsisht e njëjtë me vitin 2016, ku pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.

4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 27.2%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e tretë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 15 pikë. Krahasuar me performancën e vitit të kaluar, ku më shumë se gjysma e kontratave të nënshkruara nuk respektonin afatin 3-ditor të dorëzimit në degën e thesarit (55.6%), këtë vit vërehet një përmirësim i dukshëm për sa i përket këtij indikatori, çka tregon për një performancë mesatare të bashkisë Gramsh në këtë drejtim.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, situata paraqitet pa ndryshime nga viti i kaluar, ku raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është maksimal prej 30 pikësh.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Gramsh, situata mbi zbatimin efektiv të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit paraqitet e njëjtë me atë të një viti më parë ku komponenti i mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut, informimi dhe komunikimi si dhe monitorimi janë vlerësuar mesatarisht me 3.56 pikë, 3.83 pikë, 3.5 pikë dhe 3.75 pikë, ndaj dhe kanë marrë nga 30 pikë secila. Ndërsa, komponenti i cili është vlerësuar me më pak pikë është ai i Aktiviteteve të Kontrollit, me 3 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, por ka nevojë për përmirësime të mëtejshme për sa i përket aktiviteteve të kontrollit.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Gramsh** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesit e brendshëm është i çertifikuar dhe i trajnuar.

Raportimi në kohë i Adituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Adituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (20 pikë)

Cilësia e Raportimit të adituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 9 angazhime auditimi dhe ka realizuar 6 angazhime auditimi.

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur plotësisht strukturës së kërkuar të raportit, është raportuar për gjetjet kryesore sipas sistemeve dhe fushat me risk të lartë por nuk është dhënë asnjë opinion mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si hapi i parë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel specialisti, e përbërë nga 1 punonjës (1 specialist), i cili është i çertifikuar dhe i trajnuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Himarë për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Himarë është vlerësuar me 335 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e katërmbëdhetë krahasuar me vendin e pesëmbëdhjetë në vitin 2016.

Tabela 30. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Himarë

Bashkia Himarë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	9.67%	15	25%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0.18%	10	37%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	25	4.6%	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	10	47%	5	56%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	10	28%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e adituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Adituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të adituesve të brendshëm	30	4	30	4

14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	25
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	30

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016, është paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 25% totalit të faturave të regjistruara në Thesar, krahasuar me vitin 2016 në të cilin ky indikator prekte shifrën prej 9.67%. Nga të dhënat statistikore të gjeneruara nga sistemi i thesarit, evidentohet një përkeqësim i performancë së bashkisë Himarë për sa i përket realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 10 pikë duke qënë se mosrealizimi mesatar i këtij indikatori i përket nivelit të katërt të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 37%, krahasuar me vitin 2016 ku realizimi i këtij indikatori ishte afërsisht në masën 100%. Referuar një viti më parë, mund të themi se performanca e bashkisë Himarë lidhur me realizimin e këtij indikatori është ulur ndjeshëm, çka reflektohet dhe në vlerësimin prej 10 pikësh.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1%, krahasuar me vlerën pres 4.6% në vitin 2016. Pra, pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 56% duke treguar për një vazhdimësi të uljes së performancës nga viti i kaluar ku mosrealizimi i këtij indikatori ishte 47%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në

intervalin e pestë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 5 pikë.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Krahasuar me vitin 2016, ku indikatori ka pasur një mosrealizmin në masën 28%, këtë vit situata paraqitet mjaft pozitive. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është maksimal me 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Himarë, të gjithë komponentët janë vlerësuar respektivisht me nga 3.25 pikë, 3 pikë, 2.86 pikë, 3.33 pikë dhe 2.75 pikë, duke marrë nga 20 pikë secili komponent. Në këtë rast, evidentohet një vetëvlerësim i njëjtë me atë të vitit të kaluar ku të gjithë komponentët ishin vlerësuar me 20 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, në kuadër të përmirësimit të të gjithë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Himarë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB dhe audituesi i brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar, kurse duhet të ndjekë brenda dy viteve procesin e çertifikimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Kjo NJAB për vitin 2017 ka programuar 5 dhe ka realizuar 4 angazhime auditimi (2 a.përputhshmërie, 3 a. të kombinuara dhe 1 a.me kërkesë të titullarit).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka pasqyruar gjetjet kryesore sipas sistemeve, ka përcaktuar fushat me risk të lartë por nuk ka dhënë vlerësimet për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si hapi i parë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku drejtuesi i NJAB është i certifikuar dhe audituesi i brendshëm duhet të ndjekë brenda dy viteve procesin e çertifikimit. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Kamëz për vitin 2017

Tabela 31. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Kamëz

Bashkia Kamëz	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	0.01%	15	19%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.35%	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	25	4.2%	5	66.7%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	30	4	30	4
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4	30	4
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Kamëz është vlerësuar me 395 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë shumë të mirë të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e dytë, një pozicion më të ulët se në rankimin e vitit 2016.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me vitin 2016, është paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2016, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për

dorëzimin e faturave në Thesar në masën 19% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të mesatar të realizimit të këtij indikatori, krahasuar me vitin e kaluar ku pothuajse 100% e faturave dërgoheshin në degën e thesarit brenda afatit të përcaktuar. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.

2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, situata paraqitet e njëjtë me atë të një viti më parë, ku raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet maksimalisht me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1%, pra shumica e urdhër shpenzimeve janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Edhe për këtë vit, performaca lidhur me këtë indikator është mjaft e lartë, ndaj vlerësimi është me 30 pikë.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, në ndryshim me vitin 2016, ky institucion karakterizohet nga një numër i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 66.7%, çka tregon për një performancë mjaft të ulët, të pazakontë për këtë institucion. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e pestë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 5 pikë krahasuar me vlerësimin prej 25 pikësh në vitin 2016.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0% i njëjtë me atë të një viti më parë. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është maksimal 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Kamëz, të gjithë komponentët janë vlerësuar respektivisht me nga 3.75 pikë,

3.67 pikë, 3.57 pikë, 4 pikë dhe 4 pikë, duke marrë nga 30 pikë secili komponent. Një rritje e lehtë vërehet në komponentin e mjedisit të kontrollit ku vlerësimi mesatar për vitin 2016 ishte 3.69 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të kënaqshme për të gjithë sistemin e MFK-së në tërësi.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Kamëz** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB dhe audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Kjo NJAB për vitin 2017 ka programuar dhe ka realizuar 10 angazhime auditimi.
Në të ardhmen duhet të përqëndrohet në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës dhe realizimin më të mirë të vlerësimit të brendshëm të cilësisë për angazhimet e auditimit. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, por raporti nuk përshkruan gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm për vitin e raportimit, fushat me risk të lartë, vlerësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm si hapi i parë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe rekomandimet e propozuara për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, sikundër kërkohet në ligj NJAB nuk funksion në bazë të standardeve të auditimit të brendshëm.
Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel Drejtorie, e përbërë me 4 punonjës (1 drejtues dhe 3 specialistë), ku drejtuesi i NJAB dhe audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar dhe punonjësi i NJAB është i pa certifkuar. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Kavajë për vitin 2017

Tabela 32. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Kavajë

Bashkia Kavajë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	5	52.2%	10	38%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	1.45%	25	4%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	2.1%	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	0	100%	0	92.65%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	0	97.9%	0	83%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	30	4

10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Kavajë është vlerësuar me 300 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e nëntëmbëdhjetë nga grupi i bashkive që kanë njësi auditimi, një pozicion më ulët se viti 2016.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me vitin 2016, janë paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 38% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar, duke treguar një përmirësim të situatës krahasuar me vitin 2016 ku mosrealizimi i këtij indikatori ishte në masën 52.2%. Pavarësisht përmirësimit të të dhënave statistikore, performanca e institucionit lidhur me realizmin e këtij indikatori mbetet mjaft e ulët. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 10 pikë duke qënë se mosrealizimi shumë i lartë i këtij indikatori i përket nivelit të katërt të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 4% në karahasim me vitin 2016 ku mosrealizimi paraqitej në masën 1.45%. kjo tregon për një ulje të lehtë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 25 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1%, çka tregon një përmirësim

të realizimit të këtij indikatori krahasuar me shifrën prej 2.1% në vitin 2016. Bazuar në të dhënat statistikore, shumica e urdhër shpenzimeve janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.

4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Ashtu si në vitin 2016, edhe gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër shumë i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 92.5%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e gjashtë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 0 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 83% duke pasur një përmirësim të lehtë në realizim por jo në vlerësim, krahasuar me vitin 2016. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit vazhdon të jetë 0 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Kavajë, komponenti i mjedisit të kontrollit, aktivitetet e kontrollit dhe monitorimi janë vlerësuar respektivisht me nga 2.56 pikë, 3.29 pikë dhe 2.75 pikë, duke marrë nga 20 pikë secili komponent, vlerësim ky, i njëjtë me atë të viti 2016. Përsa i përket komponentit të informimit dhe komunikimit, vërehet një përmirësim nga viti i kaluar ku ky indikator vlerësohet mesatarisht me 3.5 pikë duke marrë 30 pikë maksimale. Situata nuk paraqitet e njëjtë për komponentin e menaxhimit të riskut, ku vlerësimi mesatar është 1.83 pikë duke marrë 10 pikë sipas metodologjisë së monitorimit, krahasuar me vlerësimin prej 20 pikësh të vitit 2016. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar nevojën për marrjen e masave, në kuadër të përmirësimit të të gjithë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, kryesisht të menaxhimit të riskut.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Kavajë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB dhe audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimin e vijueshëm profesional të organizuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Kjo NJAB për vitin 2017 ka programuar dhe ka realizuar 10 angazhime auditimi (2 a.përputhsmërie, 3 a.performance dhe 5 a. të kombinuara).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka pasqyruar gjetjet kryesore sipas sistemeve, ka përcaktuar fushat me risk të lartë por nuk ka dhënë asnje vlerësim mbi sistemet e ngritura të kontrollit të brendshëm. Raporti ka përshkrime analitike të rekomandimeve të lëna pranë çdo subjekti të audituar, të dhëna këto të panevojshme sepse janë të pasqyruara në evidencat statistikore.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialist), ku drejtuesi i NJAB dhe audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Kolonjë për vitin 2017

Tabela 33. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Kolonjë

Bashkia Kolonjë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	25	3.82%	15	21.8%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.1%	25	2.6%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0.6%	10	30%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	0		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	0	1	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	0		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	20		30	

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Kolonjë është vlerësuar me 345 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e dymbëdhjetë, shtatë pozicione më lartë se vitin e kaluar.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me vitin 2016, janë paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 21.8% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një rritje të nivelit të mosrealizimit të këtij indikatori, krahasuar me vitin 2016. Bazuar në analizën e të dhënave të mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, i njëjtë me atë të viti 2016, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 2.6%, pra shumica e urdhër shpenzimeve janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Për vitin 2016, ky indikator vlerësohej mesatarisht me 1.1%, duke evidentuar në këtë mënyrë një rënie të lehtë e cila përkthehet në një vlerësim prej 25 pikësh për vitin 2017. Pavarësisht kësaj rënie, ky institucion karakterizohet nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër në rritje i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 30% krahasuar me vitin 2016 ku vlerësimi mesatar për këtë indikator ishte në masën 0.6%. Pra, vihet re një përkeqësim i

dukshëm i performancës së bashkisë Kolonjë lidhur me respektimin e afatit kohor për dorëzimin e kontratave në thesar. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e katërt të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 10 pikë.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, ashtu si në vitin 2016, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është maksimal me 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Kolonjë, për vitin 2017, situata prezantohet pa ndryshime krahasuar me vitin 2016 ku komponenti i mjedisit të kontrollit, aktiviteteve të kontrollit dhe monitorimit janë vlerësuar respektivisht me nga 2.56 pikë, 2.71 pikë dhe 2.75 pikë, duke marrë nga 20 pikë secili secili. Komponenti me vlerësimin më të lartë është informimi dhe komunikimi vlerësuar mesatarisht me 3.5 pikë, ndërsa komponenti me vlerësimin më të ulët, mestarisht 2 pikë, është ai i menaxhimit të riskut, i cili ka marrë 10 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, në kuadër të përmirësimit të të gjithë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, por veçanërisht të menaxhimit të riskut.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Kolonjë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesi i brendshëm është në proces certifikimi.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 14 angazhime dhe ka realizuar 28 angazhime auditimi (5 a.përputhshmërie, 3 a.performance, 10 a.financiarë, 2 a. të TI, 5 a. të kombinuara, 2 shërbime këshillimi dhe 1 a. me kërkesë të titullarit).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka pasqyruar gjetjet kryesore sipas sistemeve, ka përcaktuar fushat me risk të lartë dhe ka dhënë vlerësimet përkatëse mbi sistemet e ngritura të kontrollit të brendshëm

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialist), ku dy nga audituesit e brendshëm janë në proces çertifikimi. Kjo njësi e auditimit të brendshëm

funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicion të pa plotësuar. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Krujë për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2016, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Krujë është vlerësuar me 395 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë shumë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e dytë, duke fituar 3 pozicione në rankim në krahasimme vitin 2016.

Tabela 34. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Krujë

Bashkia Krujë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	10.56%	15	23%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	2%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	14.1%	15	26%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	30	4	30	4
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	10		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016, janë paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 23% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar, vlerë e cila vjen në rritje krahasuar me 10.56% mosrealizimin në vitin 2016. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 2% krahasuar me vitin 2016, ku realizimi i këtij indikatori ishtë në masën 100%. Pavarësisht kësaj rritje të lehtë të nivelit të mosrealizimit, përsëri vlerësimi për këtë indikator, për Bashkinë Krujë mbetet në nivelin maksimal prej 30 pikësh.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Kjo tregon një ecuri të ngjashme me atë të vitit 2016 ku realizimi për këtë indikator ishte në masën 100%, Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër mesatar i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 26% dhe evidenton një ulje të masës së realizimit të këtij indikatori pavarësisht se vlerësimi mbetet i njëjtë prej 15 pikë duke qënë se kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e tretë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%, çka tregon për një realizim në masën 100% të këtij indikatori, e njejtë me vitin 2016. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Krujë, të gjithë komponentët përveç aktiviteteve të kontrollit janë vlerësuar maksimalisht, duke marrë mesatarisht 3.75 pikë, 3.67 pikë, 4 pikë, 4 pikë dhe 4 pikë. Aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 3.14 pikë, duke evidentuar në këtë rast një ulje të performancës së institucionit krahasuar me vitin 2016 si dhe nevojën për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Në një pamje të përgjithshme, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të kënaqshme për të gjithë komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Krujë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, dy nga audituesit e brendshëm janë në proces çertifikimi dhe një auditues është i çerifikuar dhe ka ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Kjo NJAB ka planifikuar dhe ka realizuar 6 angazhime auditimi (6 a. përputhshmërie).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, por ky raport nuk ka të përshkruar gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm për vitin e raportimit, fushat me risk të lartë, si dhe rekomandimet kryesore të dhëna nga audituesit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, sikundër kërkohet në ligj. NJAB nuk ka kryer analizën e veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku drejtuesi i NJAB dhe një auditues i brendshëm janë në proces çertifikimi, kurse një nga audituesit e brendshëm është i çertifikuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicione aktuale të paplotësuara. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Kuçovë për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Tabela 35. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Kuçovë

Bashkia Kuçovë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	8.14%	10	28.8%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	15	11.2%	15	7%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	5.7%	5	63.16%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	1.8%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	30	4
10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	0		0	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	25		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	0	1	20	3
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	10		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Kuçovë është vlerësuar me 295 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e njëzetë, një pozicion më lartë se vitin e kaluar.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016, janë paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 28.8% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar, krahasuar me vitin 2016 ku indikatori vlerësohej me një mosrealizim në masën 8.14%. Kjo tregon për një përkeqësim të performancës së bashkisë në fjalë, duke ndikuar kështu në vlerësimin sipas metodologjisë së monitorimit. nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi për këtë bashki është 10 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të katërt të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i

kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, i njëjtë me vlerësimin në vitin 2016, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 7% krahasuar me vlerën prej 11.2% në vitin 2016. Pra, kemi një ulje të numrit të urdhër shpenzimeve të cilat nuk janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura, çka tregon për një përmirësim të lehtë të performancës për këtë indikator. Vlerësimi për këtë indikator është me 15 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë mesatare në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 63.16% krahasuar me 5.7% në vitin 2016. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e pestë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 5 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0% duke evidentuar një perfeksionim të këtij indikatori krahasuar me vitin 2016. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është maksimal me 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Kuçovë, komponenti i mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut, aktiviteteve të kontrollit, dhe monitorimit janë vlerësuar me nga 20 pikë secili, duke marrë mesatarisht 3.25 pikë, 2.83 pikë, 3.14 pikë dhe 3 pikë. Ndërsa, komponenti i cili ka marrë vlerësimin maksimal është ai informimit dhe komunikimit, vetëvlerësuar mesatarisht me 3.83 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, krahasuar me vitin 2016, evidentojmë një përmirësim të komponentit të informimit dhe komunikimit dhe një ulje të performancës përsa i përket komponentit të mjedisit të kontrollit. Si rezultat, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme për komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, por nuk përjashtohet nevoja për marrjen e masave për funksionimin efektiv të këtij sistemi.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Kuçovë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 0 pikë sepse për vitin 2017, audituesit e brendshëm janë të pa çertifikuar dhe nuk kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, NJAB ka paraqitur pyetësor të plotësuar në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (20 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 5 dhe ka realizuar 6 angazhime auditimi (4 a. përputhshmërie dhe 2 a. me kërkesë të titullarit).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka bërë listim të fushave me risk të lartë dhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 1 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të paçertifikuar dhe të pa trajnuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB ka pozicion të paplotësuara. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Libohovë për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Tabela 36. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Libohovë

Bashkia Libohovë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2016	Pikët/ viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	0.6%	15	11%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	5	75%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	10	2	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	0	1	0	1
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15		30	

13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		25	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Libohovë është vlerësuar me 335 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e katërmbëdhjetë duke humbur dy pozicione krahasuar me rankimin e vitit 2016.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016, janë paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 11% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një ulje të ndjeshme të realizimit të këtij indikatori, krahasuar me vlerën prej 0.6% të vitit 2016. Kjo reflektohet dukshëm në vlerësimin e performancës së këtsaj bashkie për këtë indikator. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, i njejtë me atë të një viti më parë, çka flet për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, çka tregon për një ecuri të njejtë me vitin paraardhës, ndaj vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër shumë i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 75%, duke patur një përkeqësim të

dukshëm të situatës krahasuar me vitin 2016 ku realizimi i këtij indikatori ishtë në masën 100%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e pestë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 5 pikë.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%, duke prezantuar në vazhdimësi një performancë shumë të mirë të këtij indikatori. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Libohovë, komponenti i mjedisit të kontrollit, aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe komunikimit dhe monitorimit janë vlerësuar respektivisht me nga 2.88 pikë, 2.71 pikë, 3.33 pikë dhe 3 pikë, duke marrë secili nga 20 pikë. Ndërsa, komponenti i menaxhimit të riskut, ashtu si në vitin 2016, është vlerësuar me 0 pikë, duke qënë se ka pasur një vetëvlerësim shumë të ulët (1.33). Nga vetëvlerësimi, në krahasim me vitin 2016, vihet re një përmirësim i komponentit të mjedisit të kontrollit, me një diferencë në vlerësim prej 10 pikësh. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele jo shumë të kenaqshme, duke theksuar nevojën për marrjen e masave të menjehrshme, kryesisht në kuadër të përmirësimit të komponentit të menaxhimit të riskut.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bashkia Libohovë ka aktmarrëveshje me Bashkinë Dropull për realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Librazhd për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Tabela 37. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Librazhd

Bashkia Librazhd	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	12.24%	15	25.3%

2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	10	31.5%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	10.9%	5	51.9%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	25		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		15	

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Librazhd është vlerësuar me 350 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e njëmbëdhjetë, tre pozicione më lart se në vitin 2016.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me të dhënat për vitin 2016, janë paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 25.3% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo shifër tregon një uljet të performancës së këtij indikatori në krahasim me vitin 2016 ku përqindja e mosrealizimit ishtë në masën 12.24%. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë, çka tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori duke qënë se mosrealizimii këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, duke evidentuar një përformancë shumë të mirë të bashkisë për sa i përket realizimit të këtij indikatori, krahasuar kjo me vitin 2016 ku rreth 31.5% e kontratave të lidhura, ishin anuluar. Vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. E njëjta situatë prezantohej dhe në vitin 2016, ku realizimi i këtij indikatori ishtë në masën 100%. Vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 51.9%. Krahasuar me vitin 2016 ku vetëm 10.9% e kontratave nuk kishin respektuar afatin e dorëzimit në degën përkatëse të thesarit, situata për këtë vit paraqitet e përkeqësuar, duke u reflektuar në vlerësimin prej 5 pikësh sipas metodologjisë së monitorimit të performancës.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, ashtu si në vitin 2016, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për vitin 2017, për Bashkinë Librazhd, komponenti i mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut dhe aktiviteteve të kontrollit janë vlerësuar me nga 20 pikë secili, duke marrë mesatarisht 3.19 pikë, 2.67 pikë dhe 3.43 pikë. Ndërsa, komponenti i informimit dhe komunikimit dhe monitorimit kanë një vlerësim të lartë prej 30 pikësh, për shkak të vetëvlerësimit prej 3.5 pikë. Komponenti i monitorimit është vlerësuar maksimalisht me 30 pikë. Krahasuar me vitin 2016, gjendja paraqitet e përmirësuar, por nuk përjashton nevojën për marrjen e masave të mëtejshme për implementimin me sukses të një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Librazhd** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesi i brendshëm është i çertifikuar dhe ka ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Adituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Adituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Adituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 9 angazhime dhe ka realizuar 6 angazhime auditimi. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, është raportuar për subjektet me risk dhe jo fushat me risk të lartë të identifikuara nga angazhimet e realizuara në këto subjekte, nuk është dhënë asnjë opinion mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku audituesi i brendshëm është i çertifikuar dhe i trajnuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB ka dy pozicione të paplotësuar. (15 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Lushnjë për vitin 2017

Tabela 38. Vlerësimi i Indikatorëve për Bahskinë Lushnje

Bashkia Lushnjë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	10.98%	10	35.4%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	2%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.05%	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	7.7%	10	42.1%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	25	2.5%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	30	4
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e adituesve të brendshëm	20		30	
12. Raportimi në kohë i Adituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të adituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të adituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Lushnjë është vlerësuar me 375 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e gjashtë, në krahasim me renditjen në vendin e tetë gjatë vitit 2016.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016, janë paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 35.4% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar, duke evidentuar një ulje të performancës së institucionit idhur me realizimin e këtij indikatori krahasuar me vitin 2016 (përqindja e mosrealizimit ishte 10.98%). Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 10 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të katërt të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 2%, krahasuar me vitin e kaluar, në të cilin ky indikator realizohej në masën 100%. Ky vlerësim, tregon për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1%, e njëjtë me vlerësimin e viti të kaluar, ku pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër mesatar i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 42.1%, krahasuar me vitin 2016 ku realizimi për këtë indikator është në masën 7.7%. Kjo paraqet një situatë të përkeqësuar për sa i përket performacës së bashkisë Lushnjë lidhur me këtë indikator. Për këtë arsye, përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në

intervalin e katërt të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 10 pikë.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0% duke paraqitur një nivel më të lartë të realizimit të këtij indikatori, krahasuar me vlerën 2.5% në vitin 2016. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Lushnjë, gjatë vitit 2017, komponenti i mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut dhe monitorimit janë vlerësuar me nga 30 pikë secili, duke marrë mesatarisht 3.56 pikë 3.67 pikë dhe 3.75, pra vërehet një përmirësim përsa i përket komponentit të menaxhimit të riskut, krahasuar me vitin 2016. Ndërsa, komponenti i aktiviteteve të kontrollit dhe informimit dhe komunikimit kanë një vlerësim më të ulët, me nga 20 pikë, duke marrë mesatarisht 3.14 pikë dhe 3.17 pikë, e njejtë me atë të vitit të kaluar. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, por duke vazhduar marrjen e masave në kuadër të përmirësimit të atyre komponentëve të cilët janë vlerësuar më pak.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Lushnjë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB dhe një audites i brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar, dhe punonjësi i NJAB duhet të çertifikohet brenda dy viteve të para të punësimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar dhe ka realizuar 14 angazhime auditimi. Në të ardhmen duhet të përqëndrohet në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës dhe realizimin më të mirë të vlerësimit të brendshëm të cilësisë për angazhimet e auditimit.

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka raportuar për gjëtjet kryesore sipas sistemeve por nuk ka raportuar për fushat me risk të lartë, vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe rekomandimet.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), drejtuesi i NJAB dhe një auditues janë të çertifikuar dhe të trajnuar, një auditues të brendshëm është i paçertifikuar. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Bulqizë për vitin 2017

Vlerësimi i performancës së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) të Bashkive për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore mbështetet në analizën e pesë treguesve (indikatorëve) të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Bulqizë është vlerësuar me 340 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme dhe e renditur në vendin e trembëdhjetë dhe duke ruajtur të njëjtin pozicion me vitin e kaluar.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016, janë:

Tabela 39. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Bulqizë

Bashkia Bulqizë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	6.4%	15	12.3%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	15	9.8%	15	6.8%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	5	69.2%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9.Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10.Monitorimi	20	3	20	3
11.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	20	3	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	20		30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 12.3%, të totalit të faturave të regjistruara në Thesar, shifër kjo, pothuajse dy herë më të lartë se në vitin 2016. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori, pavarësisht se situata paraqitet e përkeqësuar në krahasim me vitin 2016. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, i njëjtë me atë të vitit 2016, çka flet për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë maksimale.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, 6.8% e urdhër-shpenzimet të Bashkisë Bulqizë janë paraqitur në thesar në mënyrën jo të duhur. Në vitin 2016, ky indikator vlerësohej më 9.8%, pra vihet re një përmirësim i lehtë i performancës së institucionit lidhur me këtë indikator. Vlerësimi për vitin 2017, për këtë indikator është me 15 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë mesatare në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një performancë e ulët, pasi 69.2% e kontratatave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor. Kjo tregon për një ulje të dukshme të performancës krahasuar me vitin 2016, ku realizimi i këtij indikatori ishte në masën 100%. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit për këtë indikator për vitin 2017 është 5 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, ashtu si për vitin 2016, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë të shkëlqyer lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

rejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

erësimi i performacës nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të tëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të enaxhimit financiar dhe kontrollit. Për çdo komponent janë llogaritur pikët mesatare të tij, të lat përcaktohen duke konsideruar raportin e shumës së pikëve me të cilat institucioni ka

vlerësuar çdo pyetje në përbërje të secilit komponent me numrin e pyetjeve respektive. Për Bashkinë Bulqizë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.38 pikë, gjë që i referohet nivelit të dytë të vlerësimit e barabartë me 20 pikë, vlerësim i njëjtë me vitin 2016. Komponenti Menaxhimi i riskut arrin në një nivel vlerësimi me 2.53 pikë duke i korresponduar kështu nivelit të dytë të vlerësimit me 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e Kontrollit dhe Monitorimi janë vlerësuar me 20 pikë pasi kanë një vlerësim mesatar me 2.57 dhe 3.25 pikë secila. Informimi dhe komunikimi ka marrë 30 pikë pasi është vlerësuar me 3.67 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke evidentuar një përmirësim të lehtë në krahasim me vitin 2016. Pavarësisht, shifrave në rritje, duke theksuar nevoja e marrjes së masave, kryesisht në fushën e menaxhimit të riskut, aktiviteteve të kontrollit dhe monitorimit.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Bulqizë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, një audites duhet të ndjekë procesin e çertifikimit brenda dy viteve të para të punësimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 8 dhe ka realizuar 10 angazhime auditimi (5 a.përputhsmërie, 4 a. të kombinuara dhe 1 a. me kërkesë të titullarit).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka identifikuar fushat me risk të lartë dhe ka dhënë vlerësimet konkrete për sistemet e kontrollit të brendshëm. Në të ardhmen duhet të përqëndrohet në drejtim të kryerjes së auditimeve të përformancës.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 2 punonjës (1 drejtues dhe 1 specialist), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Malësi e Madhe për vitin 2017

Tabela 40. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Malësi e Madhe

Bashkia Malësi e Madhe	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	2.47%	15	24%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%

3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	0	76.9%	0	81%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	30	4	30	4
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	10		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	10		10	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Malësi e Madhe është vlerësuar me 375 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e gjashtë, tre pozicione më lartë se në vitin 2016.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna dhe krahasimi me vitin 2016, janë paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 24% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizmit të këtij indikatori dhe një përkeqësim të performancës krahasuar me vitin 2016, ku masa e mosrealizmit ishte 2.47%. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, sitauata paraqitet e njëjtë si në vitin 2016 për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, situata paraqitet e njëjtë me vitin 2016, ku raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Realizimi i këtij indikatori është në masën 100%, ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Në krahasim me vitin 2016, gjatë vitit analizues, vihet re një përkeqësim i performancës ku institucioni karakterizohet nga një numër mjaft i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 81%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e gjashtë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj vlerësohet me 0 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Edhe për vitin 2017, situata paraqitet mjaft pozitive në të cilën raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për vitin 2017, për Bashkinë Malësi e Madhe, përveç komponentit të aktiviteteve të kontrollit, i cili është vlerësuar me 20 pikë, të gjithë komponentët e tjerë janë vlerësuar maksimalisht, me nga 30 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, duke marrë në konsideratë dhe të dhënat për vitin 2016, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të kënaqshme.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Malësia e Madhe** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB dhe audituesi i brendshëm janë në përfundim të çertfikimit, kurse punonjësi i NJAB është i çertifikuar dhe trajnuar.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 10 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 8 angazhime dhe ka realizuar 14 angazhime auditimi (5 a.përputhshmërie, 3 a.performance, 4 a.financiar, 1 a. të kombinuar dhe 1 a. me kërkesë të titullarit).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit. Raporti nuk përshkruan gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm për vitin e raportimit, fushat me riskt të lartë, vlerësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm si hapi i parë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe rekomandimet e propozuara për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, sikundër kërkohet në ligj. Raporti ka përshkrime të gjata dhe të hollësishme mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet për çdo angazhim auditimi, ku konform manualit të AB, ky raportim duhet të përfshijë vetëm konkluzionet e veprimtarisë së NjAB. NJAB nuk funksion në bazë të standardeve të auditimit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku drejtuesi i NJAB dhe audituesi i brendshëm janë në përfundim të procesit të çertifikimit dhe audituesi i brendshëm është i çertifikuar dhe i trajnuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Maliq për vitin 2017

Tabela 41. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Maliq

Bashkia Maliq	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	25	4.72%	15	14.6%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	25	3%	30	2%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	25	3%	30	2%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	30	4
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	20	3	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	20	3	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		5	

15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	30

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Maliq është vlerësuar me 400 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë shumë të mirë të kësaj bashkie, duke fituar 10 pozicione dhe renditur në vendin e parë.

Më poshtë paraqitet vlerësimi i indikatorëve për vitin 2017 dhe krahasimi i tyre me vitin 2016.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 14.6% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Krahasuar me vitin e kaluar, ku indikatori ishte vlerësuar me 4.72%, vihet re një ulje e performancës së ketij institucioni për sa i përket respektimit të afatit prej 30 ditësh për dërgimin e faturave në degën përkatëse të thesarit. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimii këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, ashtu si dhe në vitin 2016, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 2%, pra shumica e urdhër shpenzimeve janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Krahasuar me vitin 2016, Bashkia Maliq ka pasur një përmirësim të lehtë të këtij indikatori me 1%, i cili ka ndikuar dhe në vlerësimin nga 25 pikë në 30 pikë për vitin 2017. Ky vlerësim tregon një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky

institucion karakterizohet nga një numër i vogël i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 2%, duke përmirësuar situatën në krahasim me vitin e kaluar ku mosrealizimi i këtij indikatori ishtë në masën 30%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e parë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 30 pikë.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, situata paraqitet e njëjtë me atë të vitit 2016, ku raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, kjo bashki tregon një performancë mjaft të mirë, ku vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Maliq, komponenti i mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut, informimit dhe komunikimit dhe monitorimit, paraqitet në nivele shumë të kënaqshme duke u vlerësuar maksimalisht me 30 pikë (respektivisht 3.63 pikë, 3.83, 4 pikë dhe 4 pikë). Komponenti i aktiviteteve të kontrollit është vlerësuar me 20 pikë, ku realizimi i këtij indikatori ka qënë në masën 3.43 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, krahasuar dhe me rezultatet e vitit të kaluar, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të larta, duke evidentuar një vlerësim më të lartë për çdo indikator si dhe një ndërgjegjësim të nivelit të lartë menaxherial për sa i përket rëndësisë së implementimit të një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Maliq** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB është i çertifikuar dhe audituesi i brendshëm duhet të ndjekë brenda dy viteve procesin e certifikimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 5 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 7 angazhime dhe ka realizuar 9 angazhime auditimi (2 a.financiarë, 4 a. të kombinuara, 3 a. me kërkesë të titullarit).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk ka paraqitur raport vjetor por vetëm evidencat e raportimit dhe pyetësorin e vetëvlerësimit. NJAB nuk funksion në bazë të standardeve të auditimit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 2 punonjës (1 drejtues dhe 1 specialist), ku drejtuesi i NJAB është i çertifikuar dhe audituesi i brendshëm duhet të ndjekë brenda dy viteve procesin e çertifikimit. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Klos për vitin 2017

Tabela 42. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Klos

Bashkia Klos	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	8%	30	1%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	15	9.53%	30	2%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	0	81.48%	5	53%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	30	4
10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm			30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve			30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm			20	3
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm			5	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara			30	

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Klos është vlerësuar me 350 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të mirë të kësaj bashkie, duke u renditur në vendin e njëmbëdhjetë.

Risi për këtë bashki, është krijimi i NJAB gjatë vitit 2017, e cila ka ndihmuar në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të këtij institucioni.

Më poshtë paraqitet vlerësimi i indikatorëve për vitin 2017 dhe krahasimi i tyre me vitin 2016.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 1% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Krahasuar me vitin e kaluar, ku indikatori ishte vlerësuar me 8%, vihet re një përmirësim në performancën e këtij institucioni për sa i përket respektimit të afatit prej 30 ditësh për dërgimin e faturave në degën përkatëse të thesarit. Kjo tregon për një nivel mjaft të mirë të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 30 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të parë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, ashtu si dhe në vitin 2016, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 2%, pra shumica e urdhër shpenzimeve janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Krahasuar me vitin 2016, Bashkia Klos ka pasur një përmirësim të dukshëm të këtij indikatori (vlerësimi në vitin 2016 ka qënë 9.53%), i cili ka ndikuar dhe në vlerësimin nga 15 pikë në 30 pikë për vitin 2017. Ky vlerësim tregon një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i vogëli kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 53% duke përmirësuar situatën në krahasim me vitin e kaluar ku mosrealizimi i këtij indikatori ishtë në masën 81.43%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e pestë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 5 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, situata paraqitet e njëjtë me atë të vitit 2016, ku raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e

përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, kjo bashki tregon një performancë mjaft të mirë, ku vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Klos, komponenti i mjedisit të kontrollit dhe informimit dhe komunikimit, paraqitet në nivele shumë të kënaqshme duke u vlerësuar maksimalisht me 30 pikë (respektivisht 3.5 pikë secili). Komponenti i aktiviteteve të kontrollit dhe monitorimit është vlerësuar me 20 pikë, ku realizimi i këtyre indikatorëve ka qënë në masën 2.57 dhe 2.75 pikë. Ndërkohë që komponenti i menaxhimit të riskut paraqitet në fazat fillestare të implementimit të tij dhe vlerësohet me 10 pikë. Krahasuar me vitin 2016, gjendja e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, sipas vetëvlerësimit, paraqitet e përmirësuar duke evidentuar një ndërgjegjësim të nivelit të lartë menaxherial për sa i përket rëndësisë së implemetimit të këtij sistemi.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Klos** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesi i brendshëm audites duhet të ndjekë procesin e çertifikimit brenda dy viteve të para të punësimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (20 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 5 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 nuk ka realizuar asnjë angazhim auditimi.

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, nuk ka përshkrim të fushave me risk të lartë dhe ka nuk dhënë vlerësimet konkrete për sistemet e kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel specialisti, e përbërë me 1 punonjës (1 specialist), audituesi i brendshëm audites duhet të ndjekë procesin e çertifikimit brenda dy viteve të para të punësimit. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Mallakastër për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Mallakastër është vlerësuar me 315 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme (5 pikë më pak se vitin e kaluar), duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e shtatëmbëdhjetë.

Tabela 43. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Mallakastër

Bashkia Mallakastër	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	25	2.94%	10	41.2%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	15	8.4%	15	6.6%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	8.7%	10	37%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	15	7.4%	25	5%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	10	2	10	2
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	25		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25		25	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 41.2% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një ulje të performancës së institucionit përsa i përket realizimit të këtij indikatori, krahasuar me vitin 2016. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 10 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të katërt të vlerësimit.

2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, ky indikator paraqitet përsëri në nivele shumë të kënaqshme, çka evidentohet nëpërmjet raportit të kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara i cili është 0%. Kjo tregon një performancë mjaft të mirë të bashkisë për sa i përket realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Nga analiza krahasuese, vërehet se gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 6.6%, pra më e ulët se në vitin 2016. Sipas metodologjisë së performancës, vlerësimi prej 15 pikëshcmbetet i njëjtë për të dy vitet, duke evidentuar një performancë mesatare në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër mesatar i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 37%. Kjo tregon një ulje të performancës së kësaj bashkie lidhur me realizimin e këtij indikatori, nëse mbajmë në konsideratë shifrën prej 8.7% në vitin 2016. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e katërt të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 10 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 5%, çka tregon për një përmirësim të performancës krahasuar me vitin e kaluar. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 25 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Mallakastër, komponenti i mjedisit të kontrollit, informimit dhe komunikimit si dhe monitorimit janë vlerësuar me nga 20 pikë secili, duke marrë mesatarisht 2.81 pikë, 2.67 pikë dhe 3 pikë. Ndërsa, komponenti i menaxhimit të riskut dhe aktiviteteve të kontrollit kanë një vlerësim më të ulët, me 10 pikë, për shkak të vetëvlerësimit shumë të ulët prej 2.33 dhe 2.43 pikësh. Pra, edhe për këtë vit, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të

brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar nevojën për marrjen e masave, kryesisht në kuadër të përmirësimit të komponentit të menaxhimit të riskut dhe aktiviteteve të kontrollit.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Mallakstër** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 9 angazhime dhe ka realizuar 11 angazhime auditimi.

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka pasqyruar gjetjet kryesore sipas sistemeve, ka përcaktuar fushat me risk të lartë dhe ka dhënë vlerësimet mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialist), ku dy nga audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar, kurse një punonjës është në proces certifikimi. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Mat për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015. Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.
Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Mat është vlerësuar me 330 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e pesëmbëdhjetë dhe 10 pikë më pak se në vitin 2016.
Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna, janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 44. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Mat

Bashkia Mat	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	25	2.87%	10	41%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga	30	0%	30	2.2%

thesari				
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	10	26.3%	5	75%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	10		20	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 41% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të ulët të realizimit të këtij indikatori, krahasuar me vitin 2016 ku një përqindje shumë e vogël e faturave nuk respektonin afatin prej 30 ditësh të dorëzimit në degën e thesarit. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 10 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të katërt të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është mbetet i njëjtë me vitin 2016 prej 0%, çka flet për një nivel shumë të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 2.2%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, edhe për këtë vit, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi

analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 75%, disa herë më e lartë se në vitin 2016. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, tregon një përformancë të ulët të kësaj bashkie përsa i përket realizimit të këtij indikatori. Vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës është 10 pikë.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, ashtu si në vitin 2016, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Mat, komponenti i aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe komunikimit si dhe monitorimit janë vlerësuar me nga 20 pikë secili, duke marrë mesatarisht 2.57 pikë, 3.33 pikë dhe 3 pikë. Komponenti i menaxhimit të riskut ka një vlerësim shumë të ulët, me 10 pikë, për shkak të vetëvlerësimit shumë të ulët prej 2.17 pikë. Ndërsa, komponenti i mjedisit të kontrollit është vlerësuar maksimalisht me 30 pikë (3.5 pikë). Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, e njëjtë me atë të vitit 2016, duke theksuar sidomos nevojën për marrjen e masave, kryesisht në kuadër të përmirësimit të komponentit të menaxhimit të riskut, i cili është vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Mat** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 20 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB dhe një nga audituesit e brendshëm janë të pa certifikuar dhe nuk kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, kurse një audites është i çertifikuar dhe i trajnuar.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Kjo NJAB ka planifikuar 7 dhe ka realizuar 12 angazhime auditimi (12 a. përputhshmërie).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, nuk është raportuar për fushat me risk dhe rekomandimet e propozuara. NjAB nuk ka bërë një analizë të mirfilltë të veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku drejtuesi i NJAB dhe një auditues i brendshëm janë të pa certifikuar dhe të pa trajnuar, kurse një nga audituesit e brendshëm është i çertifikuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Memaliaj për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Memaliaj është vlerësuar me 390 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e tretë, pavarësisht se kalimi në një pozicion më lart është përkthyer në 5 pikë më pak, krahasuar me vlerësimin e kryer në vitin 2016.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016, sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna, janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 45. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Memaliaj

Bashkia Memaliaj	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	0%	25	5%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.9%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	20%	0	100%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4	30	4
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të	30		30	

brendshëm të paplotësuara

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 5% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, pavarësisht se ka një ulje të performancës, krahasuar me vitin 2016. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 25 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të dytë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, situata paraqitet po aq pozitive sa në vitin 2016, ku për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Në krahasim me vitin 2016, kemi një përmirësim të lehtë të performancës përsa i përket realizimit të këtij indikatori, por vlerësimi mbetet i njëjtë për të dy vitet me 30 pikë maksimale.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet një performancë mjaft e ulët, ku raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 100%, pra të gjitha kontratat nuk kanë respektuar afatin 3 ditor të paraqitjes në degën e thesarit Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e gjashtë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 0 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, ashtu si në vitin 2016, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-

prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Memaliaj, komponenti i mjedisit të kontrollit, aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe komunikimit si dhe monitorimit janë vlerësuar me nga 30 pikë secili, duke marrë mesatarisht 3.81 pikë, 3.86 pikë, 3.83 pikë dhe 4 pikë. Komponenti i menaxhimit të riskut ka një vlerësim më të ulët, me 20 pikë, për shkak të vetëvlerësimit prej 3.17 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, të ngjashëm me atë të vitit 2016, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Memaliaj** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesi i brendshëm është i çertifikuar dhe ka ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, kurse punonjësi i NJAB duhet të çertifikohet brenda dy viteve të para të punësimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar angazhime dhe ka realizuar 10 angazhime auditimi.

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit,ka pasqyruar gjetjet kryesore sipas sistemeve,ka përcaktuar fushat me risk të lartë dhe ka dhënë vlerësimet mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 2 punonjës (1 drejtues dhe 1 specialist), ku të drejtuesi i NJAB është i çertifikuar dhe i trajnuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB ka një pozicion të paplotësuar. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Mirditë për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Mirditë është vlerësuar me 365 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e tetë. Gjatë vitit 2017, kjo bashki ka krijuar NJAB, e cila ka ndikuar dhe në një vlerësim më të lartë.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016, sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna, janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 46. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Mirditë

Bashkia Mirditë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	0%	25	3.9%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	30	2%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	10	2	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm			30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve			30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm			20	3
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm			10	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara			30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 3.9% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, pavarësisht se ka një ulje të performancës, krahasuar me vitin 2016, ku realizimim i këtij indikatori ishtë në masën 100%. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 25 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të dytë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të

këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, situata paraqitet po aq pozitive sa në vitin 2016, ku për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Në krahasim me vitin 2016, kemi një ulje të lehtë të performancës përsa i përket realizimit të këtij indikatori, por vlerësimi mbetet i njëjtë për të dy vitet me 30 pikë maksimale.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet një performancë e kënaqshme, ku raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 2%, pra pothuajse të gjitha kontratat kanë respektuar afatin 3 ditor të paraqitjes në degën e thesarit. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e parë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 30 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, ashtu si në vitin 2016, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Mirditë, komponenti i mjedisit të kontrollit, aktiviteteve të kontrollit, dhe monitorimit janë vlerësuar me nga 20 pikë secili, duke marrë mesatarisht 2.88 pikë, 3.29 pikë, dhe 2.75 pikë. Komponenti i menaxhimit të riskut ka një vlerësim më të ulët, me 10 pikë, për shkak të vetëvlerësimit prej 1.5 pikë. Komponenti i cili është vlerësuar maksimalisht është ai i informimit dhe komunikimit, me 30 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, të ngjashëm me atë të vitit 2016, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, ku theksohet nevoja për marrjen e masave për përmirësimin e sistemit të MFK, duke u fokusuar kryesisht tek komponenti i menaxhimit të riskut.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Mirditë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, një audites i brendshëm është i çertifikuar dhe ka ndjekur trajnimin e vijueshëm profesional të organizuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, dy audites janë në proces çertifikimi dhe një audites duhet të ndjekë procesin e çertifikimit gjatë dy viteve të para të punësimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (20 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 10 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Kjo NJAB është krijuar gjatë vitit 2017 dhe nuk ka paraqitur plan veprimtarie por ka realizuar 4 angazhime auditimi (4 a. të kombinuara).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, vetëm ka përcjellë një informacion të shkurtër mbi veprimtarinë e njësisë. Kjo njësi nuk ka pasqyruar gjetjet kryesore sipas sistemeve, nuk ka përcaktuar fushat me risk të lartë dhe nuk ka bërë vlerësimet e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e përbërë nga 4 punonjës (1 drejtues dhe 3 specialist), ku një nga audituesit është i çertifikuar dhe i trajnuar, dy audites të brendshëm janë në proces çertifikimi dhe një audites duhet të ndjekë procesin brenda dy viteve të para të punësimit. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Patos për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Patos është vlerësuar me 380 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e pestë, tre pozicione më ulët se vitin e kaluar dhe me një diferencë negative prej 45 pikë.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016, sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna, janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 47. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Patos

Bashkia Patos	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/

		Viti 2016		Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	1.05%	15	9.28%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	15	23%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	2.23%	30	1.5%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	15	21.7%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25		25	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, kemi një ulje të performancës lidhur me realzimin e këtij indikataori, ku evidentohet një mosrespektim i afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 9.28 % të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo shifër tregon rritjen e masës së mosrealizimit të këtij indikatori, krahasuar me vitin 2016. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimii këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, në ndryshim me vitin e kaluar, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 23%, çka dëshmon përsëri për një përkeqësim të performancës së kësaj bashkie lidhur me realizimin e këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 15 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara

me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1.5%, përafërsisht e njejtë me vitin e kaluar, ku pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.

4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër mesatar i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 21.7%, duke evidentuar faktin se ky institucion ka mangësi lidhur me respektimin e afateve kohore për dorëzimin e kontratave në kohën e duhur pranë degës së thesarit. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e tretë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 15 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, ashtu si dhe për vitin 2016, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Patos, komponenti i mjedisit të kontrollit, informimit dhe komunikimit si dhe monitorimit janë vlerësuar me nga 30 pikë secili, duke marrë mesatarisht 3.69 pikë, 3.83 pikë dhe 4 pikë. Komponenti i menaxhimit të riskut dhe aktiviteteve të kontrollit kanë një vlerësim më të ulët, me 20 pikë, për shkak të vetëvlerësimit prej 2.67 pikë dhe 3.43 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, i cili paraqitet i njëjtë me atë të vitit 2016, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar sidomos nevojën për marrjen e masave, kryesisht në kuadër të përmirësimit të komponentit të menaxhimit të riskut, i cili është vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Patos** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB dhe audituesi i brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 16 angazhime dhe ka realizuar 13 angazhime auditimi (3 a.përputhshmërisë, 2 a.performance, 1 a. financiar dhe 7 a.kombinuara).

Në të ardhmen duhet të përqëndrohet në drejtim të kryerjes më shumë të auditimeve të performancës dhe realizimin më të mirë të vlerësimit të brendshëm të cilësisë për angazhimet e auditimit. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, është raportuar për fushat me risk të lartë dhe janë dhënë opinionet përkatëse për sistemet jo funksionale të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 2 punonjës (1 drejtues dhe 1 specialist), ku drejtuesi i NJAB dhe audituesi i brendshë janë të çertifikuar dhe të trajnuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Pogradec për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Pogradec është vlerësuar me 345 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e dymbëdhjetë, dy pozicione më lart se në vitin 2016, e përkthyer në një diferencë pozitive prej 15 pikësh.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016, sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna, janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 48. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Pogradec

Bashkia Pogradec	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	10	26.1%	10	29.12%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	2%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	11%	10	35.3%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	1%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	

12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		25	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 29.12% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të ulët të realizimit të këtij indikatori, referuar edhe të dhënave për vitin 2016, ku mosrealizimi ishtë në masën 26.1%. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 10 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të katërt të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 2%, çka flet për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori. Krahasuar me të dhënat e raportuara në vitin 2016, kemi një ulje të lehtë të përformancës përsa i prërket realizimit të këtij indikatori, por vlerësimi sipas metodologjisë mbetet i njejtë me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, situata paraqitet e njejtë me atë të vitit 2016, ku raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër mesatar i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 35.3%, tre herë më i lartë se në vitin 2016, çka dëshmon për një performancë më të ulët lidhur me realizimin e këtij indikatori. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e katërt të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 10 pikë.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 1%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Pogradec, komponenti i mjedisit të kontrollit, aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe komunikimit si dhe monitorimit janë vlerësuar me nga 20 pikë secili, duke marrë mesatarisht 2.88 pikë, 3.14 pikë, 2.83 pikë dhe 2.75 pikë. Komponenti i menaxhimit të riskut ka një vlerësim më të ulët, me 10 pikë, për shkak të vetëvlerësimit prej 2.17 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, të njejtë me atë të vitit 2016, duke theksuar sidomos nevojën për marrjen e masave, kryesisht në kuadër të përmirësimit të komponentit të menaxhimit të riskut, i cili është vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Pogradec** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB është i pa çertifikuar dhe audituesi i brendshëm është çertifikuar dhe i trajnuar.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Për vitin2017 ka programuar 7 dhe ka realizuar 10 angazhime auditimi, gjë që tregon për planifikim jo të drejtë të burimeve.

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka pasqyruar gjetjet kryesore sipas sistemeve, ka përcaktuar fushat me risk të lartë dhe ka dhënë vlerësimet përkatëse mbi sistemet e ngritura të kontrollit të brendshëm

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 2 punonjës (1 drejtues dhe 1 specialist), ku drejtuesi i NJAB është i pa çertifikuar dhe audituesi i brendshëm është çertifikuar dhe i trajnuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Prrenjas për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Prrenjas është vlerësuar me 285 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë jo të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e njëzet e një dhe të fundit. Vlen të theksojmë, krijimin e NJAB gjatë vitit 2017, e cila do të ndikojë në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016, sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna, janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 49. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Prrenjas

Bashkia Prrenjas	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	13%	10	29.%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	25	5%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.2%	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	10	31.8%	5	66%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	0	1
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	20	3
10. Monitorimi	30	4	10	2
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm			30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve			30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm			20	3
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm			0	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara			30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 29% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të ulët të realizimit të këtij indikatori, referuar edhe të dhënave për vitin 2016, ku mosrealizimi ishtë në masën 13%. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive

publike për këtë bashki, është 10 pikë duke qënë se mosrealizimii këtij indikatori i përket nivelit të katërt të vlerësimit.

2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori. Krahasuar me të dhënat e raportuara në vitin 2016, kemi një përmirësim të përformancës përsa i prërket realizimit të këtij indikatori dhe vlerësimi sipas metodologjisë është 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, situata paraqitet e njejtë me atë të vitit 2016, ku raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 66%, dy herë më i lartë se në vitin 2016, çka dëshmon për një performancë më të ulët lidhur me realizimin e këtij indikatori. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e pestë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 5 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, ashtu si në vitin 2016, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Prrenjas, komponenti i mjedisit të kontrollit, aktiviteteve të kontrollit, dhe informimit dhe komunikimit janë vlerësuar me nga 20 pikë secili, duke marrë mesatarisht 2.63 pikë, 2.71 pikë dhe 3 pikë. Komponenti i menaxhimit të riskut ka një vlerësim mjaft të ulët, me 0

pikë, për shkak të vetëvlerësimit prej 1.17 pikë. Edhe komponenti i monitorimit, paraqitet në nivele jo të kënaqshme, duke marrë në konsideratë dhe faktin se vetëm gjatë vitit 2017, kjo bashki ka krijuar NJAB. Vlerësimi për këtë komponent është me 10 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, më e ulët se ajo e vitit 2016, duke theksuar sidomos nevojën për marrjen e masave, kryesisht në kuadër të përmirësimit të komponentit të menaxhimit të riskut dhe monitorimit, të cilët janë vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Prrenjas** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesi i brendshëm audites duhet të ndjekë procesin e çertifikimit brenda dy viteve të para të punësimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (20 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 0 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Kjo njësi nuk ka paraqitur raport vjetor dhe evidenca.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel specialisti, e përbërë me 1 punonjës (1 specialist), audituesi i brendshëm audites duhet të ndjekë procesin e çertifikimit brenda dy viteve të para të punësimit. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Pustec për vitin 2017

Tabela 50. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Pustec

Bashkia Pustec	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	7%	15	21.8%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	25	3.48%	25	3%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	30	0%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	10	2	10	2
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	20	3	20	3

11.Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	20		20	

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Pustec është vlerësuar me 345 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e dymbëdhjetë, një pozicion më poshtë se vitin e kaluar.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 dhe krahasimi me të dhënat e vitit 2016, sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më sipër.

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 21.8% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar, shifër kjo tre herë më lartë se ajo e raportuar në vitin 2016. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori, si dhe një ulje të performancës krahasuar me vitin e kaluar. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, ashtu si në vitin 2016, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 3%, pothuajse e njejtë me atë të vitit 2016, ndaj vlerësimi për këtë indikator është me 25 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Edhe për vitin

2017, ky institucion karakterizohet nga një numër shumë i ulët i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 0%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e parë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 30 pikë, çka dëshmon për nje performancë mjaft të mirë të bashkisë lidhur me realizimin e këtij indikatori.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%, që evidenton performancën e lartë të institucionit përsa i përket realizimit të këtij indikatori Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Pustec, komponenti i mjedisit të kontrollit dhe monitorimit kanë marrë nga 20 pikë secili, duke u vlerësuar respektivisht me nga 2.81 pikë dhe 3 pikë. Informimi dhe komunikimi është vlerësuar maksimalisht, pra 30 pikë. Ndërsa menaxhimi i riskut dhe aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar me 2.17 pikë dhe 1.86 pikë, duke marrë 10 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar sidomos nevojën për marrjen e masave të mëtejshme, kryesisht në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të riskut dhe aktiviteteve të kontrollit, të cilët janë vlerësuar më pak se të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bashkia Pustec ka aktmarrëveshje me Bashkinë Devoll për realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Roskovec për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Roskovec është vlerësuar me 360 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqëshme të kësaj bashkie dhe është renditur në vendin e nëntë kundrejt vendit të shtatëmbëdhjetë që kishtë në vitin 2016 me rritje të kënaqëshme për 45 pikë. Kjo rritje e performancës është kryesisht në treguesit e auditimit të brendshëm.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 51. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Roskovec

Bashkia Roskovec	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	0.88%	15	10%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	2%	25	4%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	15	13%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	30	4
10. Monitorimi	10	2	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	10		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	25		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	10	2	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	0		5	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 10% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë, duke rezultuar me ulje në këtë indikator krahasuar me vitin 2016 që ishte 30 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato

refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 4%, kundrejt 2% që ishtë në vitin 2016, duke u vlerësuar me 25 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e kënaqshme për këtë tregues.

4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i mesatar i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 13%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, vlerësohet me 15 pikë, duke reflektuar një performancë më të ulët në krrahasim me vitin 2016, që ishtë 30 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Roskovec, komponenti i mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut, aktiviteteve të kontrollit, dhe informimit dhe komunikimit janë vlerësuar me nga 20 pikë secili, duke marrë mesatarisht 3.06 pikë, 3 pikë, 2.86 pikë. dhe 3.33 pikë. Komponenti i informim komunikimit dhe monitorimit janë vlerësuar me 30 pikë pasi vetëvlerësimi është përkatësisht 3.5 pikë për secilin komponent. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar sidomos nevojën për marrjen e masave, kryesisht në kuadër të përmirësimit të komponententëve që lidhen me menaxhimin e riskut dhe aktivitetet e kontrollit.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Roskovec** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB është i çertifikuar dhe i trajnuar, audituesi i brendshëm është i paçertifikuar por duhet të çertifikohet brenda dy viteve të para të punësimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor nuk është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 5 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit ka programuar 11 angazhime dhe ka realizuar 3 angazhime auditimi (3 a. financiare).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, nuk është raportuar për gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm për vitin e raportimit, fushat me risk të lartë, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe rekomandimet kryesore të dhëna nga audituesit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, sikundër kërkohet në ligj. Gjatë vitit 2017, NJAB nuk ka kryer analizën e veprimtarisë së Auditimit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel zyre, e përbërë me 2 punonjës (1 drejtues dhe 1 specialistë), drejtuesi i NJAB është i çertifikuar, një auditues të brendshëm është i paçertifikuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Sarandë për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Sarandë është vlerësuar me 390 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie e cila është renditur në vendin e tretë kundrejt vendit të shtatë në vitin 2016, me një rritje në performancë me 20 pikë.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 52. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Sarandë

Bashkia Sarandë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	10	29.18%	15	17.5%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	25	3.1%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	30	0%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4	30	4
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	

12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	20	3	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 17.5% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke e përmirësuar performancën me pesë pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i vogël i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 0%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e parë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 30 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Sarandë, komponenti i aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe komunikimit si dhe monitorimit janë vlerësuar me nga 30 pikë secili, duke u vetëvlerësuar mesatarisht 3.71 pikë, 4 pikë dhe 3.5 pikë. Komponenti i mjedisit të kontrollit është vlerësuar me 20 pikë duke u vetëvlerësuar 3.44 pikë , ndërsa menaxhimi i riskut ka një vlerësim më të ulët, me 10 pikë, për shkak të vetëvlerësimit prej 2.17 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare. Në fushën e menaxhimit të riskut duhet të ndërmerren aktivitete konkrete për ta bërë funksional sistemin e menaxhimit të riskut, pasi bazuar në pyetësorin e vetëvlerësimit, rezulton që nuk janë deleguar disa detyra të kordinatorit të riskut tek një punonjës i strukturës së financës apo elementë të tjerë që lidhen me menaxhimin e risqeve të jënë funksional.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Sarandë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB dhe audituesi i brendshëm janë të çertifikuar dhe kanë ndjekur trajnimin e vijueshëm profesional të organizuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Kjo NJAB për vitin 2017 nuk ka paraqitur plan veprimtarie por ka realizuar 8 angazhime auditimi (5 a.përputhshmërie, 3 a. të kombinuara).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka pasqyruar gjetjet kryesore sipas sistemeve, ka përcaktuar fushat me risk të lartë dhe vlerësimet e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialist), ku drejtuesi i NJAB është i çertifikuar dhe i trajnuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë)

<u>Monitorimi i Performancës për Bashkinë Selenicë për vitin 2017</u>

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Selenicë është vlerësuar me 360 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie e cila është renditur në vendin e nëntë. Gjatë vitit 2017, është krijuar dhe NJAB pranë kësaj bashkie e cila ka ndikuar në rritjen e performancës.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 53. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Selenicë

Bashkia Selenicë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	25	2.7%	15	15.5%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	1%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	10	33%	10	48%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	15	15%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm			30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve			30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm			30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm			15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara			30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 15.5% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar, krahasuar me vitin 2016 ku mosrealizimi ishte në masën 2.7%. Kjo tregon për një nivel të mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke e ulur performancën me dhjetë pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa

për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë, vlerësim ky i njëjtë me atë të vitit 2016.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i konsiderueshëm i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 48%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e katërt të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 10 pikë. Kjo evidenton faktin, se kjo bashki ka mangësi në respektimin e afateve kohore të përcaktuara për dorëzimin e kontratave pranë degës përkatëse të thesarit.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë. Për këtë indikator, vërehet një përmirësim i performancës krahasuar me vitin 2016, ku vlerësimi ishte 15 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Selenicë, komponenti i mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut, aktiviteteve të kontrollit dhe monitorimit janë vlerësuar me nga 20 pikë secili, duke u vetëvlerësuar mesatarisht 2.88 pikë, 3.17 pikë, 3.14 pikë dhe 3 pikë. Komponenti i informimit dhe komunikimit është vlerësuar maksimalisht me 30 pikë duke u vetëvlërësuar 3.67 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, ku vihet re një përmirësim i komponentit të menaxhimit të riskut krahasuar me vitin 2016.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Selenicë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesi i brendshëm është në proces certifikimi.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Kjo NJAB është krijuar gjatë vitit 2017 dhe nuk ka paraqitur plan veprimtarie por ka realizuar 4 angazhime auditimi (1 a.përputhshmërie, 3 a. të kombinuara).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka pasqyruar gjetjet kryesore sipas sistemeve, ka përcaktuar fushat me risk të lartë por nuk ka përshkrim mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e përbërë nga një punonjës (1 specialist), audituesi i brendshëm është në proces çertifikimi. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Shijak për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Shijak është vlerësuar me 325 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, e cila tregon për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e gjashtëmbëdhjetë me përmirësim të performancës me 95 pikë kundrejt vitit 2016 që ishte renditur në vendin e njëzet e dytë. Krahasimi i indikatorëve midis dy vitete paraqet një situatë komplekse në ndryshimet që kanë pësuar indikatorët sipas komponentëve përkatës dhe konkretish indikatorët e thesarit kanë pësuar rënie për 45 pikë kundrejt rritjes që kanë pasur treguesit e MFK dhe të auditimit të brendshëm përkatësisht 50 pikë dhe 90 pikë.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 54. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Shijak

Bashkia Shijak	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	25	4.95%	10	30%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	25	3.57%	30	2%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga	30	2.32%	25	4%

thesari				
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	25	5.12%	0	93%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	10	2	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	0	1	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	10	2	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	30	4
10. Monitorimi	10	2	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	0		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	0	1	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	0		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 30% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel jo të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 10 pikë kundrejt 25 pikë në vitin 2016, duke patur një rënie të performancës në këtë tregues me 15 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 2%, çka flet për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 4%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 25 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i konsiderueshëm i kontratave të paraqitura me vonesë në thesa, ndaj raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me

numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 93% kundrejt 5.12% në vitin 2016, duke reflektuar një performancë jo pozitive për këtë indikator me rënie në vlerësim për 25 pikë.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Shijak, komponenti i mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut, dhe aktiviteteve të kontrollit janë vlerësuar me nga 20 pikë secili, duke marrë mesatarisht 3.19 pikë, 3.33 pikë dhe 3.43 pikë. Komponenti i informimit dhe komunikimit dhe monitorimit janë vlerësuar me 20 pikë, duke u vetëvlerësuar respektivisht me 3.67 pikë dhe 3.5 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare.

Nga vlerësimi që i'u bë përgjigjeve të dhëna në pyetësorin e vëtëvlerësimit, në kuadër të monitorimit të realizuar në Bashkinë e Shijakut u konstatua që, nëse për komponentin e mjedisit të kontrollit, informim komunikimit dhe monitorimit nga institucioni situata vlerësohet e kënaqëshme, përsa i përket menaxhimit të riskut në institucion nuk ishte ngritur dhe funksiononte sistemi i menaxhimit të riskut. Për komponentin e aktiviteteve të kontrollit mund të themi se duheshin fokusuar më shumë tek përgatitja e manualeve të proceseve të punës, si një element i rëndësishëm kontrolli dhe monitorimi të punës së çdo strukture të institucionit.
Bazuar sa më sipër, kemi një vlerësim të përformancës, përsa i përket komponentëve të kontrollit të brendshëm së institucionit, më të ulët veçanërisht për komponentin e menaxhimit të riskut, nga sa është raportuar.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Shijak** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 20 pikë sepse për vitin 2017, dy nga audituesit e brendshëm janë të paçertifikuar dhe nuk kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (20 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 10 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Kjo NJAB ka planifikuar 5 dhe ka realizuar 4 angazhime auditimi (1 a. përputhshmërie, 1 a. financiar dhe 2 a. të kombinuara).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, por ky raport nuk ka të përshkruar gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm për vitin e raportimit, fushat me risk të lartë si dhe rekomandimet kryesore të dhëna nga audituesit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, sikundër kërkohet në ligj.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku dy nga audituesit e brendshëm janë të paçertifikuar dhe të pa trajnuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Skrapar për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Skrapar është vlerësuar me 355 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, me një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie duke u renditur në vendin e dhjetë kundrejt vendit të gjashtë në 2016, më rënie në performancë për 25 pikë, kryesisht në indikatorët e thesarit.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 55. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Skrapar

Bashkia Skrapar	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	5.77%	15	19.7%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.78%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	17.8%	0	100%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	10		10	

15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	30

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 19.7% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 100%, që do të thotë se të gjitha kontrat e miratuara janë paraqitur me vonesë për veprim në thesar. Bazuar sa më sipër, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës është 0, duke realizuar një performancë jo të kënaqshme në këtë tregues.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Skrapar, komponenti i mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut si dhe aktiviteteve të kontrollit janë vlerësuar me 20 pikë secili duke marrë mesatarisht 3.19 pikë, 3.33 pikë dhe 3.43 pikë. Ndërsa komponentët e informimit dhe komunikimit si dhe monitorimit janë vlerësuar me nga 30 pikë secili, duke marrë mesatarisht 3.67 pikë, dhe 3.5 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar sidomos nevojën për marrjen e masave, kryesisht në kuadër të përmirësimit të komponentit të menaxhimit të riskut dhe aktiviteteve të kontrollit, të cilët janë vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Skrapar** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesi i brendshëm është i pa çertifikuar por sipas akteve ligjore duhet të përfundojë këtë proces brenda dy viteve të para të punësimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 10 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Kjo NJAB ka programuar 8 dhe ka realizuar 5 angazhime auditimi (3 a. përputshmërie, 1 a. të kombinuar dhe 1 shërbim këshillimi).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka pasqyruar gjetjet kryesore sipas sistemeve por nuk ka bërë një përcaktim të fushave me risk të lartë dhe një vlerësim të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel specialisti, e përbërë me 1 punonjës (1 specialist), ku audituesi i brendshëm është i paçertifikuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Tepelenë për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Tepelenë është vlerësuar me 305 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e

renditur në vendin e tetëmbëdhjetë. Vlerësojmë se dy tregues të performancës kanë një përkeqësim duke u ulur me 40 pikë.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 56. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Tepelenë

Bashkia Tepelenë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	0%	15	13.7%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.58%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	5	71.1%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	10	2	10	2
7. Menaxhimi i Riskut	0	1	0	1
8. Aktivitetet e kontrollit	10	2	10	2
9. Informimi dhe komunikimi	10	2	30	2
10. Monitorimi	10	2	10	2
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	20	3	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 13.7% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë. Ky indikator në krahasim me vitin 2016 ka një ulje për 15 pikë duke ndikuar në performancën e institucionit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i

kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër shumë i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 71.10%. duke u vlerësuar me 5 pikë sipas vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës. Ky tregues parqitet me përkeqësim të performancës së këtij institucioni.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Tepelenë, komponenti i mjedisit të kontrollit, aktiviteteve të kontrollit, si dhe monitorimit janë vlerësuar me nga 10 pikë secili, duke marrë mesatarisht 2 pikë, 2.29 pikë dhe 2 pikë. Ndërsa, komponenti i menaxhimit të riskut është vlerësuar me 0 pikë, duke marrë vetëm 1 pikë. Komponenti i informim komunikimit është vlerësuar me 30 pikë duke marrë mesatarisht 3.5 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të dobëta. Nga gjithë niveli menaxherial nuk janë ndërmarrë hapa për përmirësimin e kësaj situate jo të mirë, përsa i përket komponentëve të kontrollit të brendshëm, duke vlerësuar që është e njëjta situatë në krahasim me vitin 2016. Nga kjo situatë kuptojmë që bashkia nuk e përdor pyetësorin si një dokument vetëvlerësimi për të identifikuar problematikën për përmirësimin e situatës, por vetëm si një detyrim ligjor për ta paraqitur në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Një situatë më problematike paraqitet në komponentin e menaxhimit të riskut ku rezulton se nuk është zhvilluar asnjë element i këtij procesi. Vlerësojmë se dhe puna e auditimit të brendshëm në drejtim të vlerësimit të funksionimit të kontrollit të brendshëm nuk ka funksionuar.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Tepelenë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, audituesi i brendshëm është i çertifikuar dhe ka ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, kurse punonjësi i NJAB duhet të çertifikohet brenda dy viteve të para të punësimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (20 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 4 dhe ka realizuar 5 angazhime auditimi, gjë që tregon për planifikim jo të drejtë të burimeve.

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka pasqyruar gjetjet kryesore sipas sistemeve, ka përcaktuar fushat me risk të lartë dhe ka dhënë vlerësimet mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sipas Raportimit vlerësojmë se kjo strukturë nuk ka proceduar konform standarteve dhe metodologjisë së auditimit të brendshëm sepse gjatë angazhimeve të auditimit evidentohet mbajtja e proces-verbaleve për shkeljet me dëm ekonomik, në kushtet kur roli dhe misioni i auditimit të brendshëm është vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel zyre, e përbërë me 2 punonjës (1 drejtues dhe një specialist), ku drejtuesi i NJAB është i çertifikuar dhe i trajnuar kurse punonjësi i NJAB është i paçertifikuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë).

<u>Monitorimi i Performancës për Bashkinë Tropojë për vitin 2017</u>

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Tropojë është vlerësuar me 300 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme me një performancë relativisht të mirë të kësaj bashkie duke u renditur në vendin e nëntëmbëdhjetë, kundrejt vendit të njëzet e tretë që kishtë në vitin 2016 (195 pikë). Kjo situatë tregon për një përmirësim të ndjeshëm të performancës së këtij institucioni me 105 pikë dhe është kryesisht në indikatorët që lidhen me auditimin e brendshëm dhe disa tregues të thesarit.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 57. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Tropojë

Bashkia Tropojë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	0%	15	22%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	15	8.3%	25	3%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	15	5.56%	25	5%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	0	100%	0	100%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	0	91.67%	25	3%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	10	2	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	20	3	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	10		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	0	1	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	10		0	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	20		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 22% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori i vlerësuar me 15 pikë sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike. Ky tregues krahasuar me vitin 2016 ka rënie në pikëzim për 15 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 3% që i përkojnë 25 pikë, kundrejt 8.3% që ishtë në vitin 2016, çka flet për një përmirësim të performancës për këtë indikator me 10 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më

vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 5%, pra shumica e urdhër shpenzimeve janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 25 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e mirë në këtë drejtim.

4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër shumë i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 100% dhe vlerësohet me 0 pikë. Vlerësohet që ky indikator është me të njëjtën performancë jo të kënaqshme si dhe në vitit 2016. Bashkia Tropojë duhet vlerësojë dhe analizojë këtë situatë mbasi ndikon në krijimin e detyrimeve të prapambetura.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 3%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 25 pikë. Konstatohet se ky indikator ka përmirësim të ndjeshëm në krafasim me vitin 2016 me 25 pikë, që ndikon në rritjen në rankimin e kësaj bashkie.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Tropojë, komponenti i mjedisit të kontrollit, aktivitetet e kontrollit, informimit dhe komunikimit si dhe monitorimit janë vlerësuar me nga 20 pikë secili, duke marrë përkatësisht mesatarisht 2.88 pikë, 2.57 pikë, 2.83 pikë dhe 2.75 pikë. Ndërsa, komponenti i menaxhimit të riskut është kontrollit janë vlerësuar me 10 pikë, duke marrë respektivisht 2.33 pikë

Bazuar në vetëvlerësimin e realizuar nga pyetësori i vetëvlerësimit dhe në informacionin e raportit të kontrollit të brendshëm vlerësojmë se gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare. Komponenti i menaxhimit të riskut është në nivelin e dytë të vlerësimit që tregon se ku proces për vitin 2017 nuk ka qenë i zhvilluar në të gjithë elementët e tij. Bashkia Tropojë ka paraqitur dhe një plan zhvillimi për ato fusha që janë paraqitur problematike duke u fokusuar kryesisht në menaxhimin e riskut. Auditimi i brendshëm duhet të fokusohet më shumë në vlerësimin e funksionimit të sistemeve të MFK, e cila duket dhe në vlerësimin e këtij elementi në puetësor me pikëzimin 2.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Tropojë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB është i paçertifikuar dhe audituesi i brendshëm duhet të ndjekë brenda dy viteve procesin e çertifikimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor nuk është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 0 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 4 angazhime dhe nuk ka realizuar asnjë angazhim auditimi.

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk ka paraqitur raportin vjetor së bashku me evidencat por ka përcjellë vetëm pyetësorin e vetëvlerësimit. NJAB nuk funksion në bazë të standardeve të auditimit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 2 punonjës (1 drejtues dhe 1 specialistë), ku drejtuesi i NJAB dhe audituesi i brendshëm janë në përfundim të procesit të çertifikimit. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Ura Vajgurore për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Ura Vajgurore është vlerësuar me 375 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme ,me një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie, duke u renditur në vendin e gjashtë kundrejt vendit të nëntë në vitin 2016, që ishtë vlerësuar me 355 pikë. Pra kjo bashki e ka përmirësuar performancën e vet me 20 pikë.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 58. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Ura Vajgurore

Bashkia Ura Vajgurore	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	6.14%	15	23.9%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	25	3%	30	2%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	9%	25	5%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	25	4.3%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3

8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	25		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	10		5	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 23.9%, kundrejt 6.14% në vitin 2016, për totalin e faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 2%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër mesatar i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 5%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e dytë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 25 pikë. Ka një përmirësim në këtë tregues kundrejt vitit 2016 me 10 pikë.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Ura Vajgurore, komponenti i mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut dhe aktiviteteve të kontrollit janë vlerësuar me nga 20 pikë secili, duke marrë mesatarisht 3.44 pikë, 3.33 pikë dhe 3.29 pikë. Ndërsa, komponenti i informimit dhe komunikimit si dhe monitorimit janë vlerësuar maksimalisht, me 30 pikë, duke marrë secila përkatësisht 3.67 pikë dhe 3.5 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme. Konstatojmë që pikëzimi mesatar si dhe përgjigjet e pyetjeve, sipas vetëvlerësimit, për vitin 2017 është i njëjtë me atë të vitit 2016, që tregon se nuk kemi një vlerësim serioz për ta parë pyetësorin si një mjet që ndihmon për përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, por vetëm për të kryer detyrimin ligjor kundrejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Ura Vajgurore** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, një audites i brendshëm nuk është i çertifikuar por sipas akteve ligjore duhet të ndjekë këtë proces brenda dy viteve të para të punësimit.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 5 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Kjo NJAB ka programuar 4 dhe ka realizuar 5 angazhime auditimi (3 a.përputhshmërie dhe 2 a. të kombinuara).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk ka paraqitur raport vjetor por vetëm evidencat e raportimit dhe pyetësorin e vetëvlerësimit. NJAB nuk funksion në bazë të standardeve të auditimit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel zyre, e përbërë me 2 punonjës (1 drejtue dhe 1 specialist), ku një audites i brendshëm është i pa çertifikuar dhe një audites në proces çertifikimi. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicione të paplotësuara. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Vau Dejës për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Vau Dejës është vlerësuar me 355 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e dhjetë. Kjo bashki ka treguar një performancë të qëndrueshme krahasuar me vitin 2016, që ka të njëjtin pikëzim (355 pikë).

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 59. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Vau Dejës

Bashkia Vau Dejës	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	0.56%	25	5.2%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0.42%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	25	4.7%	15	24%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	30	4	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	10		20	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 5.2% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së

njësive publike për këtë bashki, është 25 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të dytë të vlerësimit.

2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i ulët i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 24%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e tretë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 15 pikë. Ky indikator ka një rënie me 10 pikë që ndikon në performancën e institucionit.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Vau Dejës, komponenti i mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut, aktiviteteve të kontrollit dhe informimit dhe komunikimit dhe monitorimit janë vlerësuar me nga 20 pikë secili, duke marrë mesatarisht 2.88 pikë, 2.5 pikë, 2.57 pikë, 3 pikë dhe 2.75 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme. Por bazuar në përgjigjet e dhëna në pyetësorin e vetëvlerësimit konstatojmë se ka fusha për të cilat vlerësimi është dhënë me dy dhe kërkojnë marrjen e masave konkrete

nëpërmjet një plani të zhvillimit të MFK sipas formatit të sugjeruar në manualin e MFK. Këto fusha janë të fokusuar kryesisht në menaxhimin e riskut dhe trajnimin e stafit, si dhe në përmirësimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Vau i Dejës** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 20 pikë sepse për vitin 2017, dy audituesi te brendshëm janë të paçertifikuar dhe drejtuesi i NJAB është në proces çertifikimi.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për disa rezultate në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 12 angazhime dhe ka realizuar 9 angazhime auditimi (3 a.përputhshmërie dhe 5 a. të kombinuara).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, ka pasqyruar gjetjet kryesore sipas sistemeve, ka përcaktuar fushat me risk të lartë por nuk ka dhënë vlerësimet mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si hapi i parë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku drejtuesi i NJAB është në proces çertifikimi dhe audituesit e brendshëm janë të paçertifikuar. Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Vorë për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Vorë është vlerësuar me 375 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme me një performancë kënaqshme të kësaj bashkie duke u renditur në vendin e gjashtë kundrejt vendit të tretë në vitin 2016. Kjo bashki ka rënie në treguesit e performancës me 40 pikë, kryesisht në treguesit që lidhen me veprimet në thesar.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 60. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Vorë

Bashkia Vorë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017

1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	8%	10	41%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	25	2.9%	25	3%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	0	100%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	
7. Menaxhimi i Riskut	30	4	30	
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4	30	
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	
10. Monitorimi	30	4	30	
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30		30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30		30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15		10	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30		30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 41% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar, kundrejt 8% në vitin 2016. Ky indikator është vlerësuar me 10 pikë. Konstatohet se ka rënie në performancën e këtij indikatori.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 3%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 25 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi

analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 100%, duke u vlerësuar me 0 pikë. Ky tregues ka nënie të konsiderueshme me 30 pikë duke përkeqësuar performancën e bashkisë duke ndikuar në rënien në renditjen e përgjithshme të bashkive. Bashkia Vorë duhet vlerësojë dhe analizojë këtë situatë mbasi ndikon në krijimin e detyrimeve të prapambetura.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Vorë, të gjithë komponentët janë vlerësuar maksimalisht, pra 30 pikë, duke marrë respektivisht 4 pikë, 3.83 pikë, 4 pikë, 4 pikë dhe 4 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të kënaqshme.

Pavarësisht se vetëvlerësimi është bërë maksimal në të gjitha pyetjet e pyetësorit, bazuar në raportin e paraqitur mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm në bashki, sugjerojmë që menaxhimi i riskut duhet të jetë një proces që të përfshijë dhe strukturat e vartësisë. Gjithashtu duhet të punohet sidomos në drejtim të rritjes së përgjegjshmërisë menaxheriale në bashki dhe në strukturat vartëse.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Vorë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2017, drejtuesi i NJAB dhe audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 10 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar angazhime dhe ka realizuar 10 angazhime auditimi (4 a.financiare dhe 6 a. të kombinuar).

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, raportimi paraqitet si një informacion shumë i shkurtër, duke mos paraqitur asnjë të dhënë mbi arritjet dhe rezultatet e veprimtarisë së NjAB.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 4 punonjës (1 drejtues dhe 3 specialistë), ku drejtuesi i NJAB dhe audituesit e brendshëm janë të çertifikuar dhe të trajnuar. NJAB nuk ka pozicion të paplotësuar. (30 pikë)

✓ **Monitorimi i performancës së bashkive që nuk kanë njësi auditimi**

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Belsh për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe pesë treguesve që lidhen me komponentët e MFK.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Belsh është vlerësuar me 240 pikë nga 300 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë shumë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e dytë në grupin e bashkive që nuk kanë njësi auditimi.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 61. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Belsh

Bashkia Belsh	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	25	3.78%	15	21%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0.44%	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	11.1%	10	43%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	15	7%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	30	4
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4	30	4
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	20	3	20	3

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 21% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së

njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë. Ky indikator paraqitet me ulje për 10 pikë kundrejt vitit 2016 duke treguar përkeqësim të performancës së këtij treguesi.

2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i ndjeshëm i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 43%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e katërt të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 10 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë jo të kënaqshme të bashkisë Belsh, e cila është përkeqësuar në krahasim me vitin 2016 (tabela me sipër).
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 7%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 15 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Belsh, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.69 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 3.65 pikë, duke marrë 30 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 3.57 pikë, duke marrë 30 pikë sipas metodologjisë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi janë vlerësuar me 4 pikë dhe 3.25 pikë, duke grumbulluar respektivisht 30 dhe 20 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të menaxhimit të riskut.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Cërrik për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe pesë treguesve që lidhen me komponentët e MFK.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Cërrik është vlerësuar me 260 pikë nga 300 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë shumë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e parë në grupin e bashkive që nuk kanë njësi auditimi.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 62. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Cërrik

Bashkia Cërrik	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	24.02%	10	40%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	2.4%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	16.1%	10	48%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	15	7.6%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	30	4	30	4
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4	30	4
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	30	4	30	4

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 40% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel jo të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 10 pikë. Performanca e këtij treguesi ka ardhur në rënie në krahasim me vitin 2016 duke zbritur në një nivel më poshtë që i përkojnë 5 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në

vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i konsiderueshëm i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 48%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e katërt të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 10 pikë. Performanca e këtij indikatori është përkeqësuar në krahsim me vitin 2016 i cili ishte vlerësuar pesë pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Cërrik, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.75pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 3.67 pikë, duke marrë 30 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 3.57 pikë, duke marrë 30 pikë sipas metodologjisë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi janë vlerësuar me 4 pikë dhe 3.75 pikë, duke grumbulluar respektivisht nga 30 pikë secila.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të kënaqshme, duke marrë një vetëvlerësim maksimal.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Delvinë për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe pesë treguesve që lidhen me komponentët e MFK.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Delvinë është vlerësuar me 260 pikë nga 300 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe renditet në vendin e dytë. Ka një përmirësim të ndjeshëm të performancës së kësaj bashkie në krahasim me vitin 2016, e cila ndodhej në vendin e nëntë me rritje për 45 pikë.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 63. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Delvinë

Bashkia Delvinë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	0	80.4%	15	24.6%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	25	5%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	25	5%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	10	29.4%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	20	3	20	3

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 24.64% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë. Krahasuar me vitin 2016 ka një përmiresim të këtij indikatori prej 15 pikë, por detyrë e insitucionit është paraqitja në kohë e faturave për të mos krijuar detyrime të prapambetura.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i

kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra shumica e urdhër shpenzimeve janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i ulët i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 5%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e parë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 25 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë të mirë të bashkisë Delvinë në këtë drejtim.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2016, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë. Përformanca e këtij indikator për vitin 2016 është rritur në mënyrë të ndjeshme me 20 pikë duke përmirësuar rankimin e institucionit.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Delvinë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.5pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 2.5 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 3.14 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi janë vlerësuar me 3.33 pikë dhe 3.25 pikë, duke grumbulluar respektivishtnga 20pikë secila.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare. Në fushën e menaxhimit të riskut duhet të ndërmerren aktivitete konkrete për ta bërë funksional sistemin e menaxhimit të riskut, mbasi bazuar në pyetësorin e vetëvlerësimit rezulton që nuk janë deleguar disa detyra të koordinatorit të riskut tek një punonjës i strukturës së financës apo elementë të tjerë që lidhen me menaxhimin e risqeve të jenë funksional.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Has për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe pesë treguesve që lidhen me komponentët e MFK.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Has është vlerësuar me 220 pikë nga 300 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e katërt. Bashkisë Has për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016, që ishtë në vendin e dytë në rankim, paraqitet me rënie në treguesin e performancës me 30 pikë kryesisht në treguesit e thesarit.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 64. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Has

Bashkia Has	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	0%	25	3.9%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	2%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	5	64%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
39. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	20	3	20	3

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 3.9% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të mirë të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 25 pikë maksimale të mundshme.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i

kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të lartë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 2%, ndaj vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e kënaqshme në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër i ulët i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 64%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e pestë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 5 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë jo të mirë të bashkisë Has në këtë drejtim. Performanca e këtij treguesi në vitin 2017 kundrejt vitit 2016 eshtë përkeqësuar me 25 pikë duke ndikuar direkt në rënien e rankimit të institucionit
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Has, të gjithë komponentët janë vlerësuar respektivisht me nga 3.06 pikë, 2.83 pikë, 2.86 pikë, 3.33 pikë dhe 2.75 pikë, duke marrë nga 20 pikë secili komponent.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, në kuadër të përmirësimit të të gjithë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Vlen të theksohet se vlerësimi i pyetësorit për vitin 2017 është me të njëjtët tregues të vlerësimit si dhe pyetësori i vitit 2016, që sipas gjykimit tonë pyetësori i vitit 2017 nuk ka qënë objekt vlerësimi real.

<u>Monitorimi i Performancës për Bashkinë Këlcyrë për vitin 2017</u>

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe pesë treguesve që lidhen me komponentët e MFK.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Këlcyrë është vlerësuar me 190 pikë nga 300 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë jo të kënaqshme të kësaj bashkie, e cila është renditur në vendin e tetë. Bashkia Këlcyrë për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016, që ishtë në të njëjtën rankim në vendin e tetë, paraqitet me rënie në treguesin e performancës me 15 pikë.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 65. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Këlcyrë

Bashkia Këlcyrë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	0.24%	15	15.4%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	15	11.1%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0.3%	30	2%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	15	13%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	
8. Aktivitetet e kontrollit	10	2	10	
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	
10. Monitorimi	10	2	10	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 15.4% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë. Ky tregues ne krahasim me vitin 2016 është në rënie me 15 pikë, duke ndikuar në renditjen e institucionit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë Këlcyrë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, kundrejt 11.1% në vitin 2016, që tregon një performancë në rritje të këtij treuesi, i cili vlerësohet me 30.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në

përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 2%, ndaj vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer në këtë drejtim.

4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër relativisht i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është13%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e tretë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 15 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë jo të kënaqshme të bashkisë Këlcyrë për këtë tregues.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Këlcyrë, komponenti i mjedisit të kontrollit dhe informim komunikimi janë vlerësuar mesatarisht me nga 2.56 pikë dhe 3 pikë respektivisht duke marrë 20 pikë secili, sipas vlerësimit të metodologjisë së monitorimit të performancës. Ndërsa, komponentët e menaxhimit të riskut, aktiviteteve të kontrollit dhe monitorimit janë vlerësuar respektivisht me nga 1.5 pikë, 2.43 pikë dhe 2.25 pikë, duke marrë nga 10 pikë secili.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele jo të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, në kuadër të përmirësimit të të gjithë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, kryesisht të menaxhimit të riskut, i cili sipas pyetësorit të vetëvlerësimit tregon se në bashki nuk është ndërmarrë asnjë hap për zhvillimin e sistemit të menaxhimit të riskut.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Konispol për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe pesë treguesve që lidhen me komponentët e MFK.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Konispol është vlerësuar me 225 pikë nga 300 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe është renditur në vendin e tretë. Bashka Konispol në vitin 2017 ka rënie në performancën e vet me 30 pikë kundrejt vitit 2016, që ishte në vendin e parë, kryesisht në treguesit e thesarit.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 66. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Konispol

Bashkia Konispol	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	8%	15	10%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0.6%	0	100%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	30	4	30	4

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 10% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1%, ndaj vlerësimi për këtë

indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer në këtë drejtim.

4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër shumë i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 100%, që tregon se të gjitha kontratat e lidhura nuk janë paraqitur në kohë, duke pasqyruar një përformancë jo të mirë të institucionit duke u vlerësuar me 0 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Konispol, komponenti i mjedisit të kontrollit dhe monitorimit janë vlerësuar respektivisht me nga 3.69 pikë dhe 3.5 pikë, duke marrë secili nga 30 pikë. Ndërsa, komponentët e menaxhimit të riskut, aktiviteteve të kontrollit dhe informimit dhe komunikimit janë vlerësuar respektivisht me nga 3.17 pikë, 2.57 pikë dhe 3.17 pikë, duke marrë nga 20 pikë secili komponent.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, në kuadër të përmirësimit të komponentit të menaxhimit të riskut, aktiviteteve të kontrollit dhe informimit dhe komunikimit, të cilët janë vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Kurbin për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe pesë treguesve që lidhen me komponentët e MFK.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Kurbin është vlerësuar me 205 pikë nga 300 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e tetë.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 67. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Kurbin

Bashkia Kurbin	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	10	26.3%	15	23.6%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0.6%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	5	67%	0	83%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4
10. Monitorimi	20	3	20	3

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 23.6% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, ndaj vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër shumë i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e

përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 83%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e fundit të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 0 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë të dobët të bashkisë Kurbin në këtë drejtim. Performanca e këtij treguesi paraqitet me përkeqësim kundrejt vitit 2016.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Kurbin, komponenti i mjedisit të kontrollit, aktiviteteve të kontrollit dhe monitorimit janë vlerësuar respektivisht me nga 3.31 pikë, 3.14 pikë dhe 3.25 pikë, duke marrë secili nga 20 pikë. Ndërsa, komponenti i menaxhimit të riskut është vlerësuar me vetëm 10 pikë, duke qënë se ka pasur një vetëvlerësim të ulët 2. Komponenti i Informimit dhe Komunikimit është vlerësuar maksimalisht me 30 pikë 3.5.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave të mëtëjshme për përmirësime në komponentët eaktiviteteve të kontrollit, mjedisit të kontrollit dhe monitorimit. Përsa i përket komponentit të menaxhimit të riskut i cili është në kufij minimal vlerësimi. Pra, bazuar në pyetësorin e vetëvlerësimit rezulton të jetë i pazhvilluar si sistem, ku detyrat e koordinatorit të riskut nuk janë deleguar tek një punonjës i drejtorisë së financës dhe nuk është përgatitur një strategji risku si dhe të dokumentit të risqeve.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Peqin për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe pesë treguesve që lidhen me komponentët e MFK.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Peqin është vlerësuar me 150 pikë nga 300 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të dobët të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e nëntë në grupin e bashkive që nuk kanë njësi auditimi. Gjithashtu, theksojmë se performanca e kësaj bashkie ka qënë në të njëjtën nivel dhe në vitin 2016 me rritje të vogël prej 5 pikë. Pothuajse të gjithë indikatorët që lidhen me thesarin paraqiten me një performancë jo të kënaqshme, e njëjta gjë është dhe për komponentët e kontrollit të brendshëm.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 68. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Peqin

Bashkia Peqin	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	10	37%	10	44%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0.02%	25	5%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	25	4.2%	15	6.3%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	5	57.1%	0	100%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	5	68%	10	34%
6. Mjedisi i kontrollit	10	2	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	10	2	20	3

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 44% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të ulët të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 10 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 5%, çka flet për një nivel të mirë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 25 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 6.3%, ndaj vlerësimi për këtë indikator është me 15 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë mesatare për këtë indikator..
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër shumë i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e

përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 100%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e gjashtë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 0 pikë. Ky tregues në krahasim me vitin 2016 nuk ka njohur rritje por është përkeqësuar dhe më shumë. Bashkia duhet të analizojë faktorët e këtij rezultati dhe marrë masa për përmirësim,

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 34%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 10 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Peqin, komponenti i mjedisit të kontrollit, aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi si dhe monitorimi janë vlerësuar respektivisht me nga 2.5 pikë, 2.57 pikë, 3.33 pikë dhe 2.25 pikë, duke marrë secili nga 20 pikë. Komponenti i menaxhimit të riskut ka pasur një vetëvlerësim të barabartë me 1.67 pikë dhe është vlerësuar sipas metodologjisë së monitorimit të performancës me 10 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar sidomos nevojën zhvillimin e mjeteve të kontrollit të brendshëm për përmirësimin e elementëve të kontrollit të brendshëm në bashki. Menaxhimi i riskut, si një ndër komponentët e rëndësishëm të kontrollit të brendshëm, është totalisht i pazhvilluar. Kështu, fokusi i punës së institucionit duhet të jetë ngritja dhe funksionimi i menaxhimit të riskut.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Përmet për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe pesë treguesve që lidhen me komponentët e MFK.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Përmet është vlerësuar me 200 pikë nga 300 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e shtatë kundrejt vendit të gjashtë në vitin 2016 me rënie në performance për 20 pikë, kjo kryesisht në treguesit e thesarit, pasi në komponentët e kontrollit të brendshëm është e njëjta performancë e treguesve.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 69. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Përmet

Bashkia Përmet	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	30	1.19%	15	15.4%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	15	5.7%	15	13.5%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	7.1%	10	39.4%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	20	3
10. Monitorimi	20	3	20	3

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 15.4% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Performanca e këtij indikatori është më e ulët në krahasim me vitin 2016, prej 1.19% të faturave të dorëzuara duke u vlerësuar 15 pikësipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publik.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 13.5%, ndaj vlerësimi për këtë indikator është me 15 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë mesatare në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një konsiderueshëm i kontratave të paraqitura me vonesë

në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 39.1%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e katërt të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 10 pikë. Performanca e këtij treguesi paraqitet me përkeqësim kundrejt vitit 2016, në 5 pikë me pak, kurse në perqindje 32% .

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Përmet, komponenti i mjedisit të kontrollit është vlerësuar maksimalisht me 30 pikë. Komponenti i aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe komunikimit si dhe monitorimit janë vlerësuar me 20 pikë, duke marrë respektivisht 2.71 pikë, 3.33 pikë dhe 2.75 pikë. Ndërsa komponenti i cili ka marrë më pak pikë (10pikë) është ai i menaxhimit të riskut, i vetëvlerësuar me 2.17 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar sidomos nevojën për marrjen e masave, kryesisht në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të riskut.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Pukë për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe pesë treguesve që lidhen me komponentët e MFK.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Pukë është vlerësuar me 240 pikë nga 300 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e dytë. Vlerësojmë se ka një përformancë të qëndrueshme në indikatorët e thesarit, ndërsa në indikatorët e buxhetit ka një rënie prej 10 pikësh.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 70. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Pukë

Bashkia Pukë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e	30	0%	30	2%

thesarit				
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	0%	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	30	1%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	20	3
10. Monitorimi	20	3	20	3

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 2% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel shumë të lartë të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 30 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1%, ndaj vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër shumë i ulët i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 1%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e parë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 30 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP),

me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Pukë, Komponenti i mjedisit të kontrollit, aktiviteteve të kontrollit, informimi dhe komunikimi si dhe monitorimit kanë marrë nga 20 pikë secili, duke u vlerësuar respektivisht me nga 3.06 pikë, 3.43 pikë dhe 3.33 pikë si dhe 2.75pikë. Ndërsa menaxhimi i riskut është vlerësuar me vetëm 2.33 pikë, duke marrë 10 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar sidomos nevojën për marrjen e masave, kryesisht në kuadër të ngritjes dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të riskut.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Poliçan për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe pesë treguesve që lidhen me komponentët e MFK.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Poliçan është vlerësuar me 215 pikë nga 300 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të mirë të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e pestë. Vlerësojmë se kemi rënie të performancës së kësaj bashkie në krahasim me vitin 2016 me 30 pikë, kjo kryesisht në treguesit e thesarit.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 71. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Poliçan

Bashkia Poliçan	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	10.16%	15	12.8%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.96%	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%	0	86%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4	30	4

10. Monitorimi	20	3	20	3

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 12.8% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 15 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, ndaj vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër shumë lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 86%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e gjashtë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 0 pikë. Performanca e këtij treguesi është përkeqësuar ndjeshëm duke ndikuar në uljen e nivelit të renditjes së Bashkisë Poliçan
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Poliçan, përveç komponentit të informimit dhe komunikimi, të gjithë komponentët e tjerë kanë marrë nga 20 pikë secili, duke u vlerësuar respektivisht me nga 3.44 pikë, 2.67 pikë, 3.14 pikë dhe 3 pikë. Informimi dhe komunikimi është komponenti, i cili është vlerësuar maksimalisht, pra 30 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar sidomos nevojën për marrjen e masave, kryesisht në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të riskut, i cili është vlerësuar më pak se të tjerët.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Rrogozhinë për vitin 2017

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për Bashkitë për vitin 2017, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015.

Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e pesë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore si dhe pesë treguesve që lidhen me komponentët e MFK.

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Rrogozhinë është vlerësuar me 100 pikë nga 300 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë jo të mirë të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e dhjetë nga grupi i bashkive që nuk kanë njësi auditimi. Vlerësojmë se performanca e kësaj bashkie është përkeqësuar më shumë në krahasim me vitin 2016, duke pësuar rënie në pikëzim (50 pikë) si në treguesit e thesarit ashtu dhe në komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 72. Vlerësimi i Indikatorëve për Bashkinë Rrogozhinë

Bashkia Rrogozhinë	Pikët/ Viti 2016	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2016	Pikët/ Viti 2017	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse/ Viti 2017
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	10	37.9%	10	30.4%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	15	8.33%	15	20%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	30	1.7%	25	2.42%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	5	56.7%	0	90%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	0	99%	0	79%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3	10	2
7. Menaxhimi i Riskut	10	2	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3	10	2
9. Informimi dhe komunikimi	20	3	10	2
10. Monitorimi	20	3	10	2

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2017, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 30.4% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të ulët të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 10 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 20%, çka flet për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 15 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 2.42%, ndaj vlerësimi për këtë indikator është me 25 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2017, ky institucion karakterizohet nga një numër shumë i lartë i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 90%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e fundit të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 0 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike(APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2017, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 79%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 0 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare të grumbulluara, të cilat i përkasin segmentit 1-4 pikë. Për Bashkinë Rrogozhinë, komponenti i mjedisit të kontrollit, menaxhimi i riskut,

aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe komunikimit si dhe monitorimit kanë marrë nga 10 pikë secili, duke u vlerësuar respektivisht me nga 1.88 pikë, 1.5 pikë, 2.29 pikë, 2.33 pikë dhe 2.25 pikë.

Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele aspak të kënaqshme mbasi një pjesë e konsiderueshme e pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit janë në nivelin e 1 pike, që tregon se nuk ekzistojnë elementë të rëndësishëm të kontrollit të brendshëm në Bashki. Prandaj vlerësojmë se nga Bashkia Rrogozhinë duhet të ndërmerren hapa të rëndësishme për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

✓ Monitorimi i Performancës për institucionet e pavarura

Monitorimi i Performancës për Presidencën për vitin 2017

Në bazë të analizës së indikatorëve, Presidenca është vlerësuar me 315 pikë nga 540 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të mirë të këtij institucioni. Në këtë vlerësim sipas metodologjisë së monitorimit të performancës nuk janë të përfshirë të dhënat për indikatorin e thesarit, "Urdhër prokurimet e paautorizuara" dhe për indikatorin e buxhetit, "Shlyerja e detyrimeve të prapambetura". Në këtë analizë indikatorët e auditimit të brendshëm konsiderohen me 0 pikë pasi në këtë institucion nuk është ngritur ende një strukturë për të realizuar funksionin e auditimit të brendshëm dhe gjithashtu nuk është kryer auditim me ndonjë akt marrëveshje. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 73. Vlerësimi i Indikatorëve për Presidencën

Presidenca	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	10	29%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	25	5%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	0	100%
5. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
6. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	30	2%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	11%
8. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	25	3.3%
9. Mjedisi i kontrollit	30	4
10. Menaxhimi i Riskut	30	4
11. Aktivitetet e kontrollit	30	4
12. Informimi dhe komunikimi	30	4
13. Monitorimi	30	4
14. Përgatitja e audituesve të brendshëm	0	
15. Raportimi në kohë i Audituesve	0	
16. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	0	
17. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	0	
18. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	0	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë institucion gjatë vitit 2017 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 29% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të mirë të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë institucion, është 10 pikë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, gjë që tregon për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, vetëm 5% e urdhër-shpenzimeve të Institucionit të Presidentit nuk janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 25 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë të mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2017, për këtë institucion, raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 100%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin më të ulët të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 0 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik

5. Duke u bazuar në raportet e monitorimit që institucionet e pavarura dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Institucioni i Presidentit i ka dorëzuar raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e këtij institucioni i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
6. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit buxhetor. Gjatë vitit 2017, ky institucion ka realizuar 98% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është 2%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë është 30 pikë, çka flet për një performancë shumë të mirë të këtij institucioni.
7. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale** është një indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Buxhetit, i cili evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet

kapitale të planifikuara për vitin analizues. Presidenca ka realizuar rreth 89% të shpenzimeve kapitale të planifikuara, duke evidentuar në këtë mënyrë një nivel mosrealizimi të shpenzimeve kapitale (11%) që është shumë më i lartë se ato korrente (2%). Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 15 pikë, duke qënë se përqindja e mësipërme i përket intervalit të tretë të këtij sistemi vlerësimi.

8. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, shuma e rialokimeve të bëra gjatë vitit 2017 përkundrejt fondeve të miratuara ka qënë 3.3%. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës për këtë institucion është 25 pikë. Ndaj, mund të themi si përfundim që Presidenca ka një performancë të kënaqshme për këtë indikator.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku për çdo komponent janë llogaritur, mbi bazën e pikëve totale të marra dhe numrit të pyetjeve, pikët mesatare, të cilat i përkasin segmentit 0-4 pikë. Për Presidencën, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 4 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Menaxhimi i riskut dhe aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar respektivisht me nga 4 pikë secila, duke marrë 30 pikë secila sipas metodologjisë së monitorimit. Informimi dhe komunikimi si dhe monitorimi kanë marrë gjithashtu mesatarisht 4 pikë secili, duke u vlerësuar maksimalisht me nga 30 pikë secila. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të mira.

Monitorimi i Performancës për Kuvendin për vitin 2017

Në bazë të analizës së indikatorëve, Kuvendi është vlerësuar me 455 pikë nga 540 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë shumë të mirë të këtij institucioni. Në këtë vlerësim sipas metodologjisë së monitorimit të performancës nuk janë të përfshirë të dhënat për indikatorin e thesarit, " Urdhër prokurimet e paautorizuara" dhe për indikatorin e buxhetit, "Shlyerja e detyrimeve të prapambetura". Ky institucion ka njësi auditimi. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2017 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 74. Vlerësimi i Indikatorëve për Kuvendin

Kuvendi	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit	15	13%
2. Numri i kontratave të anuluara gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari	25	5%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	10	48%
5. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
6. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	15	14%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	24%
8. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	0%
9. Mjedisi i kontrollit	30	4
10. Menaxhimi i Riskut	30	4

11. Aktivitetet e kontrollit	30	4
12. Informimi dhe komunikimi	30	4
13. Monitorimi	30	4
14. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
15. Raportimi në kohë i Audituesve	25	
16. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	
17. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
18. Pozicione aktuale të audititmit të brendshëm të paplotësuara	30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë institucion gjatë vitit 2017 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 13% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të mesëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë institucion, është 15 pikë, duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket intervalit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2017, raporti i kontratave të anuluara me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2017, 5% e urdhër-shpenzimet e Kuvendit janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 25 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë të mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2017, për këtë institucion, raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 48%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e katërt të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 10 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Borxhit Publik

5. Duke u bazuar në raportet e monitorimit që institucionet dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Kuvendi i ka dorëzuar raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e këtij institucioni i

përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.

6. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit buxhetor. Gjatë vitit 2017, ky institucion ka realizuar 86% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 14%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë është 15 pikë, çka flet për një performancë të mesme të këtij institucioni.
7. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale** është një indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Buxhetit, i cili evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Kuvendi ka realizuar rreth 76% të shpenzimeve kapitale të planifikuara, duke evidentuar në këtë mënyrë një nivel mosrealizimi të shpenzimeve kapitale prej 24% që është shumë më i lartë se ato korrente (14%).Vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 15 pikë, duke qënë se përqindja e mësipërme i përket intervalit të tretë të këtij sistemi vlerësimi.
8. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, shuma e rialokimeve të bëra gjatë vitit 2017 përkundrejt fondeve të miratuara ka qënë 0%. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës për këtë institucion është 30 pikë. Ndaj, mund të themi si përfundim që Kuvendi ka një performancë të shumë të mirë për këtë indikator.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

